

DUKE ECUR ME KRISHTIN

**Të vërteta transformuese
për jetën e krishterë**



Shtëpia Botuese **T E N D A** Prishtinë 2016

Biblioteka Doktrinë Seria 34

Titulli: Duke ecur me Krishtin

Titulli në origjinal: Walking with Christ

Autori: Grup autorësh

Përktheu: Blerina Jashari

Redaktore: Belkize Cakolli

Editor: Femi Cakolli

Ballina: Fidan Bejtullahu

Realizimi: Albert Zuka

Grafikat: Entrust

Formati: 21 x 29.7 cm.

Shtypi: Printing Press

Tirazhi: 600 kopje

Boton: Shtëpia Botuese TENDA, Prishtinë

Viti i botimit: 2009, 2016

Copyright: © Tenda

ISBN: 978-9951-405-45-4

ISBN: 978-9951-405-6-4

Printed in Kosovo

Katologimi në publikim – CIP: Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

Adresa për kontakte:

Shtëpia Botuese TENDA

Rr. Nazim Gafurri nr. 66 (rruga për Gërmi)

10000 Prishtinë, Kosovë, EU

Tel. 044118088

e-mail: shb_tenda@yahoo.com

www.kishaprotestante-bum.com

Të gjitha të drejtat e këtij botimi në shqip janë të rezervuara dhe i mban Sh. B. “Tenda”. Pa lejen e mëparshme të botuesit asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, depozitohet në një sistem gjurmues apo të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopje, regjistrim apo ndonjë lloj tjetër, me përjashtim të citimeve të shkurtra në rishikime të printuara.

Botuesi origjinal:



Copyright © Entrust (BEE International) 2007

P.O. Box 25520, Colorado Springs, CO 80936-5520, USA

www.entrust4.org

Të gjitha të drejtat e rezervuara, përfshirë këtu edhe përkthimin.

Teksti i librit *Duke Ecur me Krishtin* mund të citohet dhe/apo të riprodhohet deri në 1000 fjalë pa leje të shkrimit nga ana e Entrust-it. Ju lutemi të kontaktoni Entrust-in (indo@entrust4.org) për leje për citim, huazim, riprodhim, përkthim apo transmetim të pjesëve më të mëdha.

Përmbajtja

Parathënie.....	7
Hyrje në kurs.....	9
Mësimi 1 – Krishti: Themeli ynë i fortë	15
Çfarë nënkupton të jesh i krishterë?.....	16
Të jetosh jetën e krishterë	27
Mendime përmbyllëse	32
Mësimi 2 – Burimet tona mbinatyrore	35
Jeta jonë para Krishtit	37
Jeta jonë e re në Krishtin.....	38
Burimet tona të reja	43
Mendime përmbyllëse.....	55
Mësimi 3 – Duke i ngjarë më shumë Krishtit	57
Rritja drejt pjekurisë është normë	58
Shtegu drejt pjekurisë	59
Procesi i rritjes dhe transformimit të besimtarit	64
Përcaktimi i karakteristikave të pjekurisë	73
Mendime përmbyllëse	77
Mësimi 4 – Ushqimi ynë i përditshëm: Fjala e Perëndisë	79
Ta njohësh Perëndinë nëpërmjet Fjalës së Tij	81
Qëllimi i Fjalës së Perëndisë	83
Fryma e Shenjtë dhe Fjala	85
Përfitimet e Fjalës	87
Duke u thelluar në Fjalën e Perëndisë	88
Ndërto në shkëmbin e fortë	93
Mendime përmbyllëse	99

Mësimi 5 – Komunikimi me Perëndinë në Lutje	101
Lutja është lidhja jonë personale me Perëndinë	102
Lutja është privilegji ynë i madh për të pasur qasje me Perëndinë.....	104
Si duhet të lutemi?	107
Pengesat në lutje	115
Kur Perëndia thotë ‘jo’.....	118
Kur nuk mund të lutemi	118
Qëndrimet që Perëndisë i pëlqejnë kur ne lutemi	120
Një përkushtim për t’u lutur	122
Mendime përmbyllëse.....	122
 Mësimi 6 – Duke jetuar me anë të besimit.....	 125
Çfarë është besimi?	127
Duke mësuar t’i besojmë Perëndisë	133
Testi i besimit.....	135
Besimi dhe dyshimi.....	141
Shpërblimi i besimit.....	142
Mendime përmbyllëse.....	144
 Mësimi 7 – Duke ecur me Drejtuesin tonë.....	 147
Premtimi i udhëheqjes.....	148
Mjetet e udhëheqjes	149
Kushtet e pranimit të udhëheqjes	159
Kur mungon udhëheqja	162
Pyetje rreth udhëheqjes	162
Roli i zgjedhjes	165
Hapat për të njohur vullnetin e Perëndisë	167
Mendime përmbyllëse.....	168
 Mësimi 8 – Duke jetuar si administratorë të Perëndisë	 171
E kujt është jeta?	172
Të krijuar për të qenë administratorë të Perëndisë	173
Kuptimi i administrimit	174
Administrimi i burimeve materiale.....	175
Kujdesi për trupat tonë	182
Kujdesi ndaj dhuntive dhe aftësive	184

Administrimi i përvojave jetësore	185
Administrimi i kohës	187
Administrimi: Përshkrimi ynë i punës	192
Mësimi 9 – Ta kuptosh vuajtjen	195
Perspektivat biblike mbi vuajtjen	197
Gjashtë qëllimet e vuajtjes	201
Reagimi ynë ndaj vuajtjes	210
Mendime përmbyllëse.....	214
Mësimi 10 – Jeta në familje.....	217
Bashkësia e besimtarëve	218
Karakteristikat e jetës në familje.....	225
Përgjegjësitë tona në familje	232
Mendime përmbyllëse.....	237
Shtojcë: Një qasje biblike për zgjidhjen e konfliktit në mesin e besimtarëve	241
Mësimi 11 – Një jetë e shërbesës.....	245
Të shërbyerit: Platforma për shërbesë.....	246
Shërbesa: Përgjegjësia e çdo besimtari	249
Fokusi i shërbesës	254
Forca për shërbesë	264
Mendime përmbyllëse.....	265
Mësimi 12 – Përfundimi i garës	269
Përgatitja për vrapim	270
Duke i mbajtur sytë tonë drejt qëllimit	271
Duke lënë anash çdo ngarkesë	272
Jeta e ushtarit.....	278
Duke vrapuar me qëndrueshmëri	284
Përmbledhje e kursit	289

Parathënie

Të dashur,

Po u sjellim një botim të veçantë për katër arsye. E para, se kjo seri që ka katër libra u kushtohet posaçërisht femrave të krishtera gjë që nuk kemi bërë më parë si botues. E dyta është se kjo seri po publikohet në shenjë të shënimit të 200 vjetorit të Lëvizjes Protestante mes shqiptarëve. E treta, kjo seri po botohet me ndihmën e programit **Entrust** dhe mbështetjen e Christian and Mission Alliance (CMA) të Kosovës në krye me motrën Melissa Singfiel. E katërta, kjo seri mëson çdo vajzë shqiptare, çdo grua a nënë shqiptare se si ta studiojë Biblën në grup dhe vetë në shtëpi, dhe tërë kursi është ndërtuar rreth këtyre metodave: leximi i Shkrimit, Vëzhgimi, Interpretimi dhe Zbatimi.

Kurset janë këto: **Duke ecur me Krishtin** – të vërteta transformuese për jetën e krishterë; **Besueshmëria** – trajnim për drejtueset; **Studim mbi Zbulimin e Biblës** – udhëzues për drejtueset; **Studim mbi Zbulimin e Biblës** – udhëzues për studentet.

Libri “Duke ecur me Krishtin” me nëntitullin “të vërtetat transformuese për jetën e krishterë” vjen në Kosovë si një nevojë për studimin e Shkrimit. *Duke ecur me Krishtin* është dizajnuar për të të inkurajuar në jetën tënde me Krishtin. Qëllimi kryesor në studimin e një kursi të tillë është zhvillimi i një marrëdhënieje më të thellë dhe më intime me Perëndinë: ta njohim Atë më mirë dhe ta duam Atë më shumë. Një kuptim më i qartë i veprës së Jezus Krishtit në shpëtimin tonë dhe rritjen tonë shpirtërore është esenciale për çdo besimtar. Kursi fillon me vënien e këtij themeli. Më tutje, hulumton veprën e larmishme të Frymës së Shenjtë në jetën e besimtarit. Teksa rritemi dhe i kuptojmë këto të vërteta, ne do të rritemi në dashurinë tonë për Perëndinë dhe dëshirën tonë për ta nderuar Atë dhe për t’i shërbyer Atij.

Dy tema kryesore që theksohen përgjatë këtij kursi janë rëndësia e Fjalës së Perëndisë dhe lutja. Bibla është burimi qendror prej të cilit Fryma e Perëndisë na flet neve dhe i frymëzon jetët tona. Qëllimi i këtij kursi është që të shtohet apetiti yt për Fjalën e Perëndisë dhe të njoftohesh me disa aftësi bazike që janë të nevojshme për të ushqyer vetveten me Fjalën e Perëndisë në mënyrën e duhur dhe të vazhdueshme. Përderisa Perëndia komunikoi me ne nëpërmjet mjeteve të Shkrimit, ne gjithashtu kemi privilegjin që të komunikojmë me Të nëpërmjet lutjes. Ky kurs ofron mësim praktik rreth lutjes si dhe inkurajim për të zhvilluar një jetë më të qëndrueshme të lutjes. Të dëgjuarit e zërit të Perëndisë nëpërmjet Shkrimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me Të e formojnë kornizën e marrëdhënies personale të besimtarit me Perëndinë.

Një theks tjetër kyç në kurs vihet mbi rritjen drejt pjekurisë dhe karakterin e perëndishmërisë. Çdo mësim është i dizajnuar për të të motivuar ty që të mendosh se si ta zhvillosh karakterin e perëndishmërisë dhe të të inkurajojë ty që ta vesh në praktikë të vërtetën, e cila të shpie drejt rritjes shpirtërore. Ne shpesh flasim në lidhje me ngjasimin në Krishtin, perëndishmërinë, dhe shëmbëllimin me Krishtin. Brenda këtyre koncepteve

është jeta e vetë Krishtit dhe mënyra e përsosur se si Ai përdori kapacitetet e Tij të Perëndisë dhe ato njerëzore që gjithnjë të shkoj drejt njohurisë, drejtësisë, shenjtërisë, dhe mbi të gjitha, dashurisë. Për shkak se ne jemi krijuar në shëmbëlltyrën e Perëndisë, ne kemi kapacitete të njëjta për të lëvizur drejt këtyre cilësive të karakterit të perëndishmërisë e që reflektojnë imazhin dhe karakterin e Krishtit.

Si shtesë, ky kurs përpiket të ofrojë një kuptim të freskët dhe biblik të temave kyçe të cilat janë themelore në jetën e besimtarit. Hulumton pyetje në lidhje me temat rreth besimit, udhëheqjes, udhëheqjes së Krishtit, shërbesës për Perëndinë dhe të tjera. Pyetjet përdoren për ta drejtuar studentin në disa pasazhe kyçe biblike të cilat lidhen me këto çështje, për ta inkurajuar studentin që të mendojë më tepër në lidhje me këto çështje, dhe gjithashtu t'i aplikojë ato në jetën personale.

Gjithashtu do t'i lihet hapësirë edhe motivimit të besimtarit për t'i ecur vetë shtigjet e jetës me Krishtin. Do të trajtohen gjithashtu realiteti i parajsës dhe botës që do të vijë, ashtu siç janë edhe realiteti i Satanit dhe shumë taktikave të tij të dizajnuara për të na penguar neve që të mos ecim me Krishtin. Ky kurs ka për qëllim që t'i ndihmojë studentët që të rriten në maturi dhe besnikëri, teksa përdoren burimet që Perëndia na ka ofruar për të jetuar jetën e Krishterë.

Falënderoj të gjithë ata që kanë punuar në këtë projekt për disa vjet jo vetëm duke e mbikëqyrur dhe drejtuar (Melissa Singfiel), duke e përkthyer (Blerina Jashari – Zyrapi), duke e redaktuar (Belkize Cakolli, gruaja e ime). Falënderoj po ashtu Fidan Bejtullahun për punën lidhur me dizajnin, sikurse edhe Jeff Singiel për mbështetjen e këtij projekti në cilësinë e drejtuesit të CMA për Kosovë.

Pastor Femi Cakolli, editor

Tetor 2016 Prishtinë

Në shenjë të 200 vjetorit të Lëvizjes Protestante mes shqiptarëve

Hyrje në kurs

Duke ecur me Krishtin është dizajnuar për të të inkurajuar ty në jetën tënde të krishterë duke të prezantuar të vërteta që janë transformuese. Në këtë kurs ti do të mësosh se si të mbështetesh vërtetë në Jezus Krishtin çdo ditë të jetës tënde. Besimi në personin e Krishtit për shpëtimin tonë është hapi i parë i besimit që ne hedhim në shtegun që quhet Jetë e Krishterë. Ky hap i parë ndiqet nga shumë hapa tjerë të besimit teksa ne e thellojmë besimin tonë në Perëndinë dhe Fjalën e Tij

Kur mendojmë për fjalën “ecje” ne mendojmë për një lëvizje apo shkuarje në një drejtim të caktuar. Në Bibël akti fizik i të ecurit ka gjithashtu kuptim shpirtëror. Të ecurit përfaqëson tërë gjerësinë e aktivitetit njerëzor apo të gjitha mënyrat e jetesës apo sjelljes së një personi. Bibla shpesh e krahason mënyrën se si besimtarët dhe jobesimtarët “ecin”, duke potencuar se jeta dhe sjellja e besimtarit duhet të jenë plotësisht të dallueshme nga ato të një jobesimtari. Si ndodhin këto ndryshime në ne? Si bëhemi më shumë si Krishti? Ne do t’i hulumtojmë këto pyetje më shumë së bashku në këtë kurs.

Kur ne ecim, ne duhet t’i lëvizim këmbët dhe ta lëmë vendin ku kemi qenë duke qëndruar në mënyrë që të lëvizim përpara. E njëjta gjë është edhe në jetën e Krishterë; ne jemi të ftuar që t’i lëvizim këmbët tona, ta lëmë mbrapa vendin ku kemi qenë duke qëndruar, dhe të ecim mbi shtegun që shtrihet para nesh.

Teksa ecim, çdo hap na shpie më pranë destinacionit tonë. E njëjta gjë është edhe me ecjen tonë të përditshme me Krishtin; ne përparojmë gradualisht drejt qëllimit për t’i ngjasuar më shumë Atij. Nëse diku gjatë rrugës pengohemi, ne nuk kemi pse kthehemi ne fillim për të filluar sërish udhëtimin tonë. Krishti është aty për të na ngritur dhe për të na ndihmuar që të ecim përpara.

Kur fillojmë këtë udhëtim me Krishtin, nuk e dimë se ku do të na shpie. Rruga është e panjohur. Mirëpo, ne e kemi sigurinë se Ai do të ec skaj nesh në çdo hap të rrugës. Teksa e studioni këtë kurs, uroj që të inkurajoheni për të hedhur hapin, duke lënë mbrapa jush vendin ku keni qenë, dhe të vendosni dorën tuaj në dorën e Shpëtimtarit, i cili të fton që të ecësh me Të.

Përshkrim i kursit

Duke ecur me Krishtin është dizajnuar për të të inkurajuar në jetën tënde me Krishtin. Qëllimi kryesor në studimin e një kursi të tillë është zhvillimi i një marrëdhënieje më të thellë dhe më intime me Perëndinë: ta njohim Atë më mirë dhe ta duam Atë më shumë. Një kuptim më i qartë i veprës së Jezus Krishtit në shpëtimin tonë dhe rritjen tonë shpirtërore është esenciale për çdo besimtar. Kursi fillon me vënien e këtij themeli. Më

tutje, hulumton veprën e larmishme të Frymës së Shenjtë në jetën e besimtarit. Teksa rritemi dhe i kuptojmë këto të vërteta, ne do të rritemi në dashurinë tonë për Perëndinë dhe dëshirën tonë për ta nderuar Atë dhe për t'i shërbyer Atij.

Dy tema kryesore që theksohen përgjatë këtij kursi janë rëndësia e Fjalës së Perëndisë dhe lutja. Bibla është burimi qendror prej të cilit Fryma e Perëndisë na flet neve dhe i frymëzon jetët tona. Qëllimi i këtij kursi është që të shtohet apetiti yt për Fjalën e Perëndisë dhe të njoftohesh me disa aftësi bazike që janë të nevojshme për të ushqyer vetveten me Fjalën e Perëndisë në mënyrën e duhur dhe të vazhdueshme.

Përderisa Perëndia komunikon me ne nëpërmjet mjeteve të Shkrimit, ne gjithashtu kemi privilegjin që të komunikojmë me Të nëpërmjet lutjes. Ky kurs ofron mësim praktik rreth lutjes si dhe inkurajim për të zhvilluar një jetë më të qëndrueshme të lutjes. Të dëgjuarit e zërit të Perëndisë nëpërmjet Shkrimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me Të e formojnë kornizën e marrëdhënies personale të besimtarit me Perëndinë.

Një theks tjetër kyç në kurs vihet mbi rritjen drejt pjekurisë dhe karakterin e perëndishmërisë. Çdo mësim është i dizajnuar për të të motivuar ty që të mendosh se si ta zhvillosh karakterin e perëndishmërisë dhe të të inkurajojë ty që ta vesh në praktikë të vërtetën, e cila të shpjet drejt rritjes shpirtërore.

Ne shpesh flasim në lidhje me ngjasimin në Krishtin, perëndishmërinë, dhe shëmbëllimin me Krishtin. Brenda këtyre koncepteve është jeta e vetë Krishtit dhe mënyra e përsosur se si Ai përdori kapacitetet e Tij të Perëndisë dhe ato njerëzore që gjithnjë të shkoj drejt njohurisë, drejtësisë, shenjtërisë, dhe mbi të gjitha, dashurisë. Për shkak se ne jemi krijuar në shëmbëlltërinë e Perëndisë, ne kemi kapacitete të njëjta për të lëvizur drejt këtyre cilësive të karakterit të perëndishmërisë e që reflektojnë imazhin dhe karakterin e Krishtit.

Si shtesë, ky kurs përpaket të ofrojë një kuptim të freskët dhe biblik të temave kyçe të cilat janë themelore në jetën e besimtarit. Hulumton pyetje në lidhje me temat rreth besimit, udhëheqjes, udhëheqjes së Krishtit, shërbesës për Perëndinë dhe të tjera. Pyetjet përdoren për ta drejtuar studentin në disa pasazhe kyçe biblike të cilat lidhen me këto çështje, për ta inkurajuar studentin që të mendojë më tepër në lidhje me këto çështje, dhe gjithashtu t'i aplikojë ato në jetën personale.

Gjithashtu do t'i lihet hapësirë edhe motivimit të besimtarit për t'i ecur vetë shtigjet e jetës me Krishtin. Do të trajtohen gjithashtu realiteti i parajsës dhe botës që do të vijë, ashtu siç janë edhe realiteti i Satanit dhe shumë taktikave të tij të dizajnuara për të na penguar neve që të mos ecim me Krishtin. Ky kurs ka për qëllim që t'i ndihmojë studentët që të rriten në maturi dhe besnikëri, teksa përdoren burimet që Perëndia na ka ofruar për të jetuar jetën e Krishterë.

Kontributet për të zhvilluar karakterin

Kur ne e lejojmë Frymën e Shenjtë për t'i drejtuar jetët tona, rezultati do të jetë rritja në karakterin e perëndishëm. Çdo mësim në këtë kurs përfshinë pyetje për të inkurajuar ty që ta hulumtosh jetën tënde, për të bërë zgjedhje të perëndishme, dhe për të parë se si përgjigjesh ndaj Frymës së Shenjtë. Mësimi 3 fokusohet në mënyrë më specifike mbi zhvillimin e karakterit të perëndishëm si një rezultat i marrëdhënies së besimtarit me Krishtin.

Kontributet për të kërkuar aftësitë për të shërbyer

Disa aftësi të shërbesës lidhen me këtë kurs. Hapat fillestarë prezantohen për aftësitë e shërbesës si në vijim, dhe gjithashtu këtu jepen edhe mundësitë për zhvillimin e këtyre aftësive.

Ungjillëzimi. Kursi ofron një shpjegim të qartë të Ungjillit dhe kërkon nga studenti që të ketë mundësi ta artikulojë ungjillin. Studenti inkurajohet të mendojë për çështje që janë themelore për ungjillin dhe të dallojë çështjet që janë periferike, si dhe ato që janë nga natyra kulturore dhe jo biblike. Kursi ju sfidon juve që të përgjigjeni ndaj Urdhërimit të Madh të Krishtit dhe të bëni dishepuj nga të gjitha kombet, si dhe sugjeron mënyra praktike se si ju mund të filloni ta bëni këtë aty ku jeni. Juve ju kërkohet që ta ndani besimin tuaj në një ballafaqim personal dhe inkurajoheni që të zhvilloni marrëdhënie të cilat mund të hapin dyer për kontakte në të ardhmen për ungjillëzim. Ungjillëzimi diskutohet në një kontekst më të gjerë në lidhje me ndikimin tuaj tek njerëzit që të rrethojnë.

Dishepullimi. *Duke ecuar me Krishtin* në vetvete është një libër mbi dishepullimin. Juve ju prezantohen koncepte kyçe që janë themelore për çdo besimtar për të jetuar si një dishepull i Krishtit, si dhe aplikime personale dhe detyra të dobishme në lidhje me dishepullimin. Nëse punoni gjatë këtij kursi me përkushtim, ju do të kuptoni se çfarë do të thotë të jesh një dishepull i Krishtit, gjithashtu do të fitoni disa mjete të dobishme që do të mund t'ua kaloni atyre që jeni duke i dishepulluar.

Kontributet në zhvillimin e marrëdhënieve

Ky kurs ju inkurajon të mendoni për rëndësinë e marrëdhënieve, duke filluar nga marrëdhënia juaj me Perëndinë, dhe duke u zgjeruar në marrëdhënien tuaj me familjen, miqtë, besimtarët e tjerë, dhe botën rreth jush. Reflektimet personale janë të dizajnuara në atë mënyrë që të të inkurajojnë ty për të marrë në konsideratë efektet e sjelljes tuaj dhe zgjedhjet e juaja në lidhje me të tjerët, si dhe si të zhvillohesh në fushat e përkujdesit, dashurisë, dhe shërbimit ndaj të tjerëve. Ndihma i jepet studentit në formë të mësimi praktik në fushat që ndërlidhen me zhvillimin e marrëdhënieve, siç janë aftësitë e komunikimit, falja dhe zgjidhja e konfliktit.

Marrëdhënia me shërbëtorët drejtues

Duke ecur me Krishtin e paraqet Jezus Krishtin si shembullin tonë më të lartë të asaj se çfarë do të thotë të jesh një shërbëtor-drejtues dhe e thërret çdo student që të ketë një marrëdhënie më të ngushtë me Të. Shumë detyra kërkojnë nga studenti që të ekzaminojnë modelin e Krishtit, si dhe modelet e burrave dhe grave të tjera të perëndishme. Teksa studentët zhvillohen në karakter si Krishti, rezultati i kësaj ecje të ngushtë me Jezusin do të jetë një rrjedhë e natyrshme e dashurisë dhe shërbimit ndaj të tjerëve.

Detyrat e kursit

1. Zgjidhni një pasazh për studim. Duke përdorur një metodë të thjeshtë për studimin e Biblës, identifikoj temën kryesore dhe të vërtetën kryesore që komunikohet në pasazh. Mbaj shënim për gjërat që ke mësuar gjatë studimit të këtij pasazhi.
2. Bëjë një plan që do të ndihmojë të rritesh në fushat e jetës tënde të krishterë teksa i merr në konsideratë aspektet në vijim të jetës tënde si një dishepull: kalim i kohës në leximin e Fjalës dhe në lutje, përkujdesje, përfshirje në bashkësi dhe shërbesë, dhe ndarje e besimit tuaj. Gjej një të krishterë të matur i cili do të inkurajojë që të rritesh në këto fusha.
3. Zgjedh një fushë të shërbesës që ndërlidhet me ungjillëzimin apo dishepullimin dhe merr pjesë në këtë shërbesë. Pasi ta mbarosh, shkruaj një përmbledhje në një faqe, ku do të përshkruash shërbesën dhe përfshirjen tënde, dhe vlerëso përvojën tënde.

Përmbledhje e kursit

Mësimi 1 – Krishti: Themeli ynë i fortë

Mësimi 2 – Burimet tona mbinatyrore

Mësimi 3 – Duke i ngjarë më shumë Krishtit

Mësimi 4 – Ushqimi ynë i përditshëm: Fjala e Perëndisë

Mësimi 5 – Komunikimi me Perëndinë në lutje

Mësimi 6 – Duke jetuar me anë të besimit

Mësimi 7 – Duke ecur me Drejtuesin tonë

Mësimi 8 – Duke jetuar si administratorë të Perëndisë

Mësimi 9 – Ta kuptosh vuajtjen

Mësimi 10 – Jeta në familje

Mësimi 11 – Një jetë e shërbesës

Mësimi 12 – Përfundimi i garës

Qëllimet e kursit

Kur ta keni kompletuar këtë kurs ju do të jeni në gjendje që:

1. Të përjetoni një dëshirë të ripërtërirë për të thelluar marrëdhënien tuaj me Perëndinë dhe që të ecni çdo ditë me Krishtin, të mbështeteni në Të për rritjen tuaj në karakterin e Krishtit.
2. Të citoni Shkrime për të shpjeguar esencën e ungjillit dhe se si ne rritemi si të krishterë
3. Të zhvilloni një plan për t'u rritur në marrëdhënien tuaj me Perëndinë që përfshinë Fjalën, lutjen, përkujdesjen, bashkësinë, dhe shërbimin.
4. Të shpjegoni pse besimi, udhëheqja dhe fjala e Perëndisë janë të rëndësishme për të jetuar jetën e krishterë.
5. Të ndërlidhni rolin e vuajtjes në testimin e besimit tonë me vlerën që vuajtja ka në rritjen tonë shpirtërore.
6. Të mbron thënien që “çdo i krishterë duhet të shërbej” dhe ta arsyetoni rëndësinë e ungjillëzimit ashtu edhe të dishepullizimit.
7. Të vlerësoni rritjen tuaj në karakterin e krishterë gjatë kohës suaj të studimit.
8. Të demonstoni përparimin drejt fitimit të aftësive të shërbesës për të ungjillëzuar dhe dishepulluar nëpërmjet kompletimit të suksesshëm të detyrave të kursit.

Duke ecur me Krishtin në lidhje me tërë kurrikulumin

Duke ecur me Krishtin është i dizajnuar për të qenë kursi themelor i kurrikulumit të Entrust-it, pasi që trajton të vërteta themelore dhe mësim që janë esenciale për çdo besimtar për të jetuar si dishepuj të Krishtit. Mësimi thelbësor jepet në fushat e shpëtimit dhe rritjes në shenjtëri. Të kuptuarit e këtyre të vërtetave do t'ju ndihmojë që të ndërtoni jetën tuaj mbi një shkëmb të fuqishëm. Ne ju rekomandojmë që këtë kurs ta përdorni një pas një me kurset e tjera të Entrust-it.

Ikonat



Detyrë: një pyetje apo studim që fokusohet mbi përmbajtjen e kursit. Përgjigjet me shkrim kërkohen dhe duhet të shënohen në fletoren e studentit.



Reflektime Personale: një udhëzim për të reflektuar mbi të vërtetat e shkrimit apo tipare të karakterit apo të dyja në ndërlidhje me rritjen tonë me Perëndinë. Fokusi është mbi aplikimin personal. Mund të kërkohet një përgjigje me shkrim.



Adhurim: një udhëzim për ta adhuruar Zotin sipas përmbajtjes së kursit. Fokusi është në Perëndinë. Nuk kërkohet ndonjë përgjigje me shkrim.

Krishti: Themeli ynë i fortë

Kur e pyetën Robertin se çfarë mendonte në lidhje me atë se si një njeri mund të shkojë në parajsë apo të ketë jetë të përjetshme, ai u përgjigj: “Mundohu të jetosh një jetë të mirë, ji i mirë me të tjerët, dhe ndihmoju të tjerëve. Ji një person i sinqertë.” Duke iu përgjigjur pyetjes, “A mendon se do të shkosh në parajsë?” ai u përgjigj, “Shpresoj se po. Unë kam bërë më shumë gjëra të mira se sa të këqija në jetën time. Kam dhënë për bamirësi. Nuk e kam vrarë askënd. Mendoj se më shumë se kushdo tjetër unë kam shans për këtë.”



Pikëpamja e Robertit për të arritur në parajsë është një pikëpamje që besohet në masë të gjerë. Teksa e fillojmë këtë kurs mbi jetën e krishterë, ne duam të shikojmë mësimet biblike mbi atë se çfarë do të thotë të jesh një i krishterë dhe se si mund të shikojmë në parajsë. Si bëhet një person i krishterë? Çfarë roli luajnë besimi dhe veprat e mira në jetën e besimtarit? Shpresojmë se ju do të inkurajoheni dhe nxiteni teksa hulumtoni themelin e fortë për besimin tonë nëpërmjet Jezus Krishtit.

Përmbledhje e mësimi

Çfarë do të thotë të jesh një i krishterë?

“Të krishterët” e parë.

Përjetimi i një ballafaqimi personal me Krishtin

Barriera e patejkalueshme

Të kuptuarit e nevojës tonë për një Shpëtimtar

Perëndia siguron shpëtimin tonë

Bazat e shpëtimit tonë

Veçantia e krishterimit

Pranimi i dhuratës së shpëtimit

Po rrugët e tjera për te Perëndia?

Duke jetuar jetën e krishterë

Vazhdimi i jetës së krishterë me besim

Të çliruar për të shërbyer

Mendime përmbyllëse

Qëllimet e mësimit

Kur ta përfundoni këtë mësim, ju do të jeni në gjendje që:

1. Të tregoni çfarë është hiri dhe të shpjegoni rezultatet e hirit në jetën e besimtarit
2. Të shpjegoni se si një njeri bëhet i krishterë, duke përdorur Biblën për t'i shpjeguar pikëpamjet e juaja.
3. Të përshkruani se si një njeri e vazhdon jetën e vetë si i krishterë, duke përfshirë rolin e besimit, veprat e mira, dhe hirin në jetën e besimtarit.
4. Të vlerësoni jetën tuaj duke e kuptuar hirin dhe duke aplikuar këto të vërteta në përvojën tuaj të krishterë.

Çfarë do të thotë të jesh një i krishterë?

Shumë njerëz kanë një ide të paqartë se çfarë do të thotë të jesh i krishterë. Shpesh njerëzit mendojnë se, nëse besojnë në Perëndinë dhe shkojnë në kishë ata janë të krishterë. Çfarë do të thotë të jesh një i krishterë apo të jetosh një jetë të krishterë?



Çfarë ju vije në mendje kur e dëgjoni frazën “jetë e krishterë”?
Shënoni disa nga përshtypjet e juaja të para.

Të “krishterët” e parë

Libri i Veprave të Apostujve përshkruan aktivitetet e dishepujve të Jezusit pas kryqëzimit, ringjalljes dhe ngritjes së Tij në qiell. Tek Veprat e Apostujve 11 ne shohim se si Pali dhe Barnaba takohen me një grup të ri të besimtarëve në Antiok të Sirisë, duke i mësuar dhe duke i thelluar në besimin e tyre. Tek ky takim në Antiok (Turqia e sotshme) dishepujt e Jezusit u quajtën për herë të parë “të krishterë”, që do të thotë “ndjekës të Krishtit”.

Ndoshta i emëruar nga jobesimtarët, termi “i krishterë” shumë shpejtë u bë titulli evident dhe u përdor në masë të gjerë brenda një gjenerate të vetme. Fjala u përdor për ata që demonstuan një përkushtim për ta ndjekur Krishtin. Kur një person jepte dëshmi se besonte në Jezus Krishtin si Shpëtimtar, ai person shoqërohej me vetë emrin e Krishtit.

Të jetosh një jetë të krishterë do të thotë të jesh ndjekës i Krishtit, i lidhur me Krishtin dhe që i takon Atij.

Përjetimi i një ballafaqimi personal me Krishtin

Si bëhet një njeri i krishterë? Për t'u bërë pjesë e familjes së Perëndisë, ne duhet të kemi një ballafaqim personal me Birin e Perëndisë, Jezus Krishtin. Përderisa Jezusi jetoi dhe shërbeu në tokë, Ai u përzije me ta dhe foli me njerëz të çdo niveli shoqëror, prej atyre më të shquarit deri tek ata më të përjashtuarit. Në shumë biseda Jezusi shfaqti se Ai ishte duke i kërkuar ata që dëshironin të dinin se si ta gjenin Perëndinë, dhe Ai dëshironte t'u tregonte atyre se si mund të kishin jetën e përjetshme.

Le t'i hedhim një sy këtyre tri ballafaqimeve.

Ballafaqimi i Jezusit me një krerë fetar: Në Ungjillin e Gjonit ne kemi të regjistruar bisedën e Jezusit me Nikodemin, një krerë i judenjëve. Nikodemi ishte një mësues i respektuar fetar dhe anëtar i këshillit të krerëve në Jerusalem.



Lexo Gjoni 3:1-18. Çfarë na nevojitet që të hymë në mbretërinë e Perëndisë që të kemi jetë të përjetshme?

Ballafaqimi i Jezusit me gruan tek pusi. Menjëherë në kapitullin tjetër, Gjoni kthehet nga Nikodemi, drejtuesi fetar i judenjëve, tek një grua samaritane pa emër. Vendosja e këtyre dy tregimeve njëra pas tjetres sigurisht që nuk është një rastësi, pasi që Gjoni, i frymëzuar nga Fryma e Shenjtë, na tregon kontrastin në mes të udhëheqësit “të drejtë” jude dhe gruas “imorale” samaritane.

Samaritanët dhe hebrenjtë kishin zhvilluar një marrëdhënie të gjatë të urrejtjes në mes tyre, kryesisht për shkak të dallimeve fetare.¹ Si një grua samaritane ajo do të konsiderohej e papastër nga hebrenjtë. Si një grua imorale, ajo do të konsiderohej e përjashtuar nga shoqëria si nga hebrenjtë ashtu edhe nga populli i saj.



Lexoni Gjoni 4:1-30, 39-42 dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim:

1. Si e trajtoi Jezusi këtë grua?
2. Çfarë dinte Ai rreth saj?
3. Çfarë mendoni ju se Ai nënkuptoi me “ujë të gjallë”?
4. Duke e lexuar tregimin, çfarë ndryshime vëreni tek gruaja samaritane?
5. Cili ishte rezultati i dëshmisë së saj në qytet?

Ballafaqimi i gruas samaritane me Jezusin ishte një përvojë jetë-ndryshuese e cila solli falje dhe shpresë për një grua e cila kishte qenë duke kërkuar dashurinë gjatë tërës së saj. Në dashurinë e Perëndisë ajo gjeti atë për çfarë zemra e saj kishte me të vërtetë mall, dhe kështu ajo u transformua nga kjo dashuri.

Ballafaqimi i Jezusit me tagrambledhësin. Në Ungjillin sipas Mateut, dishepulli Mate e kujton mënyrën se si Jezusi e thërriti atë që të bëhet një nga ndjekësit e Tij. Si

një tagrambledhës, Mateu ishte një figurë e urreyer në mesin e judenjëve. Farisenjtë, krerët fetar të asaj kohe që ndiqnin një kod të ashpër të moralit, u ankuan tek dishepujt e Jezusit duke thënë: “Pse mësuesi juaj han me tagrambledhës dhe mëkatarë?” Ata me këtë nënkuptonin se nëse Jezusi ishte një njeri i Perëndisë, Ai do të dëshironte të kishte punë vetëm me ata që jetonin një jetë të mirë dhe të moralshme, për shembull me njerëz siç ishin ata vetë.



Lexoni Mateu 9:9-12 dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim:

1. Çfarë nënkuptoi Jezusi kur iu përgjigj farisenjve në vargun 12?
2. Pse ishte e vështirë për farisenjtë që të bëheshin ndjekës të Krishtit?

Jezusi nuk ishte duke u thënë farisenjve se ata ishin të drejtë në vetvete dhe se nuk kishin nevojë për një Shpëtimtar, mirëpo po potenconte se ata nuk ishin në dijeni se ata ishin mëkatarë. Për këtë arsye, kushti për shpëtim është të kuptosh nevojën personale për të.

Kushti për shpëtim
është të kuptosh
nevojën personale
për të.

Ne i pamë tre ballafaqime në të cilat Jezusi ofroi fjalë ftese për tre njerëz me prapavija të ndryshme: Nikodemi, një krerë i respektuar fetar; gruaja samaritane, një e përjashtuar nga shoqëria dhe morali; dhe Mateu, një biznesmen i pasur jude por edhe i urreyer. Shembulli i Jezusit tregon se të gjithë janë të mirëpritur në mbretërinë e Perëndisë.

Në sytë e Perëndisë nuk ka dallim në mes të hebreut dhe jo-hebreut, në mes të njerëzve fetar dhe ateistëve, në mes të njerëzve shumë të moralshëm dhe atyre shumë të degjeneruar.² **Në fund të fundit, të gjithë qeniet njerëzore bien nën të njëjtën kategori mëkatore.** (Rom 3:22-23). Të tre individët me të cilët u takua Jezusi, kishin dy gjëra të përbashkëta – kushti mëkatar dhe nevoja e tyre për shpëtim. Jezusi u dha secilit prej tyre ofertën e njëjtë të marrëdhënies me Perëndinë. Oferta nuk u kufizua në bazë të grupeve shoqërore, raciale, të nivelit ekonomik apo religjioz. Ajo shtrihej tek të gjithë.



A mendoi se të tre nga këta individë do të ishin të mirëpritur në kishën tuaj? Nëse po pse dhe nëse jo pse?

Nganjëherë njerëzit nuk vijnë në kishë sepse ata ndjejnë se janë shumë mëkatarë dhe se jetët e tyre nuk përkojnë me standardet e Perëndisë. Ata besojnë se kisha është një vend për ata njerëz jetët e të cilëve janë të shenjta, të mira dhe jo për njerëz siç janë ata. Si do të flisnit me njerëz të tillë?

Barriera e patejkalueshme

Edhe pse Nikodemi ishte një mësues i respektuar fetar në Palestinë, ai nuk e kishte kuptuar një të vërtetë shumë të rëndësishme. Ashtu si shumë drejtues jude, ai e kishte zëvendësuar një jetë duke bërë gjëra të mira për Perëndinë, me gjënë e vetme që Perëndia kërkon: besimin në Të. Drejtuesit jude mendonin se duhej të bënin vepra të mira dhe ta mbanin tërë ligjin në mënyrë që t'i pëlqenin Perëndisë. Edhe sot shumë njerëz e kanë po këtë ide. Ata besojnë se ata që jetojnë një jetë të mirë do ta meritojnë parajsën, përderisa ata që nuk jetojnë një jetë të mirë, do të dërgohen në ferr.

Shumë vepra të artit grafikisht e portretizojnë këtë pikëpamje. Në një manastir në Voronezh, Rumani, ekziston një freskë në mur e cila portretizon gjykimin përfundimtar. Në këtë freskë paraqitet një shpirt lakuriq duke u peshuar në një peshore. Nëse çanta e cila përmban veprat e tij të mira nuk është mjaft e rëndë, atëherë ai do të bie nga peshorja në flakët e ferrit, të cilat portretizohen në fund të freskës. Shumë njerëz e kalojnë jetën me këtë besim, duke shpresuar që në fund veprat e tyre të mira do të peshojnë më shumë se sa veprat e këqija, dhe kështu Perëndia do t'i lejoj ata që të hyjnë në parajsë.

Një pikturë tjetër në një kishë në Suceava, Rumani, paraqet një njeri duke u ngjitur nëpërmjet një shkalle për në parajsë. Secila këmbë e shkallës paraqet një virtut të ndryshëm, si durimin, mirësinë, vetë-kontrollin, dhembshurinë. Nëse shket nga njëra prej këtyre këmbëve, atëherë ai do të rrëshqas nga shkalla dhe do të bie në kërkimin e tij për të arritur parajsën.

Këto vepra të artit konceptualizojnë nocionin e përhapur gjerësisht që shpëtimi në fund të fundit vije si rezultat i mundit (veprave) të njerëzve. A është ky këndvështrim i mësuar në Bibël? A është e mundur për ndonjë qenie njerëzore që të balancojë peshoren me veprat e veta të mira?

Që nga faqet e veta të para, Bibla na mëson se ekziston një pengesë e pakalueshme e cila qëndron në rrugën e shpëtimit: problemi i mëkatit. Përderisa Perëndia e krijoi një botë të përkryer dhe i vendosi burrin dhe gruan në të që të shërbejnë si nën-mbretër dhe kujdestar të krijimit tonë, ata zgjodhën një rrugë të mosbindjes dhe rebelimit kundër Perëndisë (Gjen. 2-3).

Mëkati, pengesa e patejkalueshme



Rënia e burrit dhe gruas së parë kishte pasoja gjithëpërfshirëse. Qeniet njerëzore si rezultat iu nënshtruan vdekjes fizike dhe vdekjes shpirtërore (Rom 5:12-21).



Lexo Romakëve 3:9-18, 23. Çfarë mësoni në lidhje me kushtin njerëzor nga perspektiva e Perëndisë?

Ne si qenie njerëzore jemi të lindur me një prirje të keqe për të ecur ndaras dhe për të jetuar të pavarur nga Perëndia. Nga këto dhe pasazhe të tjera ne mësojmë se problemi i mëkatit nuk është një problem i vogël që Perëndia mundet thjesht ta anashkalojë. Ne shpesh kemi tendenca që të shfajësojmë vetveten për ndonjë mëkat në jetën tonë. Ndoshta e keni dëgjuar ndonjë njeri duke e shfajësuar veten me fjalët: “Epo, asnjë njeri nuk është i përsosur.” Perëndia ka një këndvështrim më serioz për mëkatin se sa që kemi ne.

Bibla e përshkruan gjendjen tonë mëkatore duke përdorur terme si “ligësi”, “poshtërsi”, “fëlliqësi” dhe “rebelim kundër Perëndisë.”³ Në fund, mëkati është rebelimi kundër Krijuesit dhe Zotit tonë Sovran dhe një fyerje ndaj shenjtërisë së Tij. Një Perëndi që është shenjtëria absolute nuk mund të vështroj mbi mëkatin.

Për këtë arsye, gjendja jonë mëkatore paraqet një pengesë të patejkalueshme për çdo qenie njerëzore, një pengesë që qëndron në mes Perëndisë dhe nesh. Mëkati ynë ka krijuar një ndasi tepër të madhe në mes të Perëndisë dhe neve. Ne jemi të ndarë nga Ai.

Në librin e Romakëve, Pali na thotë se ne jemi armiq të Perëndisë. Teksa disa mund të mendojnë se është e padrejtë që Perëndia të na fajësojë neve për shkak të zgjedhjes së Adamit dhe Evës, Bibla e bënë të qartë se ne jo vetëm se jemi të lindur me një natyrë mëkatore, mirëpo në mënyrë aktive ne zgjedhim të mëkatojmë dhe të jetojmë jetët tona në mënyrë të pavarur nga Perëndia.

A mund ta tejkalojmë pengesën që na ndanë nga Perëndia me anë të veprave tona të mira?

Romakëve 3:27-28 e vë në pah që asnjë njeri nuk do të shfajësohet (nuk do të deklarohet i drejtë përpara Perëndisë) në bazë të veprave të mira (duke iu bindur ligjit).

Të kuptuarit e nevojës tonë për Shpëtimin

Ne mund t’i krahasojmë përpjekjet tona për ta kënaqur Perëndinë me veprat tona të mira me përpjekjet për ta kaluar oqeanin duke notuar. Një notues i dobët, mund të notojë për disa metra. Një notues i fuqishëm dhe i trajnuar mirë mund të jetë në gjendje të notojë në një distancë bukur të mirë, mirëpo krahasuar me gjerësinë tepër të madhe

Gjendja jonë
mëkatore paraqet
një pengesë të
patejkalueshme ... që
qëndron në mes të
Perëndisë dhe nesh.

të oqeanit, bile edhe kjo distancë është kurrgjë. Edhe notuesi më i fuqishëm në fund do t'i dorëzohet lodhjes dhe do të fundoset nën valë. Dhe kështu është edhe me ne, kur mundohemi ta kënaqim Perëndinë me anë të veprave tona të mira. Ne jemi mjerisht të pamjaftueshëm dhe të dobët, dhe pa as edhe një mundësi më të vogël për të arritur qiellin me anë të përpjekjeve tona.

Në mënyrë që ne t'i përgjigjemi dhuratës së shpëtimit, ne duhet të jemi në dijeni për nevojën që kemi për të. Një shembull mund ta bëjë më të qartë. Imagjinoni sikur jeni të ulur në shtëpinë tuaj, dhe një mik u jep një xhaketë shpëtimit. Sigurisht që ju do të qeshni dhe do ta vendosni diku anash. Tani imagjinoni sikur jeni në një barkë në det, dhe barka po mbushet shumë shpejt me ujë, dhe miku juaj u jep xhaketën e shpëtimit. Teksa barka juaj fundoset, ju do ta merrni xhaketën e shpëtimit me një pasion që nuk ishte i njohur për ju kur ishit të ulur në dhomën e ditës dhe po e soditnit po të njëjtën xhaketë të shpëtimit.

Sapo ta kuptojmë sa e madhe është kjo pengesë që na ndanë neve nga Perëndia dhe se sa e mjerueshme është gjendja jonë, ne me kënaqësi do t'ia zgjasim duart Atij që na ofron ndihmë për të na shpëtuar.

Perëndia siguron shpëtimin tonë

Perëndia në mëshirën e Tij nuk na ka lënë pa një xhaketë shpëtimi. Para themelimit të botës Perëndia pati një plan për shpëtimin tonë. Plani i Tij përfshinte dërgimin e një zëvendësuesi për të marrë dënimin për mëkatet tona, në mënyrë që ne të pajtoheshim me Perëndinë.

Kryqi i Krishtit. Rrënjët e shpëtimit janë në kryqin e Krishtit, aty ku Perëndia kreu aktin më të rëndësishëm të shpëtimit. Perëndia e shtriu mëshirën dhe hirin e Tij mbi ne duke dërguar Birin e Tij që të vdes për mëkatet tona. Jezusi vdiq në vendin tonë. Përderisa Krishti u var në kryq, Ai mori mbi Vete barrën e mëkateve të botës, duke marrë dënimin për mëkatet tona dhe duke paguar një borxh që ne nuk do të mund të paguanim.



Lexoni pasazhet në vijim dhe përgjigjuni pyetjeve pasuese: Isaia 53:1-9, 2 Korintasve 5:21, Kolos.2:13-14 dhe 1 Pjetrit 2:24-25:

1. Pse u kryqëzua Jezusi?
2. Nga pasazhi i Isaia's vini re detajet e vdekjes së Krishtit.
3. Çfarë përmbushi kryqëzimi?

Ky akt i Perëndisë i kryer për ne ishte parashikuar qindra vite para se të vinte Krishti. Profeti Isaia shkroi për Njërën i cili do të vinte si një shërbëtor i përvuajtur, duke

potencuar se plani i Perëndisë për të dërguar një Shërbëtor për t'i marrë dënimet tona ishte përmbushur në Krishtin (Isaia 53:1-9).

Disa i referohen 2 Korintasve 5:21 si një pasazh që përmban parimin e “jetës së ndryshuar”. Në kryqin e Krishtit ndodhi një këmbim. Krishti në fakt u bë mëkat për ne, dhe unë u bëra në realitet drejtësia e Krishtit. Ai që pranon sakrificën e Krishtit për mëkatet, e pranon drejtësinë e Krishtit si një dhuratë falas. Çfarë këmbimi i mahnitshëm!

Martin Luteri ishte një prift i shekullit të gjashtëmbëdhjetë, i cili e kaloi jetën e tij të hershme në mundime të tmerrshme për ta kënaqur Perëndinë me anë të drejtësisë së vet, me dhimbje të vetëdijshme për dobësitë e tij. Ai kaloi orë të tëra duke u rrëfyer dhe prapë se prapë largohet duke bartur peshën e fajit të tij dhe paaftësinë për ta kënaqur një Perëndi të drejtë.

Pastaj, me anë të mëshirës së Perëndisë sytë e tij ranë në fjalët jetë-ndryshuese “I drejti do të rroj me anë të besimit” (Rom 1:17). Ai e kuptoi se drejtësia vjen te ne me anë të besimit, në të cilën: “ne nuk punojmë asgjë, nuk përfitojmë asgjë ndaj Perëndisë, por vetëm pranojmë dhe [lejojmë] një tjetër që të punojë në ne.”² Luteri u ndryshua në mënyrë dramatike. Barra e vuajtjes për të fituar shpëtimin e tij u hoq nga shpatullat e tij.

Ai që e pranon
sakrificën e Krishtit
për mëkatet, e
pranon drejtësinë e
Krishtit si një
dhuratë falas. .

Ringjallja e Krishtit. Puna e Krishtit për ne në kryq nuk do të kishte aspak rëndësi nëse nuk do të ekzistonte e vërteta e ringjalljes së Tij.



Lexoni 1 Korintasve 15:12-23. Çfarë argumente jep Pali në lidhje me rëndësinë e besimit në ringjalljen e Krishtit?

Disa thonë se Jezusi ishte thjeshtë një njeri i mirë, një mësues i madh i moralit, i cili vdiq heroikisht, mirëpo i cili nuk u ringjall nga vdekja. Pali shkruan se të besosh në një person të tillë nuk ka fare vlerë. Një Krisht i vdekur do të nënkuptonte se ne akoma jemi në mëkatet tona, sepse vetëm ai që u ngjall prej së vdekuri mund të ofroj çlirim nga fuqia e mëkatit si dhe shpresë për jetën e përjetshme. Vetëm një Krisht i ringjallur ka fuqi të shpëtojë.

Bazat e Shpëtimit tonë

Shpëtími vjen vetëm
me anë të hirit, vetëm
nëpërmjet besimit dhe
vetëm në Krishtin.

Jeta e krishterë, është një jetë e bazuar në Krishtin e gjallë. Ne jemi plotësisht të varur në Perëndinë për shpëtimin tonë. Në mënyrë që të shpëtohem, unë duhet të mbështetem në Krishtin, sakrificën e Tij në kryq për mëkatet e mia, dhe ringjalljen e Tij që më ofron mua jetë të përjetshme. Shpëtimi vjen vetëm me anë të hirit, vetëm nëpërmjet besimit dhe vetëm në Krishtin (Tití 3:4-8).

Burimi i hirit. Pjetri flet për Perëndinë dhe “hirin e vërtetë të Perëndisë” (1 Pjetri 5:10). Nga faqet e para, Bibla e shfaq Perëndinë të jetë Perëndi i hirit. Ne e shohim Perëndinë si Atë që krijon një botë mahnitëse nga asgjë dhe se si vendosja e bijve të Tij në botë bëhet pranim i hirit të Tij. Në kopshtin e Edenit, Adami dhe Eva pranuan shumë dëshmi të mrekullueshme të dashurisë dhe të kujdesit të Perëndisë për ta. Ata nuk bënë asgjë për ta fituar vendin e tyre aty apo për ta fituar dashurinë e Perëndisë. Perëndia thjeshtë zgjodhi që të jetë i kujdesshëm, i dashur dhe i mirë me ta.

Nga fillimi ne shohim se si Perëndia e derdh dashurinë dhe mirësinë e Tij mbi njerëzimin. Është natyra e Perëndisë që të dojë dhe që të tregojë mirësinë dhe dhembshurinë e Tij. “Perëndia ka mall që të jetë i hirshëm me ju, dhe për këtë arsye Ai pret nga lart që të derdh mbi ju dhembshurinë e Tij” (Isaia 30:18).

Kuptimi i hirit. Mund ta definojmë hirin si “bekim i pamerituar që i dhurohet njerëzve falas nga Perëndia.”⁵ Fjala “favor” shpesh përdoret në Dhjatën e Vjetër për të shprehur konceptin e hirit. Filip Jensi ka shkruar, “Hir do të thotë se unë nuk mund të bëjë asgjë që ta bëjë Perëndinë të më dojë më shumë, dhe nuk mund të bëjë asgjë që ta bëjë Perëndinë të më dojë më pak.”⁶ Perëndia e shfaq mirësinë dhe favorin e Tij falas ndaj nesh edhe pse s’kemi bërë asgjë për ta merituar atë.

Perëndia e shfaq
mirësinë dhe favorin e
Tij falas ndaj nesh,
edhe pse s’kemi bërë
asgjë për ta merituar

Një shembull i hirit të Perëndisë. Mbase shumë pak e kanë kuptuar hirin e Perëndisë aq qartë siç e kishte kuptuar Apostulli Pal. Si një krerë i zellshëm fetar, me emrin Saul, ai ishte përkushtuar që ta asgjësonte krishterimin, duke besuar se krishterimi i kërcënonte të vërtetat që gjendeshin në besimin jude. Ai miratoi vrasjen me gurë të Stefanit, që ishte martiri i parë i krishterë. Urrejtja e tij kundër ndjekësve të Krishtit ishte e fuqishme; tek Veprat e Apostujve 9:1 ai përshkruhet si një që “shfryen kërcënime dhe kërdi kundër dishepujve të Zotit”



Lexoni tregimin e konvertimit të Palit tek Veprat e Apostujve 9:1-19.

A shihni ndonjë evidencë që Pali kishte bërë ndonjë gjë për ta merituar shpëtimin? Mbi çfarë baza e shpëtoi Perëndia Palin?

Me anë të një shkëndijë të mahnitshme të hirit, Perëndia zbriti për ta prekur Saulin, dhe kështu jeta e tij ndryshoi në mënyrë dramatike. Brenda disa minutash Sauli, i cili kishte qenë shpirtërisht i verbër, u verbërua fizikisht, në mënyrë që sytë e tij të hapeshin për të vërtetën – që të kuptonte se ky Jezus që ai po persekutonte, ishte në fakt Vetë Zoti. Urrejtja ndaj Krishtit u konfrontua me Krishtin e gjallë, dhe jeta e tij ndryshoi përgjithnjë.

Çmimi i hirit. Edhe pse shpëtimi është një dhuratë falas nga Perëndia nuk do të thotë që nuk ka një çmim. “**Hiri nuk i kushton asgjë atyre që e marrin atë, por i kushton atij që e dhuron ... çmimi tepër i lartë i Kalvarit.**”⁷

Pagesa e vetme e mëkatit të cilën Perëndia do ta pranonte ishte vdekja e Birit të Tij të vetëm – i vetmi që jetoi një jetë plotësisht të drejtë dhe vdekja e të cilit për njerëzimin mund t’i shlyej mëkatet tona dhe të na ofrojë drejtësinë.



Lexoni Romakëve 5:6-11 dhe 3:21-24.

1. Si e shpjegojnë vargjet 6-8 gjendjen tonë si qenie njerëzore?
2. Sipas vargjeve 9-10 çfarë ishte përmbushur me anë të vdekjes së Krishtit?
3. Kush na mundëson që të shpallemi të drejtë para Perëndisë?

Vdekja e Krishtit ia bëri të mundur Perëndisë që të shpall të drejtë një person të padrejtë. Perëndia e ka ofruar drejtësinë e Tij të përsosur për ne, dhe këto vargje na tregojnë neve se ky ofrim i drejtësisë është “i pavarur nga Ligji” apo nga ruajtja e standardit të Tij të përsosur. Drejtësia e Tij na ofrohet falas, si një dhuratë, në personin e Jezus Krishtit. Ai që beson për shpëtim në vdekjen e Krishtit në kryq, ai është i shpallur para Perëndisë i drejtë. Një himn i vjetër anglez e shpreh këtë mendim kështu: “Duarthatë po vij tek Ti. Thjesht në kryqin Tënd të mbështetem.”

Veçantia e krishterimit

Një dijetar biblik tregon se si një herë një grup teologësh po diskutonin pyetjen se çfarë e bënë krishterimin të ndryshëm nga religjionet e tjera? A ka ndonjë gjë të veçantë në lidhje me krishterimin? Ishin dhënë shumë sugjerime, por asnjëra nuk dukej e kënaqshme. Me atë rast, C. S. Lewis, një autor dhe apologjet i njohur, hyri në dhomë,

dhe këta burrat e ftuan që t'i bashkohej edhe ai diskutimit. Kur ata ia treguan pyetjen, Lewis u përgjigj, “Oh, është e lehtë. Është hiri.”⁸

Hiri në fakt është ai që e dallon krishterimin nga çdo religjion tjetër në botë. Çdo religjion na vë neve mbi një përmbushje të ritualeve. Ne jemi të thirrur që të bëjmë diçka, që t'i ndjekim disa ligje apo lista të urdhrave, në mënyrë që të fitojmë dashurinë apo favorin apo faljen apo aprovimin e Perëndisë.

Dikush ka thënë, “Krishterimi është i vetmi religjion që garanton parajsën bindshëm.”⁹ çdo religjion tjetër thotë, “Le të shohim se si jeton jetën një herë.” Krishterimi shpall se vetëm Perëndia i ofron njerëzimit dashuri dhe falje të pakusht dhe falas dhe se ne duhet t'i marrim ato vetëm me anë të besimit. I krishteri nuk ka asgjë që t'i ofrojë Perëndisë dhe vetëm mund t'i thërras Atij për mëshirë dhe hir.

Që shpëtimi ynë varet nga hiri i Perëndisë, kjo i sjell plotësisht lavdi Perëndisë, në atë mënyrë që asgjë tjetër nuk mund ta bëjë. Ne nuk mund të themi se e meritojmë as edhe një thërrime të shpëtimit tonë.



Shqyrtoni këtë pjesë dhe shkruani definicionin e juaj mbi hirin. Cilat janë disa nga rezultatet e hirit të Perëndisë në jetën tuaj?

Pranimi i dhuratës së shpëtimit

Në fillim të mësimin ne parashtruam një pyetje, çfarë është një i krishterë?



Duke pas në mendje leximin paraprak nga Gjoni 3:1-18 dhe Romakëve 3:21-24, lexojeni dhe mendoni rreth Gjoni 1:1-12; 6:28-29, Romakëve 4:1-8, dhe Efesianëve 2:1-10. Identifiko ato pjesë që juve ju duken se janë kyçe, tema apo koncepte të përsëritura në këto vargje, të cilat mund të kontribuojnë për të gjetur përgjigjen e kësaj pyetje.

Të besosh në Jezusin do të thotë t'i besosh Atij dhe veprës së Tij, duke u mbështetur në të vërtetën se vdekja dhe ringjallja e Tij e kanë paguar dënimin për mëkatin tonë. Një besim i tillë në Të, e largon fajin tonë para Perëndisë dhe rivendos marrëdhënien tonë të përjetshme me Perëndinë – duke mos na obliguar ne ndaj asgjëje, pos besimit në Jezus Krishtin.

Besimi nuk konsiston në të **bërit** e diçkaje (veprat e mira) por në të **besuarit** në dikë: **besimi** në Krishtin dhe **varësia** në efektshmërinë e vdekjes dhe ringjalljes së Tij për të na shpëtuar neve.

Të krishterët janë ata që e kuptojnë natyrën e tyre mëkatore dhe paaftësinë për ta shpëtuar vetveten dhe të cilët vijnë te Krishti për të pranuar falas dhuratën e shpëtimit. Ata që bëhen ndjekësit e Krishtit duhet të besojnë se Jezusi vdiq në kryq për mëkatet e tyre dhe u ringjall sërish, duke e mposhtur vdekjen dhe duke ofruar jetë të përhjetshme si një dhuratë falas për ata që besojnë në Të si Shpëtimtar. Kjo jetë e re nuk është e mundshme pa besimin në vdekjen e Krishtit dhe në ringjalljen e Tij.

Të krishterët janë ata që
e kuptojnë natyrën e tyre
mëkatore dhe paaftësinë
për ta shpëtuar vetveten
dhe të cilët vijnë te
Krishti për të pranuar
falas dhuratën e
shpëtimit.

Një i krishterë nuk është një person i mirë i cili është në gjendje ta kënaq Perëndinë me anë të veprave të mira, mirëpo ai është një person që i beson plotësisht veprës së Krishtit për shpëtimin. Ne duhet ta kuptojmë se jemi të paaftë ta kënaqim Perëndinë apo ta prodhojmë shpëtimin tonë për shkak të natyrës tonë serioze mëkatore dhe egoizmit tonë, të cilat na ndajnë nga Perëndia. Ne duhet të vijmë tek Perëndia, duke besuar se Jezus Krishti ka vdekur për të na shpëtuar neve nga gjendja jonë mëkatore.

Hapi i thjeshtë i besimit në
Jezus Krishtin si Shpëtimtar
është akti i përgjigjes ndaj hirit
të Perëndisë që na vendos ne
në familjen e Perëndisë.

Hapi i thjeshtë i besimit në Jezus Krishtin si Shpëtimtar është akti i përgjigjes ndaj hirit të Perëndisë që na vendos ne në familjen e Perëndisë. Shpëtimi ynë është një dhuratë nga Perëndia të cilën ne nuk e meritojmë; vjen tek ne vetëm nëpërmjet hirit të Perëndisë, vetëm nëpërmjet besimit, dhe vetëm në Krishtin. Ne thjesht duhet t'i zgjasim duart

tona dhe ta pranojmë dhuratën e drejtësisë së Krishtit.

Dhjata e Re e bënë të qartë se jeta e krishterë është një jetë e cila është në dispozicion për ata që e kuptojnë gjendjen e tyre mëkatore dhe nevojën për një Shpëtimtar dhe që besojnë se Jezus Krishti është Biri i Perëndisë, i cili vdiq që t'i shpëtojë ata nga mëkatet e tyre dhe që u ringjall sërish nga vdekja. Askush nuk është aq mëkatar sa të mos arrihet nga dashuria dhe hiri i Perëndisë.



A mund ta kujtosh kohën kur ti iu përgjigje ftesës së Perëndisë për shpëtim? Shpjego çfarë ndodhi?



Merr kohë tani për ta falënderuar Perëndinë për dashurinë e Tij të madhe për ty, që e ka shtrirë hirin e Tij mbi ty, dhe që të ka bërë pjesë të familjes së Tij. Kërko nga Ai që të të bëjë të ditur mënyrën se si mund ta bësh emrin e Tij të njohur në mesin e atyre që kanë nevojë ta njohin Atë.



Imagjino sikur jeni duke biseduar me Robertin, i cili u përmend në fillim, dhe ju dëshironi t'i shpjegoni në një mënyrë të thjeshtë se si mund të bëhet i krishterë. Çfarë do t'i thoni atij? (Gjej vargje nga Shkrimi për ta mbështetur përgjigjen tuaj, dhe përgatitu që ta luash rolin në këtë ballafaqim.)

Ne kemi parë se dashuria e Perëndisë është shtrirë në ne pavarësisht prej pozitës tonë shoqërore, prapavijës etnike, racës tonë, apo pavarësisht se sa shumë kemi mëkatuar.

Po shtigjet e tjera që të çojnë te Perëndia?

Shumë njerëz besojnë se ekzistojnë shumë shtigje që të çojnë tek Perëndia. Gjëja e rëndësishme, sipas atyre që qëndrojnë mbrapa kësaj pikëpamjeje, është sinqerteti në lidhje me atë që njëri beson. Në anën tjetër vetë Jezusi mësoi se Ai ishte rruga për tek Ati dhe se nuk ka rrugë tjetër (Gjoni 14:6). Ai gjithashtu e përshkroi Vetën si dera nëpërmjet të cilës hyjmë në mënyrë që të shpëtohem (Gjoni 10:9-10). Luka tek Veprat e Apostujve 4:12 shkruan për mbrojtjen e Pjetrit pas arrestimit të tij dhe thekson këtë thënie madhështore në lidhje me Jezusin: “dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që iu është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem.” (HCSB)

Është një emër dhe vetëm një emër i cili është i denjë të thirret për shpëtim: emri i Jezus Krishtit. Disa njerëz mendojnë se është e padrejtë nga Perëndia që të kërkojë që të gjithë njerëzit të vijnë tek Ai nëpërmjet Jezus Krishtit, ndërsa në anën tjetër ne shohim mëshirën dhe dashurinë e madhe të Perëndisë në gatishmërinë e Tij për të dërguar Birin e Tij që të vdes për një botë mëkatore dhe të ofrojë një rrugë për ne në mënyrë që të mund të pajtohemi me Perëndinë.

Të jetosh jetën e krishterë

Kur besimtarët përgjigjen në besim ndaj dhuratës së hirshme të shpëtimit, fillon një proces për t'u përgatitur për parajsë, për t'u bërë më shumë si Krishti. **Ky proces i rritjes për t'u bërë më shumë si Krishti në karakter quhet shenjtërim.** Është procesi i shenjtërisë. Disa ndjekës të Krishtit ishin të hutuar në lidhje me këtë proces.

Ata shpejtë erdhën në konkludimin se ata duhet t'i shtonin veprës së Krishtit veprat e tyre të mira, ose për ta fituar shpëtimin ose për ta ruajtur atë.

Vazhdimi i jetës së krishterë me anë të besimit

Teksa dishepujt e përhapnin lajmin e mirë të Jezus Krishtit, ata u përballën me shumë njerëz që e keqkuptuan ofertën e shpëtimit me anë të hirit. Judaizerët ishin një grup i judenjëve të shekullit të parë të cilët së paku nga jashtë e pranuan Jezus Krishtin si Mesinë e tyre, megjithatë ata filluan të insistojnë që jo judenjët që ishin konvertuar, duhet të merrnin pjesë në disa prej ritualeve të judenjëve, si rrethprerja, apo t'i mbajnë disa ligje të Ligjit Jude në mënyrë që të shpëtoheshin. Duke i shtuar disa kërkesa shpëtimit që është me anë të besimit, Judaizerët ishin duke thënë se vetëm besimi në Krishtin nuk është i mjaftueshëm. Ata shtuan një kusht: ata thanë që ka gjëra që një besimtar duhet t'i bëjë si shtesë ndaj besimit në Krishtin në mënyrë që të meritohet shpëtimi.

Shumë paganë në Galat i pranuan mësimet e Judaizerëve, dhe shumë sosh u hutuan në lidhje me rolin e veprave të mira dhe mbajtjen e ligjit. Pali i shkroi kishës në Galat për t'ju adresuar mendimeve të rreme në këtë fushë. Ai kuptoi që mësimet e Judaizerëve ishin në drejtim të kundërt me mesazhin e Krishterimit. Pali i rikujtoi besimtarëve të Galatisë se shpëtimi është një dhuratë nga Perëndia për të gjithë ata që besojnë.

Tek Galatasve 2:19 Pali u tregon Galatasve që besimtari ka vdekur për ligjin. Çfarë nënkupton kjo? Një autor sugjeron se ne kemi vdekur për ligjin në dy mënyra. E para, ne kemi vdekur për ligjin si një kërkesë për të fituar drejtësinë përpara Perëndisë. E dyta, ne kemi vdekur ndaj mallkimit dhe dënimit që kishte ardhur si rezultat i paafësisë sonë për ta mbajtur ligjin në mënyrë të përkryer.¹⁰

Tek Galatasve 2:20-21 Pali përshkruan mënyrën se si Krishti e prodhon jetën e Tij në ne. Ai shkruan, “Unë u kryqëzova bashkë me Krishtin dhe nuk rroj më unë, po Krishti rron në mua; dhe ajo jetë që tani jetoj në mish, e jetoj në besimin e Birit të Perëndisë, që më deshi dhe dha veten për mua.”

Kjo jetë e re nuk duhet të
jetohej me anë të
përpjekjeve tona më të mira.
Duhet të jetohej me anë të
varësisë në Krishtin.

Kjo jetë e re nuk duhet të jetohej me anë të përpjekjeve tona më të mira. **Ajo duhet të jetohej me anë të besimit dhe varësisë në Të.** Është një jetë ku ne marrim ushqimin dhe fuqinë shpirtërore nga marrëdhënia me Krishtin. Jezusi, jo vetëm që na jep jetë të përhershme, por Ai bënë që jeta e Tij të rrjedh në ne teksa jetojmë jetën e Krishterë me anë të varësisë në Krishtin.



Lexo Galatasve 3:1-4. Pali reagon fuqishëm në këto vargje, duke u thënë Galatasve, “Çfarë ka ndodhur? Si jeni magjepsur?” Ai i quan ata “të marrë”.

1. Çka e shtyri Palin që ta nxirrte këtë paralajmërim të fuqishëm? Sipas vargut 3, në ç'farë gabimi kishin rënë galatasit?
2. Si thotë Pali se galatasit e kishin pranuar Frymën, dhe si thotë ai që ata duhet të bëheshin të plotë?
3. Çfarë përfundime mund të nxirrni nga kjo?

Pali u kujton atyre se ata duhet të bëhen të plotë në mënyrën e njëjtë se si ata e pranuan Krishtin – duke iu përgjigjur Perëndisë me anë të besimit, dhe jo duke bërë vepra të mira. Vini re se besimtarët e Galatisë tanimë ishin bërë të krishterë, “kishin filluar në Frymë”. Çështjet që ishin në rrezik këtu kishin të bënin me atë se si të jetohej jeta e krishterë dhe cili do ishte roli i veprave të mira në kompletimin e shpëtimit.

Në vijim tek Galatasve 5:3 Pali tregon se çdonjëri që dëshiron të shfajësohet duke e mbajtur një pjesë të ligjit është i obliguar që ta mbajë tërë ligjin. Një person i cili është i vendosur që ta fitoj parajsën duke bërë vepra të mira, ai duhet të jetojë një jetë të përkryer, pa as edhe një mëkat. Askush tjetër pos Krishtit nuk ka qenë në gjendje që ta përmbush këtë kërkesë. Vetëm Krishti e mbajti ligjin e Perëndisë, dhe vetëm Krishti ka mundur të ofrojë sakrificën e përkryer për mëkat.

Sot shumë njerëz janë aq të hutuar sa ishin edhe galatasit në lidhje me këtë pyetje. Përgjatë shekujve shumë të krishterë kanë rënë në prenë e këtij mendimi. Ata besojnë që, sapo të bëhen fëmijë të Perëndisë, u takon atyre që të fitojnë dashurinë dhe favorin e vazhdueshëm të Perëndisë me anë të veprave të tyre të mira. **Jeta e krishterë shpesh shikohet si një përzierje e hirit të Perëndisë dhe efektshmërisë personale. Rezultati i këtij lloj të menduari është që t'i vendos të krishterët në punë rutinore për të arritur efektshmërinë.** “Ne u predikojmë hirin jo të krishterëve dhe detyrat të krishterëve.”¹¹

Rezultati është që shpesh ne të krishterët jetojmë me fjalët “do të” të drejtuara në kokat tona si revole. Ne mundohemi çdo ditë nën pikëpamjen se duhet të arrijmë lartësinë e duhur me standardin e Perëndisë, gjë e cila na lë të frikshëm dhe të pasigurt. Ne mund të provojmë ta shikojmë Perëndinë si një mbikëqyrës të ashpër. Ne kurrë nuk mund ta dimë nëse kemi bërë mjaft gjëra të mira për ta fituar dashurinë dhe aprovimin e Perëndisë. **Ne priremi që të jetojmë nën renë e turpit, duke e nuhatur mosmiratimin e Perëndisë apo dëshpërimin sa herë që dështojmë t'i arrijmë standardet e Perëndisë.**

Kur ne mëkatojmë, ne mund të ndihemi të turpëruar që të vijmë tek Ai për të kërkuar falje, duke e paramenduar Atë se Ai është duke e tundur kokën dhe duke menduar, “Jo, prapë!” Ne mund ta paramendojmë se Perëndia nuk do të ketë dëshirë që të na i shikoj sërish fytyrat tona, posaçërisht kur ne e gjejmë vetveten duke i përsëritur mëkatet e

njëjta në mënyrë të vazhdueshme. Mbase mund të ndihemi se ne nuk mund t'i qasemi Atij derisa të kemi pastruar veten tonë

E vërteta është se: ne asnjëherë nuk do të jemi në gjendje që të pastrojmë veten tonë. “Gabimin më të madh që shumica e njerëzve të Perëndisë kanë bërë ka qenë shpresa për të zbuluar në vetvete atë që mund të gjendet vetëm në Krishtin.”¹²

Nëse besojmë se jemi të shpëtuar me anë të hirit dhe që duhet ta fitojmë dashurinë dhe favorin e vazhdueshëm të Perëndisë, ne mund të priremi që të bëjmë vepra të mira dhe të përfshihemi në aktivitete të krishtera me qëllim që ta fitojmë dashurinë e Perëndisë dhe për ta ruajtur shpëtimin tonë. Në këtë mënyrë, ne besojmë se shpëtimi ynë është me anë të hirit nëpërmjet besimit, mirëpo ne besojmë që shenjtërimi ynë, procesi për t'u bërë i shenjtë, duhet të arrihet me anë të veprave tona. Kur ne mendojmë në këtë mënyrë, përvoja jonë e krishterë mund të ndihet jashtëzakonisht si një detyrë.

A janë besimtarët nën obligimin për ta ruajtur shpëtimin apo për ta fituar dashurinë e Perëndisë me anë të veprave të duhura dhe të mira? Në shumicën e letrave të tij, Pali mëson që i tërë shpëtimi ynë është i bazuar vetëm në hir. Çdo ditë ne qëndrojmë në po këtë hir që edhe na shpëtoi ne (Rom 5:1-2)



Lexoni Filipianëve 1:6 dhe Hebrenjëve 7:23-25. Çfarë na mësojnë këto vargje në lidhje me përfundimin e procesit të shpëtimit?

Në pasazhe si ky Pali na rikujton për varësinë tonë të plotë në Perëndinë për tërë procesin e shpëtimit, nga fillimi deri në fund. Jo vetëm që ishte vdekja e Krishtit e mjaftueshme për të fituar shpëtimin tonë, mirëpo edhe jeta e Krishtit është e mjaftueshme për ta ruajtur shpëtimin tonë. Teksa ndërmjetësi dhe ndërhyrësi ynë i përjetshëm Krishti qëndron para Atit njëzetekatër orë në ditë, shtatë ditë në javë, duke na siguruar që Perëndia na shikon plotësisht të mbuluar në shfajësimin e Tij.

Jo vetëm që ishte vdekja e Krishtit e mjaftueshme për të fituar shpëtimin tonë, mirëpo edhe jeta e Krishtit është e mjaftueshme për ta ruajtur shpëtimin tonë.

Nga fillimi deri në fund, procesi i shpëtimit tonë është i kryer nga Krishti. “Një ndër fshehtësitë më të mira të mbajtura nga të Krishterët në ditët e sotme është ky: Jezusi pagoi për çdo gjë.”¹³ Krishti jo vetëm që e bleu biletën për në parajsë, por Ai bleu edhe faljen e **plotë** të mëkateve tona, statusin tonë të shfajësimit para Atit, identitetin tonë si fëmijë të Perëndisë, vendin e përhershëm në familjen e Perëndisë.

Gjon Njuton, i cili një kohë ishte një tregtar skllav, u kthye te Krishti nga një jetë me moral të korruptuar. Më vonë ai shkroi fjalët e një ndër himneve më të famshme angleze, “Hiri i Mahnitshëm”, në të cilin ai shkruan për hirin që është aq i fuqishëm sa që “e shpëtoi një qyqar si unë.” Njuton e kuptoi gjendjen e tij të mjerë. Në një rresht ai shkruan, “është hiri ai që më solli të sigurt deri këtu, dhe hiri do të më çoj në shtëpi.” A e besojmë ne këtë, apo besojmë që përpjekjet tona për t’i shërbyer Perëndisë dhe për ta kënaqur Atë na çojë të sigurt në shtëpi?

Më herët ne e përshkruam hirin si zgjatje e duarve për të pranuar dhuratën e shfajësimit të Krishtit. **Tani mund ta përshkruajmë shenjtërimin si** varësinë ditore në shfajësimin e Krishtit.

Kështu teksa e jetojmë jetën e Krishterë, ne shohim se e jetojmë këtë jetë çdo ditë duke e shikuar Perëndinë dhe duke u varur plotësisht në Të për shpëtimin dhe shenjtërimin tonë. Pranimi ynë nga Perëndia dhe qëndrimi ynë në Të janë të bazuara vetëm në meritat e Jezus Krishtit. Themeli ynë i fortë për jetën e krishterë është Jezus Krishti. Çdo themel tjetër është rrëzë e fundosur.

Të çliruar për të shërbyer

Të kuptosh që marrëdhënia jonë e përditshme me Perëndinë bazohet në meritat e pafundme të Krishtit, dhe jo në veprimet tona, na çliron që t’i shërbejmë Krishtit duke u motivuar nga dashuria dhe mirënjohja. Përfundimisht, hiri i bënë njerëzit që t’i shërbejnë Perëndisë me një liri më të madhe dhe kjo gjë ndryshon jetët tona më shumë se çdo gjë tjetër. Veprat e mira do të jenë rezultati i natyrshëm i të jetuarit me këtë njohuri të hirit, teksa dëshirojmë ta kënaqim Atë që ka derdhur kaq shumë dashuri mbi ne.

Bazuar në të kuptuarit e tij të qartë në lidhje me hirin e Perëndisë, Pali i nxiti të gjithë ithtarët e Krishtit që t’ia ofrojnë jetët e tyre tërësisht Perëndisë (Rom 12:1-2). Ky akt adhurimi është rrjedhja e natyrshme e përgjigjes së një njeriu të krishterë ndaj hirit të Perëndisë.



Si ndërlidhen besimi, veprat e mira dhe hiri me të jetuarit e jetës së Krishterë?



Shkruani në fletoren tuaj mendimet e tua në lidhje me pyetjet në vijim:

- Kur ta imagjinoni Perëndinë duke ju shikuar, cila është shprehja e fytyrës së Tij që ju e imagjinoni? A keni ndjenjën se Ai është i dëshpëruar me ju? A e imagjinoni Atë duke ju shikuar me vetulla të mbledhura? Apo i shikoni sytë e Tij të mbushur me kënaqësi dhe ëndje? Përse mendoni kështu?

- A e gjeni veten duke u përpjekur ta kërkonit favorin e Perëndisë duke u bazuar në veprimet e tua? Për shembull, a ndiheni “i kualifikuar” më shumë që të hyni në praninë e Tij kur ta keni lexuar Biblën apo kur të keni kryer ndonjë vepër të mirë dhe të dobishme? A i shmangeni bisedës me Të kur të keni mëkatuar apo nuk keni bërë atë që është dashur ta bëni? Çfarë është ajo që të mbanë larg nga të ardhurit pranë Tij?
- A keni qenë duke jetuar jetën e krishterë në një rutinë të veprave dhe duke u përpjekur nën faj dhe turp për shkak të dështimeve tuaja? Sa ju ka qartësuar ky lloj i të menduarit për rolin e hirit të Perëndisë për të jetuar jetën e krishterë? Si ndikon kjo në motivin tuaj për t’i shërbyer Perëndisë?

Teksa fillojmë që të mbërthejmë horizontin e mahnitshëm të hirit të Perëndisë në jetët tona, përgjigjeja jonë do të jetë ajo e falënderimit dhe adhurimit.



Ndaluni dhe kaloni disa minuta duke e lavdëruar Perëndinë për atë që Ai ka bërë për ty. Reflekto mbi hirin e Tij të shtirë në ty dhe si do të doje t’i përgjigjeshe këtij hiri.

Mendime përmbyllëse

Ne bëhemi pjesë e familjes së Perëndisë me anë të një takimi personal me Jezus Krishtin, pasi të kemi kuptuar gjendjen tonë mëkatore e cila na ndanë nga Perëndia dhe pasi të vendosim besimin tonë në veprën e Krishtit që bëri në kryq për ne. Jeta jonë në Krishtin pushon në Të dhe drejtësinë e Tij, e cila transferohet plotësisht tek ne.

Procesi i ngjasimit me Krishtin bazohet gjithashtu në drejtësinë e Tij, dhe jo në drejtësinë tonë. Si të krishterë ne vazhdojmë të jetojmë me anë të besimit në Krishtin, duke u varur në Të, dhe duke marrë forcën dhe ushqimin shpirtëror nga marrëdhënia jonë me Të. Ai jo vetëm që na jep jetë të përjetshme por gjithashtu prodhon në ne pikërisht vetë jetën e Tij. Ne kemi ardhur në mbretërinë e Perëndisë me anë të hirit; ne jemi shenjtëruar me anë të hirit; dhe përfundimisht do të përlevdohemi me anë të hirit. Nuk është e çuditshme se si kaq shpejtë ky mesazh u emërua “lajmi i mirë.”

Fusnotat

¹ Shumica mendojnë se samaritanët janë një racë e përzier, gjë që ka kontribuar në urrejtjen e hebrenjve kundër tyre

² Jerry Bridges, *Transforming Grace* (Colorado Springs, CO: NavPress, 1991), 27.

³ Zbulesa 6:5 “ligësi”; Psalmi 12:8 “poshtërsi”; Fjalët e Urta 30:12 “fëlliqësi” dhe Ligji i Përtërirë 13:5 “rebelim kundër Perëndisë

⁴ Martin Luter, Komentar mbi letrën e Palit drejtuar Galatasve (n.p., {1575}; reprint LondonnL James Clarke, 1953), 22.

⁵ Philip Edgcumbe Hughes , “Grace” në Fjalorin Ungjillor të Teologjisë , ed. Walter A. Elwell (Grand rapids, MI: Baker, 1984), 479.

⁶ Philip Yancey, What’s So Amazing About Grace? (Çfarë e bënë hirin kaq të mahnitshëm?) (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1997), 71.

⁷ Ibid., 67

⁸ Që ndërlidhet me profesorin e filozofisë Peter Kraft pranë Kolegjit “Calvin”, siç është përshkruar te *The Riddle of Grace: Applying Grace to the Christian Life* (Gjëegjëza e Hirit: Zbatimi i hirit në jetën e krishterë) nga Scott Hoezee, (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1996), 41-42

⁹ Stephen Brown, *The Key Life Tapes* (Shiritat kyç të jetës) (Key Biscayne, FL: Key Life Network, n.d.).

¹⁰ Bridges, 109.

¹¹ Brown, *Tapes*

¹² Arthur Pink, *The Doctrine of Sanctification* (Doktrina e Shenjtërimit) (Swengel, PA: Bible Truth Depot, 1995), 200, quoted in Bridges, 101.

¹³ Bridges, 19

Burimet tona mbinatyrore

Alena asnjëherë nuk mungon në ndonjë prej shërbesave të kishës. Ajo këndon në kor dhe jep mësim në një klasë në Shkollën e së Dielës për fëmijët. Ajo është e shpejtë për t’ju ndihmuar të tjerëve që janë në nevojë dhe shërben me besnikëri kudo që nevoja e saj kërkohet. Në anën tjetër përbrenda Alena shumë shpesh lufton me fajin. Burri i saj nuk është besimtar, dhe ajo shpesh e humb durimin ndaj tij dhe zemërohet me të. Ajo zemërohet me tre fëmijët e saj dhe u thotë gjëra për të cilat pendohet. Shpesh ajo i shërben Perëndisë me zemër jo të plotë, dhe ndoshta vetëm sepse të tjerët presin që ajo të shërbejë. Ajo asnjëherë nuk arrin të kuptojë se çfarë Perëndia do nga ajo. Burri dhe fëmijët e saj duken të zhgënjyer me të. Duket sikur ajo asnjëherë nuk mund të jep mjaftë, të bëjë mjaftë apo të jetë mjaftë. Shpesh është e vështirë që të lutet sepse ajo e di që Perëndia mund të jetë i zhgënjyer me të. Duket se vazhdimisht ajo i rrëfen të njëjtat mëkate. Duke qëndruar zgjuar dhe e shtrirë gjatë natës, ajo shpesh mendon me vete nëse me të vërtetë është e krishterë apo jo. Jeta e saj thjesht nuk është në lartësinë e duhur.

A jeni ndier ndonjëherë sikur Alena? Si do t’i ndihmonit asaj që te tejkalonte ndjenjat e fajit dhe të dëshpërimit në jetën e saj si e krishterë? Teksa e studioni këtë mësim, kërkonit të vërteta biblike, të cilat do të mund ta inkurajonin Alenën.



Në Mësimin 1 ne pamë bazat e shpëtimit tonë. Ne shikuam shumë pasazhe në Bibël të cilat na mësojnë se shpëtimi është nga hiri nëpërmjet besimit në Jezus Krishtin. Ne zbuluam se shpëtimi mbështetet plotësisht në veprën e Krishtit – themeli ynë i fortë. Perëndia mund të na shikojë neve si fëmijët e Tij, të shenjtë dhe të pranueshëm, për shkak të veprës së Krishtit në kryq. Drejtësia e Tij ofron të vetmin themel për drejtësinë tonë përpara Perëndisë.

Jo vetëm që Perëndia na i ka ofruar mjetet e justifikimit, Ai gjithashtu na ka ofruar edhe mjetet për shenjtërimin tonë – procesi për t’u bërë të shenjtë – dhe burimet që neve na nevojiten për të jetuar jetën e krishterë. Këto burime nuk gjenden në ne, por tek Ai. Në këtë mësim ne do të shikojmë identitetin tonë para se të vinim te Krishti,

identitetin e ri të të krishterit, dhe burimet e mbinatyrshme të cilat na janë dhënë për të jetuar jetën e krishterë.

Përmbledhje e mësimit

Jeta jonë para Krishtit
Identiteti ynë i vjetër
Skllëvër të mëkatit
Jeta jonë e re në Krishtin
Një rrugë e re e jetës
Identiteti ynë i ri
Burimet tona të reja
Rruga për tek shenjtëria
Beteja në mes
Shpëtimi
Fuqia e Frymës së Shenjtë në ne
Fryma e Shenjtë është Perëndia
Fryma e Shenjtë është një Person
Fryma e Shenjtë na sjell te Krishti
Fryma e Shenjtë banon në çdo besimtar
Fryma e Shenjtë është aktiv në jetën e besimtarit
Mendime përmbyllëse

Qëllimet e mësimit

Kur ta përfundoni këtë mësim, ju do të jeni në gjendje që të:

1. Identifikoni aspektet specifike të identitetit tuaj në Krishtin të cilat të inkurajojnë më së shumti ty si një i/e krishterë.
2. Të bëni një përmbledhje të aspekteve të reja të jetës së besimtarit.
3. Ta përkufizoni kuptimin tuaj në lidhje me shenjtërinë.
4. Të identifikoni nga Shkrimi atributet dhe veprat e Perëndisë që i janë atribuuar Frymës së Shenjtë.
5. Të përshkruani punën e Frymës së Shenjtë në jetën e besimtarit dhe të theksoni ato që kanë më së shumti kuptim për ju.
6. Të vlerësoni reagimin tuaj ndaj punës së Frymës së Shenjtë në jetën tuaj.

Jeta jonë para Krishtit

Ata që i janë përgjigjur ofertës së Krishtit për shpëtim duke besuar në veprën e Tij të kryqit, përjetojnë një transformim të brendshëm, transformim i cili është aq dramatik sa që përshkruhet si një kalim nga bota e errësirës në botën e dritës (p.sh. Gjoni 5:24; Kol. 1:13). Në të vërtetë, të krishterët pranojnë një identitet plotësisht të ri, i cili është krejt ndryshe nga identiteti që i ka karakterizuar ata më përpara.

Identiteti ynë i vjetër

Natyra, të cilën e ka trashëguar secili person nga Adami, Bibla i referohet si “mishi”¹ ynë dhe në teologji kjo referohet si “natyra jonë mëkatore”, e cila është një natyrë egocentrike dhe e cila është në armiqësi me Perëndinë (Rom 8:5-8). Çdo person është i lindur me këtë natyrë mëkatore, me një prirje për të mëkatuar. Në kundërshtim me atë se çfarë mendojnë shumë njerëz, fëmijët nuk vijnë në botë të pafajshëm; askush nuk ka nevojë ta mësojë një fëmijë që të jetë egoist (Ps 51:5; Rom 3:9-18). Pali thotë tek Romakëve 3:10, “NUK KA ASNJERI TË DREJTË, AS EDHE NJË”

Skllavëri të mëkatit

Jo vetëm që vijnë në botë me një natyrë mëkatore, mirëpo ne edhe zgjedhim që të mëkatojmë. Një jobesimtar përshkruhet në Bibël si një skllav i mëkatit dhe i fuqive të errëta (Gal 4:8). Shpesh njerëzit tundohen ta kategorizojnë mëkatin, duke e ndarë atë prej shprehive të këqija e deri tek aktet e dhunës. Ne priremi që të mendojmë se mëkatet e tona të “vockla” nuk bien në kategorinë e njëjtë me vrasjen, përdhunimin, tradhtinë bashkëshortore apo vjedhjen. Megjithatë, në kemi mësuar tek Mësimi 1 se çdo mëkat është fyerje kundër natyrës së shenjtë të Perëndisë. Teksa mund të vërejmë mëkate të caktuara, si krenarinë apo thashethemet, që janë si më të pranueshme në shoqëri, Perëndia i sheh po këto mëkate si një neveri. Pa marrë parasysh se sa të respektueshëm dukemi apo se sa fetar sillemi, natyra jonë rrënjësore në thelb ngelet mëkatore. Nuk ka shpresë për të përmirësuar natyrën tonë bazë që është mëkatore apo për të çrrënjosur plotësisht fuqinë e saj.

Ekzistojnë shumë ilustrime në Bibël në lidhje me kontrollimin e fuqishëm të natyrës sonë mëkatore. Merrni në konsideratë, për shembull, popullin e Izraelit, të cilët ishin çliruar nga skllavëria në Egjipt (një pamje e shpëtimit nga skllavëria e mëkatit). Mojsiu rrëfen me hollësi kohën kur ai u thirr në Malin e Sinait për të marrë Ligjin e Perëndisë. Njerëzit poshtë malit e dëgjuan zërin e Perëndisë duke zbritur nga mesi i malit në formë të zjarrit që digjej. Me plotë kuptimin e fjalës brenda fushës së largpamësisë së tyre, ata kishin evidencë të dukshme, të dëgjueshme, të prekshme për prezencën e Perëndisë në Malin Sinai.



Lexoni Eksodi 32:1-4, 19. Kur Mojsiu zbriti nga mali që po digjej me dy pllakat e gurit në duart e tij, çfarë gjeti ai? Çfarë konkluzione mund të nxirrini nga kjo ngjarje? Në çfarë mënyra mund të ndërlidheni me përvojën e izraelitëve?

Pavarësisht prej pamjes tmerruese të malit flakërues, si përkujtues vizual i vetë prezencës së Perëndisë dhe shenjtërisë së Tij, njerëzit prapëseprapë kryen këtë mëkat të madh. Mu në kohën kur Mojsiu ishte duke i marrë Dhjetë Urdhëresat nga Perëndia, populli i Izraelit që ishte poshtë malit, po i shkelte ato. Thyerja e pllakave të gurit nga Mojsiu ishte një gjest simbolik mbi faktin se urdhërimet e Perëndisë veçse ishin thyer (shkelur).

Një vështrim mbi Dhiatën e Vjetër zbulon se historia e popullit të Izraelit është një histori e dështimit të mjerë, si personal ashtu edhe të përgjithshëm, e pamundësisë për të ndjekur parimet e Perëndisë apo për ta dashur Atë me një zemër të pandarë. Kjo është e vërtetë për çdo qenie njerëzore mbi faqen e dheut. Edhe si të krishterë ne vazhdojmë të përpëlitemi për t’ju bindur Perëndisë dhe për ta dashur Atë me gjithë zemrën tonë. Faleminderit Zotit sepse Ai na ka dhënë disa burime për të na mundësuar që të jetojmë jetën e krishterë.

Jeta jonë e re në Krishtin

Në momentin që një person beson në Krishtin për shpëtim, në atë person ndodhin disa ndryshime të mëdha. Disa njerëz përjetojnë një rrjedhë të gëzimit dhe ndjenja të forta të çlirimit nga mëkati. Disa njerëz të tjerë ndjejnë shumë pak gjëra. Ndryshimet ndodhin, pa marrë parasysh nëse e ndjejmë apo jo që një gjë e tillë po ndodh; këto ndryshime nuk bazohen mbi emocionet por mbi qëllimin sovran të Perëndisë.



Lexoni vargjet si më poshtë dhe tregoni cilat gjëra të reja janë të vërteta për një besimtar. Si ndikojnë këto të vërteta në jetën tënde tani?

- Kolosianëve 1:13
- 2 Korintasve 5:17-19
- Filipianëve 3:20
- Romakëve 6:4
- Kolosianëve 3:9b-10

Tek Kolosianëve 1:27, Pali flet për një mister i cili u mbajt i fshehtë nga kohërat dhe brezat e kaluara, një mister të cilin Perëndia na e ka zbuluar neve si besimtarë. Ky mister i madh është “Krishti në ju, shpresa e lavdisë.” Prania e Krishtit të gjallë në ne na jep neve shpresën më të madhe, e cila është shpresa e lavdisë.

Tek Galatasve 2:20 Pali shkruan, “Unë u kryqëzova bashkë me Krishtin dhe nuk rroj më unë, po Krishti rron në mua; dhe ajo jetë që tani jetoj në mish, e jetoj në besimin e Birit të Perëndisë, që më deshi dhe dha veten për mua.” Këto vargje flasin për një të vërtetë që është transformuese, e vërteta që Vetë Krishti është në mua, dhe jeton jetën e Tij nëpërmjet meje. Mu në qenien time unë jam një njeri i ri.

Jo vetëm që na mëson Dhiata e Re se Krishti është në ne, ajo gjithashtu na mëson se edhe ne jemi “në Krishtin”. Ne marrim pjesë në jetën e Tij, dhe shijojmë përfitime të pamases që Perëndia derdh mbi ne si fëmijët e Tij.



Lexoni Efesianëve 1:3-14 dhe krijoni një listë të bekimeve që kanë ata që janë në Krishtin.

Kur të reflektojmë mbi të vërtetën se Krishti është në ne dhe mbi të vërtetën se ne jemi transformuar në një mbretëri të re të dritës, ne shpejtë vijmë në një përfundim se ne jemi të thirrur për një jetë të re. Imagjinoni një fëmijë të varfër i cili adaptohet nga një sundimtar i pasur. Babai i tij do ndihej i çnderuar nëse ky djalë do të vazhdonte të dilte rrugëve çdo ditë për të kërkuar lëmoshë apo nëse do të vazhdonte të vishej në lecka. Ngjashëm është edhe me ne. Edhe ne jemi të thirrur që të jetojmë një mënyrë të re të jetesës.

Mënyra e re e jetesës

Kur ne bëhemi të krishterë, dëshira jonë e re për ta kënaqur Perëndinë do të sjell ndryshime të mëdha në jetën tonë.



Lexoni Kolosianëve 3:1-17.

1. Si e përshkruan Pali mënyrën tonë të vjetër të jetesës?
2. Si e përshkruan Pali mënyrën e jetesës së një besimtari?
3. Çfarë konkluzione mund të nxjerrësh nga tekst në lidhje me mënyrën se si ndodh ky ndryshim?

Dhiata e Re na mëson se ne jo vetëm që fillojmë të **veprojmë** ndryshe kur të bëhemi të krishterë, por edhe se ne **jemi** ndryshe. Ne kemi vdekur dhe jeta jonë është e fshehur në Krishtin me Perëndinë (Kol 3:3). Një identitet i ri është në qendër të mënyrës sonë të re të jetesës në Krishtin.

Një identitet i ri

Thuhet për Augustinin, një prift i kishës së shekullit të katërt, që pasi u konvertua, ai u takua me një shoqe të vjetër në rrugë. Ajo e thirri atë disa herë, mirëpo ai nuk u përgjigj. Më në fund ajo e thirri, “Augustin, jam Unë!” Augustini u përgjigj, “Po, vetëm se Unë, më nuk jam Unë”¹.

Si të krishterë ne kemi një identitet të ri. Ne më nuk jemi ata që kemi qenë dikur, dhe ky fakt do të ketë një efekt radikal mbi mënyrën se si jetojmë.

Pali flet tek Romakëve 6:1-11 për një aspekt të identitetit të ri të një besimtari. Pasi disa besimtar romakë e dëgjuan shpjegimin e Palit se shpëtimi është vetëm prej hirit, ata u tunduan të mendojnë se nëse shpëtimi është plotësisht prej hirit ata mund të vazhdonin pa problem të mëkatonin, pasi që hiri do të tepronte aty ku mëkati ishte më i madh.



Lexoni Romakëve 6:1-11. Jepni një përmbledhje mbi mësimin e Palit mbi këto vargje.

Baza e identitetit tonë të ri është marrëdhënia jonë me Krishtin e ringjallur.

Besimtarët janë të bashkuar me Krishtin në vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen e Tij, të ngritur në një sferë të re të jetës në Krishtin. Ne jemi të bashkuar në Krishtin, i cili është i pavdekshëm dhe i përjetshëm. Ai është jeta jonë dhe burimi i identitetit tonë të ri. Drejtësia dhe jeta e Tij na takojnë neve. Ne më nuk jemi skllevër të mëkatit. Si besimtarë ne përcaktohem me anë të këtyre të vërtetave për ne. Ne jetojmë prej këtij identiteti të ri.

Shumë premtime të Dhiatës së Re na përkujtojnë identitetin tonë të ri dhe na nxisin që të jetojmë këtë identitet me plot kuptimësi. Lexoni fjalitë në vijim për të rikujtuar identitetin e një besimtari në Krishtin:

Kush jam unë në Krishtin

Unë jam fëmijë i Perëndisë, pjesë e familjes së Tij (Gjoni 1:12; 1 Pjet 2:9).

Unë jam zgjedhur nga Ai para themelimit të botës që të jem i shenjtë dhe i pafaj përpara Tij (Ef. 1:4).

Unë jam i shpenguar me anë të gjakut të Tij (Ef 1:7).

Unë jam i falur dhe i pastruar nga të gjitha mëkatet. (Kol. 1:13-14; 1 Gjoni 1:9).

Unë jam shpallur i drejtë nga Perëndia dhe kam paqe me Të (Rom 5:1).

Unë jam pajtuar me Perëndinë (Rom 5:10).

Unë jam i vulosur në Të me anë të Frymës së Shenjtë të premtimit (Ef 1:13).

Unë jam pjesë e njerëzve të zgjedhur të Perëndisë, një priftëri mbretërore, një komb i shenjtë (1 Pet 2:9).

Unë jam i paracaktuar që të përshtatem në ngjashmërinë e Jezusit (Rom 8:29).

Unë jam bashkëtrashëgimtar me Krishtin (Rom 8:17).

Unë do të kaloj përjetësinë në praninë e Perëndisë. (Fil 3:20-21; Kol 3:4).

Ndonjëherë lexojmë një listë të tillë dhe jemi në gjendje që ta aprovojmë pa i kuptuar me të vërtetë nënkuptimet e këtyre të vërtetave në jetët tona. Vallë, çfarë ndryshimi ndodh tek besimtarët kur fillojnë të jetojnë mbi bazat e identitetit të tyre në Krishtin dhe të aplikojnë përgjatë situatave të përditshme këto të vërteta që u thanë mbi një të krishterë.

Sepse jam në Krishtin

Kur ndjehem i padashur, mund të dijë

Se jam plotësisht i dashur (Kol 3:12).

Asgjë nuk mund të më ndajë nga dashuria e Krishtit (Rom 8:38-39).

Kur nuk mund të pranoj veten time, mund të dije

Se Ai më ka krijuar (Ps 139:13-15).

Ai është në procesin e përshtatjes sime në shëmbëlltyrën e Birit të Tij (Rom 8:29).

Kur ndjehem i dobët dhe i papërshtatshëm, mund të dijë se

Jam i plotë në Të (Kol 2:10).

Ai më ka dhënë çdo gjë që më nevojitet për jetën dhe perëndishmërinë (2 Pjet 1:3).

Mund të mbështetem në fuqinë e Tij (Fil 4:13).

Kur ndjehem vetëm, mund të dijë se

Ai është gjithnjë me mua (Ps 139:5-12).

Mund të lidhem me Perëndinë në lutje (Heb 10:19).

Ai kurrë nuk do të më braktisë (Heb 13:5; Ps 27:10).

Kur jam i shqetësuar, mund ta dijë se

Nuk kam nevojë të shqetësohem për asgjë dhe mund të kem paqen e Tij (Fil 4:6-7).

Mund t'ia dorëzoj Atij shqetësimet e mia (1 Pjet 5:6-7).

Kur kam frikë, mund ta dijë se

Unë mund t'i besoj Atij që të kujdeset për mua (Ps 91).

Ai është me mua në çdo sprovë që përballem (Isa 43:1-3).

Kur jam i tunduar që të bëjë të keqen, mund të dijë se

Unë kam fuqi mbi mëkatën më anë të Frymës së Shenjtë (Rom 6:14).

Unë kam mundësinë të zgjedh që t'i shërbej o mëkatit o Perëndisë (Rom 6:1).

Kur ndjehem se jam i dënuar, mund ta dijë

Se jam plotësisht i falur për mëkatet e mia të kaluara, të tanishme dhe ato të së ardhmes. (Kol 2:13-14).

Nuk do të përballem me dënimin (Rom 8:1).

Unë qëndroj në mëshirën e Tij (1 Pet 2:10).

Kur ndjej se dua të dorëzohem, mund ta dijë se

Ai është duke punuar që çdo të bashkëveprojë për të mirë (Rom 8:28).

Vuajtja ime e tanishme nuk mund të krahasohet me lavdinë

që do të përjetojë në praninë e Tij (Rom 8:18).

Jeta e krishterë, pra, është proces që na bënë ata që jemi, që na adapton në identitetin tonë të ri, dhe na mundëson të reflektojmë sferën e re të Frymës në të cilën jetojmë. **E vërteta e identitetit tonë të ri duhet të bëhet bindja e qëndrueshme e zemrave tona.** Ne duhet që vazhdimisht t'ia përkujtojmë vetvetes që ne më nuk jemi ata që kishim qenë dikur.

Për ne si besimtar është thelbësore ta kuptojmë identitetin tonë të ri sepse ky identitet i ri është identiteti ynë i vërtetë. Një shembull nga natyra e ilustron këtë të vërtetë. Një studim i gjetheve zbulon se ato në të vërtetë nuk e ndërrojnë ngjyrën në vjeshtë. Në të kundërtën, klorofili që ka shërbyer si maskë për gjethen, ai zhduket, dhe pastaj gjethja zbulon ngjyrën e vet të vërtetë – të kuqe, të verdhë, apo të portokalltë. Ky identitet i vërtetë ka ekzistuar përgjatë tërë kohës, vetëm se nuk ka qenë i zbuluar. Kështu, ekzistojnë shumë besimtarë që jetojnë pa një njohuri mbi identitetin e tyre të vërtetë në Krishtin.



Shqyrto ndryshimet në jetën e besimtarit dhe mendo se si mund t'i ndash ato me dikë si Alena. Bë një përmbledhje të secilit aspekt “të jetës sonë të re në Krishtin” në atë mënyrë që të mund të ndash me Alenën për ta inkurajuar atë.



Shqyrto njësinë “Jeta Jonë e Re në Krishtin.” Si e ndikojnë këto të vërteta jetën tuaj dhe zgjedhjet tuaja si një i krishterë? Shkruaj se cilat aspekte të identitetit tënd në Krishtin janë më inkurajueset për ty. Nga pjesa “Sepse jam në Krishtin” identifikoj se si disa nga këto mendime janë ngushëlluese për ty, duke të ndihmuar ty që të vazhdosh jetën tënde në Krishtin.



Merr pak kohë për të reflektuar mbi këto të vërteta në lidhje me jetën tënde të re në Krishtin dhe identitetin tënd si një ndjekës i Krishtit dhe falëndero Perëndinë për atë që të ka dhënë ty në Krishtin.

Burimet tona të reja



Jo vetëm që kemi nevojë të jemi në dijeni për jetën tonë të re dhe identitetin tonë të vërtetë, mirëpo gjithashtu është esenciale që të jemi në dijeni edhe për burimet që Perëndia na ka dhënë për të jetuar jetën e krishterë. Tregohet për një lypës i cili kishte trashëguar një milion dollar nga një i afërm i pasur dhe për kundër kësaj ai vazhdonte të jetonte në rrugë në një varfëri të mjerë. Edhe

pse ai i kishte burimet për të jetuar në rehati, ky njeri kurrë nuk shkoi në bankë për të bërë një tërheqje të thjeshtë të pasurisë që i ishte transferuar në llogarinë e tij.

Ka shumë të krishterë që e jetojnë jetën e tyre pak a shumë në këtë mënyrë, pa e kuptuar dhe pa i përvetësuar burimet e pasuara që na janë dhënë “në Krishtin” për të na mundësuar neve që të jetojmë jetën e krishterë dhe që të rritemi në shenjtëri. **Këtë proces të rritjes në shenjtëri Bibla e quan shenjtërim.**

Tek 2 Pjetri 1:3 Pjetri thotë se “fuqia e Tij hyjnore na dhuroi të gjitha gjërat që i takojnë jetës dhe perëndishmërisë, me anë të njohjes së atij që na thirri me lavdinë dhe virtytin e vet.” Ky varg na siguron se ne i kemi të gjitha burimet që na nevojiten për të jetuar një jetë të perëndishme. Ne jemi të bashkuar me Krishtin. Ne kemi një identitet të ri dhe një jetë të re brenda nesh. Jo vetëm kaq, ne kemi vetë personin e Perëndisë që jeton brenda nesh.

Në mënyrë që të shfaqet më shumë jeta jonë e re, ne duhet të mbështetemi në Krishtin dhe fuqinë e Frymës së Shenjtë. Krishti thotë, “Ai që beson në mua, siç ka thënë Shkrimi, nga brendësia e tij do të burojnë lumenj uji të gjallë”(Gj.7:38). Uji i

gjallë – Fryma e Shenjtë – është brenda nesh. Në Të ne kemi një burim të pasur dhe që mbushet gjithnjë me jetë dhe fuqi.



Teksa lexoni përgjatë gjithë këtij mësimi, vini re se çfarë mësoni në lidhje me shenjtërimin: çfarë është ai, si ndodh, dhe kush është i përfshirë. Në fund të mësimit, bëje një përmbledhje të shkurtër se si e kupton shenjtërimin ti.

Rruga për tek Shenjtëria

Është qëllimi i Krishtit që ta prezantoj çdo besimtar përpara Perëndisë shenjtore, faqebardhë dhe të pafajshëm (Kol1:22) Si mund të bëhemi të shenjtë? Bibla flet për dy lloj shenjtëri. E para është shenjtëria që e posedojmë në Krishtin me anë të besimit. E dyta është një shenjtëri e cila rritet ditë për ditë teksa rritemi në dashurinë tonë për Perëndinë dhe teksa ecim në pajtueshmëri me Frymën.



Lexo Hebrenjve 10:10-14. Sipas autorit çfarë është e vërtetë për besimtarët?



Autori këtu flet për faktin se ne si besimtarë jemi të shenjtë për shkak se shenjtëria e Krishtit na është veshur. Megjithatë çdo besimtar shkon nëpër një proces të rritjes në shenjtëri. Të dyja këto aspekte mbështeten në veprën e Krishtit – i cili **është** shenjtëria jonë. Sa më shumë që të jetojmë në këtë të vërtetë, aq më shumë do të çlirohemi nga përpjekjet për ta kënaqur Perëndinë me fuqitë tona. Në të kundërtën, ne do të fillojmë që të mbështetemi sa më shumë në jetën e Krishtit dhe shpengimin e Tij.

Beteja e përbrendshme

Teksa flasim për procesin e shenjtërimit, e rritjes për t'u bërë më shumë si Krishti, ne duhet ta kemi të qartë se vetë ne e kemi të pamundur që të prodhojmë karakterin e krishterë. Në Mësimin 1 ne e paraqitëm shpëtimin si mbërthimin e xhakëtës së shpëtimit i cili na ofrohet neve. Pasi ta kemi marrë xhakëtën e shpëtimit në Krishtin, shumë prej nesh tundohemi që ta heqim dhe të provojmë të notojmë në oqean përsëri me anë të forcave tona.

Ne duhet të bindemi se burimet tona janë plotësisht të pamjaftueshme, jo vetëm për shpëtim, por edhe për të jetuar jetën e krishterë. Mbase mund të kemi tendencat më të

mira, mirëpo mundësia për të jetuar këtë jetë në mënyrën se si i pëlqen Perëndisë dhe i sjell lavdi Perëndisë (Rom 7:14-23) nuk është në ne. Shpesh, besimtarët zhgënjehen kur shohin se edhe pse e kanë marrë dhuratën e shpëtimit nga Perëndia, ata prapë vazhdojnë të mëkatojnë. Pali e trajton këtë çështje tek Romakëve 6 dhe 7.

Lexoni Romakëve 6:12-23. Pali mëson në këtë pasazh se edhe pse një besimtar është i vdekur ndaj fuqisë së mëkatit, natyra e mëkatit mbetet, e lidhur ngushtë për këtë trup të mishit. Pa marrë parasysh se sa shumë mundohemi ne si të krishterë, ne kurrë nuk do të kemi mundësi që ta përmirësojmë natyrën tonë mëkatore. Mishit jonë çdo herë do të mbetet mish. Kjo shpjegon se pse edhe një i krishterë i rritur herë pas here e gjen veten duke menduar mendimet më të këqija apo duke bërë gjëra, për të cilat ai e din se janë në kundërshtim me rrugët e Perëndisë. Pali deklaron se mëkati nuk ka më aq kontroll në jetën e besimtarit sa që ka pasur më përpara. (v. 14). Më përpara kemi qenë skllëvër të mëkatit, por Perëndia na ka çliruar (v. 16-18), dhe tani jemi bërë skllëvër të bindjes, e cila na çon drejt shpengimit. Për këtë arsye ne duhet t'i paraqesim trupat tonë si skllëvër të shpengimit (v.19).

Në praktikë, kjo nënkupton se ne kemi një mundësi për t'i thënë mëkatit po ose jo. Mëkati mbetet një fuqi e madhe kundërshtuese në jetët tona, mirëpo mëkati më nuk është zotëria të cilit ne duhet t'i bindemi. Zotësia e mëkatit mbi ne është thyer. Tani e kemi zgjedhjen që të bindemi. Në çdo moment të dhënë ne zgjedhim t'i shërbejmë ose mëkatit ose Perëndisë. Është e pamundur që të jemi të përkushtuar edhe ndaj mëkatit edhe ndaj drejtësisë në të njëjtën kohë.

Mëkati mbetet një fuqi e madhe kundërshtuese në jetët tona, mirëpo mëkati më nuk është zotëria të cilit ne duhet t'i bindemi. Zotësia e mëkatit mbi ne është thyer.



Lexoni 1Gjoni 1:8-10, Jakobi 3:2, dhe Filipianëve 3:12. Si e përgënjeshtrojnë këto vargje mundësinë e përsosmërisë në jetën e besimtarit?

Pali thotë se ne jemi të vdekur për mëkatin (Rom. 6:11), duke nënkuptuar se zotësia e mëkatit në jetën e besimtarit është e thyer. Ai vë në pah se fuqia e mëkatit vazhdon të jetë e pranishme në ne dhe se ne duhet që vazhdimisht të zgjedhim që t'ia japim vetën tonë Perëndisë për shpengim. Ekziston një dallim në mes të një besimtari që mëkaton dhe atij i cili vazhdimisht gjen kënaqësi në mëkat.



Lexoni Romakëve 7:14-24. Pali rrëfen dilemën e të krishterit, i cili tani e gjen veten me një konflikt përbrenda natyrës së tij mëkatore dhe jetës së tij të re në Krishtin.

1. Jep një përmbledhje se si Pali e përshkruan këtë vështirësi?
2. Çfarë përfundimi mund të jepni ju nga kjo?

Pali e ka kapur në këto vargje dekurajimin dhe zhgënjimin që sigurisht çdo besimtar ka ballafaquar, dijeninë e të dyjave – dëshirës për të bërë mirë dhe joshjen e fuqishme për të bërë të keqen. Vini re se në vargjet 20-21 Pali thotë, “Edhe, në qoftë se bëj atë që nuk dua, s’jam më vetë ai që e bëj, por është mëkati që banon në mua. Unë, pra, po zbuloj këtë ligj: duke dashur të bëj të mirën, e keqja gjendet në mua.”

Shpëtimi

Pali e mbyll me një thirrje pasionante, duke shprehur pikëllimin e tij të dëshpëruar në faqen e kësaj dileme. “Kush do më çlirojë nga trupi i kësaj vdekjeje?” Ai e kupton ashpërsinë e problemit: vdekja është në të, në çdo pjesë të trupit të tij. Nëse letra e Palit drejtuar Romakëve do të përfundonte këtu, ne do të ishim mjeranët më të mëdhenj si besimtarë, mirëpo Pali vazhdon tutje duke ngritur zërin lart, duke thënë: “I falem nderit Perëndisë me anë të Jezus Krishtit, Zotit tonë.” Ai e kupton se Perëndia është i Vetmi i cili mund ta shpëtojë atë dhe se ky shpëtim në fakt është përmbushur me anë të vdekjes dhe ringjalljes së Birit të Tij.

Fuqia e Frymës së Shenjtë brenda nesh

Fitorja jonë mbi pagën e mëkatit është përmbushur nëpërmjet Krishtit. Për të na ndihmuar neve në betejën e vazhdueshme kundër natyrës sonë mëkatore dhe kundër Satanait, neve na është dhënë burimi i Vetë Personit të Perëndisë, i cili banon në ne.



Lexo Romakëve 8:1-8.

1. Çfarë kanë përmbushur vdekja dhe ringjallja e Krishtit për besimtarët (v.1-4)?
2. Ne kemi një zgjedhje. Cila është ajo?

Lajmi i mirë që kundërshton situatën e mjerë të përshkruar tek Romakëve, kapitulli i 7, është se, edhe përkundër luftës brenda besimtarit dhe prezencës së vazhdueshme të natyrës mëkatore, ne si besimtarë kurrë nuk do të përballemi me dënimin e përjetshëm. Kur Jezusi vdiq, Ai e mori dënimin mbi Vetën e Tij dhe na çliroi neve nga përgjegjësia e mbajtjes së ligjit për të fituar shpëtimin. Sipas fjalëve të Palit, besimtari tashmë është

“në Frymë”, i ndarë nga sfera e mëkatit dhe nga vdekja. Tani ne mund të ecim dhe të rritemi në shenjtëri për shkak që Fryma e Shenjtë banon në ne.

Ai na nxit neve që si besimtarë të kemi mendjet tona në Frymë. Tek Romakëve 8:9-11 ai thotë se Fryma e njëjtë që ringjalli Jezusin nga vdekja, po kjo Frymë banon në ne, dhe po kjo Frymë do t’i jep jetë trupave tonë të vdekshëm. Çfarë e vërtetë e mahnitshme dhe transformuese për t’u soditur, që Ai, i cili pati fuqinë ta ngrejë Vetë Birin e Perëndisë nga vdekja, po Ai jeton brenda nesh. Ç’burim tjetër më të madh do kishte pas mundësi të na jepte Perëndia për të jetuar jetën e krishterë? Ai na ka dhënë Frymën e Shenjtë që të jetojë për brenda nesh, të na drejtojë dhe të na mësojë. Nëse Fryma është në gjendje të ringjall trupat tonë të prishur dhe të vdekshëm, aq më shumë Ai është në gjendje që t’i bëjë të vdekshme edhe veprat e natyrës tonë të vjetër.

Një ditë do të jemi të lirë nga natyra jonë mëkatore dhe trupat tonë do të përlëvdohen. Deri sa të vijë ajo ditë, ne do të vazhdojmë të kemi vështirësi me natyrën tonë të vjetër. Për më tepër Fryma që është në ne, që është jetë, është çdo herë prezent për të na ndihmuar neve.



Përkruaj përvojën tënde apo vështirësinë me natyrën mëkatore. Në çfarë fusha identifikohesh ti me Palin kur ai thotë, “duke dashur të bëj të mirën, e keqja gjendet në mua”? Në këtë pjesë, cila është ndihma apo inkurajimi që ju keni zbuluar në lidhje me këtë dilemë?

Është e rëndësishme për ne që të kemi një pamje të qartë të burimit të fuqishëm që Perëndia na ka dhënë si bijtë e Tij në Personin e Frymës së Vetë Perëndisë. Fryma e Shenjtë shpesh është keqkuptuar apo keqinterpretuar, si historikisht ashtu edhe në ditët e sotshme. Le të shikojmë se çfarë na mëson Bibla rreth Frymës së Shenjtë dhe marrëdhënien e Tij me jetën e besimtarit.

Fryma e Shenjtë është Perëndia

Fryma e Shenjtë përshkruhet në Shkrim se posedon atributet apo cilësitë e Perëndisë. Tek Veprat e Apostujve 5:3-4 thuhet se të gënjesht Frymën e Shenjtë është barazi me të gënjerit ndaj Perëndisë



Lexoni këto vargje dhe tregoni se cili atribut i Perëndisë i është atribuuar Frymës së Shenjtë në secilin varg:

1. Luka 1:35; Mateu 12:28
2. Psalmi 139:7-13
3. 1 Korintasve 2:9-11
4. Gjoni 16:13

5. Hebrenjve 9:14

Përveç posedimit të attributeve të Perëndisë, Fryma e Shenjtë gjithashtu atribuohet për kryerjen e veprave të caktuara që zakonisht i atribuohen Perëndisë.



Lexoni vargjet në vijim dhe tregoni se cila vepër i atribuohet Frymës së Shenjtë në secilin varg?

1. Zanafilla 1:2
2. Gjoni 3:5-8; Titit 3:5
3. Romakëve 8:11
4. 2Timoteu 3:16; 2Pjetri 1:21

Fryma e Shenjtë gjithashtu është e lidhur me Atin dhe me Birin në kohë të ndryshme përgjatë shërbesës së Jezusit, veçanërisht tek pagëzimi i Jezusit (Mat. 3:16-17), ku Fryma u paraqit në formën e një pëllumbi, përderisa zëri i Atit deklaroi që Jezusi ishte Biri i Tij i dashur. Në shumë faqe Fryma e Shenjtë ndërlidhet me Atin dhe me Birin në baza të barabarta (Mat. 28:19-20).

Si plotësisht i shenjtë, Fryma e Shenjtë është i denjë të marrë nderin dhe frikën e njëjtë që duhet të jetë ndaj Atit dhe Birit. Fatkeqësisht, përgjatë historisë dhe në ditët e sotshme Fryma e Shenjtë është keqkuptuar shpesh. Herezi të ndryshme në vitet e hershme të historisë së kishës e kanë çuar Atë në një status më të ulët se ai i Perëndisë At dhe Perëndisë Bir.¹

Fryma e Shenjtë është një Person

Fryma e Shenjtë është një person i cili posedon të gjitha cilësitë që përfshijnë personalitetin. Ai nuk prezantohet si një influencë abstrakte, forcë apo energji e mjegullt. Si një Person, Fryma e Shenjtë është ai me të cilin mund të kemi një marrëdhënie personale.

Tendenca jonë mund të jetë që të mendojmë për Krishtin në një mënyrë më personale se sa që mendojmë për Frymën. Është më lehtë të mendosh për Jezusin si një person sepse Ai edhe mori trajtën njerëzore. Madje esenca e personalitetit përshinë emocionet, intelektin dhe vullnetin. Ne mund të kemi një marrëdhënie personale me Frymën e Shenjtë në të njëjtën mënyrë që edhe kemi me Krishtin.

Fryma e Shenjtë na sjell tek Krishti

Jezusi tregoi se Fryma e Shenjtë luan një rol kyç në kthimin e secilit besimtar. Pa punën e Frymës së Shenjtë, i cili e bind botën për mëkat, drejtësi dhe gjykim (Gjoni 16:8-11), asnjë njeri nuk do të kthehej në besim. Në Mësimin 1 ne pamë ballafaqimin

e Jezusit me Nikodemin, një krerë fetar jude. Jezusi e bëri të qartë se lindja shpirtërore është një gjë mbinatyrore dhe se kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet Frymës së Shenjtë (Gjoni 3:5-6; Romakëve 5:5).

Nënkuptimi i kësaj është se ne kemi nevojë ta thërrasim Frymën e Shenjtë dhe të mbështetemi në Të për të shpallur fajtorë dhe për të bindur të dashurit tanë për nevojën tyre që kanë për shpëtim dhe për të hapur sytë e tyre për të vërtetën e dashurisë së Perëndisë për ta.



Si mbështeteni në Frymën e Shenjtë teksa luteni për të tjerët që të vijnë tek Krishti dhe teksa mundoheni të flisni me ta në lidhje me ungjillin?

Fryma e Shenjtë banon në çdo besimtar

Teksa shërbesa e Jezusit në tokë po përfundonte dhe Ai u takua me dishepujt e Tij ne dhomën e sipërme në natë n para se të kryqëzohej, Ai i ngushëlloi ata me këto fjalë: “Dhe unë do t’i lutem Atit dhe ai do t’ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju, Frymën e së Vërtetës, që bota nuk mund ta marrë, sepse nuk e sheh dhe nuk e njeh; por ju e njihni, sepse qëndron me ju dhe do të jetë në ju.” (Gjn 14:16-17).

Jezusi u premtoi ndjekësve të Tij se Ai do të dërgonte Frymën e Shenjtë për të banuar në ta. Në trupin e Tij tokësor, Jezusi nuk mund të paraqitej në çdo vend; për këtë arsye, ndikimi i Tij ishte i kufizuar në gjerësinë e vetë. Kur Jezusi u ngrit në qiell, Ai u tha dishepujve që të prisnin për ardhjen e Frymës së Shenjtë, i cili do t’u jepte fuqinë për t’u bërë dëshmitarët e Tij (Veprat e Apostujve 1:4-8). Ky premtim u përmbush në ditën e Rrëshajave, kur njëqindënjëzet dishepujt e pranuan Frymën e Shenjtë. Pjetri predikoi atë ditë, gjë që rezultoi në përgjigjen e tre mijë njerëz ndaj Ungjillit me anë të pendimit dhe besimit; ata gjithashtu e pranuan Frymën e Shenjtë.

Kur një person përgjigjet ndaj dhuratës së Krishtit për shpëtim me anë të besimit, ai person pranon faljen e mëkateve dhe bashkë me të edhe dhuratën e Frymës së Shenjtë. Prania e Frymës që banon është shenja që tregon se një person i takon Krishtit (Rom 8:9). Çdo besimtar posedon Frymën e Shenjtë, si një burim të brendshëm, e që e kalon jashtë mase praninë e kufizuar të Krishtit.

Fryma Shenjtë është aktiv në jetën e të krishterit

Sapo Ai të fillojë të banojë në ne, Fryma e Shenjtë fillon punën e Tij për të na shenjtëruar neve. Prezenca aktive e Frymës së Shenjtë në jetën e besimtarit është forca që sjell transformimin dhe rritjen në karakterin e perëndishmërisë. Nga fillimi deri në fund Fryma e Shenjtë është aktiv në procesin e shpëtimit tonë.

Përveç rolit të Tij si agjent i rigjenerimit, Fryma vazhdon punën e Tij brenda nesh, duke na ndihmuar që të tejkalojmë zakonet tona të mishit dhe të prodhojë në ne një set cilësish të cilat bashkërisht referohen si “fryti i Frymës” (Gal 5:22-23). Këto cilësi janë rezultat i punës mbinatyrore të Frymës brenda nesh.

Ndikimi i Frymës së Shenjtë në jetën e besimtarit mund të shihet në shumë aktivitete që i atribuohen Atij.



Lexoni vargjet në vijim dhe përshkruani veprën apo aktivitetin e Frymës në jetën e të krishterit. Si e keni përjetuar punën e Frymës së Shenjtë në secilën fushë të përshkruar si më poshtë?

Gjoni 14:26

Gjoni 15:26

Gjoni 16:13

Veprat e Apostujve 1:8

Veprat e Apostujve 9:31

Romakëve 5:3-5

Romakëve 8:13-14

Romakëve 8:15-17

Romakëve 8: 26

Romakëve 15:13

1Korintasve 2:9-13

1Korintasve 12:7-11

2Korintasve 1:22; Efesianëve 4:30

Këto shërbesa në jetën e besimtarit janë themelore përgjatë procesit të shenjtërimit. Fryma e Shenjtë është Ai i cili sjell shenjtërimin tonë. Jeta në Krishtin quhet jeta në Frymë.

Duke ecur në Frymë. Cila është përgjegjësia jonë në të jetuarit e jetës së krishterë? Në shumë pasazhe të Dhiatës së Re, si Romakëve 8:1-17, Galatasve 5:16-26, dhe Efesianëve 5:15-21, Pali e mëson të vërtetën në lidhje me atë se ne besimtarët nuk jemi më në botën e mishit, por jemi në botën e Frymës (shiko Rom. 8:9). Kjo e vërtetë e bënë Palin që të na këshilloj neve, “Tani, jetoni në këtë mënyrë. Ecni në Frymë.”

Të ecësh në Frymë është procesi ditor i zgjedhjes për të bërë dhe menduar ato gjëra që janë në harmoni me Frymën, dhe jo me mishin. Teksa e bëjmë këtë, ne shfaqim fuqinë dhe praninë e banueshmërisë së Frymës në ne. Dhe teksa vazhdimisht zgjedhim që të ecim në Frymë, ne rritemi shpirtërisht, duke u përshkuar nga ajo që është e perëndishme dhe e shenjtë – e që është karakteri i Frymës.

Pengimi i Frymës së Shenjtë (trishtimi dhe shuarja e Frymës). Pali e bënë të qartë se ne mund ta pengojmë shërbesën e Frymës së Shenjtë në jetët tona. Janë dy fjalë

në Dhjatën e Re të cilat e përshkruajnë këtë pengesë: “trishtoj” (Ef 4:30) dhe “shuaj” (1 Thes 5:19). Të shuash diçka do të thotë ta asgjësosh apo fikësh atë. Kështu, ne mund ta fikim zjarrin e Frymës së Shenjtë në jetët tona dhe ta pengojmë Atë që ta kryej punën e Tij.

Shuarja e Frymës shpesh paraqitet tek besimtarët si një gjendje kur ata thonë ‘jo’ kur Fryma është duke thënë ‘po’. Trishtimi i Frymës mund të shihet si një gjendje kur besimtari thotë ‘po’ për diçka që Fryma veçse ka thënë ‘jo’ në Fjalën e Tij. Ne bëjmë zgjidhje që e trishtojnë dhe shuajnë Frymën, apo ne bëjmë zgjidhje që e lejojnë Atë të punojë në ne dhe nëpërmjet nesh.



Mendo në lidhje me disa zgjedhje nëpërmjet të cilave të është dashur të kalosh, të cilat mbase e kanë trishtuar apo shuar Frymën në jetën tënde. Shkruaj këto në fletoren tënde.

Shkruaj disa zgjedhje të cilat ti i ke bërë dhe që e kanë lejuar Atë të punoj në ty dhe nëpërmjet teje.

Fryma e vulos besimtarin. Dhiata e Re na mëson se besimtari është i vulosur nga Fryma e Shenjtë. Koncepti i një vule është një metaforë komerciale, i marrë nga transaksionet e biznesit në botën antike. Në shekullin e parë një vulë shpesh është vendosur në dokumente apo ligje. Shpesh një vulosje e gdhendur apo e vulosur është bërë me dyllë, duke bartur një dizajn apo shenjë të pronarit apo dërguesit. Sa i përket ligjit, vula i ka dhënë vlefshmëri dokumentit apo ka garantuar vërtetësinë e tij. Prania e një vule paraqet pronësi dhe autenticitet.²



Lexoni 2Korintasve 1:21-22 dhe Efesianëve :13-14.

Si i përshkruan Pali besimtarët? Si përshkruhet këtu Fryma e Shenjtë?

Në këto dy pasazhe si dhe tek Efesianëve 4:30 Pali tregon se Fryma e Shenjtë i jepet besimtarëve si një premtim dhe si një dhuratë për shpengimin e tyre përfundimtar. Vetë Fryma e Shenjtë është vula, me anë të së cilës Perëndia ka shënuar çdo besimtar duke i deklaruar se janë të Tijtë. Perëndia i konfirmon ata, pasi t’i ketë vulosur me anë të dhënies se Frymës së Shenjtë si depozitën e Tij për të ardhmen e tyre të sigurt. Fryma është garantuesi aktual që besimtari do të kompletojë të tërë procesin e shpëtimit – nga shfajësimi në shenjtërim deri në përlëvdim.

Perëndia, duke na dhënë neve Frymën e Shenjtë, e obligon Vetveten që të përmbush kontratën e Tij, që është besëlidhja e Tij me besimtarët. Kjo marrëveshje fillon me shpëtimin dhe do të mbarojë kur besimtarët të marrin trupat e tyre të përlëvduar. Përderisa njerëzit mund ta shkelin një marrëveshje të lidhur, Perëndia asnjëherë nuk e shkel besëlidhjen me njerëzit e Tij. Për këtë arsye, përlëvdimi ynë në

të ardhmen është i sigurt. Çfarë garancie më të madhe do të kishim mundësi të kemi se sa Frymën e Vetë Perëndisë?

Fryma e sjell besimtarin të sigurt në shtëpi. Jezusi me mësimet e tij shpesh i ka siguruar dishepujt në lidhje me natyrën e përhershme të shpëtimit.

Tek Gjoni 14:16-17 Jezusi tha se Ngushëlluesi që do të dërgonte do të ishte me ne gjithmonë. Duke banuar në ne përgjithmonë dhe duke na vulosur ne deri sa shpëtimi ynë të kompletohet, Fryma e Shenjtë sigurohet që ne asnjëherë nuk do të largohemi nga Perëndia apo të rrëshqasim nga duart e Tij.

Bibla na mëson se ne si besimtarë mund të jemi të sigurt, duke e ditur se ne i takojmë Perëndisë dhe jemi anëtarë të përhershëm të familjes së Tij. Disa njerëz mund ta quajnë presupozim apo mendjemadhësi kur besimtarët thonë se janë të sigurt se janë përjetësisht të shpëtuar. Në të vërtetë, do të ishte mendjemadhësi nëse do të kishim të bënim me sigurimin e shpëtimit tonë. Mirëpo ju mund edhe të kujtoni se si tek Efesianëve 2:8-9 Pali thotë që “askush të mos mburret”. Pse? Mburria përjashtohet sepse shpëtimi ynë është plotësisht dhuratë e Perëndisë dhe nuk bazohet në përpjekjet tona (shiko Rom 4:1-5).



Lexoni 1Gjoni 5:11-13 dhe Gjoni 5:24. Çka i shtojnë këto vargje kuptimit tuaj mbi shpëtimin tonë?

Vini re se Gjoni thotë “të dini se keni jetën e përhershme”. Ai nuk thotë “të shpresoni” apo “mund të jeni deri diku të sigurt”. Fjalët “dhe ai nuk vjen në gjyq” tek Gjoni Gjoni 5:24 na tregojnë që në të vërtetë ne “në asnjë mënyrë të mundshme nuk do të gjykohejmë.”

Çfarë sigurie të mahnitshme që i jep Gjoni besimtarëve në këto dy pasazhe: “Kushdo që ka Birin ka jetën” dhe “ka kaluar nga vdekja në jetë” (ESV). Besimtarët nuk duhet të shpresojnë apo të jenë sadopak të sigurt se do të kenë jetë të përhershme. Gjoni thotë se shpëtimi është diçka që e posedojmë tani!

Ne e gjemë këtë të vërtetë të njëjtë të shprehur tek Romakëve 8:1: “Tani, pra, nuk ka asnjë dënim për ata që janë në Krishtin Jezus.” Kjo nënkupton se besimtarët kurrë nuk do të qëndrojnë para Perëndisë për t’u gjykuar në lidhje me të drejtën e tyre për të hyrë në parajsë apo në lidhje me mjaftueshmërinë e drejtësisë së Krishtit si bazën e tyre për shpëtim. Si besimtarë ne do të qëndrojmë para karriges së gjykimit të Krishtit, ku do të vlerësohen veprat tona për të përcaktuar natyrën e shpërblimeve tona në qiell, mirëpo veprat tona nuk do të luajnë asnjë rol në futjen tonë në qiell. Një biletë e tillë për të hyrë ne në qiell është parapaguar nga Vetë gjykatësi, Jezus Krishti.

Është e rëndësishme që besimtarët të kuptojnë këtë të vërtetë dhe t’ia kujtojnë vetvetes sa herë që dyshimi të rritet. Në të vërtetë, të vërtetat biblike të paraqitura në

këtë mësim janë disa nga të vërtetat kyçe që Satanai dëshiron t'i shtrembërojë apo ngatërrojë në mendjet tona. Satanai dëshiron që ne ta vëmë në pikëpyetje masën e përjetshme të Perëndisë për shpëtimin tonë. Ai gjithashtu dëshiron të dekurajojë besimtarët duke na e kujtuar shpesh identitetin tonë të vjetër dhe duke na bindur se ne dështojmë nga standardet e Perëndisë dhe se duhet të punojmë më shumë për ta kënaqur Atë.

Një rrugë tjetër e sulmit i përket burimeve tona të rritjes në shenjtëri. Satanai vazhdimisht do të na sjell mendime të cilat na sugjerojnë se ne jemi vetë, se ne nuk mund të jemi ndryshe nga ç'jemi dhe se ne kurrë nuk do të përmirësohemi. Këto mendime nuk janë mendimet e Perëndisë për ne. Vetëm kur të ngulitemi fuqishëm në të vërtetat që ndërlidhen me identitetin tonë të ri në Krishtin dhe fuqinë tonë të re, ne mund t'i përdorim ato si armë për të luftuar sulmet e djallit.



Me çfarë sulme je ballafaquar nga Satanai në një apo më shumë fusha që u përmendën më sipër? Si do ta kishit kundërshtuar mendimin tuaj paraprak në këtë fushë me të vërtetat që janë paraqitur në këtë mësim?



Lexoni Gjoni 10:27-29 dhe Romakëve 8:38-39. Çfarë sigurie mund të gjesh në këto vargje?

Fjalët e Krishtit janë më se bindëse. Ne mund të jemi të sigurt në lidhje me shpëtimin tonë, duke e ditur se jo vetëm që jemi të vulosur me anë të banimit të Frymës në ne, mirëpo edhe se ne jemi në duart e forta të Atit dhe të Birit. Vini re se Krishti thotë se ne **kurrë** nuk do të humbasim. Jeta që Ai na jep është jetë e **përjetshme**. Buron nga jeta e Krishtit dhe ka vlerë të përjetshme, jo vetëm për të na shpëtuar, mirëpo edhe për të na ruajtur nga rënia.

Tani ne jemi të mbuluar përgjithnjë me drejtësinë e Krishtit, dhe ne mund t'i afrohem Perëndisë në bazat e gjakut të Krishtit, i cili na ka pastruar nga çdo mëkat, dhe drejtësinë e Krishtit, e cila na lejon që të qëndrojmë në praninë e Krishtit. Çfarë do të mund t'i shtonim kësaj sakrifice të përjetshme për ta bërë më mirë apo për ta ruajtur nga vyshkja?

Shumë të krishterë e kanë të vështirë ta besojnë këtë të vërtetë dhe shqetësohen sa herë që të mëkatojnë duke u frikësuar se Perëndia do t'i refuzojë ata. Kjo frikë bazohet në keqkuptimin e hirit të Perëndisë dhe të natyrës së sakrificës së Krishtit dhe jetën e ringjallur që besimtari e posedon.

Jeta e përjetshme është e përjetshme. Nëse besojmë se mund ta humbasim shpëtimin tonë kur të mëkatojmë, në të vërtetë ne jemi duke thënë që për ne gjaku i Jezusit nuk ka qenë i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha mëkatet tona. Kur ne

vazhdojmë të përpiqemi që të paguajmë për shpëtimin tonë, ne tregojmë se sa pak e kemi kuptuar hirin dhe mbi të gjitha sa pak e kemi kuptuar dashurinë e pakusht. Kjo është njëjtë sikur të shkosh në bankë dhe të provosh të paguash një kredi e cila tashmë është vulosur me shkronjat “E Paguar Plotësisht”. Perëndia dëshiron që ne ta përjetojmë lirinë dhe gëzimin që vije me njohurinë që borxhi ynë është paguar plotësisht.



Zgjedh dy vargje që të mbash mend, të cilat do të ndihmojnë që të jesh i sigurt në lidhje me natyrën e përjetshme të shpëtimit tuaj.



Shqyrto veprën e Frymës së Shenjtë në jetën e besimtarit, dhe merr ca kohë që të shqyrtosh marrëdhënien tënde me Frymën e Shenjtë. Teksa e vlerëson njohurinë tënde të tanishme mbi praninë dhe fuqinë e Tij në jetën tënde, shkruaj më poshtë përgjigjet tuaja për pyetjet në vijim:

1. A mendon se Fryma e Shenjtë është një Person? Në çfarë mënyra?
2. A e dëgjon zërin e Tij dhe a mbështetesh në Frymën e Shenjtë për të udhëhequr dhe për të vepruar në jetën tënde, apo merr ti kontrollin e plotë pa i dëgjuar fare këshillat e Tij? Si mund të rritesh në këtë fushë që t’ia lësh kontrollin Frymës së Shenjtë?
3. Medito mbi shërbesën e Frymës së Shenjtë në jetën tënde dhe identifiko çfarëdo fushe të mëkatit në jetën tënde që ti nuk e ke rrëfyer dhe që ti nuk ke dëshirë t’ia dorëzosh Perëndisë nën kontrollin e Tij? Çfarë duhet të bësh në lidhje me këtë?
4. A po mundohesh të prodhosh bindje pa u mbështetur në Frymën e Shenjtë?



Merr ca kohë që ta falënderosh Perëndinë për burimet mbinatyrore që Ai të ka dhënë ty për të të mundësuar që të jetosh jetën e krishterë dhe për të vërtetën që Ai do t’ju sjell të sigurt në shtëpi, duke kompletuar procesin e shpëtimit. Falënderoje Atë për shërbesat e shumta të Frymës së Shenjtë në jetën tënde.

Mendime përmbyllëse

Perëndia na ka dhënë burimet që ne na nevojiten për të jetuar jetën e krishterë. Si besimtarë neve na është dhënë një jetë e re që gjen kënaqësi në gjërat e Perëndisë. Ne gjithashtu kemi një identitet të ri si fëmijë të Perëndisë dhe një pozitë të re dhe të përhershme të drejtësisë përpara Tij. Ne më nuk jemi skllëvër të mëkatit por kemi mundësi që të zgjedhim që të bindemi me anë të fuqisë së re që banon brenda nesh – Fryma e Shenjtë. Kur e lejojmë Frymën e Perëndisë që të na kontrollojë, ne zgjedhim të bëjmë ato gjëra që e kënaqin Perëndinë, duke rezultuar në një mënyrë të re të jetesës. Shenjtëria personale nuk mund të prodhohet ndaras nga Fryma e Perëndisë që është në ne. Procesi i shpëtimit tonë është në duart e Perëndisë që nga fillimi deri në fund. Në mësimin e radhës ne do të shikojmë në frytin e Frymës në jetën e besimtarit dhe në procesin e rritjes dhe pjekurisë.

Fusnotat

1 Jo çdo përdorim i fjalës “mish” në Bibël nënkupton natyrën mëkatore

2 Shiko Richard J. Faichild “ By changing your minds”
<https://www.rockies.net/1spirit/sermons/a-or22se.php>

3 William Hendricksen, *New Testament Commentary, Romans* (Grand Rapids, MI: Baker, 1981), 253.

⁴ Gordon D. Fee, *God’s Empowering Presence: The Holy Spirit in the Letters of Paul* (Peabody, MA: Hendrickson, 1994), 292.

Duke i ngjarë më shumë Krishtit

Samueli është besimtar që nga mosha e tij e re. Prindërit e tij e sollën në kishë që kur ai ishte një fëmijë. Ai e kuptoi se Krishti kishte vdekur në kryq për mëkatet e tij kur ai ishte në Shkollën e së Dielës. Mirëpo, pastori gjithnjë flet rreth një jete të ndryshuar, dhe jeta e Samuelit nuk është që ka ndryshuar edhe aq shumë. Në moshën 28 vjeçare ai ndjehet larg nga Perëndia dhe e ka shumë të vështirë ta dojë Perëndinë. Nëna e tij i thotë që ta lexojë Biblën më shumë, mirëpo kur ai provon ta lexojë atë, ajo duket e thatë dhe e vështirë për t'u kuptuar. Njerëzit e tjerë ngazëlleheshin rreth besimit të tyre, mirëpo Samueli nuk dëshiron të quhet fanatik. Ai mendon me vete, “ndoshta mund të shkoj në studim Bible”, mirëpo gjithmonë ndodh që studimi mbahet mbrëmjeve kur ai duhet të luajë futboll me shokët e tij.

Çfarë vendime ka marrë Samueli të cilat e kanë ndaluar atë nga rritja në pjekuri? Si kanë ndikuar veprimet e tij nga të menduarit e tij? A keni përjetuar ndonjëherë ndjenja të tilla?



Në Mësimet 1 dhe 2 ne kemi vendosur themelin e jetës së krishterë. Ne kemi parë që shpëtimi ynë varet plotësisht nga Krishti, nga fillimi deri në fund. Një besimtar shpallet i drejtë sepse Jezusi pagoi dënimin për mëkatet tona. Shfajësimi ynë jo vetëm që bazohet në drejtësinë e Tij, mirëpo edhe procesi i shenjtërimit tonë pushon në drejtësinë e Tij dhe jetën e Tij që na është dhënë neve.

Në Mësimin 2 ne i pamë burimet mbinatyrore që Perëndia i ka dhënë çdo besimtari për të na mundurar neve që të jetojmë jetën e krishterë. Besimtari është “në Krishtin” dhe ka një identitet të ri dhe një zemër të re e cila kënaqet në gjërat e Perëndisë. Fryma e Shenjtë banon në secilin besimtar dhe vulos secilin përjetësisht, *ashtu sikur që një njeri kur bëhet i Krishtit, faktikisht i takon Krishtit*. Ai punon brenda secilit besimtar, duke i mësuar ata, duke i drejtuar ata dhe duke i fuqizuar për të zgjedhur rrugët e Perëndisë.

Në Mësimin 3 ne dëshirojmë të shikojmë procesin e rritjes shpirtërore dhe qëllimin e jetës së krishterë. Perëndia ka diçka në mendje për secilin besimtar, teksa jetojmë nën

zotërimin e Jezus Krishtit duke vënë në përdorim burimet mbinatyrore që Ai na ka dhënë për rritjen tonë.

Plani i mësimit

Rritja drejt pjekurisë është normë

Shtegu drejt pjekurisë

Qëllimi: t'i ngjajmë më shumë Krishtit

Një jetë e dedikuar plotësisht Perëndisë

Një përshkrim i një besimtarit të rritur

Procesi i rritjes dhe transformimit të besimtarit

Zhvillimi i marrëdhënies së ngushtë me Perëndinë

Roli ynë i rritjes në pjekuri

Përcaktimi i karakteristikave të pjekurisë

Rritja e dhënies së dashurisë dhe hirit

Rritja e shërbimit të përlësisë

Mendime përmbyllëse

Qëllimet e mësimit

Kur ta përfundoni këtë mësim, ju do të jeni në gjendje që të:

1. Të konstatosh qëllimin e jetës së krishterë dhe të vlerësosh progresin tënd ndaj këtij qëllimi.
2. Të përcaktosh zotësinë e Krishtit.
3. Të përcaktosh frikën tënde ndaj Perëndisë, dashurinë tënde ndaj Perëndisë dhe dëshirën tënde për Perëndinë.
4. Të shpjegosh procesin e rritjes (1) teksa ndërlidhet me rolin e Perëndisë dhe (2) teksa ndërlidhet me rolin e besimtarit.
5. Të krijosh një plan të rritjes në një apo më shumë fusha të fryteve të Frymës.
6. Të përshkruash “karakteristikat përcaktuese të pjekurisë” dhe të shpjegosh se si ato ndërlidhen me njëra tjetrën dhe me pjekurinë.

Rritja drejt pjekurisë është normë

Një vajzë e sapolindur të cilën e mban nëna e saj në krah duket një portret shumë i bukur. Kjo vajzë e vogël duket se nuk bënë as edhe një gjë për veten e vetë. Ajo nuk merr vendime, nuk i kontribuon kujdesit të saj dhe askujt nuk i jep gjë pos buzëqeshjes së saj të vogël dhe të ëmbël. Ajo mbështetet plotësisht në ekzistencën dhe kujdesin e të tjerëve, duke ofruar vetëm praninë e saj të lezetshme dhe të rehatshme si kompensim për kërkesat e saj. Mirëpo askush nuk merakoset. Foshnjat duhet të jenë të tilla.

Në anën tjetër, një njëzetvjeçare e ulur në prehrin e nënës duke pirë me shishe, do të dukej një pamje për t'u ardhur keq. Vallë, përse? Ne nuk presim që njëzetvjeçarët të veprojnë si foshnjat. Zhvillimi normal i një foshnje përfshinë rritjen drejt pjekurisë. Foshnja rritet për t'u bërë një i rritur duke marr gjithnjë e më shumë përgjegjësinë për veten, duke mësuar të ushqej vetveten dhe të kujdeset për nevojat e veta. Përfundimisht, pritet nga ajo që të jetë në gjendje të kontribuojë në kujdesin dhe mirëqenien e të tjerëve.

Zhvillimi normal i një qenie njerëzore është një analogji me vend për procesin e rritjes shpirtërore. Në nivelin njerëzor ne e përdorim fjalën “pjekuri” për të përshkruar shkallën në të cilën një individ është bërë një anëtar përgjegjës i shoqërisë. Le t'i hedhim një vështrim më të thellë fjalës “pjekuri” dhe të shohim se si aplikohet në jetën shpirtërore të një besimtari.

Shtegu drejt pjekurisë

Pjekuria mund të definohet si shfaqja e vazhdueshme e shëmbëlltyrës së Krishtit në karakterin e besimtarit e që mundësohet nga ana e Frymës së Shenjtë.

Qëllimi i jetës së krishterë është arritja e pjekurisë. Pjekuria mund të përkufizohet si shfaqja e vazhdueshme e shëmbëlltyrës së Krishtit në karakterin e besimtarit e që mundësohet nga ana e Frymës së Shenjtë. Në Dhiatën e Re fjalët më të zakonshme për pjekurinë personale janë “i pjekur”, “i plotë” dhe “i përsosur”.¹

Qëllimi: t'i ngjajmë më shumë Krishtit

Për të na ndihmuar neve në procesin e rritjes si të krishterë, Perëndia neve na ka dhënë shembullin më të mirë për ta ndjekur: Birin e Tij, i cili jetoi një jetë të përsosur dhe sakrifikoi Vetveten për ne (1 Pjet 2:21-25).



Lexoni Kolosianëve 1:28-29. Si e ka shprehur Pali qëllimin e tij për besimtarët e Kolosit?

Mbiemri “i përsosur” në këtë pasazh nuk e ka kuptimin “i pa mëkat” por “i pjekur”. Vini re se qëllimi i Palit ka qenë të paraqes **çdo** besimtar të pjekur dhe të përsosur në Krishtin. Përderisa Pali kishte zemrën e një ungjilltari, ai në të njëjtën kohë ishte i kujdesshëm që të dishepullonte (mësonte) të konvertuarit e rinj në secilin regjion që ai vizitonte. Modeli i tij ishte ky, të rrinte në një vend për disa muaj apo vite duke i mësuar intensivisht në mënyrë që t'i sillte të kthyerit në

besim në çdo fushë në një pikë të pjekurisë. Sa gjatë mund të zgjaste ky proces i arritjes tek pjekuria?

Nga studimet e udhëtimeve misionare të Palit ne e dimë se ai së pari vizitoi Korintin rreth vitit 50 pas Krishtit, dhe kaloi përafërsisht tetëmbëdhjetë muaj atje (Veprat e Apostujve 18:11, 18). Letrën e parë ai ia shkroi Korintit në mes të viteve 50-ta². Nga kjo ne mund të konkludojmë se Pali kishte pritur të gjente një masë të pjekurisë tek besimtarët e Korintit pasi që i kishte mësuar ata për një periudhë shtatë vjeçare. Fatkeqësisht, ne shohim se të krishterët e Korintit kishin devijuar nga shumë probleme dhe nga mësimet e gabuara, kështu që ata kishin dështuar dhe nuk kishin përparuar në jetën e tyre shpirtërore ashtu siç do të duhej të bënin (1Kor 3:1-3).

Duke u shkruar besimtarëve në Korint, Pali thotë se ata do të duhej të ishin në gjendje të asimilonin mishin e Fjalës së Perëndisë, mirëpo ata në të kundërtën ishin akoma duke pirë qumësht. Ata akoma ishin duke jetuar në bazë të natyrës së tyre mëkatore. Më vonë tek 1Korintasve 14:20 Pali i këshillon ata që të jenë të matur në të menduarit e tyre. Këtu ne shohim se rritja për kah pjekuria fillon në të menduarit e besimtarit pasi që Fryma e Shenjtë e përdor Fjalën e Perëndisë për të ndikuar në mendjen e besimtarit. Ne do ta shikojmë më në detaje këtë temë në Mësimin 4.



Lexoni Efesianëve 4:13-16. Çfarë aspekte të rritjes paraqet Pali në këto vargje?

Kur Pali flet për “plotësinë e Krishtit”, ai është duke folur për ngjashmërinë me Krishtin. Qëllimi i tij për çdo besimtar është që ai të bëhet sa më shumë si Vetë Jezus Krishti, duke shfaqur karakterin dhe motivet e Krishtit.

Tek 2 Korintasve 3:18 Pali thotë se edhe ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, transformohemi në të njëjtën shëmbëllim nga lavdia në lavdi. Ne shohim lavdinë e Krishtit fillimisht në Fjalën e Perëndisë. Teksa kalojmë kohë në Fjalën e Perëndisë, Fryma e Shenjtë na vetëdijeson për karakterin e Krishtit dhe motivet e Krishtit dhe na jep ne një dëshirë të thellë për t’i ngjarë më shumë Atij.




Lexoni 1 Gjoni 3:2-3.

1. Çfarë ngjarje është duke u përshkruar në vargun 2?
2. Çfarë është e vërtetë për një besimtar kur një ngjarje e tillë ndodh?
3. Si i këshillon Gjoni besimtarët që të veprojnë në bazë të kësaj shprese?

Teksa Jezusi i mësonte dishepujt e Tij, Ai theksoi të vërtetën që një ndjekës i Krishtit duhet që sa më shumë që të jetë e mundur t'i ngjajë Mësuesit. Kështu ne shohim se qëllimi i jetës së krishterë është që çdo besimtar të rritet në pjekuri, dhe kjo pjekuri të jetë baras me ngjasimin në Krishtin. Ky proces i rritjes, siç mësuam në Mësimin 2, është procesi i shenjtërimit.

Të bëhesh një besimtar i rritur që reflekton shëmbëlltyrën e Krishtit mundësohet nga prania dhe fuqia e Frymës së Shenjtë në jetën e besimtarit. Duke shfrytëzuar burimet mbinatyrore që Perëndia na ka dhënë, i krishteri duhet të rritet në perëndishmëri, duke u bërë gjithnjë më shumë si Jezus Krishti. Sa më shumë që të bëhemi si Krishti, aq më shumë lavdi i sjellim emrit të Tij. Diagrami më poshtë ilustron këtë proces të rritjes në jetën e besimtarit.

Qëllimi i jetës shpirtërore



Nëse qëllimi i jetës së krishterë është që të bëhemi si Krishti, a nënkupton kjo se një njeri mund të arrij të jetoj një jetë pa asnjë mëkat? **Një i krishterë i pjekur asnjëherë nuk është paraqitur në Dhiatën e Re si një njeri që nuk mëkaton më.** Në të kundërtën, një i krishterë i pjekur përshkruhet si një njeri i cili zhvillon një vetëdije më të mprehtë ndaj potencialit për të mëkatuar dhe një vigjilencë të përlulur dhe të matur kundër tundimit për të mëkatuar.



Defino qëllimin e jetës së krishterë, duke përdorur Shkrimin për të mbështetur konkludimet tuaja. Personifiko këtë qëllim duke përfshirë disa ndryshime që ti do të doje t'i shihje në karakterin dhe veprimet e tua (p. Sh. “Qëllimi im si i krishterë është që të që dëshmohej me”).

Një jetë e dedikuar plotësisht Perëndisë

Ajo që është e qartë në Dhiatën e Re është rëndësia e dedikimit të jetës ndaj Perëndisë. Ashtu siç ishin ndarë objektet e caktuara në tabernakull si të shenjta, të dedikuara për qëllimet e Perëndisë, në këtë mënyrë besimtarët duhet t'ia dedikojnë jetën e tyre që të përdoret plotësisht për qëllimet e Perëndisë. Shtegu drejt pjekurisë fillon kur ne ia dedikojmë jetën tonë Perëndisë. Kur ne marrim këtë vendim, ne lejojmë Perëndinë që të na përdorë për qëllimet e Tij dhe për lavdinë e Tij.

Shtegu drejt
pjekurisë fillon
kur ne ia
dedikojmë jetën
tonë Perëndisë.

Lexoni Romakëve 12:1-2. Në këto vargje neve na urdhërohet që të paraqesim veten tonë si fli të gjalla përpara Perëndisë. Duket sikur Pali është duke shikuar mbrapa në njëmbëdhjetë kapitujt e parë të letrës së Romakëve dhe është duke thënë: “Shikoni çfarë Krishti ka bërë për ju; tani, dozojuani veten tuaj plotësisht Atij.”

Disa njerëz ia përkushtojnë jetët e tyre plotësisht Perëndisë qysh prej momentit që ata i besojnë Krishtit për shpëtim. Të tjerët mund ta bëjnë këtë përkushtim më vonë. Por sido që të ndodh, Pali është duke i thirrur të gjithë besimtarët që të jetojnë çdo ditë me një përkushtim të plotë ndaj Tij.

Në çfarëdo kohe gjatë përvojës së krishterë, një besimtar mund të kuptojë se një pjesë e jetës së tij apo saj nuk është plotësisht e përkushtuar ndaj Perëndisë. Çdo besimtar do të përjetojë se një pjesë e jetës së tij është duke jetuar në mosbindje dhe e cila nuk i është nënshtruar zotësisë së Krishtit. Kur një besimtar i flijuar e kupton një gjë të tillë, ai do të vijë përpara Perëndisë në rrëfim, pendesë, dhe qëndrim të ripërtëritë të përkushtimit ndaj zotësisë së Krishtit.

Çfarë nënkuptojmë kur flasim për zotësinë e Krishtit?



Lexoni tek Luka 6:46-48 dhe shikoni se çfarë thuhet në lidhje me zotësinë e Krishtit?

Krishti e theksoi paradoksin në mes të thirrjes që i bëjmë Atij duke iu referuar me emrin “Zot”, që do të thotë “mësues”, dhe mos respektimin e urdhërimeve të Tij. Duke pranuar zotësinë e Krishtit besimtarët i nënshtrohen me dëshirë Krishtit gjatë jetës së tyre dhe ndërtojnë jetët e tyre mbi Fjalën e Perëndisë. Një definicion i zotërimit është ky: gjithçka që kam dhe gjithçka që jam i takojnë Jezus Krishtit. Ky definicion mbulon çdo fushë të jetës sonë: kohën tonë, aftësitë tona, pasuritë tona, marrëdhëniet tona, të hollat tona, planet tona.



Çfarë nënkupton zotërimi i Krishtit për ty? A keni marrë një vendim për t'i lejuar Krishtit që të jetë zot i jetës tënde? Nën dritën e këtij definicioni për zotësinë e Krishtit, a ekzistojnë shumë fusha në jetën tënde për të cilat ju mund të thoni se nuk i janë nënshtruar Atij?



Merr kohë tani që të flasësh me Perëndinë në lidhje me këto fusha dhe shpreh dëshirën tënde që Perëndia të marr vendin e pare në jetën tënde.



Si mund të ndërlidhet “zotësia” me ndjenjat dhe pyetjet e Samuelit? (Shikoni edhe një herë anekdotën në fillim të mësimit.)

Një përshkrim i një besimtari të rritur

Ne e theksuam më sipër se Pali qortoi besimtarët e Korintit për shkak të mungesës së pjekurisë. Shumë pasazhe të Dhiatës së Re e bëjnë të qartë se disa besimtarë dështojnë të rriten në pjekuri apo stagnojnë në rritjen e tyre shpirtërore për një periudhë kohore. Ne mund t'i krahasojmë ata me një adoleshent i cili vazhdon të ushqehet me luge nga nëna e tij.



Lexoni pasazhet në vijim: Hebrenjve 5:11–6:1, Filipianëve 3:7-15, Jakobi 3:2.

1. Renditni tri karakteristika të një të krishteri të papjekur.
2. Renditni së paku gjashtë karakteristika pozitive të një të krishteri të pjekur.

Ne mund të shohim nga këto pasazhe se modeli normal për besimtarët është që të rriten në pjekuri, që të jenë në gjendje ta ushqejnë vetveten nga Fjala e Perëndisë, të jenë në gjendje ta kuptojnë dhe të aplikojnë mësimin e thellë, dhe të përjetojnë një marrëdhënie më të thellë dhe më të afërt me Perëndinë.



Teksa i lexoni karakteristikat e një të krishteri të papjekur dhe ato të një besimtari të pjekur, si do ta klasifikonit vetveten? Cilat nga këto karakteristika aplikohen tek ti

Procesi i rritjes dhe transformimit të besimtarit: Si ndodh rritja në jetën e një besimtari? Nëse Romakëve 12:1 e thekson rëndësinë e lejimit të Krishtit që të jetë zot në jetën tonë, Romakëve 12:2 thekson procesin e vazhdueshëm të ndryshimit dhe rritjes i cili duhet të vij si rezultat i këtij vendimi. Urdhërimi në vargun 2 është për ne besimtarët që të transformohemi me anë të ripërtëritjes së vazhdueshme të mendjes sonë.

Ky varg është një nga ato vargje të shumta që tregojnë një lidhje të veçantë në mes të sjelljes sonë dhe të karakterit tonë si dhe me mënyrën se si mendojmë ne. Pali e paraqet jetën e krishterë si një proces të rritjes dhe transformimit të vazhdueshëm, me qëllimin e vetëm të rritjes shpirtërore nën udhëheqjen e Zotit Krisht.

Si përmbledhje, pikëpamja biblike e pjekurisë thekson një rritje të qëndrueshme të besimtarit që ndodh gjatë tërë jetës, sepse besimtarët gjithnjë e më shumë përvetësojnë fuqinë e Frymës së Shenjtë për të ndërtuar karakterin e Krishtit në jetët e tyre.

Pikëpamja biblike e pjekurisë thekson një rritje të qëndrueshme... që ndodh gjatë tërë jetës, sepse besimtarët gjithnjë e më shumë përvetësojnë fuqinë e Frymës së Shenjtë për të ndërtuar karakterin e Krishtit në jetët e tyre.

Gjatë këtij shtegtimi drejt pjekurisë mund të ndodhin disa pika kulmore që çojnë drejt shpërthimit të rritjes në jetët tona. Teksa këto pika kulmore mund të na stimulojnë drejt kërkimit të ripërtëritjes së shenjtërisë, ato nuk na hedhin në përsosmëri. Jeta e krishterë është një proces i rritjes së qëndrueshme drejt pjekurisë. Edhe pse disa zhvillohen më shumë se sa të tjerët, qëllimi për secilin besimtar është të ngjaj çdo herë e më shumë në Krishtin.

Një vështrim i shpejtë mbi jetën e Jezus Krishtit shpalos karakterin e lartë të moralit dhe integritetin që Ai demonstroi në çdo çast. Nuk është fare një detyrë e lehtë kur Ai na thotë që t'i ngjasojmë Atij. Tek 1 Pjetri 1:14-16 Pjetri i thërret besimtarët që të jenë të shenjtë në çdo sjellje, "ashtu siç është i shenjtë Ai që ju thirri." Si njerëz ne nuk kemi mundësi të jemi të shenjtë. Megjithatë në Mësimin 2 ne i kujtuam se cilat janë burimet që Ai na ka dhënë neve; ne kemi një burim të ujit të gjallë përbrenda nesh i cili na jep si dëshirën ashtu edhe fuqinë për të kërkuar perëndishmërinë.

Burimi i fuqisë sonë duhet të gjendet në Vetë Krishtin dhe në marrëdhënien tonë me Të.

Zhvillimi i marrëdhënies së ngushtë me Perëndinë

“Të praktikuarit e perëndishmërisë para se gjithash është kultivimi i marrëdhënies me Perëndinë, dhe nga ky kultivim është jeta që e kënaq Perëndinë.”

Marrëdhënia që kemi me Perëndinë do të ketë një ndikim të madh në veprimet tona dhe në sjelljen tonë. “Të praktikuarit e perëndishmërisë para se gjithash është kultivimi i marrëdhënies me Perëndinë, dhe nga ky kultivim është jeta që e kënaq Perëndinë”³

Nga Zanafilla e deri te Zbulesa, Bibla shpalos dëshirën e Perëndisë për një marrëdhënie të brendshme me krijesën e Tij. Ne shohim këtë në faqet e para të Shkrimit, ku është regjistruar se si Perëndia e vendosi Adamin dhe Evën në kopshtin e Edenit, dhe Vetë Perëndia vinte për të ecur çdo ditë me ta në freskinë e mbrëmjes, duke shijuar miqësinë personale me ta.

Në faqet e fundit të Biblës, Gjoni e përshkruan vizionin e Jerusalemit të ri duke ardhur nga qielli, dhe ai dëgjon zërin e Perëndisë që thotë: “Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta” (Zbulesa 21:3 TNIV). Dëshira e Perëndisë është që të jetë me ne. Juzusi u quajt “Emanuel” që do të thotë “Perëndia me ne”. Ashtu siç prindërit e dashur kanë dëshirë që të kenë një marrëdhënie vitale dhe të afërt me fëmijët e tyre, ashtu edhe Perëndia dëshiron që të ketë një marrëdhënie të ngushtë me ne dhe këtë Ai e ka bërë të mundur nëpërmjet Birit të Tij.

Karakteri i perëndishëm buron nga marrëdhënia jonë me Krishtin. Tek Gjoni 15, ne gjejmë fjalët e Jezusit që i drejtohen dishepujve të Tij vetëm disa orë para se të burgosej dhe të çohet për t’u marrë në pyetje dhe për t’u kryqëzuar. Jezusi përdori një alegori me të cilën dishepujt e Tij mund të identifikoheshin shumë lehtë, sepse ata shpesh ecnin nëpër vreshtat e Judesë. Mësimi i Tij mbi hardhinë dhe degët e saj, nuk është vetë një pamje e këndshme baritore për një të krishterë. Ne duhet ta nuhasim urgjencën që shtrihet mbrapa këtyre fjalëve, teksa hija e kryqit përvijohet, dhe Jezusi e di se i ka ngelur edhe shumë pak kohë për t’ia komunikuar miqve të Tij shumë të dashur, disa mendime të fundit dhe shumë të rëndësishme. Çfarë do t’i fuqizojë ata, çfarë do t’i mbajë ata në orët tragjike dhe të hutuara si dhe në ditët në vazhdim?



Lexoni Gjoni 15:1-17.


1. Teksa shikoni pamjen e hardhisë dhe degëve, çka mendoni se cila është e vërteta kryesore të cilën Jezusi dëshiroi t’ia komunikoj dishepujve të Tij?
2. Nga kjo alegori çfarë mësojmë për frytet në jetën e një besimtari?

3. Sipas vargut 11 si karakterizon Jezusi ata që qëndrojnë të lidhur ngushtë me Të?
4. Sipas vargjeve 12-17 cilat janë disa prej qëllimeve kryesore të Jezusit për dishepujt e Tij?
5. A duhet të mundohen hardhia apo ndonjë pemë tjetër që të japin fryt? Çfarë konkluzioni mund të nxjerrësh nga kjo?

Ky pasazh thekson natyrën esenciale të marrëdhënies së ngushtë në mes të një besimtari dhe Perëndisë, sepse nga kjo marrëdhënie riprodhohet karakteri i Perëndisë në besimtarin.



Teksa mendoni për këtë pasazh, si jetoni në Krishtin dhe si jeton Krishti në ju? Cilat janë disa zgjedhje që ti mund të bësh për të zhvilluar këtë marrëdhënie “të qëndrueshme” me Krishtin?



Thellimi i marrëdhënies tonë me Perëndinë. Në një marrëdhënie të thellë dhe të qëndrueshme me Perëndinë përfshihen disa elemente: frika e Perëndisë, dashuria për Perëndinë, dhe dëshira për Perëndinë. Disa njerëz mendojnë se Dhiata e Vjetër e thekson frikën ndaj Perëndisë dhe se Dhiata e Re e thekson dashurinë për Perëndinë, megjithatë frika ndaj Perëndisë nuk mbetet vetëm një koncept i Dhiatës së Vjetër.⁴

Frika e Perëndisë. Tek Jeremia 32:40 ne shohim se një nga bekimet e besëlidhjes së re është vendosja e frikës së Perëndisë në zemrat e besimtarëve. “Do të bëj me ta një besëlidhje të përjetshme ... dhe do të shtie në zemrën e tyre frikën, me qëllim që të mos më braktisin.”

Termi “frika e Perëndisë” përdoret në dy mënyra në Shkrim. Lloji i parë i frikës së Perëndisë i referohet frikës shqetësuese, e cila zakonisht është e lidhur me mendimet e kërcënimit të Perëndisë për gjykim. Kjo lloj frike na distancon neve nga Perëndia, ashtu siç Adami u fsheh nga frika në kopshtin e Edenit pasi që kishte ngrënë frytin e ndaluar.

Lloji i dytë i frikës ndërlidhet me respektin për Perëndinë. Kjo lloj frike e Perëndisë është ajo që Fjalët e Urta e quajnë “fillimi i njohurisë” sepse ajo na tërheq më afër

Perëndisë. Charles Spurgeon (Çarls Spërgjën), predikuesi i madh anglez i shekullit të nëntëmbëdhjetë, tha: “Frika jo e rilindur të largon nga Perëndia; frika e hirshme të afron tek Ai.”⁵

Dhiata e Vjetër përmban shumë shembuj të burrave të perëndishëm, të cilët ishin të motivuar nga dëshira për ta nderuar Perëndinë. Tek Zanafilla 39 ne gjejmë tregimin e Jozefit të cilin mundohet ta josh gruaja e Potifarit. Arsyeja pse Jozefi i rezistoi asaj nuk ishte se pse ai kishte frikë nga padroni i tij, i cili mund të zbulonte mos besnikërinë e tij dhe i cili mund ta vriste atë. Ne e shohim Jozefin se si mendon në vargun 9, “Si mund ta bëj unë këtë të keqe të madhe dhe të kryej një mëkat kundër Perëndisë?” Motivimi parësor i Jozefit ishte dëshira e tij për ta kënaqur Perëndinë me jetën e tij sepse ai e respektonte dhe e donte Perëndinë.

Marrëdhënia e besimtarit me Perëndinë duhet të karakterizohet nga respekti dhe frika për Perëndinë. Frika e Perëndisë që të çon drejt karakterit të perëndishëm është pranimi i shenjtërisë, lavdisë dhe fuqisë së Perëndisë. Një nga tendencat e fundit në qarqet e krishtera është bërë theksimi i dashurisë së Perëndisë, pothuajse deri në përjashtimin e shenjtërisë së Perëndisë. **Në mënyrë që të kemi frikën e duhur të Perëndisë, ne duhet të kemi një pamje të qartë të karakterit të Perëndisë dhe një shenjtëri mbi-kulmore e cila përhap karakterin e Tij.**

Dashuria për Perëndinë. Frika e Perëndisë në mënyrë të natyrshme duhet të na drejtoj tek të kuptuarit e dashurisë së Perëndisë. Teksa sodisim shenjtërinë e Perëndisë dhe zemërimin e Tij kundër mëkatit, ne e kuptojmë në një mënyrë më të thellë dashurinë që e shtyu Atë të dërgojë Birin e Tij të Vetëm që të paguaj për mëkatet tona në mënyrë që ne të pajtohemi me Atin.

Tek 1Timoteu 1:15 Pali e përshkruan veten si i pari ndër mëkatarët. Pali nuk e krahasoi veten me të tjerët që ishin rreth tij, por me standardin e shenjtë dhe të drejtë të Perëndisë. Si përfundim ai mund të rrinte i mahnitur nga dashuria e Perëndisë e cila e shpëtoi atë nga gjendja mëkatore. Dashuria e besimtarit **për** Perëndinë rritet teksa rritet edhe njohuria e tij për dashurinë dhe hirin e Perëndisë. Gjoni shkroi, “Ne e duam atë, sepse ai na deshi i pari.” (1Gjoni 4:19)

Në një çast të jetës
secili prej nesh duhet të
mbërthehet nga e
vërteta se “Perëndia më
do mua.”

Të kuptuarit e krishterë për dashurinë e Perëndisë duhet të jetë personal. Në një çast të jetës secili prej nesh duhet të mbërthehet nga e vërteta se “Perëndia më do mua.” Ne duhet të bindemi se dështimet tona shpirtërore nuk e ndryshojnë dashurinë e Perëndisë që Ai ka për ne.

Dashuria jonë për Perëndinë rritet teksa ecim me Perëndinë në shtegun e jetës dhe kuptojmë çdo ditë e më shumë karakterin e Perëndisë. Pali u lut te Efesianëve 3:17-19 që besimtarët, “që Krishti të banojë në zemrat tuaja me anë të besimit, që, të rrënjosur dhe të themeluar

në dashuri, të mund të kuptoni me të gjithë shenjtorët cila është gjerësia, gjatësia, thellësia dhe lartësia, dhe ta njihni dashurinë e Krishtit që tejkalon çdo njohuri, që të mbusheni me tërë plotësinë e Perëndisë.” Dashuria e besimtarit për Perëndinë është e bazuar në rritje të të kuptuarit të thellësisë së dashurisë së Perëndisë. Njohuria e Palit për dashurinë e Krishtit ka qenë faktori nxitës në jetën e tij.

Është shkruar shumë në lidhje me dashurinë e krishterë për Perëndinë. Teksa mendojmë për një marrëdhënie të shëndetshme të një fëmije me babanë e vetë, ne vërejmë disa karakteristika të kësaj marrëdhënieje. Së pari fëmija ka besim të padyshimtë tek babai i saj. Ajo e di se babai do të kujdeset për të dhe do ta mbroj atë. E dyta, ky fëmijë gjen kënaqësi të plotë në këtë marrëdhënie. Ajo kënaqet thjesht duke **qenë me** babanë e saj. Ajo e pret miratimin e tij dhe buzëqesh. E treta, fëmija ka dëshirë që ta kënaq babanë e saj.

Këto thjesht janë mendime, mirëpo ato na kujtojnë neve për marrëdhënien që Perëndia ka dëshirë të ketë me fëmijët e Tij: një marrëdhënie që karakterizohet me besimin tonë, me kënaqësinë tonë për të qenë me të, me gëzimin tonë për të bërë gjërat që e kënaqin Atë.

Dashuria jonë për Perëndinë do të vërtetohet me anë të dashurisë tonë për njerëzit e tjerë. Gjoni shkroi se një besimtar i cili nuk i do besimtarët e tjerë nuk mund ta dojë Perëndinë (shiko 1Gjoni 4:20). Krishti bëri një lidhje të ngushtë në mes të urdhërimit për ta dashur Perëndinë mbi të gjitha gjërat e tjera dhe urdhërimit për të dashur të afërmit ashtu siç e duam vetveten. Dashuria e vërtetë për të tjerët buron nga dashuria jonë për Perëndinë.

Dëshira për Perëndinë. Një karakteristikë e tretë për një marrëdhënie të ngushtë me Perëndinë është dëshira për Perëndinë.



Lexoni Psalmin 42:1-2a. Si e përshkruan psalmisti mallin e tij për Perëndinë?

Këtu ne gjejmë përshkrimin e një e drenushe e cila sigurisht se ka qenë duke ikur nga gjuetarët apo ka qenë duke u endur nëpër fusha të shkretuara ku nuk ka ujë. Më në fund ajo arrin pranë brigjeve të ujit ku pinë ujë duke përmbushur etjen e saj plotësisht. Psalmisti i cili i shkroi këto fjalë e kishte kapur të vërtetën që Jezusi kishte dëshiruar që të impresionoj dishepujt e Tij tek Gjoni 15. Pa marrëdhënien tonë me Të, jeta jonë shpirtërore do të vyshket plotësisht dhe do të jetë e pafrytshme. Kur jemi duke u kënaqur me këtë lidhje të ngushtë me Të, fryti do të jetë një prodhim automatik i jetës së Tij në ne.

Davidi, i cili u quajt “njeri sipas zemrës së Perëndisë”, përjetoj këtë afërsi me Perëndinë.



Lexoni Psalmin 27:4-8.

Çfarë është një gjë që Davidi e dëshiron?
Si e shpreh ai fokusin e tij në vargun 8?

Mbi të gjitha, Davidi në jetën e tij e kërkoi praninë e Perëndisë. Ai u fokusua në karakterin e Perëndisë (bukurinë e Tij) dhe në marrëdhënien e tij me Të (Ps.27:4-8).



Lexoni Psalmin 73:25, 28.

1. Si e shpreh Asafi afërsinë e marrëdhënies së tij me Perëndinë?
2. Sipas vargut 28 përfundimisht cila është mirësia më e madhe për të në jetë?

Asafi e kishte mësuar të vërtetën kryesore të cilën secili prej nesh duhet ta mësojë: **Perëndia është i mjaftueshëm.** Marrëdhënia jonë me Perëndinë është ajo marrëdhënie që është plotësisht në gjendje të na kënaq neve.

Perëndia na fton që të vijmë tek Ai për të përjetuar Atë në këtë mënyrë, për të përjetuar se Ai është i mjaftueshëm. Tek Isaia 55:1 Perëndia thotë: “O ju të gjithë që keni etje, ejani tek ujërat” (NIV). Ne duhet të zhvillojmë një etje për Perëndinë, një dëshirë për të shkuar vazhdimisht tek burimi i Krishtit dhe për të pirë ujë nga ai burim. Ai është i vetmi burim i mjaftueshëm.



- Cilën frikë të Perëndisë e përjeton më së shpeshti?
- Si bëhet respekti për Perëndinë motivimi drejt perëndishmërisë në jetën tënde?
- Si ka ndryshuar përgjatë jetës tënde dashuria për Perëndinë?
- Sa e afërt dhe e ngushtë është marrëdhënia jote me Perëndinë?
- Sa e fuqishme është dëshira jote për Perëndinë?
- Sa shpesh kërkon nga Ai forcë dhe ushqim shpirtëror dhe sa shpesh e mbush shpirtin tënd nga burimet e Tij të ujit të gjallë?
- A e kërkon Atë për shkak se e dëshiron Atë apo për shkak se ti mendon se duhet ta bësh këtë?
- Çfarë do të të ndihmonte që t’i afroheshe më pranë Atij?
- Çfarë janë disa zgjedhje që ti mund të bësh dhe të cilat do të ndihmonin që të rriteshe në këto fusha?



Pushoni për një moment dhe adhurojeni Zotin. Lavdërojeni Atë për dashurinë e Tij dhe falënderojeni Atë për dëshirën e Tij për të pasur një marrëdhënie me ty. Kërkoji Atij që të të japë një respekt më të madh për Të, një dashuri më të madhe për Të, dhe një dëshirë për ta kërkuar fytyrën e Tij dhe për t'u kënaqur me prezencën e Tij.

Roli ynë i rritjes drejt pjekurisë

Një ndër shenjat dalluese të pjekurisë së besimtarit është rritja drejt perëndishmërisë. Thirrja jonë parësore si besimtarë është që të përlëvdojmë Perëndinë duke u bërë çdo ditë e më shumë si Jezusi. Jeta e besimtarit duhet të jetë një shprehje e qartë e natyrës së shenjtë të Perëndisë teksa ai rritet më shumë në imazhin e Krishtit. Karakteri ynë i perëndishëm drejtohet tek Perëndia si burimin dhe qëllimin e vet.

Perëndia nuk do të prodhojë në jetët tona fryte kundër vullnetit tonë. Ai kërkon bashkëpunimin e besimtarëve, të cilët në mënyrë aktive duhet të kërkojnë perëndishmërinë dhe të lejojnë Frymën e Shenjtë që të veprojë në jetën e tyre.



Lexoni Filipianëve 2:12-13. Çfarë thonë këto vargje në lidhje me rolin e një të krishteri dhe rolin e Perëndisë në lidhje me rritjen tonë drejt pjekurisë?

Vini re se Pali nuk është duke u thënë filipianëve të punojnë **për** shpëtimin e tyre mirëpo që të përfshihen në përmbushjen e shpëtimit të tyre: në veprimet dhe qëndrimet e dukshme që tregojnë evidencën e rigjenerimit të brendshëm. Ashtu si besimtari edhe Perëndia që të dytë luajnë një rol në këtë proces, sepse Perëndia ndërvepron me vullnetin tonë për të prodhuar karakterin e Tij në ne.

Ne jemi thirrur që të ndjekim shenjtërinë, të bëjmë zgjedhje që do të na sjellin më pranë Perëndisë, dhe që të reflektojmë sa më shumë që të jetë e mundur në karakterin e Krishtit.

Duke veshur karakterin e Krishtit. Teksa mbështetemi në Frymën e Shenjtë për të na bindur, për të na drejtuar, për të na mësuar më tepër për Krishtin, dhe për të na fuqizuar që të bëhemi më shumë si Ai, ne nuk duhet të jemi pasiv në procesin e bërjes si Krishti. Ne jemi thirrur që të ndjekim shenjtërinë, të bëjmë zgjedhje që do tan a sjellin më pranë Perëndisë, dhe që të reflektojmë sa më shumë që të jetë e mundur në karakterin e Krishtit.

Në Shkrim shumë vargje e theksojnë rolin aktiv që besimtari duhet të ketë në këtë proces. Neve na është thënë që të ndjekim drejtësinë (2Tim.2:22) dhe shenjtërinë

(Heb.12:14). Pjetri tha tek 2Pjet.1:5-8 se ne duhet të përdorim çdo mjet për të zhvilluar virtytin moral, diturinë, vetë-kontrollin, qëndresën, perëndishmërinë, mëshirën vëllazërore dhe dashurinë. Pali tha **“duke u prirur drejt atyre që kam përpara ... po rend drejt synimit, drejt çmimit të thirrjes së larte të Perëndisë në Krishtin Jezus.” (Fil 3:13-14)**

Në disa pasazhe kyçe të krishterët thirren që “të zhveshin apo të heqin” veten e vetë të vjetër dhe të “vishen” me njeriun e ri. Pali i përdor këto terme tek Efesianëve 4:20-24 dhe Kolosianëve 3:8-14.

Çfarë ju sugjerojnë juve fjalët “të zhveshim” dhe “të heqim”? Duket sikur Pali po sugjeron një ndërrim të rrobave. Sigurisht, ai është duke theksuar se vullneti ynë duhet të përfshihet. Ne duhet të dimë se cili lloj i veshjes së karakterit është i përshtatshëm për ne si fëmijët dhe ambasadorët e Tij dhe kështu të zgjedhim pastaj atë lloj veshjeje. Pali nuk është duke folur vetëm për zgjedhjen e veprimeve apo aktiviteteve të jashtme por gjithashtu për zgjedhjen e qëndrimeve tona.

Tek Romakëve 13:14 Pali thotë se ne duhet të veshim Zotin Jezus Krisht. Qëndrimet tona, veprimet tona, zgjedhjet tona, mendimet tona duhet të jenë si të Krishtit sepse ne jemi në Të.



Lexoni Kolosianëve 3:1-17.

1. Sipas vargjeve 1-4, cili duhet të jetë fokusi ynë si ndjekës të Krishtit?
2. Përshkruani dallimin më të madh në jetën e njeriut që është rilindur në Krishtin. Bazuar në pasazhin e Kolosianëve, bëni një listë nën titujt e mposhtëm dhe krahasoni sjelljen dhe karakteristikat që i takojnë natyrës sonë të vjetër dhe sjelljen dhe karakteristikat që i takojnë jetës sonë të re në Krishtin.

Njeriu i Vjetër

Njeriu i Ri

Teksa shikoni listën tuaj, ju mund të vëreni se shumë ndryshime ndodhin në njeriun që është rilindur në Krishtin.



Lexoni Kolosianëve 2:9-14. Tregoni se si ndodhën këto ndryshime.

Duke u mbështetur në Frymën e Shenjtë për të prodhuar fryte. Tek Psalmi 1 ne zbulojmë një pamje të një peme e cila është mbjell pranë brigjeve të ujit dhe që jep frytin e saj në stinën e duhur. Krishti tha për ndjekësit e Tij “Do t’i njihni nga frytet e

tyre,” dhe theksoi se një pemë e mirë do të sjell edhe fryt të mirë. Pali foli për karakterin e perëndishëm si “fryt i Frymës”, duke thënë se burimi i këtij karakteri është Fryma e Shenjtë në jetën e besimtarit.

Në Mësimin 2 ne pamë se Fryma e Shenjtë është burimi ynë i brendshëm. Ashtu si Ai që na drejton te Krishti, Fryma e Shenjtë është Ai i cili na ndihmon të fokusohemi në Krishtin dhe që të bëhemi më shumë si Ai. Fryti i Frymës është pikërisht kjo; është fryti i Tij që është rezultati i punës së Tij brenda nesh.

Disa pasazhe na flasin për frytin që Fryma e Shenjtë zhvillon në jetën e besimtarit: Galatasve 5:22-23, Eesianëve 4:2-3, 32, Jakobi 3:17, dhe 2 Pjetri 1:5-7.



Lexoni këto pasazhe dhe bëjë një listë të attributeve të karakterit që zhvillon Fryma e Shenjtë në jetën e të krishterit i cili është i hapur ndaj Tij.



- Si ka ndryshuar sjellja jote që kur erdhe në besim në Krishtin?
- Nëse ke ardhur në besim shumë herët në jetën tënde, në ç’ mënyra e ke parë Perëndinë të ndryshojë karakterin tënd?
- Cilat janë ato karakteristika të natyrës së vjetër me të cilat akoma je duke u ballafaquar?
- Si i ke parë ndryshimet teksa i ke mënjanuar këto karakteristika?
- A ke parë rritje në jetën tënde në karakteristikat e natyrës së re?
- Si ka punuar Fryma e Shenjtë në jetën tënde për të sjellë këtë rritje?
- Në cilën fushë të jetës tënde është duke punuar Perëndia tani?



Merr pak kohë për të falënderuar Perëndinë për ndryshimet që Ai ka bërë në jetën tënde. Kërkoji Atij që të vazhdojë të ndryshojë zemrën tënde dhe të të bëjë shumë e më shumë në ngjasim me Krishtin



Bëjë një përmbledhje të rolit të Perëndisë dhe të rolit të besimtarit në rritjen shpirtërore të një besimtari.



Pjesa “Duke u mbështetur në Frymën e Shenjtë për të prodhuar fryte” paraqet këto karakteristika: përlësinë, kënaqësinë, mirënjohjen, gëzimin, shenjtërinë, vetë-kontrollin, besnikërinë, paqen, durimin,

zemërbutësinë, mirësinë, faljen, mëshirën dhe dashurinë. Zgjedh një karakteristikë që ti mendon se është një fushë e dobët në jetën tënde.

Kërko për vargje në lidhje me karakteristikën e karakterit që ka të bëjë me ty. Do të ishte mirë të shikoheshin vargjet që theksojnë karakteristikën e kundërt, për shembull nëse ti zgjedh përlësinë, shiko gjithashtu vargjet që flasin për krenarinë, si karakteristikë e kundërt.

Kërko nga Perëndia të të tregojë ku ke nevojë të ndryshosh dhe të të ndihmojë që të marrësh nga burimet e Tij për të ndryshuar. Çfarë janë disa gjëra që ti mund të bësh për të të ndihmuar që të rritesh në këtë fushë? Çfarë duhet të “zhveshësh” në mënyrë që të “të veshësh” këtë karakteristikë? Përgatitu të ndash në sesionin e radhës disa aspekte mbi atë se çfarë të ka mësuar Perëndia.

Karakteristikat përcaktuese të pjekurisë

Rritja drejt karakterit të krishterë është progresiv. Ne asnjëherë nuk do të arrijmë një pikë ku mund të themi se jemi bërë plotësisht në ngjasim me Krishtin. Pali edhe në fund të jetës së tij ishte duke u përpjekur dhe aq më tepër ai nuk hezitoi për të rendur drejt qëllimit për të parë dishepujt e tij të arrijnë masën e lartësisë së rritjes në Krishtin.

Teksa lexojmë Ungjijtë dhe letrat e Dhiatës së Re, ne shohim shqetësimin e Krishtit dhe të apostujve për të parë ndjekësit e Krishtit tek vazhdojnë të rriten në dashuri dhe në perëndishmëri. Le të shohim disa nga evidencat e rritjes shpirtërore.

Rritja e dashurisë

Jezusi u tha ndjekësve të Tij: “Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:35).

Karakteristikë përcaktuese e të krishterit është dashuria. Pali, nën frymëzimin e Frymës së Shenjtë, përshkroi këtë dashuri të mbinatyrshme tek 1 Korintasve 13, duke përdorur fjalë që tejkalojnë konceptin tonë në lidhje me dashurinë, dashuri e cila kryesisht bazohet në ndjenjat.



Lexoni 1Korintasve 13:1-8.

1. Shkruani gjërat që dashuria bënë dhe gjërat që dashuria nuk bënë (v.4-8).
2. Si e përshkruan Pali besimtarin i cili nuk ka dashuri (v. 2)?
3. Çfarë vlere kanë veprimet e tij pa dashuri (v. 3)?
4. Çfarë mund të nxirrni si përfundim?

Në mësimin e Tij, Jezusi e theksoi dashurinë për Perëndinë si urdhërimin më të madh, dhe dashurinë për të afërmin si të dytin, i ndërlidhur mjaftë ngushtë me dashurinë për Perëndinë (Mat 22:40). Në qarqet e krishtera ne shpesh ndjejmë një theksim më të madh në bindjen se sa në dashurinë për njëri tjetrin. Pse mendoni se Jezusi e theksoi më shumë dashurinë se sa bindjen?



Lexoni Gjoni 14:15. Si i ndërlidh ky varg dashurinë dhe bindjen?

Dashuria jonë për Krishtin nuk është vetëm karakteristika përcaktuese e të krishterit; por është i vetmi motivim i duhur për veprimet dhe qëndrimet e perëndishme. Në thelb, Jezusi ka mësuar se bindje buron nga dashuria. “çdo urdhërim tjetër varet në motivimin e dashurisë për përmbushjen e tyre.”⁶

Pali shkroi se dashuria përmbush ligjin. (Rom.13:10). Kur ne e duam Perëndinë, ne në mënyrë të natyrshme do t’i bëjmë gjërat që urdhërohen në Fjalën e Perëndisë. Kur Jezusi deklaroi se urdhërimi më i madh është dashuria për Perëndinë, Ai po na mëson se, nëse ne e duam Perëndinë dhe të afërmin tonë, ne nuk do të bëjmë tradhti bashkëshortore me bashkëshortin/en të afërmit tonë. Nëse i duam armiqtë tonë, ne nuk do t’i vrasim ata. Nëse e duam shefin tonë, ne nuk do të gënjejmë atë apo nuk do të mashtrojmë për një ditë të ndershme pune. Nëse e duam shitësin e dyqanit, ne nuk do t’i flasim atij në mënyrë të pahijshme. Për këtë arsye, etika e vërtetë e të krishterit është një rezultat dhe një masë e dashurisë sonë për Krishtin dhe dëshira jonë për ta nderuar Atë.

Nëse dashuria është urdhërimi më i madh, atëherë veprimet e pahijshme (pa dashuri) janë mëkatet më të mëdha. Sa shpesh e vëmë vrasjen në një kategori më të keqe se sa urrejtjen, me ç’rast të dyja e kanë burimin në mungesën e dashurisë. Frika nga pasojat mund të na mbajë larg nga moskryerja e veprimeve të vrasjes apo tradhtisë bashkëshortore, mirëpo vetëm dashuria është ajo që mund të na mbajë nga mos kryerja e këtyre mëkateve në zemrat tona.⁷

Tek 1Selanikasve 4:9-10 Pali urdhëron selanikasit në lidhje me dashurinë që ata kishin treguar për vëllezërit e tyre në Maqedoni, dhe në anën tjetër ai u bënë thirrje që të thelloheshin më shumë në dashuri. Kështu, lutja jonë duhet të jetë që ne të rritemi çdo ditë në dashuri.

Dashuria jonë për Krishtin
nuk është vetëm
karakteristika përcaktuese e
të krishterit; por është i
vetmi motivim i duhur për
veprimet dhe qëndrimet e
perëndishme.



Kalo disa çaste duke falënderuar Perëndinë për dashurinë që Ai ka për ty, dhe se teksa ti përjeton dashurinë e Tij, ti mund të mësosh të duash ashtu siç ka dashur Krishti. Perëndia do t'i përgjigjet një lutjeje si kjo: “Zot, më mëso si të dua. Me vë në dijeni për veprimet dhe mendimet e mia të pahijshme.” Merr ca minuta dhe bëjë këtë lutje.



A ndryshojnë gjithmonë rrethanat dhe marrëdhëniet kur i duam të tjerët ashtu siç duhet? A mund të sigurohemi që personi tjetër do të përgjigjet? Si mund të vazhdojmë të duam kur nuk ka asnjë përgjigje?

Dhënia e hirit

Pjetri i inkurajoi besimtarët “që të rrisin hirin dhe njohurinë për Zotin dhe Shpëtimtarin tonë Jezus Krishtin” (2Pjet.3:18). Teksa rritja në hir përfshinë rritjen tonë në karakterin e krishterë, një autor sugjeron që kuptimi parësor është “të rritemi vazhdimisht në të kuptuarit e hirit të Perëndisë, posaçërisht kur aplikohet për ne personalisht, për t’u vetëdijesuar më shumë për falimentimin tonë të vazhdueshëm shpirtëror dhe për favorin e pamerituar të Perëndisë.”⁸

Në një kuptim ne bëhemi “hir-dhënës”, duke shtrirë tek të tjerët hirin e Zotit që ne kemi marrë. Kjo lloj jete, e karakterizuar nga dashuria dhe hiri, ndërton një platformë prej të cilës ne mund të komunikojmë ungjillin në një botë pa hir në atë mënyrë që do t’i tërheq të tjerët tek Krishti.



A je ti një dhurues i hirit? A mund të mendosh për ndonjë njeri që karakterizohet për dhënien e hirit? Si ju ka motivuar ky person që t’u jepni hir të tjerëve? Kërko nga Perëndia që të bëhesh një dhurues i hirit.

Rritja e përlësisë

Një karakteristikë tjetër e besimtarit të pjekur është përlësia. Përgjatë Biblës Perëndia në mënyrë të përsëritur premton që do të lartësojë të përlurit. Përderisa bota shpesh na nxit që të jemi agresiv, të rendim përpara, t’i shkelim të tjerët për të arritur në majë, buri apo gruaja që Perëndia bekon, karakterizohet nga përlësia. (Mikea 6:8).

Shembulli më i lartë i përlësisë është Vetë Krishti. Lexoni Filipianëve 2:5-11. Këtu neve na rikujtohet se Krishti morri mu formën e një shërbëtori dhe se e përlu veten e Tij deri në vdekje. Vdekja me anë të kryqit ka qenë forma më e tmerrshme e ekzekutimit, e rezervuar për kriminelët më të këqij kështu, Krishti vdiq një vdekje çnderuese që i shtoi turp të pa thënë vuajtjes së tij fizike. Për shkak se Ai deshi që të

përul Vetën e Tij në këtë mënyrë për neve, Perëndia e përlëvdoi atë në vendin më të lartë dhe i ka dhënë Atij një emër që është për mbi çdo emër, një emër që do të bëjë që çdo njeri në faqen e dheut të përulet para Tij, qoftë në këtë jetë, qoftë në jetën që do të vijë.

Ky është shembulli i përulësisë që ne duhet të ndjekim. Perëndia nuk është duke kërkuar për përulësi të rreme, që shfaqet në interes personal dhe që pret nga Perëndia dhe të tjerët që të duartrokashtojnë vetëmohimin tonë. Përulësia e vërtetë i nënshtrohet zotësisë së Krishtit. Nuk kërkon njohje, respekt, apo shpërblim. Nuk u parashtrohet kërkesa të tjerëve, por u shërben atyre dhe i do ata. Për besimtarin përulësia vije së bashku me një kuptim të hirit të Perëndisë, ashtu siç kuptojmë gjendjen tonë vërtetë në nevojë dhe hirin e pamasë që na është dhënë në Krishtin.

Pali na kujton tek Romakëve 12:3 që të mos e vlerësojmë veten më shumë se sa duhet ta çmojmë, por të kemi një vlerësim të përkorë për veten tonë.



Ç'farë nënkupton të kemi një vlerësim të përkorë për veten tonë? Pse mendoni se Perëndia e vlerëson kaq shumë përulësinë? Si do të ishte mungesa e përulësisë e dëmshme në rritjen tonë në karakterin e Krishtit? Shqyrto veten tënde para Perëndisë dhe kërko nga Ai që të të mësojë hirin.

Shërbimi

Një karakteristikë e fundit e besimtarëve është se jetët e tyre jepen për t'i shërbyer Perëndisë dhe të tjerëve. Ne shpesh kemi tendencë që të mendojmë për jetën e krishterë si një jetë të shërbesës, mirëpo ndoshta ne fokusohemi tepër në aktivitete dhe shumë pak në qëndrimet tona. Shërbimi i vërtetë buron nga dashuria jonë për Perëndinë dhe ka për fokus Perëndinë, për ta kënaqur dhe për ta nderuar Atë. Kolosianëve 3:17 thotë: “Dhe çdo gjë që të bëni, me fjalë a me vepër, t'i bëni në emër të Zotit Jezus, duke e falënderuar Perëndinë Atë nëpërmjet tij.”

Lexoni tregimin e Jezusit duke ua larë këmbët dishepujve të Tij tek Gjoni 13:1-16.



1. Si i mësoi Jezusi dishepujt e Tij për shërbimin?
2. Si ndërlidhet shërbimi me përulësinë?

Në këtë pamje të fundit para kryqëzimit të Tij, Jezusi demonstroi përulësinë, shërbimin dhe dashurinë. Dishepujt sigurisht se janë stepur kur kanë parë mësuesin e tyre të gjunjëzohet para tyre për t'ju larë atyre këmbët e tyre të ndyta. Ne mund të imagjinojmë ndikimin që ajo natë pati shumë më vonë tek dishepujt. Ne mund të imagjinojmë turpin që digjej brenda tyre teksa ata mendonin në lidhje me argumentet që Jezusi kishte dëgjuar atë natë kur ata debatuan se kush ishte më i madhi në mesin e

tyre. Jezusi i la ata me pamjen më të gjallë që ata kishin parë ndonjë herë të përlësisë dhe të shërbimit: Mbreti i mbretërve dhe Zoti i zotave i ulur në gjunjë për t'u larë atyre këmbët e ndyta.

Si Biri i Perëndisë, Krishti personifikoi gjithë atë që na kërkon ne që të bëhemi. Ai kërkon që ne të duam; Ai kërkon që ne t'u shfaqim hir të tjerëve; Ai kërkon nga ne që të bëhemi shërbëtor të përlur. Teksa ecim përpara në shtegun tonë me Krishtin, duke u mbështetur në Frymën e Tij, Ai do të na jep një karakter të ngjashëm me atë të Krishtit, i cili do t'i bëjë të tjerët që ta lartësojnë Atë.



Përshkruaj shkurtimisht secilën “karakteristikë të pjekurisë” të dhënë në këtë mësim: rritjen në dashuri, dhënien e hirit, përlësinë dhe shërbimin. Shpjego se si ndërlidhen këto me njëra tjetrën. Jep një shembull se si e ke parë njërën apo tjetrën në jetën e një besimtari apo kur ke përjetuar apo demonstruar njërën prej tyre në jetën tënde.

Mendime përmbyllëse

Ne pamë që rritja drejt pjekurisë është normë për një të krishterë. Perëndia do që ne t'ia dedikojmë jetën tonë plotësisht Atij, duke e ofruar veten tonë për t'i shërbyer Atij dhe që të përdoremi për lavdinë e Tij. Rritja jonë drejt karakterit të Krishtit ndodh teksa zhvillojmë një marrëdhënie të ngushtë me Perëndinë, duke kaluar kohë me Të në lutje dhe në Fjalën e Tij dhe duke iu përgjigjur zërit të Frymës së Tij. Perëndia do që ne të marrim një rol aktiv në kërkim të shenjtërisë, duke bërë zgjedhje që do të na ofrojnë me pranë Perëndisë dhe duke zhvilluar një zakon për t'u mbështetur çdo ditë në Frymën e Tij. Teksa thellojmë marrëdhënien tonë me Krishtin, Ai do të prodhojë frytin e rritjes së dashurisë ndaj Perëndisë dhe të tjerëve, rritjen në karakterin e Krishterë dhe një zotim për t'i shërbyer Atij

FUSNOTAT

¹ E.g., Mt 5:48; 1Kor. 2:6; 14:20; Ef. 4:13; Fil. 3:15; Kol. 1:28; Heb. 5:14; 6:1; 10:1, 14; Jak. 1:4; 3:2.

² Vargu i datave të mundshme është 53-57 pas K. , ndërsa vitet 54-55 janë vitet që janë cituar më së shumti nga shkollarët

³ Jerry Bridges , The Practice of Godliness (Colorado Springs, CO.: Nav Press, 1986), 23.

⁴ Bridges, Godliness, 25

⁵ Charles Spurgeon. The Treasury of David , 2 vols. (McLean, VA: MacDonald, n.d.), 2:465 (me theks të veçantë)

⁶ Briddges, Godliness, 73

⁷ Ibid

⁸ Bridges, Transforming Grace (Colorado Springs, CO: Nav Press, 1991), 84.

Ushqimi ynë i përditshëm: Fjala e Perëndisë

Ana u zgjua si në ankth kur një zë i lartë e pengoi gjumin e saj të thellë. Duke vrapuar nga dhoma e saj e gjumit, ajo pa që foshnja e saj 4 vjeçe kishte rrëzuar një lule saksie në dhomën e ditës dhe kishte shpërndarë dheun në tërë tapetin. Ajo mendoi me vete se ku do ta gjente kohën për ta pastruar atë?

Një ndjenjë e rëndesës dhe paaftësisë e mbuloi atë. Foshnja po qante dhe kishte nevojë që të ushqej. Ajo kishte nevojë të gatuante mëngjesin për familjen dhe t'i dërgonte fëmijët në shkollë. Sapo filloi të gatuajë mëngjesin, ajo pa Biblën e saj në tavolinën e vogël aty pranë saj. “Ndoshta pasi që foshnja të fle mund të gjej kohë dhe ta lexoj atë,” mendoi ajo me vete. Megjithatë çdo herë duket se dilte diçka që kërkonte vëmendjen e saj. As që mund t'i kujtohet hera e fundit kur ka kaluar kohë vetëm me Perëndinë. Kur erdhi koha që fëmijët të shkonin në shtrat, ajo ishte tepër e lodhur për t'u koncentruar.

A të duket vetja si Ana dhe dita e saj e zënë? Si mund të ndikojë Fjala e Zotit në zgjedhjet që ajo bënë gjatë ditës dhe si mund të behet ajo pjesë e të menduarit të saj? Si mund të gjej kohë në mes të kërkesave dhe aktiviteteve të jetës që ta bëjë Fjalën e Perëndisë një prioritet në jetën e saj?



Si e zhvillon një besimtar një marrëdhënie me Perëndinë? Kjo fushë e jetës sonë të krishterë mund të quhet jeta jonë e brendshme pasi që ka të bëjë me zhvillimin e bashkësisë personale me Perëndinë e gjallë. Teksa është e vërtetë se përvoja e një njeriu me Perëndinë do të dallojë nga ajo e një njeriu tjetër, për shkak të faktorëve të ndryshëm si personaliteti dhe kultura, përvoja e secilit të krishterë është e mbështetur në elemente të caktuara që janë të ngjashme: ndërveprimi me Fjalën e Perëndisë, lutja dhe një zotim për të jetuar me besnikëri. Bibla është burimi qendror nëpërmjet të cilit Fryma e Perëndisë ndikon jetët tona. Qëllimi i Mësimi 4 është që të zgjojë apetitin tuaj për Fjalën e Perëndisë dhe të të njoftojë me aftësitë e nevojshme për t'u ushqyer në mënyrë

të duhur dhe të vazhdueshme me të. Do të prezantojmë një qasje të thjeshtë për një studim ditor të Biblës dhe do të koncentrohemi në atë se si t'i aplikojmë të vërtetat e shkrimit në jetët tona.

Përmbledhje e mësimit

Ta njohësh Perëndinë nëpërmjet Fjalës së Tij
Qëllimi i Fjalës së Perëndisë
Gjetja e Perëndisë në Fjalën e Tij
Duke ushqyer veten shpirtërisht
Fryma e Shenjtë dhe Fjala
Fryma e Shenjtë na flet neve
Fryma e Shenjtë aplikon Fjalën e Perëndisë
Përfitimet e Fjalës
Të kuptuarit e Fjalës së Perëndisë
Zgjedh Fjalën
Përdore Fjalën
Medito në kuptimin
Aplikoje Fjalën
Mbaje mend Fjalën
Duaje Fjalën
Ndërto në Shkëmbin e fuqishëm
Kalo kohë çdo ditë me Fjalën e Perëndisë
Lexoje Fjalën e Perëndisë që të rritesh
Një qasje e thjeshtë e studimit të Biblës
Mendime përmbyllëse

Qëllimet e mësimit

Kur ta kesh përfunduar këtë mësim, të do të jesh në gjendje që:

1. Të identifikosh dhe vlerësosh se si studimi i Fjalës të ndihmon që të zhvillosh një marrëdhënie me Krishtin.
2. Të kuptosh se si Fryma e Shenjtë të ka udhëhequr në Fjalën për të marrë një veprim apo për të bërë një ndryshim në jetën tënde, si dhe të vlerësosh përgjigjen tënde në këtë drejtim të Perëndisë.
3. Të vlerësosh se ti i përvetëson përfitimet e Fjalës së Perëndisë: (a) rëndësinë e saj për ty; (b) pengesat për të gjetur kohë për ta studiuar atë; dhe (c) zgjedhjet që ti mund të bësh për t'i dhënë vetes më shumë kohë për Fjalën e Perëndisë.
4. Të shikosh pesë karakteristikat e një metode të mirë të studimit të Biblës dhe të krahasosh praktikën tuaj në lidhje me to.

5. Të zhvilloni një zakon personal të kohë së përditshme me Fjalën e Perëndisë.
6. Të zhvilloni një dashuri për Fjalën e Perëndisë dhe një dëshirë për ta lexuar atë rregullisht dhe për të aplikuar parimet e saj në jetën e përditshme.

Ta njohësh Perëndinë nëpërmjet Fjalës së Tij

Në Mësimin 1 ne kemi diskutuar se çfarë do të thotë të jesh një i krishterë. Të jesh i krishterë do të thotë të kesh një marrëdhënie me Perëndinë, gjë që është mundësuar nëpërmjet Birit të Perëndisë, Jezus Krishtit, i cili u sakrifikua për mëkatet tona. Teksa i përgjigjemi dhuratës plot hir të Perëndisë duke e vënë besimin tonë për shpëtim në Birin e Tij, ne hymë nëpër portën e ngushtë e cila na çon në shtegun që është jeta e krishterë.

Ashtu si një burrë dhe një grua në ditën e dasmës nuk dinë çdo gjë që mund të dihet për njëri tjetrin, ashtu edhe njohuria jonë për Perëndinë në ditën tonë të shpëtimit mund të jetë e kufizuar. Nëse mendojmë për një marrëdhënie të mirë martesore, ne shohim se si çdo vit intimiteti thellohet më shumë. Një çift rritet teksa ata ndajnë përvojat e tyre çdo herë e më shumë. Secili partner mëson për karakterin e partnerit tjetër dhe sigurohet më shumë në dashurinë e tjetrit. Bisedat rreth përvojave janë një faktor që i bashkon çiftet më afër njëri tjetrit.

Kështu është edhe me marrëdhënien tonë me Perëndinë. Përderisa dita e shpëtimit është dita jonë më e rëndësishme në jetën tonë, ajo është vetëm fillimi i jetës sonë me Perëndinë. Ne arrijmë ta njohim Perëndinë më shumë teksa kalojmë jetën së bashku me të dhe teksa kuptojmë më shumë karakterin e Tij.

Jetët e shumë personazheve të Biblës na kujtojnë neve natyrën rritëse të marrëdhënies tonë me Perëndinë. Mojsiu kishte ecur me Perëndinë shumë vite para se ai të thërritej për t'u ngjitur në Malin e Sinait për të përjetuar ballafaqimin e tij më personal me të Gjithëpushtetshmin. Dëshira e Mojsiut për ta njohur Perëndinë më thellë duket qartë në lutjen e tij: “Më bëjë të njohura rrugët e tua, që të kem mundësi të të njoh dhe të fitoj hir në sytë e Tu.” (Eksodi 33:13) Tek Eksodi 33:18 ai u lut “Tregomë lavdinë Tënde.” Perëndia e nderoi kërkesën e tij duke bërë që lavdia e Tij të kaloj para Mojsiut teksa ai qëndroi në një të qarë të një shkëmbi.



Lexo Eksodi 34:5-7 dhe 34:28-29.

1. Si ia tregoi veten Perëndia Mojsiut?
2. Si e përshkruan veten Perëndia?
3. Çfarë efekte pati në Mojsiun ky ballafaqim?

Ne vetëm mund të marrim me mend mënyrat në të cilat ky ballafaqim me Perëndinë e gjallë ndryshoi jetën e Mojsiut. Tek Numrat 12:3 ne lexojmë që Mojsiu ishte njeriu më i përlurur mbi faqen e dheut. Burrat dhe gratë e Biblës që patën një ballafaqim personal me Perëndinë u bënë të përlurur kur kuptuan lavdinë dhe fuqinë e Tij dhe patën një dëshirë për ta njohur Atë edhe më shumë.

Pali kishte qenë një ndjekës i Krishtit për shumë vite para se t'i shkruante fjalët tek Filipianëve 3:10, duke shprehur dëshirën e tij të thellë për të njohur Krishtin. Marrëdhënia që kishte filluar në rrugën për në Damask, ishte rritur gradualisht më thellë, më fuqishëm dhe më ëmbëlsisht teksa Pali kishte ecur me Krishtin. Njohja e

Qëllimi ynë në jetën e krishterë është një intimitet më i madh me Krishtin në mënyrë që të mund të reflektojmë Atë dhe t'i sjellim lavdi emrit të Tij.

Krishtit ishte bërë forca tërheqëse në jetën e Palit. Qëllimi i tij kryesor në jetë nuk ishte që të bëhej një ungjillor apo teolog më i mirë apo të jepte më shumë mësim mbi studimet e Biblës, mirëpo qëllimi ishte ta njohte Krishtin në mënyra edhe më të thella. Qëllimi ynë në jetën e krishterë është një intimitet më i madh me Krishtin në mënyrë që të mund të reflektojmë Atë dhe t'i sjellim lavdi emrit të tij.

Perëndia na ka dhënë atë që kemi nevojë për të realizuar këtë intimitet. Për të na mundësuar ta njohim Atë, ne kemi privilegjin që ta takojmë Atë nëpërmjet Fjalës së Perëndisë dhe lutjes. Bibla na është dhënë si fjalë e shkruar e Perëndisë – Fjala e Tij për ne, Komunikimi i Tij me ne, që na mundëson neve ta njohim Atë. Perëndia mori Vetë iniciativën për ta bërë Veten e Tij të njohur ndaj nesh. Sigurisht, ne mund të shohim fuqinë dhe hyjninë e Tij të shfaqur në natyrë; qielli, deti, malet, pyjet e dendura, dhe shkretëtirat, që të gjitha na flasin për Të. Megjithatë, Perëndia dëshiron që ne të dimë më shumë në lidhje me Veten e Tij se sa mund të shohim vetëm në natyrë. Teksa Ai i shfaqte Veten e Tij Abrahamit, Mojsiut, Davidit, dhe Palit, po në të njëjtën mënyrë Ai dëshiron që të na shfaqet edhe neve, dhe Ai e bënë këtë kryesisht nëpërmjet Fjalës së Tij.



Lexoni Hebrenjëve 1:1-5. Si na ofroi Perëndia një njohuri më të gjerë për Veten e Tij?

Biri i Perëndisë referohet si Fjala, Ai që na flet dhe e komunikon Atin tek ne (Gjoni 1:1-5). Teksa fokusohemi në fjalën e shkruar në këtë mësim, ne duhet të përkujtojmë se qëllimi i leximit të fjalës së shkruar është të njohim Fjalën e gjallë, Fjalën e gjallë të Perëndisë, Vetë Jezus Krishtin.

Qëllimi i leximit të fjalës së shkruar është të njohim Fjalën e gjallë, Fjalën e gjallë të Perëndisë, Vetë Jezus Krishtin

Sa më shumë që arrijmë të njohim Jezusin, aq më shumë e njohim Atin; sepse Jezusi ka thënë që kushdo që e ka parë Atë e ka parë Atin (Gjoni 14:9). Sa herë që ulemi për të hapur Biblën në mendjen tonë duhet të jetë mendimi më i lartë për të njohur Perëndinë. Ne duhet t'i qasemi leximit tonë me një qëndrim, që thotë, “Zot, çfarë do të më mësosh? Me trego më shumë për Ty dhe rrugët e Tua.”

Shpesh të krishterët e bëjnë zakon që t'i qasen Fjalës së Perëndisë mekanikisht, sikur thjeshtë leximi i saj do t'i bëjë ata automatikisht të shenjtë. Leximi i Fjalës së Perëndisë nuk është një vepër e mirë e cila duhet të jetë në listën e gjërave që kemi për të bërë. Farisenjtë e lexonin Dhiatën e Vjetër me shumë zell, megjithatë ata dështuan në ndërtimin e një marrëdhënieje personale me Autorin e faqeve të saj, dhe nuk arritën ta njohin Krishtin si Shpëtimtarin e premtuar (Gjoni 5:39). Satani dukshëm e njeh dhe mund edhe ta citojë Shkrimin, mirëpo në anën tjetër ai urren Atë që proklamohet në faqet e Shkrimit. Ne jemi në rrezik për të humbur elementin themelor të ndërtimit të marrëdhënies me Perëndinë kur e kthejmë studimin e Shkrimit në një ushtrim të thatë dhe të pajetë.



Falëndero Perëndinë për Fjalën e Tij që të mundëson ty ta njohësh Perëndinë në një mënyrë më të thellë. Teksa i qasesh Fjalës së Perëndisë sot, kërko nga Perëndia që Ai të shfaq më shumë nga Vetja e Tij dhe nga rrugët e Tij.

Qëllimi i Fjalës së Perëndisë

Perëndia na ka dhënë Fjalën e Tij për shumë arsye të ndryshme. Në mesin e tyre, e para është dëshira e Tij që ne ta njohim Atë, të thellojmë marrëdhënien tonë me Të, dhe të bëhemi më tepër në ngjasim me Krishtin. Duke i njohur arsyet pse Perëndia na ka dhënë Fjalën e Tij, ne mund të motivohemi që ta studiojmë atë.

Gjetja e Perëndisë në Fjalën e Tij

Mojsiu e inkurajoi popullin e Perëndisë që ta kërkojë Zotin me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt (Ligji i Përtërirë 4:29). **Perëndia dëshiron që ne ta kërkojmë Atë, dhe Ai kënaqet me ne kur ne i qasemi Fjalës së Tij me një dëshirë për ta takuar Atë**

dhe për ta njohur Atë. Ne mund t'i afrohemi Fjalës së Tij, që është komunikimi i Tij me ne, me pritjen e plotë që Ai do të na takojë ne dhe që do të shfaq vetën e Tij tek ne.

Gjoni na tregon neve se qëllimi kryesor i leximit të ungjillit të tij është që lexuesi të besojë se Jezusi është Krishti dhe të përjetojë jetën e përjetshme në Të (Gjoni 20:30-31). Ky mendim përsëritet përgjatë tërë Dhiatës së Re (Shiko Rom 10:17; 2 Tim 3:15; 1 Gjoni 5:13). Ne mund të arrijmë në konkludim se një ndër qëllimet e Perëndisë, pasi që Ai i drejtoi autorët e Dhiatës së Re të shkruajnë, ishte shpallja e së vërtetës në lidhje me Birin e Tij, Jezus Krishtin, në mënyrë që njerëzit t'i përgjigjeshin Atij me besim.

Duke ushqyer veten tonë shpirtërisht

Një qëllim tjetër i Fjalës së Perëndisë mund të shihet në vargjet në vijim.



Lexo vargjet në vijim. Përcakto qëllimin që Bibla ka sipas secilit varg si më poshtë.

Vargu(-gjet)

Qëllimi

Mateu 4:4

Gjoni 17:17

2Timoteu 2:15

2Timoteu 3:16-17

1Pjetri 2:2

Këto vargje përcaktojnë që Fjala e Perëndisë është dizajnuar për të na ushqyer në mënyrë që ne të mund të rritemi në shenjtëri. Fjala e Perëndisë jo vetëm që na ofron atë që kemi nevojë për të na sjell tek shpëtimi, ajo gjithashtu na ofron atë që ne si besimtarë kemi nevojë për t'u rritur në maturi dhe për t'u bërë më shumë si Krishti.

Shumë njerëz janë të kënaqur që ta njohin Krishtin si Shpëtimtarin e tyre, mirëpo nuk kanë asnjë dëshirë që të shkojnë në një nivel më të thellë në njohurinë e tyre për Të. Të kthehemi tek analogjia jonë mbi martesën, kjo është ekuivalente sikur të martohesh dhe t'i thash burrit apo gruas tënde, “Mirë, ne jemi martuar tash, dhe tani unë di që çdo gjë që mund të jetë e njohur në lidhje me ty, dhe kështu ne nuk kemi nevojë që të komunikojmë më me njëri tjetrin.” Një deklaratë e tillë është qesharake sepse e dimë që komunikimi është thelbësor nëse një çift do që të rritet më afër njëri tjetrit. Po kështu, Perëndia dëshiron të vazhdojë komunikimin me ne. **Ai ka një arkë thesari të së vërtetës rreth Vetës dhe Birit të Tij, të cilën dëshiron ta ndajë me ne, e cila përgjatë viteve do t'i ndihmojë marrëdhënies tonë që të rritet më thellë dhe më fuqishëm.**

Bibla përmban “qumësht” për t'i ushqyer të krishterët e sapolindur, në mënyrë që ai apo ajo të themelohet fuqishëm në besim, mirëpo Bibla ka shumë më tepër për të ofruar se sa thjeshtë qumësht. Bibla gjithashtu përmban “mish”, mësim më të thellë që është

më i vështirë të kuptohet dhe të tretet. Ashtu si një foshnje fillon jetën me ushqim të lëngshëm dhe gradualisht fillon të tret ushqim të fortë, ashtu edhe një besimtar i ri duhet të përparojë në mësim më të forta.

Fjala e Perëndisë na ndihmon që të rritemi në jetën tonë të krishterë. Tek 2Timoteu 3:16 ne shohim që Shkrimi është i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi. Këto katër aspekte mbulojnë tërë fushën e asaj që ne duhet të dimë për Perëndinë dhe marrëdhënien tonë me Të. Bibla është e mbushur me mësim të pasura në lidhje me karakterin dhe veprat e Perëndisë, planin e Tij për shpëtim, dhe zbulimin e Birit të Tij, Jezus Krishtit. Shkrimi jo vetëm që na mëson rreth Perëndisë dhe zbulon planin e Tij të shpëtimit në Krishtin, ai gjithashtu na jep udhëzimet në drejtësi, duke na treguar se si të jetojmë një jetë që e kënaq Perëndinë.

Bibla gjithashtu është e dobishme për qortim dhe korrigjim, të cilat në fakt janë vetëm dy anët e së njëjtës medalje. “Qortimi” nënkupton kur Bibla na tregon se e kemi gabim, si në të kuptuarit tonë ashtu edhe në praktikën tonë. Jo vetëm kaq, Bibla gjithashtu na tregon edhe rrugën e drejtë. “Korrigjimi” është ai që na kthen në rrugën e drejtë.

Ne mund të përmbledhim dy qëllime të Fjalës së Perëndisë: Perëndia dëshiron që ne të shpëtohem dhe që rritemi në shenjtëri. Fjala e Perëndisë – e shkruar, e mësuar, dhe e predikuar – është instrumenti kryesor që Perëndia përdor për të përmbushur këto qëllime.



Si i ke përjetuar në jetën tënde dy qëllimet e Fjalës së Perëndisë? Si është thelluar intimiteti yt me Perëndinë nëpërmjet studimit të Biblës?

Fryma e Shenjtë dhe Fjala

Ekziston një lidhje shumë e ngushtë në mes të Fjalës së Perëndisë dhe burimit tonë mbinatyror në personin e Frymës së Shenjtë. Në mënyrë që të përmbushet vepra e Tij në këtë botë, Fryma e përdor Fjalën e Perëndisë.

Fryma e Shenjtë na flet neve

Tek 2Pjetri 1:21 ne mësojmë se Fryma e Shenjtë ka frymëzuar dhe ka drejtuar shkrimtarët biblik teksa ata kanë regjistruar fjalët e Shkrimit. Fryma e Shenjtë, si Personi që ka frymëzuar shkrimtarët biblik, është plotësisht në gjendje që të na ndihmojë ta kuptojmë Fjalën e Perëndisë. Pasi që Perëndia shfaq Veten e Tij nëpërmjet Fjalës dhe nëpërmjet Fjalës njerëzit ndërlidhen me Të, dhe kështu Bibla bëhet mjeti me të cilin Fryma i hap zemrat dhe mendjet tona për të menduar në lidhje me Zotin Jezus. Njerëzit, pa Frymën, nuk mund të kenë këtë qasje.



Lexo 1Korintasve 2:11-16. Si mund ta shpjegosh marrëdhënien në mes të Frymës dhe të kuptuarit tonë rreth të vërtetës shpirtërore?

Fryma e Shenjtë bënë të njohura mendimet e Perëndisë për ne, duke na ndihmuar që t'i kuptojmë ato. Perëndia dëshiron që të gjithë njerëzit të shpëtohen, dhe Ai i ka frymëzuar autorët e Shkrimit që të komunikojnë të vërtetën, për pjesën më të madhe, në një mënyrë të qartë dhe të thjeshtë në mënyrë që ne të mund ta kuptojmë atë. Fryma e Shenjtë do t'i përgjigjet me gatishmëri atij që dëshiron ta dijë të vërtetën me gjithë zemër.

Ne shohim se si Fryma e merr Fjalën dhe ndërvepron me ne, duke na i hapur sytë që të shohim Jezus Krishtin si Birin e Perëndisë. Jo vetëm kaq, ashtu siç mësuam në Mësimin 2, është Fryma, Ai që na shtyn t'i bindemi Atij, duke na bindur për mosbindjen tonë, dhe është Fryma që na drejton për të jetuar jetën në atë mënyrë që është e pëlqyeshme për Perëndinë. Vepra e Perëndisë dhe Fryma e Shenjtë janë të pandashme.

Fryma e Shenjtë aplikon Fjalën e Perëndisë

Në Mësimin 2 ne pamë se Fryma e Shenjtë punon në jetët tona në një sërë mënyrash. Le të shikojmë një shembull se si punon Ai në jetët tona nëpërmjet Fjalës së Perëndisë.

Për shembull, ne mund të lexojmë një pasazh si Efesianëve 4:32 që flet rreth faljes. Ne e dimë që jeta e krishtere duhet të karakterizohet me anë të faljes. Kur marrim këtë të vërtetë dhe fillojmë të mendojmë rreth implikimeve të saj, Fryma e Shenjtë na bënë të ditur për ndonjë situatë ku ne nuk kemi dashur që të falim. Ai vazhdon të punojë në ne deri sa të përgjigjemi drejt thirrjes së Tij për të falur atë person të caktuar.

Fryma e Shenjtë e përdor Fjalën e Perëndisë për të na bërë të ditur praninë e mëkatit në jetën tonë dhe na ndihmon që ta shkulim atë prej jetës tonë. Perëndia e ka dizajnuar Shkrimin për t'i dhënë orientim moral njerëzve që jetojnë në çfarëdo kulture, në çfarëdo moshe, nën çfarëdo klime të moralit. Udhëzimet morale që gjenden në Bibël reflektojnë karakterin e Perëndisë. Kur shohim një urdhërim specifik, Fryma derdh dritë mbi të për ne, i ndihmon ndërgjegjes sonë që të riorientohet, dhe pastaj na jep një mprehtësi për të kuptuar se si mund ta aplikojmë atë në jetën tonë.

Për shembull, 1Korintasve 6:18 u tregon besimtarëve që të heqin dorë nga imoraliteti seksual. Fryma punon në ne për të na bërë që të kuptojmë më thellë se çdo të thotë mëkat seksual dhe për nevojën tonë për të hequr dorë nga një mëkat i tillë. Ai na bind për dështimin tonë dhe na tregon për mënyrat ku mund të aplikojmë këtë urdhër. Ne fillojmë të shohim se ky urdhër ndikon çdo gjë që mund të vije në mendjen tonë. Për t'ju bindur, ne duhet të aplikojmë atë ndaj asaj që më parë kemi lexuar, parë, menduar dhe bërë. Fryma na bind në këto fusha teksa meditojmë në Fjalën e Perëndisë. Sa më shumë që të meditojmë në të, aq më shumë ne fillojmë të kemi mendjen e Krishtit në

lidhje me atë fushë. Kur i përgjigjemi nxitjeve të Frymës, Shkrimi bëhet më me ndikim duke i dhënë kështu formë sjelljes sonë.



Si e ke përjetuar Frymën e Shenjtë të bashkëveprojë në jetën tënde nëpërmjet Fjalës së Perëndisë? Si je përgjigjur ndaj nxitjeve të Frymës së Shenjtë?

Përfitimet nga Fjala

Bibla është një thesar që është i yni për ta shijuar dhe për ta hulumtuar. Një jetë e tërë nuk mjafton për të hulumtuar tërë pasuritë e saja. Teksa shikojmë Shkrimin, ne zbulojmë bekime apo përfitime të panumërta që i ofrohen personit që ka dëshirë që të marrë kohë për ta kërkuar Perëndinë që zbulon Vetën e Tij në faqet e Fjalës së Tij.



Lexoni vargjet si më poshtë. Cilat janë ato bekime apo përfitime që ti gjen nga studimi i Fjalës së Perëndisë sipas këtyre vargjeve?

Vargu(-gjet)

Përfitimet

Psalmi 17:4; 119:11, 101-102

Psalmi 19:8; 119:111

Psalmi 19:11

Psalmi 119:9

Psalmi 119:50

Psalmi 119:98-99, 130

Psalmi 119:105; 25:4-5

Psalmi 119:165

Fjalët e Urta 6:23

Romakëve 15:4



Lexoji këto vargje edhe një herë. Cilat nga këto përfitime të Fjalës së Perëndisë janë të rëndësishme për ty? Si mund t'i përjetosh këto bekime në një masë më të madhe?



Merr kohë për ta falënderuar Perëndinë për përfitimet që dalin nga Fjala e Tij sipas vargjeve të mësipërme dhe për mënyrat që Fjala e Tij të ka ruajtur në rrugën e drejtë.

Përfitimet më të mëdha nga Fjala e Perëndisë janë rezultat i bashkëveprimit të vazhdueshëm me të në mënyra të ndryshme.

Duke u thelluar në Fjalën e Perëndisë

Një fjalë e njohur thotë, “Mund ta çosh kalin tek uji, por nuk mund ta detyrosh që të pijë ujë” Kjo është një zgjedhje që kali duhet ta bëjë vetë. Kështu është edhe me ushqimin shpirtëror. Ekzistojnë shumë mënyra për t’i drejtuar njerëzit tek burimi i Fjalës së Perëndisë, mirëpo pirja gjithmonë u takon atyre. **Si të krishterë ne duhet të zgjedhim që ta lexojmë Fjalën.**

Zgjedh Fjalën

Shumë kundërshtojnë, “Unë nuk kam kohë që ta studioj Biblën.” Sa shpesh e mbushim agjendën tonë të ditës me aktivitete, shumë duke pretenduar që mund të bëjmë shumë më shumë gjera se sa në realitet mund të përmbushim. Në fund të ditës e kuptojmë se nuk kemi kaluar aspak kohë me Fjalën e Perëndisë. Shumë gjëra që zgjedhim për të bërë janë të mira, mirëpo e mira mund të jetë armiku i më të mirës. Kur në agjendën tonë ditore nuk gjejmë kohë për Fjalën e Perëndisë, ne në thelb jemi duke vdekur urie shpirtërisht, dhe rezultatet do të jenë të dukshme në përvojën e pa fryt dhe të thatë të jetës së krishterë.



Kur në agjendën tonë
ditore nuk gjejmë kohë
për Fjalën e
Perëndisë, ne në thelb
jemi duke vdekur urie
shpirtërisht

Studimi serioz i Biblës është aq i domosdoshëm për një të krishterë sa është edhe ushqimi. Ashtu siç gjejmë kohë për të ngrënë, fjetur, punuar, për t’u shoqëruar, dhe për t’u kënaqur me aktivitet e kohës së lirë, po ashtu ne duhet të gjejmë kohë për të studiuar Biblën, duke e bërë atë një zakon të rregullt të jetës sonë të përditshme.

Por, si e lexojmë ne Fjalën e Perëndisë? Në librin e tij, *Shaped by the Word (I formuar nga Fjala)*, Rober Mulholland, bënë një dallim në mes të leximit “formues” dhe leximit “informues”¹ **Përderisa në leximin informues detyra e lexuesit është që të kontrollojë tekstin, qëllimi i leximit formues është që teksti ta kontrollojë lexuesin.**² Kjo kërkon një qasje tjetër të leximit të Biblës. “Në vend të qasjes analitike, kritike dhe gjykuese, leximi formues kërkon një qasje të përlur, të veçuar, të vullnetshme dhe të dashur.”³ Në këtë qasje, lexuesit do të formohen nga ajo që lexojnë.

Shpesh ne i qasemi leximit të Biblës si një detyrë ditore, e cila duhet të përmbushet. Shumë shpejt e mbyllim Biblën pasi që të kemi përfunduar leximin e pasazhit ditor, duke e përdorur Fjalën e Perëndisë si një detyrë në listën tonë ditore. Ne mund ta shikojmë leximin e Biblës si një arritje shpirtërore sapo të kthehemi në detyrat tona ditore. Për pastorët dhe drejtuesit e krishterë, ekziston një tendencë për të lexuar Biblën me pikëvështrimin e planifikimit për t’i mësuar të tjerët. Mirëpo shkrimtarët biblik kishin një perspektive tjetër ndaj Fjalës së Perëndisë.



Lexoni tërë Psalmin 119. Cilat janë temat që përsëriten në këtë psalm?

Në këtë psalm autori e lartëson vlerën e Fjalës së Perëndisë. Askund tjetër në Shkrim nuk gjejmë ndonjë katalog aq të gjerë mbi pasuritë e Biblës. Në vargjet e poshtëshënuara vini re disa nga zgjedhjet personale që autori i psalmit regjistron për ne.



Lexoni secilin varg dhe shënoni zgjedhjen që autori kishte marrë.

Vargu

Zgjedhja

Psalmi 119:1-2

Psalmi 119:30

Psalmi 119:44

Psalmi 119:59-60

Psalmi 119:101

Psalmi 119:147-8

Në vargun 133 psalmisti lutet, “Stabilizoi hapat e mia sipas fjalëve të tua dhe mos lejo që asnjë paudhësi të më sundojë.” Kjo është lutja e një njeriu që i ka vendosur rrugët e Perëndisë dhe Fjalën e Perëndisë përpara tij si spirancën e jetës.



Shqyrto zgjedhjet e regjistruara nga psalmisti.

- Çfarë zgjedhje ke bërë në lidhje me Fjalën e Perëndisë?
- A i ke dhënë Fjalës së Perëndisë një vend të lartë në jetën tënde?
- Çfarë janë ato gjëra që priren të të pengojnë për ta bërë Fjalën një prioritet në jetën tënde?



Ndalu dhe falëndero Perëndinë që na ka dhënë Fjalën e Tij dhe kërko nga Ai që të ndihmoj për ta dëshiruar Fjalën e Tij ashtu siç e ka dëshiruar shkrimtari i Psalmi 119.

Përdore Fjalën

Psalmi 119 na ofron një model se si mund të përdorim Fjalën e Perëndisë në jetët tona.



Në Psalmin 119 shikoni vargjet e poshtëshënuara. Si kishte bashkëvepruar autori me Fjalën e Perëndisë teksa e kishte lexuar atë? Vini re se si e aplikon ai atë në jetën e tij.

Vargu

Psalmi 119:10
 Psalmi 119:18, 27
 Psalmi 119:25
 Psalmi 119:29
 Psalmi 119:33-34, 73
 Psalmi 119:36
 Psalmi 119:116
 Psalmi 119:125

Aplikimi

Është e qartë se psalmisti kishte kaluar mjaft kohë në Fjalën e Perëndisë, duke e lexuar atë, duke e studiuar atë, duke menduar në lidhje me kuptimin e saj, dhe duke kërkuar që ta aplikojë atë në jetën e tij.

Është i duhur një shënim për të pasur kujdes se si e përdorim Shkrimin. Shumë të krishterë kanë tendencën ta trajtojnë Biblën si një horoskop. Ata e hapin Biblën me hamendje dhe shpresojnë që Perëndia do t'ju jap një këshillë specifike nga pasazhi që ata lexojnë. Rreziku i kësaj qasjeje është se lexuesit zakonisht humbasin mësimin e vërtetë të pasazhit teksa e kalojnë nëpër filtrin e nevojave dhe rrethanave personale. **Në etjen tonë për të gjetur vargun që të do ta ndihmonte për të na drejtuar neve, ne mund ta keqpërdorim Biblën.** Kur lexojmë Fjalën, Perëndia nganjëherë na flet drejtpërsëdrejti për problemin apo situatën në jetën tonë. Mirëpo ne duhet të kemi kujdes që të mos insistojmë që Bibla të thotë atë që ne duam që ajo të thotë, por të fokusohemi në atë që ajo thotë me të vërtetë.

Medito në kuptimin

Ne kemi folur në lidhje me rëndësinë e leximit të Fjalës së Perëndisë dhe rolin e Frymës së Shenjtë për të na hapur sytë drejt së vërtetave që ne duhet të lexojmë. Është gjithashtu e rëndësishme që të meditojmë mbi atë që lexojmë në mënyrë që t'i lejojmë Fjalës së Perëndisë dhe Frymës së Shenjtë të punojnë në ne.

Çfarë nuk është meditimi. Këto vitet e fundit fjala “meditim” ka marrë disa ngjyime negative. Meditimi, në kuptimin që jemi duke e përdorur këtë fjalë, nuk është një rit apo teknikë fetare. Shumë fe e përdorin një formë të meditimit, që është një qasje e cila përfshinë teknikat e relaksimit, siç është për shembull frymëmarrja e thellë. Këta njerëz meditojnë duke e kthyer vëmendjen përbrenda, duke trajnuar mendjet e tyre të filtrojnë jashtë mendimet dhe duke u fokusuar në frymëmarrjen e tyre, përdërisa përsëritja gojore përfshinë vetëm një fjalë apo një tog fjalësh të thjeshtë. Qëllimi i një “meditimi” të tillë është që të arrihet “harmonia e brendshme” me anë të pastrimit të mendjes. Kur shkrimtarët biblik folën për meditimin mbi Fjalën e Perëndisë nuk patën një mendje një meditim të tillë. Në fakt, zbrazja e mendjes dhe këndimi i një mantre*

mund të jetë një ftesë e rrezikshme ndaj fuqive djallëzore për të mbushur atë vend të zbrazët.

Çfarë është meditimi. Meditimi mbi Shkrimin është qartë një shprehje e një personi të perëndishëm. Davidi meditoi shpesh mbi Shkrimet, dhe përmbajtja e meditimit të tij është ruajtur për ne në psalmet e tij. Në Psalmin 63:6-8 ai shkroi, “Të kujtoj në shtratin tim, të mendoj kur rri zgjuar natën, duke qenë se ti ke qenë ndihma ime, unë këndoj tërë gëzim nën hijen e krahëve të tu. Shpirti im mbahet ngushtë te ti; dora jote e djathtë më mban.”



Lexo Jozueu 1:7-9.

1. Sipas këtyre vargjeve çfarë e urdhëroi Moisiu Jozueun që të bëjë?
2. Pse ishte kjo e rëndësishme për udhëheqësin e ri?

Meditimi, siç e kuptojmë nga vargjet e tilla, **është thjeshtë të menduarit rreth Perëndisë dhe Fjalës së Tij, duke fokusuar vëmendjen tonë në Të dhe rreth karakterit të Tij dhe në të vërtetat e Fjalës së Tij.** Teksa lexojmë një varg apo pasazh, ne mendojmë rreth kuptimit dhe aplikimit të asaj sapo kemi lexuar. Kur marrim kohë të mendojmë rreth Tij, ne mund t’i përkujtojmë vetes të vërtetat që lidhen me karakterin e Tij, premtimet e Tij, veprat e Tij dhe dëshirën e Tij për ne. Të menduarit rreth Perëndisë dhe Fjalës së Tij na ndihmon që të ngremë një urë në hapësirën që është në mes të asaj që kemi lexuar dhe jetës që jetojmë. Na ndihmon që të sjellim Fjalën e Tij në situatat e përditshme që ballafaqojmë dhe të aplikojmë personalisht të vërtetat që kemi lexuar. Një ndër gjërat më të rëndësishme që mund të bëjmë për t’u formuar dhe ndërtuar nga Fjala e Perëndisë është që t’i japim kohë për të reflektuar mbi të.

Apliko Fjalën

Perëndia jo vetëm që dëshiron që ne ta lexojmë Fjalën e Tij dhe të reflektojmë e të meditojmë në të, Ai gjithashtu dëshiron që ne t’i bindemi asaj.



Lexo Jakobi 1:22-25. Krahasoni dy përgjigjet që jepen në këto vargje për Fjalën e Perëndisë.

Jakobi thotë se ai që shikon me vëmendje ligjin e përsosur, duke u bërë një bërës i veprës dhe do të jetë i bekuar. Ai na këshillon duke na thënë “Bëhuni bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues, që gënjejnë vetveten”. Së fundi jetët tona duhet të ndryshohen nga leximi dhe studimi i Biblës. Perëndia do që ne të rritemi drejt pjekurisë dhe që t’i ngjasojmë sa më shumë Krishtit. Teksa lexojmë, meditojmë dhe aplikojmë Fjalën e Perëndisë në jetët tona të përditshme, ne do të fillojmë të shohim se si ndodhin ndryshimet përbrenda nesh.



- Si je rritur në fushën e meditimit mbi kuptimin e Fjalës së Perëndisë?
- Si e vendos Fjalën e Perëndisë në praktikë në jetën tënde?
- Cilat janë ato ndryshime që mund t'i vëresh në jetën tënde e që janë rezultat i leximit, meditimit dhe aplikimit të Fjalës së Perëndisë në situata të ndryshme të jetës tënde?

Mëso përmendësh Fjalën

Mësimi përmendësh i Fjalës së Perëndisë është një mënyrë e shkëlqyer për ta ndërtuar atë në jetën tënde në mënyrë që të jetë e gatshme sa herë që të nevojitet. Psalmisti shkroi: “E kam ruajtur fjalën tënde në zemrën time, që të mos mëkatoj kundër teje.” (Ps. 119:11) Jezusi i përdori fjalët që kishte mbajtur mend nga Shkrimi për të mbrojtur Vetën kur ballafaqoi tundimet e Satanit. Ne mund t'i ndihmojmë vetes me të njëjtën burime që Shpëtimtari ynë përdori.



Merr kohë dhe mëso përmendësh Psalmin 1 para se takimi i radhës të vije. Mëso për çdo ditë nga një varg, duke e mbajtur mend dhe duke medituar në lidhje me të. Shtoji nga një varg deri sa mund ta përsëritësh të gjitha vargjet së bashku. Pastaj parafrazoje me fjalët e tua.

Teksa mëson vargjet përmendësh, sigurohu që do të meditosh për tërë pasazhin rreth atij vargu, mbase edhe për tërë kapitullin, për t'u siguruar që e ke kuptuar si duhet dhe në pajtim me kontekstin e tij. Përndryshe, mund të rrezikosh që ta keqkuptosh një varg dhe kështu ta aplikosh gabueshëm në jetën tënde.

Duaje Fjalën

Shkrimtarët e Biblës shpesh ishin shtyrë që të shprehnin atë se çfarë Bibla nënkuptonte për ta.



Lexo vargjet në vijim. Çfarë vlere kishte Fjala e Perëndisë për autorët e këtyre vargjeve? Si e përshkruan, secili autor, Fjalën apo ndjenjat e tij rreth Fjalës?

Vargu

Jobi 23:12

Psalmi 119:20, 24

Psalmi 119:97

Psalmi 119:131

Jeremia 15:16

Përshkrimet e autorit për Fjalën



- Si mendoni që këta shkrimtarë arritën të kenë këtë dashuri të zjarrtë për Fjalën e Perëndisë?
- Çfarë roli ka Fjala e Perëndisë në jetën tënde?
- Çfarë hapa praktik mund të marrësh në mënyrë që Fjala e Perëndisë të ketë një ndikim edhe më të madh në jetën tënde?




Kërkoji Perëndisë që të të jep një dashuri për Fjalën e Tij, në mënyrë që ti të mendosh për të si për kënaqësinë e “zembrës tënde” dhe që do të kesh mall të kalosh kohë me të.

Ndërto në shkëmbin e fuqishëm

Kur ne Zgjedhim Fjalën dhe e përdorim atë çdo ditë, duke aplikuar të vërtetat e saj në jetët tona, ne jemi duke ndërtuar jetët tona në Fjalën e Perëndisë.



Lexo Mateu 7:24-27. Për çfarë themeli është duke folur Jezusi, dhe çfarë roli ka ky themel në kohë të vështira?



Në çdo situatë ne mund të shkojmë tek Fjala e Perëndisë dhe të zbulojmë se Fjala është një themel i fuqishëm. Një grua që kishte përjetuar një tragjedi të madhe në jetën e saj, shkruan, “Në mesin e stuhive më të fuqishme që kam ndeshur Fjala e Perëndisë ka qenë një spirancë për mua. Pa këtë spirancë në jetën time, do të isha mbytur në mesin e valëve të frikës dhe të pikëllimit. Nëpërmjet Fjalës së Tij, Perëndia më ka dhënë paqe, dhe qetësi në vend të panikut, pasi që më ka përkujtuar mirësinë e Perëndisë, praninë e Tij me mua, dhe dashurinë e Tij të përjetshme ndaj meje.

Në mënyrë që të ndërtojmë mbi këtë themel, ne duhet të bindemi se ne mund të mbështetemi në Biblën si mbi një kompas të besueshëm për të na udhëhequr ne në jetë. A është themeli i besueshëm?

Ne pamë disa pasazhe, si 2 Timoteu 3:16 dhe 2 Pjetri 1:20-21, që tregojnë se Bibla deklaron se është e Fjala e frymëzuar e Perëndisë. Fjala e Perëndisë është e përjetshme, një udhëzues i sigurt që Perëndia na ka dhënë për të drejtuar hapat tona teksa ecim në këtë botë drejt rrugës së përjetësisë. Udhëzues të tjerë mund të duken të besueshëm por si do që të jetë në fund do të na dështojnë. Fjala e Perëndisë është i vetmi standard në të cilin ne mund të mbështetemi si udhëzuesin tonë përgjatë jetës. Ajo është vija e plumbçit (*Plumbçi – masa për matjen e thellësisë së tokës shën i perk.*), standardi i besimit, me anë të së cilës ne masim gjithçka që besojmë dhe çdo gjë që bëjmë.

Disa, sigurisht, mund të dyshojnë që Bibla është Fjala e Perëndisë, e frymëzuar nga Ai. Kur ne kemi dyshime të tilla, Perëndia na fton që të vërtetojmë autenticitetin e Fjalës së Tij. Merr kohët për ta lexuar Biblën me një mendje të hapur, me një gatishmëri për t’i pranuar pohimet e saj. Kërko nga Perëndia që Ai të të tregoj nëse kjo me të vërtetë është Fjala e Tij.

Kalo çdo ditë kohë me Fjalën e Perëndisë

Ashtu siç ushqejmë trupat tanë fizik, me ushqim dhe me pije ditore, po ashtu edhe natyra jonë shpirtërore ka nevojë për ushqyerje të përditshme. Ne me siguri që nuk zgjedhim të vdesim urie kur kemi ushqim në dispozicion, ndërsa shpesh të krishterët nuk arrijnë të kuptojnë nevojën edhe kënaqësinë e të ushqyerit të shpirtave të tyre me Fjalën e Perëndisë.

Kur populli i Izraelit u larguan nga skllavëria e Egjiptit, Perëndia furnizoi për nevojën e tyre të ushqimit me anë të një substance misterioze të quajtur mana. Mana binte çdo ditë, dhe populli i Perëndisë duhej vetëm të dilte jashtë tendave për ta mbledhur atë çdo ditë. Ata ishin udhëzuar që të mos mblidhnin më shumë se sa ata mund të hanin dhe të mos mblidhnin për të ruajtur për ditën tjetër. Nëse bënë ashtu, mana do të kalbej dhe do të prodhonte krimba (Eksodi 16:13-31). Kjo mana është një fotografi e Krishtit, që është buka e jetës, dhe tregimi na mëson neve për nevojën që kemi çdo ditë që të ushqehemi me Të. Koha jonë që kalojmë me Fjalën e Perëndisë është sikur mana për ne.

Kur shohim nevojat tona shpirtërore, ne kuptojmë se zakoni për t'u ushqyer me Fjalën është thelbësor për t'u bërë të fortë dhe për të na ndihmuar që të mbështetemi në Perëndinë çdo ditë për nevojat tona. Kur dishepujt e petën Jezusin, që t'i mësonte ata sitë luteshin, lutjen që Jezusi u ofroi atyre, përfshiu edhe fjalët, “Na jep bukën tonë të përditshme”. Kjo do të thotë që lutemi **çdo ditë**, duke i kërkuar Perëndisë të furnizojë për nevojat tona për atë ditë specifike.

Ne shohim se ky zakon i të festuarit në Fjalën e Perëndisë është një privilegj që Perëndia na ka dhënë për përfitimin tonë – për të na bërë të fortë dhe përparimtarë. Ai na jep atë që kemi nevojë për ushqimin tonë shpirtëror, megjithatë Ai mendon që ne të vijmë çdo ditë për të mbledhur këtë ushqim shpirtëror. Mana e javës së kaluar nuk do të jetë e mjaftueshme për ne në mesin e situatës së sotshme.

Lexo Fjalën e Perëndisë për t'u rritur

Shumë besimtarë ndër shekuj kanë dhënë këshilla të ndryshme se si të lexohet Bibla me efekt dhe me përkushtim. Martin Luteri kishte rekomanduar që të lexohet Shkrimi para se të biem në gjumë në mënyrë që të t'i mbush mendimet në mbrëmje. Gjon Ueslli shkroi: “Nëse dëshironi që të lexoni Shkrimet në atë mënyrë që do të ishte më se e efektshme ... a nuk do të ishte e këshillueshme që të ndani pak kohë, nëse mundeni, çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje?”⁴ Ai sugjeroi që të lexohej një kapitull nga Dhiata e Vjetër dhe një nga Dhiata e Re, apo një pjesë të kapitullit, duke lexuar, “me një sy të vetëm, për të njohur gjithë vullnetin e Perëndisë, dhe me një vendim të vetëm, për ta jetësuar atë” Ai gjithashtu inkurajoi besimtarët që të luteshin para dhe pas leximit të Fjalës së Perëndisë “në mënyrë që ato që kemi lexuar të shkruhen në zemrat tona.”⁵

Qëllimi i kalimit të kohës në Fjalën e Perëndisë për çdo ditë është që ta njohim Perëndinë më mirë dhe të thellojmë marrëdhënien tonë me Të, përderisa Ai na flet

me anë të Fjalës së Tij. Teksa është e rëndësishme që të mësojmë se si të studiojmë Shkrimet me kujdes dhe me themel, ky nuk duhet të jetë qëllimi ynë i kohës së përditshme me Perëndinë. Një studim i detajuar i Biblës është shumë i rëndësishëm dhe mund të arrij rezultate të mëdha, mirëpo nëse studimi ynë nuk tejkalon marrjen e informacionit, atëherë ai është i pavlerë.

Ekzistojnë qindra shkollare që dinë më shumë në lidhje me historikun dhe detajet e Biblës se sa shumica e neve mund të dinë, por sidoqoftë ata janë të vdekur shpirtërisht. **Vetëm studimi i Biblës asnjëherë nuk do ta ndryshojë jetën e një njeriu.** Udhëheqësit e krishterë mund të rrëshqasin në një metodë të studimit të Fjalës së Perëndisë në mënyrë që të paraqesin një predikim më të mirë, apo që të mos turpërohen

Qëllimi i kalimit të kohës
në Fjalën e Perëndisë për
çdo ditë është që ta njohim
Perëndinë më mirë dhe të
thellojmë marrëdhënien
tonë me Të.

kur japin një mësim. Ekziston rreziku për t'u bërë një ekspert i mësuar i cili nuk është i hapur personalisht që ta dëgjojë zërin e Perëndisë. Studimi i Fjalës së Perëndisë në një mënyrë të pastër akademike, mund të na bëjë zemërgurë dhe që nuk reagojmë ndaj veprën së Frymës në jetët tona. Qëllimi i kohës sonë të përditshme me Perëndinë nuk është që të bëjmë detyra të shkollës, mirëpo të njohim Krishtin në mënyrë më intime, dhe të dëgjojmë Perëndinë se si na flet nëpërmjet Fjalës së Tij.

Nëse dëshirojmë të lexojmë Fjalën e Perëndisë, të dëgjojmë zërin e Tij dhe të rritemi, është e rëndësishme që të kemi sa më pak hutime që të jetë e mundur. Eliminimi i hutimeve dhe vendosja e kohës së rregullt dhe të mbrojtur, janë elemente të rëndësishme për të mirëmbajtur një jetë të mirë të devotshme. Një faktor tjetër që kontribuon në kohën e qetë të efektshme është gjetja e një vendi të përshtatshëm. Është e rëndësishme që të kesh një vend ku ti rregullisht shkon për të qenë vetëm me Perëndinë. Kjo është më se e vërtetë sidomos nëse keni fëmijë të vegjël apo nëse jetoni me shumë njerëz.



Përgjigjuni këtyre pyetjeve për t'ju ndihmuar të vlerësoni zotimin tuaj për të komunikuar me Perëndinë nëpërmjet Fjalës së Tij.

1. Ku kaloni kohë me Zotin? A është një vend i qetë me pak hutime? Nëse jo, a mund të gjesht një vend më të përshtatshëm?
2. Sa shpesh kaloni kohë në Fjalën e Perëndisë?
3. Nëse është e vështirë, çfarë mund të bësh për ta bërë atë një prioritet?
4. Cilat aktivitete mund t' i heqësh në mënyrë që t' i ofrosh vetes kohën e nevojshme?

Një qasje e thjeshtë e studimit të Biblës.

Një metodë e thjeshtë e studimit na ndihmon që të mendojmë në lidhje me atë që kemi lexuar dhe ta aplikojmë atë në jetën tonë të përditshme. Një jetë e ndryshuar është rezultat i bashkëveprimit me Shkrimet. Në një kurs tjetër do të paraqesim një metodë më të zgjeruar të studimit të Biblës që quhet studim induktiv. Studimi induktiv e tërheq lexuesin drejt një ndërveprimi më personal me Biblën. Studenti e shikon një pasazh apo një libër të tërë në Bibël, duke i përdorur tre hapa: vështimin, interpretimin dhe aplikimin.

Një qasje tjetër e studimit të Biblës është leximi i Biblës nga fillimi deri në fund. Nëse lexoni katër kapituj për çdo ditë, ju do të arrini ta mbuloni gjithë materialin për nëntë muaj. Kjo qasje ju ofron një pamje të madhe të të gjithë Shkrimit, të shkruar brenda një periudhe kohore rreth 1600 vjetësh. Ju mund të shikoni ndërlidhjet e mahnitshme të pjesëve të ndryshme të Biblës.⁶

Teksa këto metoda janë të vlefshme për studime më intensive të Biblës, qëllimi ynë në këtë mësim është që të prezantojmë një metodë të thjeshtë dhe të thellë të studimit të Biblës, që mund të përdoret për një studim devotshmërie për çfarëdo pasazhi të Shkrimit dhe që thekson aplikimin e parimeve biblike në jetë.

Karakteristikat e një metode të mirë ditore të studimit të Biblës. Këtu përfshihen disa karakteristika të një studimi të mirë ditor të Biblës. Mendo në lidhje me metodën që je duke përdorur aktualisht, dhe shiko nëse i takon këto kritere.

1. E thjeshtë. Një i krishterë i ri pyeti një herë një mik që t'i tregonte se si ta studionte Biblën. Si për inat të tij, ai kishte dhënë një metodë prej pesë faqesh për të studiuar Biblën, që kishte rreth 100 hapa për të ndjekur. I përkushtuar që të provonte këtë metodë, ky burri i ri kaloi dy orë të frustruara vetëm në dy hapat e parë. Hoqi dorë i dëshpëruar duke menduar se kurrë nuk do të arrinte të studionte Biblën për veten e tij. Ne duhet të pyesim veten tonë se sa e mirë mund të jetë një metodë nëse njerëzit nuk e përdorin atë asnjëherë. Metoda më e mirë është ajo metodë që është aq e thjeshtë sa të përdoret nga secili besimtar.
2. Plotësisht e mjaftueshme për të prodhuar një depërtim real në pasazh dhe që të çon drejt interpretimit të saktë. Është më e rëndësishme që të studiohet një pasazh i shkrimit, se sa të shikohen vargjet individuale jashtë kontestit të tyre. Një rrezik shumë i madh i një studimi të shkurtër është mos shikimi i pasazhit në detaje për ta kuptuar atë me saktësi. Kjo shpesh na shpie drejt interpretimeve dhe aplikimeve të varfra. Është shumë e lehtë që njerëzit të shohin në një pasazh atë që duan të shohin, dhe jo atë që Fjala me të vërtetë thotë. Një metodë e mirë është parashtrimi i pyetjeve të duhura për të hapur kuptimin e pasazhit.
3. E zbatueshme. Qëllimi i kohës sonë me Fjalën e Perëndisë është që të kuptojmë çfarë Bibla thotë dhe t'i bindemi asaj. Kjo është ajo që e bënë Biblën të gjallë për ne dhe për ata që u shërbejmë. Ne nuk mund të jemi që të gjithë shkollar të Biblës, mirëpo ne të gjithë mund ta studiojmë Biblën aq sa të mund ta aplikojmë në jetët tona. Zoti është shumë më i kënaqur me një person të thjeshtë që kupton ndoshta shumë pak, por që e aplikon atë që kupton, se sa që është me shkollarët e sofistikuar që e njohin Biblën tërësisht, mirëpo që e praktikojnë atë shumë pak.
4. Merr pak kohë. Një metodë e mirë e studimit të Biblës duhet të jetë aq e shkurtër sa të mund ta përdorim atë çdo herë. Njerëzit në përgjithësi nuk do ta përdornin një metodë të studimit ditor që do të kërkonte më shumë se njëzet apo tridhjetë minuta. Shumica e njerëzve janë të zënë dhe kanë vështirësi që të gjejnë kohë të gjerë të studimit personal.
5. E transmetueshme. Ne duhet të jemi në gjendje që t'ua mësojmë këtë metodë të tjerëve. Një ndër mënyrat më praktike që mund t'u ndihmojmë njerëzve që të rriten, është t'u tregojmë atyre se si të studiojnë Biblën për veten e tyre. Metoda

më e mirë për qëllimet e mësimimit është ajo që e njohim dhe që e kemi përdorur vetë, ajo që mund ta rekomandojmë nga përvoja personale. Një metodë e mirë duhet të jetë në gjendje t'u kalohet të tjerëve në atë mënyrë që të tjerët të jenë në gjendje ta përdorin lehtë dhe pa ndihmën tonë.



Mendo për mënyrën se si ti e lexon Fjalën e Perëndisë tani?

1. Çfarë bënë?
2. Si janë këto pesë kritere pjesë e studimit tënd të Biblës?
3. Çfarë ndryshme duhesh të bësh në lidhje me mënyrën se si e studion Fjalë e Perëndisë?

Udhëzues për studimin tënd ditor. Disa udhëzues mund të të ndihmojnë që t'ia fillosh. Një vend i mirë për t'ia filluar është Dhiata e Re, ndoshta njëri nga Ungjijtë. Zgjedh një libër për të studiuar dhe fillo të lexosh një pjesë apo një kapitull. Shumë përkthime e kanë ndarë librin në paragrafë apo pjesë. Lexo një pasazh deri sa ta kuptosh se ka ndërruar tema dhe se një temë e re ka filluar.

Teksa reflekton mbi pasazhin, parashtroja vetes këto pyetje:

- Cila është tema kryesore e këtij pasazhi? A është tema besimi, lutja apo falja? (Shiko kush është përfshirë, çfarë po ndodh, kur dhe ku janë duke ndodhur ngjarjet.)
- Cila është ideja qendrore apo pika kryesore që komunikohet nëpërmjet pasazhit?
- Çfarë po mësoj për Perëndinë nga ky pasazh? Çfarë mësoj për karakterin e Tij, premtimet e Tij, planet e Tij për mua?
- Çfarë mendoj se Perëndia dëshiron që unë të bëjë si rezultat i leximit të këtij pasazhi?
- Çfarë veprimi specifik mund të ndërmarr për të aplikuar këtë pasazh në jetën time sot?



Praktiko duke lexuar Marku 6:30-44 dhe përgjigju drejtimeve dhe pyetjeve si më poshtë.

1. Shkruaj në një fjali të thjeshtë temën kryesore të pasazhit dhe të vërtetën kryesore që Perëndia dëshiron të komunikojë?
2. Çfarë mendo se po të mëson Perëndia për veten e Tij me anë të këtij pasazhi?

3. Çfarë mendon se Perëndia dëshiron që ti të bësh si rezultat i leximit të këtij pasazhi?
4. Çfarë hapa mund të ndërmarrësh për të aplikuar këtë pasazh në jetën tënde sot?
5. Sa kohë të është dashur për ta lexuar këtë pasazh dhe për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve?

Pyetje të tjera që mund të jenë të dobishme gjatë studimit të një pasazhi janë:

- A ekziston një premtim ku mund të mbështetem?
- A ka ndonjë shembull që mund ta ndjek?
- A ka ndonjë paralajmërim që duhet të kem parasysh? ⁶
- A ekziston ndonjë urdhër që duhet t'i bindem?
- A kam ndonjë mëkat të cilin duhet ta rrëfej apo ta heq?
- A ka ndonjë inkurajim të cilin mund ta pranoj?
- A ka fjalë lavdërimi të cilat mund t'i ngre lart?
- A ka ndonjë mësim të ri rreth Perëndisë për të cilin mund ta falënderoj? ⁷

Teksa vazhdon studimin me këtë kurs, përdore këtë metodë ditore apo ndonjë metodë tjetër të ngjashme të studimit të Biblës. Teksa fiton përvojë me këtë metodë të thjeshtë dhe sheh rezultatet e saj në jetën tënde, mendo se si ta ndash këtë metodë me një besimtar tjetër.



Si po ndikon (apo si ka ndikuar) studimi i Fjalës së Perëndisë në marrëdhënien tënde me njerëzit që ke përreth vetes? Si lidhet Fjala e Perëndisë me veprimet dhe qëndrimet e tua në raste specifike apo çfarëdo situatë tjetër?

Mendime përmbyllëse

Ne kemi parë burimet e mrekullueshme që Perëndia na ka dhënë neve në Fjalën e Tij. Nëpërmjet faqeve të saj, neve na jepet mundësia që të krijojmë një marrëdhënie me Të nëpërmjet Jezus Krishtit, të njohim Krishtin në mënyrë më të afërt, të rritemi në jetën tonë shpirtërore, dhe t'i ngjasojmë Krishtit më shumë, të korrim përfitime të panumërta si urtësinë, paqen dhe forcën, dhe të themelohemi fuqishëm në shkëmbin e fortë të Krishtit dhe të Fjalës së Tij. Në Fjalën e Perëndisë, shumë të krishterë ndër shekuj kanë gjetur forcë, paqe dhe urtësi nga Perëndia që u ka dhënë atyre shpresë dhe i ka mbajtur edhe në mesin e stuhive më të fuqishme të jetës. Çfarë privilegji që kemi për të poseduar Fjalën e Perëndisë dhe të ushqejmë veten me të vërtetat e saj për çdo ditë!

FUSNOTAT

¹ Robert Mulholland, *Shaped by the Word: The Power of Scripture in Spiritual Formation* (Nashville, TN: Upper Room, 1986), 58, e cituar te Mel Lawrenz, *Dynamics of Spiritual Formation* (Grand Rapids, MI: Baker, 2000), 63

² Lawrenz, 63

³ Ibid., 63=64.

⁴ John Wesley, *Explanatory Notes upon the Old Testament* (n.p.: [1765]) e cituar tek Lawrenz, 65

⁵ Ibid.

⁶ Shiko John White, *The Fight: A Practical Handbook for Christian Living* (Downers Grove, IL: Inter Varsity, 1976), 48

⁷ Ibid.

Të komunikosh me Perëndinë me anë të lutjes

Toma shërben në kishën e tij dhe ai e ka zhvilluar zakonet e të luturit dhe leximit të Biblës çdo ditë. Por, nëse është i sinqertë, shpesh jeta e tij e lutjes bëhet e thatë. Ai mban një listë me kërkesa të lutjes dhe lutet për to rregullisht. Ai ka parë disa përgjigje lutjesh, mirëpo shpesh herë duket sikur Perëndia nuk përgjigjet. Si rezultat i lutjeve të tij, njerëzit në jetën e tij duket sikur nuk do të ndryshojnë. Ai e di se duhet të lutet edhe më shumë, mirëpo shpesh dëshira e tij për t'u lutur mungon.

Cilat janë ato pengesa që Toma ballafaqon? Çfarë do ta forconte jetën e tij të lutjes dhe çfarë do ta inkurajonte atë për një përkushtim më të thellë ndaj lutjes?



Në mësimin e fundit ne mësuam në lidhje me rëndësinë e Fjalës së Perëndisë në jetën e besimtarit dhe në lidhje me ndërtimin e jetëve tona mbi të vërtetat e Biblës. Si shtesë ndaj Fjalës së Perëndisë, Perëndia na ka dhënë edhe një burim tjetër të madh për të zhvilluar marrëdhënien tonë me Të: burimin e lutjes.

Përmbledhje e mëimit

Lutja është lidhja jonë personale me Perëndinë
Lutja është privilegji ynë i madh për të hyrë tek Perëndia
Hyrja te Perëndia nëpërmjet Krishtit
Ftesa për t'u afruar më pranë Perëndisë
Si duhet të lutemi?
Le t'ia ofrojmë Perëndisë lavdërimin tonë
Falëndero Perëndinë për bekimet e Tij
Le t'ia rrëfejmë mëkatet tona Perëndisë
Le t'i sjellim kërkesat tona para Perëndisë
Pengesat në lutje
Arsyet përse nuk lutemi
Arsyet përse Perëndia nuk i përgjigjet lutjeve tona
Kur Perëndia thotë 'jo'

Kur nuk mund të lutemi
 Të besosh në kohë të errësirës
 Fryma ndërhyr për ne
 Qëndrimet që Perëndisë i pëlqejnë kur ne lutemi
 Një zemër e përulur dhe e nënshtruar
 Një dëshirë për t'u bindur
 Besim fëmijëror
 Një përkushtim për t'u lutur
 Mendime përmbyllëse

Qëllimet e mësimit

Kur ta keni përfunduar këtë mësime, ju do të jeni në gjendje që:

1. Të shpjegosh rëndësinë e lutjes si një shprehje e marrëdhënies sonë me Perëndinë dhe se si është mundësuar hyrja tek Perëndia nëpërmjet Krishtit.
2. Të përshkruash katër elementet e lutjes të prezantuara në këtë mësime.
3. Të vlerësosh jetën tënde të lutjes për bilanc të elementeve të ndryshme të lutjes dhe për qëndrimet që përcjellin lutjet e juaja.
4. Të shpjegosh çfarë mund të bësh nëse Perëndia duket larg ose nëse ndihesh i paaftë për t'u lutur
5. Të planifikosh dhe zbatosh një kohë të qëndrueshme të lutjes dhe të fillosh një shtegtim të lutjes

Lutja është lidhja jonë personale me Perëndinë

Fillimisht lutja është shprehje e marrëdhënies sonë me Perëndinë. Është lutja ajo që na lidh me Atin për çdo ditë. Një marrëdhënie nis dhe ushqehet me fillimin e një bisede. Kur dy njerëz takohen, ata fillojnë të flasin, në fillim zakonisht në një nivel shumë sipërfaqësor, por gradualisht një marrëdhënie thellohet teksa të dy individët hapen dhe ndajnë çdo herë e më shumë mendimet dhe ndjenjat e tyre. Perëndia ka ofruar një mënyrë për ne për t'u lidhur me Të në një marrëdhënie aq të thellë si kurrë ndonjë herë më parë. Në thelb lutja është bisedë me Perëndinë, duke i treguar Atij çfarë është në zemrën tonë, duke e ftuar Atë që të bëhet një pjesë e rëndësishme e jetëve tona.

Fillimisht lutja është
 shprehje e
 marrëdhënies sonë me
 Perëndinë. Është
 lutja ajo që na lidh me
 Atin për çdo ditë.

Pasi që lutja është shprehje e marrëdhënies sonë me Perëndinë, lutja asnjëherë nuk mund të jetë anësore në jetën e krishterë. Në jetën tonë shpirtërore është thelbësore që

të lutemi. Teksa shikojmë jetën e Krishtit në Ungjijtë, ne vërejmë se lutja ishte një prioritet për Jezusin.



Lexo Marku 1:29-38. Përshkruaj këtë ditë të zënë në jetën e Jezusit dhe vë re se pavarësisht këtij fakti çfarë zgjedhje ndërmori Ai (v.35).

Jeta e Jezusit ishte e fokusuar në shërbesë dhe shërbim ndaj të tjerëve por për kundër kësaj ajo ishte e balancuar me kohë të lutjeve intensive. Ai shpesh tërhiqej në vende të vetmuara për t'u lutur. Nëse Jezusi kishte nevojë të kalonte kohë vetëm me Atin, atëherë sa më shumë do të na duhej ne një kohë e tillë. **Asgjë tjetër nuk mund ta zëvendësojë kohën personale me Perëndinë.** Perëndia na ka krijuar me një mall të thellë për Të. Ne jemi krijuar që të kemi bashkësi me Krijuesin tonë, dhe pa atë bashkësi ne përjetojmë një zbrazëti të thellë. Augustini, një ndër etërit e kishës së hershme, shkroi në *Rrëfimin* e tij "Ti na ke krijuar për veten tënde, dhe zemrat tona nuk gjejnë paqe përderisa nuk pushojnë në ty."¹

Që nga krijimi Perëndia gjithmonë ka pasur një dëshirë që të ketë një bashkësi me fëmijët e Tij. Pamja ideale e kopshtit të Edenit pa dyshim që përfshinë një bashkësi të ëmbël dhe të papenguar në mes të Adamit, Evës dhe Zotit. Ishte kënaqësi për Zotin që të kalonte kohë me së bashku me ta, mbase duke folur për ndodhitë e ditës, ashtu si bënë një baba me fëmijët e tij.

Më vonë, pas rënies së njeriut, Perëndia e demonstroi dëshirën e Tij të vazhdueshme që të banoj me krijesën e Tij. Ai foli me individë si Abrahami, Jakobi, Noeu, dhe Mojsiu. Ai e zbuloi veten e Tij gjithnjë e më shumë para popullit të Izraelit në mënyrë që ata ta njihnin Atë. Në Sinai Ai i rekomandoi popullit të Izraelit që të ndërtojnë një tabernakull në mënyrë që Ai të mund të banonte me ta. Prania e Tij u bë e ditur me anë të një shtylle të zjarrtë dhe resë, që tregonin lavdinë dhe shenjtërinë e Tij. Ky tabernakull ishte vendosur në mes kampit të izraelitëve si një kujtim i dukshëm i pranisë së Perëndisë në mesin e popullit (Eksodi 30:36-38).

Dëshira e Perëndisë për të na restauruar në një bashkësi më intime me Të ishte ajo që e tërhoqi Atë për të dërguar Birin e Tij të Vetëm për të qenë me ne, që të identifikohet me ne në racën njerëzore. Vetë Krishti u quajt Emanuel ("Perëndia me ne"), dhe Ai u dërgua që të na pajtojë me Perëndinë (2 Kor 5:18-19; Rom 5:10).

Kur një person pajtohet me dikë, linjat e komunikimit rihapen. Ç'gjë e bukur është kur njerëzit pajtohen dhe muret e ndarjes në mes të njerëzve rrëzohen. Vetë Perëndia mori iniciativën për të na pajtuar me Vetën e Tij nëpërmjet sakrificës së Birit të Tij.

Kështu, ne kuptojmë se Perëndia na ka bërë me një nevojë të brendshme për Të, që Ai dëshiron të ketë bashkësi me ne dhe se Ai e ka bërë të mundur këtë gjë. Lutja është rruga të cilën Perëndia na ka dhënë që të lidhemi me Të në një mënyrë personale, një

mënyrë e cila do të plotësojë mallin e shpirtit për të pasur një bashkësi me Krijuesin tonë.

Si në Dhiatën e Vjetër ashtu edhe në atë të Renë ne jemi të urdhëruar që të lutemi. Shumë vargje na këshillojnë që të lutemi (Ef. 6:18). Në fakt ne na kujtohet që të lutemi pa pushim (1 Thes 5:17). **Vetëm detyrimi nuk është ndonjë motivim i fuqishëm për ne që të zhvillojmë një jetë të lutjes.**



Lexo Psalmin 27:4-8.

1. Për çfarë kishte mall Davidi?
2. Çfarë mendoni se e shtyu Davidin drejt fokusit të tij të vetëm për të qenë në praninë e Perëndisë?

Kjo ishte ajo që Davidi përjetoj kur ai qe në praninë e Perëndisë: bukuria e Zotit, ndjenja e sigurisë dhe strehimit, dhe ripërtëritja e fuqisë. Davidi përjetoj bashkësi me një persona real, bashkësi e cila e forcoi dhe e inkurajoi shpirtin e tij. Ai zbuloi një burim që vazhdimisht e rifreskoi shpirtin e tij dhe që e bëri të kthehej çdo herë për të pirë aty. Kjo është jeta e lutjes.



Çfarë të motivon ty që të lutesh? A është lutja kryesisht një detyrë për ty? Apo tërhiqesh për të ardhur në prani me Perëndinë? A pret me mall për të kaluar kohë në praninë e Tij? A ke atë lloj marrëdhënie me Perëndinë, ku ti mund t'i tregosh Atij çdo gjë që ke në zemrën tënde? Nëse jo, si mund të fillosh ta kultivosh këtë lloj marrëdhënieje?



Falënderoj Perëndinë për mënyrat e shumta se si e ka shprehur Ai dëshirën e Tij për të qenë me popullin e Tij dhe me ty. Teksa studion këtë mësim mbi lutjen, kërko nga Ai që të të mësoj më shumë rreth Vetes së Tij

Lutja është rruga të cilën Perëndia na ka dhënë që të lidhemi me Të në një mënyrë personale, një mënyrë e cila do të plotësojë mallin e shpirtit për të pasur një bashkësi me Krijuesin tonë.

Lutja është privilegji ynë i madh për të hyrë tek Perëndia

Në periudhën e Dhiatës së Vjetër, njerëzit kishin shumë frikë të hynin në praninë e Perëndisë. Kur Moisiu u thirr që të takonte Perëndinë në Malin Sinai, njerëzit u paralajmëruan që të mos vinin afër malit dhe që të mos e preknin atë, përndryshe dënimi ishte vdekja. Në këtë skenë, dhe shumë të tjera, ne shohim se **hyrja në praninë e**

Perëndisë, i cili është absolutisht i shenjtë, është një përvojë e mahnitshme. Të bësh një gjë të tillë pa leje adekuate nënkuptonte vdekje të posaçme.

Kur njerëzit e Izraelit erdhën nga Egjipti, Perëndia i dha Mojsiut udhëzime të detajuara për ndërtimin e tabernakullit, një tendë e lëvizshme për adhurim, së bashku me të gjitha pjesët dhe orenditë e tij. Ky tabernakull ishte një figurë tokësore e një realiteti qiellor. Të gjitha praktikatat e adhurimit të Izraelit në Dhiatën e Vjetër të çonin drejt diçkaje më të mirë që do të vinte, diçka që do të ishte më reale. Nën ligjin e Mojsiut vetëm priftërinjtë hebre mund të hynin në këtë tabernakull, dhe vetëm kryepriifti mund të hynte në vendin më të shenjtë të tabernakullit, aty ku lavdia e Perëndisë shfaqej. Aty ishte një perde shumë e trashë që e mbronte këtë zonë, që quhej “vendi shumë i shenjtë.”

Hyrja te Perëndia nëpërmjet Krishtit

Përderisa në periudhën e Dhiatës së Vjetër, hyrja në praninë e Perëndisë ishte e ndaluar, për ne si besimtarë hyrja tek Perëndia është siguruar përjetësisht nëpërmjet sakrificës së Krishtit. Si Bir i Perëndisë, Krishti ishte i pamëkatë, dhe kështu ishte i vetmi që mund të jepte jetën e Tij për të paguar për mëkatet tona. Ai është quajtur Qengji i Perëndisë, sakrifica e vetme e përkryer, që do të mund të hiqte mëkatin dhe të blinte shpëtimin tonë të përjetshëm (Gjoni 1:29). Hebrenjve 9:12 na tregon: “Ai hyri një herë e përgjithmonë në shenjtërore... me gjakun e vet, dhe fitoi një shpëtim të amshuar.”

Jo vetëm që Jezus Krishti është sakrifica e përkryer, mirëpo Ai është gjithashtu edhe kryepriifti ynë i përkryer. Hebrenjve 9:6-7 i përshkruan detyrat e priftërinjve të Dhiatës së Vjetër, të cilët hynin në tabernakull një herë në vit për të spërkatur gjakun e një kafshe për të bërë shlyerjen e mëkateve të popullit. Pasi që kryepriifti ishte një mëkatar dhe vetë sakrifica nuk ishte e përsosur, atëherë ai duhej ta përsëriste sakrificën çdo vit (Heb. 9:25; 10:3-4).

Në anën tjetër, siç tregon autori i Hebrenjve, Krishti është priifti i përkryer. Përderisa priftërinjtë tokësor duhet të shërbejnë çdo ditë duke blatur shpesh herë të njëjtat flijime, që nuk mund të heqin kurrë mëkatet, ai Krishti, përkundrazi, pasi dha për gjithnjë një flijim të vetëm për mëkatet, u vu të rrijë në të djathtën e Perëndisë, (Heb 10:12). Për këtë arsye, “Ai mund të shpëtojë plotësisht ata që me anë të tij i afrohen Perëndisë, sepse gjithmonë rron që të ndërmjetësojë për ta.” (Heb 7:24-25). Ndërmjetësimi i Tij për ne ndodh njëzetekatër orë në ditë, shtatë ditë në javë, teksa Ai qëndron si ndërmjetësuesi ynë në mes nesh dhe Perëndisë që ne të kemi hyrje të vazhdueshme tek Ati. Ç’vërtetë e mahnitshme!



Lexoni Hebrenjve 10:10-14 dhe 10:19-22.

1. Çfarë përmbushi sakrifica e Krishtit për besimtarët?
2. Bazuar në sakrificën e Krishtit, çfarë na inkurajon vargu 22 që të bëjmë?

Ftesa për t'u afruar më pranë Perëndisë

Veprimet që kërkohen nga ana jonë janë të thjeshta: **Ai na fton që t'i afrohem** me një zemër të sinqertë, me besim, me një siguri të plotë që ne do të pranojmë bazuar në sakrificën e Birit të Tij. Nënkuptimet e këtyre pasazheve janë të mahnitshme. Si besimtarë ne kemi një privilegj të jashtëzakonshëm për të hyrë në vendin më të shenjtë, mu në praninë e Perëndisë. Ne ftohemi që të hyjmë aty, duke ditur që zemrat tona janë pastruar nga një ndërgjegje e ligë dhe trupat tanë janë larë me ujë të pastër.

Kjo leje për të hyrë te Perëndia është shpallur në mënyrë dramatike dhe simbolike me vdekjen e Krishtit kur u shqye perdja e trashë e tempullit që mbështillte vendin më të shenjtë. Asnjë dorë njerëzore nuk e kishte guxuar ta prekte atë; ajo u shqye nga lart poshtë nga Ati përderisa Ai hapi rrugën për të hyrë në fronin e Tij nëpërmjet vdekjes dhe ringjalljes së Birit të Tij të vetëm, sakrifica e përkryer për mëkatin (Mat 27:51).



Lexo Psalmin 5:1-2 dhe Efesianëve 2:11-18. Si ka ndikuar sakrifica e Krishtit tek një besimtar? (Fjala “që të dy” tek Efesianëve i referohet Hebrenjve dhe Paganëve.)

Përse duhet të fokusohemi kaq shumë në këto të vërteta kur tema jonë është lutja? Ne duhet ta kuptojmë që privilegji ynë për të hyrë tek Perëndia ka ardhur me anë të sakrificës më të madhe që ndonjëherë mund të imagjinohej. Sa e rëndësishme është që ta pranojmë dhuratën e pamasë që na është dhënë dhe t'i përgjigjemi asaj ashtu siç Perëndi dëshiron – “duke iu afruar Atij sa më pranë.”

Ne duhet ta kuptojmë që
privilegji ynë për të hyrë tek
Perëndia ka ardhur me anë të
sakrificës më të madhe që
ndonjëherë mund të
imagjinohej.

Pali shkruan në letrën e Efesianëve 3:12 që ne kemi “lirinë dhe hyrjen te Perëndia në mirëbesimin” nëpërmjet besimit tonë Jezus Krishtin. Të hysh i lirë nuk nënkupton të hysh në mënyrë arrogante (sepse është Krishti Ai që e ka bërë të mundur hyrjen tonë) por ashtu siç hyn një fëmijë në praninë e babait të tij, duke qenë i sigurt në dashurinë dhe pranimin e babait të tij. Nëse e kemi pranuar Birin e Tij si sakrificën tonë, ne i takojmë familjes së Perëndisë.

Rrëfëhet një tregim në lidhje me presidentin amerikan Abraham Linkoln, i cili ishte në një takim të rëndësishëm me këshilltarët e tij. Ai me sa duket kishte paralajmëruar se nuk do të dëshironte që të pengohej, mirëpo në mes të takimit hapet dera, dhe djali i vogël i presidentit hyn në dhomë me vrap. Kur djali vrapoi drejt babait të tij, disa të pranishëm në dhomë, pa dyshim se u mërzitën nga një pengesë e tillë. Anëtarët e

kabinetit, me siguri që u mahnitën kur presidenti e ndërpreu atë që po bënte dhe me durim mori kohë për ta dëgjuar djalën e tij, teksa ata pritën.²

Ky tregim ilustron hyrjen e lehtë që kemi tek Ati si fëmijët e Tij. Ai asnjëherë nuk është shumë i zënë; ne gjithmonë jemi të mirëseardhur. Ne thjeshtë jemi të ftuar që të vijmë në praninë e Tij. Motivimi ynë për t'u lutur bazohet në dashurinë tonë për Atin, në ndjeshmërinë tonë të privilegjit tonë si fëmijët e Tij, dhe në dëshirën tonë për një bashkësi më të ngushtë me Të.



Merr ca minuta për të reflektuar mbi të vërtetat që e prezantuan në këtë pjesë: sakrificën e madhe që u bë për ne e që na mundëson të hyjmë të ke Perëndia, ftesën për t'u afruar më pranë Tij, dhe ndërhyrjen e përditshme të Krishtit për ty. Falëndero Perëndinë për dhuratën e shpëtimit dhe afrohu më shumë pranë Atit tënd të dashur Qiellor.



Shpjego shkurtimisht rëndësinë e lutjes si një shprehje e marrëdhënies tonë me Perëndinë dhe si është mundësuar hyrja tek Perëndia nëpërmjet Krishtit?

Si duhet të lutemi?

Shume shpesh ne i qasemi lutjes me një listë kërkesash të cilat dëshirojmë t'ia parashtrojmë Perëndisë. Sigurisht që lutja përfshinë më shumë gjëra se sa një qasje e tillë e tillë e kufizuar dhe e përqendruar tek vetvetja. Çfarë na mëson Bibla se si duhet të lutemi?

Le t'ia ofrojmë Perëndisë lavdërimin tonë

Kur ne jemi me të vërtetë të vetëdijshëm për privilegjin tonë të madh që si besimtar të vijmë në lutje para Perëndisë, ne nuk mund të bëjmë gjë tjetër pos që të adhurojmë dhe admirojmë Atë që na ka bërë të mundur shpëtimin tonë të madh. **Në të vërtetë, kur sjellim ndër mend të folurit me të Shenjtin, krijuesin e qiellit dhe tokës, mendimet tona të para gjithmonë duhet të jenë për ta lavdëruar dhe admiruar Atë.** Kur Jezusi i mësoi dishepujt e Tij që të luteshin, Ai filloi me fjalët, “Ati ynë që je në qiell, u shenjtëroftë emri Yt.” Mendimi i parë i Jezusit në lutje ishte t'i drejtohej Atit të Tij të dashur dhe të lavdëronte madhësitinë dhe lavdinë e Perëndisë, duke e lartësuar emrin e Perëndisë si të denjë. “U shenjtëroftë Emri Yt” do të thotë që Perëndia duhet të njihet si i shenjtë, dhe Ai duhet të pranojë gjithë nderin dhe lavdinë që i takon Atij.

Ne jemi krijuar për t'u ngazëllyer në veprat e Perëndisë dhe në personin e Perëndisë. E tërë Bibla është e zbukuruar me shpërthime lavdërimi për Perëndinë. Shumica e psalmeve janë himne lavdërimi për Perëndinë, duke u fokusuar në karakterin dhe

veprën e Tij. Në Dhiatën e Re ne shohim si shumica e atyre që përjetojnë prekjen shëruese dhe pastruese të Jezusit, në mënyrë spontane shpërthejnë në lavdërim (Mk. 2:12; Lk. 18:43; Veprat 2:46; 3:8; 11:18).

Katekizmi i Shkurtër i Westminster thotë se “fundi kryesor i njeriut” është “ta lavdërosh Perëndinë dhe të gëzohesh në Të përjetësisht.” Ne mund të mendojmë se lavdërimi është shprehja e gëzimit tonë në Zotin. Ne nuk mund ta lavdërojmë Perëndinë nëse nuk e dorëzojmë veten tonë.



Lexo Psalmet e lavdërimit në vijim: Psalmi 8, 33, 77, apo 115 (psalme tjera të lavdërimit janë 29, 48, 67, 68, 71, 95-100, 103, 104, 107, 111-113, 116, 136, 146-150).

1. Vini re se për çfarë po e lavdëron psalmisti Perëndinë.
2. Çfarë attribute keni gjetur për Perëndinë për çka ju mund ta lavdëroni Atë sot?
3. Pse është ky atribut i rëndësishëm për ju?



Merr kohë për t’u lutur, duke u koncentruar në atë se kush është Perëndia deh çfarë ai ka bërë në të kaluarën. Lavdëroje Atë aspekte specifike të karakterit të Tij, si për besnikërinë, mirësinë, natyrën e Tij të pandryshueshme, dhe për të gjitha veprat e mëdha që ke përjetuar.

Falënderojë Perëndinë për bekimet e Tij

Një element tjetër i rëndësishëm i lutjes është ta falënderosh Atë për bekimet e Tij. Falënderimi duhet të jetë një reagim i natyrshëm për atë që Perëndia ka bërë për ne. Teksa lavdërimi dhe admirimi janë të lidhura ngushtë me falënderimin, megjithatë ekziston një dallim. Falënderimi është një përgjigje ndaj Perëndisë për bekimet e pranuara, ndërkaq lavdërimi dhe admirimi i drejtohen personit të Perëndisë dhe veprës së Tij.

Dikush e ka thënë shumë mirë, “Falënderimi e fut Perëndinë në mendimet tona.”³ Sa e lehtë është që të harrojmë ta falënderojmë Perëndinë. Shpesh shohim përgjigje specifike të lutjeve, mirëpo nuk arrijmë që të falënderojmë Perëndinë për mënyrën se si ka punuar për ne. Kur Jezusi shëroi të dhjetë leprosët, vetëm një u kthye për ta falënderuar Atë për atë shërim të mahnitshëm!

Ne mund të jemi kritikues ndaj nëntë të tjerëve, por sa shpesh jemi mu si ata? Ne duhet të zhvillojmë një frymë të falënderimit, duke shikuar të gjitha bekimet që

Perëndia na jep çdo ditë dhe duke e falënderuar Atë për këto bekime dhe për përgjigjet e lutjeve. Jezusi e përdori falënderimin në lutje (Lk 10:21; Gjn 6:11; 11:41; Mat 26:27).

Falënderimi është gjithashtu i lidhur ngushtë me përlësinë. Ata që janë krenar, e kanë të vështirë të pranojnë mirësinë e Perëndisë. Kur gjërat janë duke ecur mirë, ne mund ta kemi më të lehtë ta falënderojmë Perëndinë për bekimet e Tij të shumta. Por, ne mund ta falënderojmë Perëndinë si në kohë të mira ashtu edhe në mesin e kohëve më të vështira, duke e ditur se Ai ka lejuar që të na prekin ato ngjarje.

Mateu, një besimtar, i cili vuante nga një kancer i skajshëm, çdo ditë kishte shprehur ta falënderonte Perëndinë për bekimet që kishte përjetuar, edhe pse në anën tjetër po kalonte vuajtje shumë të mëdha dhe ishte për muaj të tërë në trajtim të zgjeruar. Në disa ditë ai ishte falënderues që infermierja ishte në gjendje ta kalonte gjilpërën në krahun e tij pa ndonjë dhimbje të panevojshme apo për ndonjë procedurë që kishte shkuar mirë.

Shumë sosh në rrethana të njëjta do të shihnin vetëm anën negative; Mateu zgjodhi që të shihte dorën e Perëndisë në bekimet edhe më të vogla. Ai ndriçoi jetët e shumë infermiereve dhe doktorëve me anë të frymës së tij të gëzuar. Për shkak të frymës së tij falënderuese, shumë njerëz iu afruan dhe filluan ta pyesnin për besimin e tij në Perëndinë. Ai pati rastin ta shihte shokun e dhomës, me diagnozë të njëjtë të kancerit, të vijë tek Zoti para se të vdiste.



Lexoni këto psalme të falënderimit: Psalmi 34, 116, apo 136 (psalme të tjera të falënderimit janë 9, 118, 126, 138). Çfarë e shtyu psalmistin që të shprehte falënderimet e tij për Perëndinë?



Çfarë të ndalon që të kesh një frymë falënderuese? Cilat janë disa mënyra me anë të së cilave ti mund ta zhvillosh një frymë falënderimi? Cilat janë atë bekime të fundit për të cilat mund ta falënderosh Perëndinë?



Ndalu për një moment dhe falënderoj Perëndinë për këto bekime dhe kërko nga Ai që të të jap një zemër falënderuese për të pranuar bekimet e Tij në çdo situatë.

Le t'ia rrëfejmë mëkatet tona Perëndisë

Jezusi gjithashtu i mësoi dishepujt të kërkonin falje nga Ati: “Na i fale fajet tona, ashtu siç ne i falim fajtorët tonë” (Mat. 6:12). Rrëfimi i mëkateve tona është një ndër aspektet kyçe të lutjes dhe të cilin jemi shumë të prirur që ta anashkalojmë.

Nuk mund të ketë jetë efektive të lutjes nëse e keqja ruhet në zemrën e një besimtari (Ps. 66:18). Për këtë arsye, rrëfimi është shumë i rëndësishëm në lutjet tona. **Nëse mëkati i bënë lutjet tona joefektive, atëherë rrëfimi është zgjidhja e problemit.**



Lexo Psalmin 32:1-5 dhe Psalmin 51:1-10.

1. Sipas këtyre psalmeve, çfarë kishte përjetuar Davidi gjatë kësaj kohe të mëkatimit me paramendim?
2. Në jetën tuaj të krishterë, a ke përjetuar ndonjëherë po të njëjtën gjë? Përshkruaje.
3. Si të ndihmojnë këto vargje që ta kuptosh rrëfimin?
4. Si mund t'i aplikosh këto të vërteta kur të kesh mëkatuar?

Tek 1Gjoni 1:9 ne kemi premtimin e mrekullueshëm që Perëndia Po t'i rrëfejme mëkatet tona, ai Perëndia do të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi. Kur ne rrëfemi, ne njohim dhe pranojmë mëkatin tonë para Perëndisë, duke kërkuar nga Ai që të na fal. Rrëfimi është një aspekt i vazhdueshëm i jetës së krishterë.

Kur ne rrëfemi, ne njohim dhe pranojmë mëkatin tonë para Perëndisë, duke kërkuar nga Ai që të na fal.

Kur vijmë para Perëndisë për të rrëfyer mëkatet tona, ne përjetojmë një pastrim që restauron bashkësinë me Perëndinë e cila ka qenë e thyer nga mëkati. Ne nuk kemi nevojë që të shpëtohem nga fillimi sa herë që të mëkatojmë; rrëfimi restauron marrëdhënien e duhur me Atin dhe gëzimin e shpëtimit tonë. Ashtu si një fëmijë i cili nuk është i bindur, vazhdon ende të jetë pjesë e familjes, po ashtu edhe ne vazhdojmë t'i takojmë Perëndisë edhe kur mëkatojmë.

Rrëfimi ka të bëjë me marrjen e faljes atërore të Perëndisë dhe me restaurimin dhe mirëmbajtjen e gëzimit të shpëtimit tonë dhe jo me statusin tonë të përvetshëm para Perëndisë. Ne duhet të rrëfemi menjëherë ashtu sikur pastrohemi menjëherë pasi që jemi përlyer pas punëve në kopsht apo pas një dite të zënë me plot punë. Rrëfimi na çliron ndërgjegjen tonë nga fajësia dhe pastron rrugën që Perëndia t'i përgjigjet lutjeve tona.

Përderisa thelbi i rrëfimit është të pranuarit e mëkatit tonë para Perëndisë, kjo nënkupton se ne do të ndiejmë keqardhje për shkak se kemi ofenduar Perëndinë dhe se ne do të bëjmë gjithçka që të mundemi për ta braktisur atë mëkat dhe për të mos e përsëritur më. Atëherë, ne duhet ta lëmë mëkatin anash, ashtu siç bënë edhe Perëndia. (Ps. 32:5; 103:12).

Përveç rrëfimit të mëkateve tona para Perëndisë, një besimtarë duhet t'i rregullojë gjërat edhe me personat e tjerë. Shpesh ne mund të kemi nevojë që të kërkojmë falje nga dikush apo edhe të falim dikë që na ka lënduar (Mat. 5:21-26). Tek Efesianëve 4:32 Pali na thërret që të jemi të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia na ka falur në Krishtin.



Cilat mëkate në jetën tënde mund të pengojnë efikasitetin e lutjeve tua? A je gati të vish përpara Perëndisë për të kërkuar falje dhe për ta braktisur atë mëkat të caktuar në jetën tënde?

A ke në mendje ndonjë njeri kundër të cilit ke mëkatuar apo kundër të cilit ke mbjell zemërim apo hidhërim? Shkruaj në fletoren tënde emrin apo inicialet e këtij personi dhe kërko nga Perëndia të të ndihmoj që t'i afroresh këtij personi për t'i kërkuar falje apo për t'u pajtuar.



Merr kohë për të rrëfyer mëkatet e tua. Pranoi para Perëndisë mëkatet për të cilat ti je në dijeni dhe kërko nga Fryma e Shenjtë për të zbuluar ndonjë mëkat në zemrën tënde për të cilin ti mbase nuk je në dijeni? Falënderoje Perëndinë për faljen e Tij.

Le t'i sjellim kërkesat tona para Perëndisë

Lutja, parashtrimi i kërkesave para Perëndisë, në thelb është një shprehje e varësisë në Perëndinë.

Kërkimi i gjërave specifike nga Perëndia është një pjesë e rëndësishme e lutjes. Ndonjëherë këto kërkesa janë personale, kur kërkojmë për nevoja personale specifike apo për ndihmë. Jezusi i mësoi dishepujt që të luten, “Bukën tonë të përditshme na e jep sot”(Mat. 6:11). Në raste të tjera kërkesat tona janë ndërhyrëse, kur kërkojmë për nevojat e të tjerëve.

Lutja, parashtrimi i kërkesave para Perëndisë, në thelb është një shprehje e varësisë në Perëndinë. Disa njerëz hezitojnë që të kërkojnë çdo gjë nga Perëndia, mirëpo Ai kënaqet kur ne i afrohem Atij me gjithçka që është në zemrën tonë, dhe kështu Ai reagon në përgjigje ndaj lutjeve të popullit të Tij. Me anë të lutjes ne marrim pjesë në Perëndinë, në një mënyrë që nuk e kuptojmë plotësisht, duke bërë që qëllimi i Tij hyjnor të përmbushet. Le t'i shikojmë disa udhëzime tjera në lidhje me parashtrimin e kërkesave para Perëndisë.

Perëndia dëshiron që ne të kërkojmë. Ne mund t'i sjellim të gjitha kërkesat tona përpara Perëndisë sepse Perëndia dëshiron që ne të kërkojmë dhe sepse Ai dëshiron që t'i përgjigjet kërkesave tona.



Lexoni Mateu 7:7-11; Gjoni 15:1-7; 16:22-27..

1. Çfarë mësoni për lutjen në këto pasazhe?
2. Përse ne nuk kërkojmë? Cilat janë disa nga arsyet që ne nuk i sjellim kërkesat tona para Perëndisë?

Jezusi i mësoi dishepujt e Tij që t'i sillnin kërkesat e tyre para Perëndisë: “Lypni dhe do t’ju jepet; kërkoni dhe do të gjeni; trokitni dhe do t’ju çelet.” (Mat 7:7). Si besimtarë ne mund të vijmë tek Perëndia me të gjitha kërkesat tona, të mëdha apo të vogla, që janë në pajtueshmëri me natyrën e Tij të zbuluar. Asgjë nuk është shumë e komplikuar apo e parëndësishme për t’u paraqitur para Tij. Ai kënaqet kur ne vijmë tek Ai. Ai është duke pritur që ne të kërkojmë.

Ndonjëherë ne vijmë tek Perëndia në lutje sikur ne duhet të insistojmë që Ai të na jep ndonjë gjë që në realitet nuk do të na jepte. Jezusi tha “Në qoftë se ju, që jeni të këqij, dini t’u jepni dhurata të mira bijve tuaj, aq më tepër Ati juaj, që është në qiej, do t’u japë gjëra të mira atyre që ia kërkojnë” (Mat 7:11) Ashtu siç një baba kënaqet kur fëmijët e tij vijnë tek ai me kërkesa, po ashtu edhe Perëndia kënaqet kur ne vijmë tek Ai. Kur ne i sjellim kërkesat tona tek Ai, ne shfaqim varësinë tonë tek Ai dhe pranimin tonë se Ai është vetë burimi i çdo gjëje të mirë.

Perëndia nuk ngurron t’i përgjigjet lutjeve tona. Pikëpamja që ne kemi për Perëndinë, në mënyrë të madhe e ndikon qëndrimin tonë kur vijmë tek Perëndia në lutje. A e shohim Atë vërtetë si Atin tonë të dashur, që pret të na marrë në krahët e Tij dhe t’i dëgjoj shqetësimet tona, apo e shohim si një at të largët, të ashpër apo të zemëruar, i cili ngurron të na jep çfarëdo që do të na mbushte me gëzim?



A ke hezituar të vish para Perëndisë me lutjet e tua? Nëse po, përse mendon se kjo është e vërtetë? Si mund të të ndihmojnë të vërtetat e shprehura më sipër që të tejkalosh ngurrimin tënd?

Kërko në besim. Lutja efektive bazohet në besim. Çfarë do të thotë të kërkosësh në besim? Besimi, ashtu siç e paraqet Bibla, nuk është thjeshtë besim i singertë në diçka. Nuk është një koncept abstrakt. Në Bibël besimi është i lidhur me një person – personin e vetë Perëndisë. Është besimi në Perëndinë, i shprehur me anë të dëshirës për t’ia besuar veten tonë Perëndisë pa asnjë rezervë.

Besimi, në thelb, lidhet me Perëndinë, duke besuar se Ai mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë (Ef 3:20) dhe se gjithçka që Ai bënë është e mirë. Të kërkosësh në besim nuk do të thotë që ne duhet të besojmë aq fuqishëm që Perëndia do të bëjë atë që ne kemi kërkuar, mirëpo kjo nënkupton që Perëndia është i mirë dhe se Ai do të bëjë atë që është më e mira për ne. Kur vijmë në lutje para Perëndisë, Ai dëshiron që ne të kemi besim në Të, dhe të besojmë që Ai është i mirë dhe se Ai do të bëjë atë që është më e mira për ne në atë situatë.

Shumë të krishterë hutohen, dhe shumë sosh edhe ikin nga Perëndia, kur Perëndia nuk i përgjigjet lutjeve në mënyrën se si ata dëshirojnë. Shpesh ne e keqkuptojmë besimin dhe e vështrojmë atë si rehati që e këmbejmë me përgjigjet e lutjeve. Ashtu si personazhi imagjinar “Ali Baba dhe Dyzet Hajdutët”, ne mund të besojmë që dera e

qiellit do të hapet me anë të një formule magjike që ne shqiptojmë. Megjithatë, qëllimi i lutjes nuk është që të bëhet vullneti ynë në qiell, por që vullneti i Perëndisë të bëhet në tokë.

Disa besimtarë e kanë idenë që ata duhet të kenë aq besim të madh në mënyrë që Perëndia t'i përgjigjet secilës kërkesë që ata mund të dëshirojnë. Nuk është në vullnetin e Perëndisë që Ai t'i përgjigjet secilës kërkesë që ne mund të dëshirojmë. Ashtu si një at tokësor, edhe Perëndia ndonjëherë përgjigjet me 'jo'. Në kohë të tjera, Ai kërkon nga ne që të presim edhe pak kohë, dhe Ai lejon që ne të zhvillojmë një durim, qëndrueshmëri dhe besim më të thellë në mirësinë dhe kohën e Tij.

Të kërkossh në besim nuk do të thotë që ne duhet të besojmë aq fuqishëm që Perëndia do të bëjë atë që ne kemi kërkuar, mirëpo kjo nënkupton që Perëndia është i mirë dhe se Ai do të bëjë atë që është më e mira për ne.

Kërko në emrin e Krishtit. Kur të lutemi, ne vijmë tek Perëndia nëpërmjet Krishtit. Përdorimi i emrit të Krishtit nuk është një formulë magjike dhe garanton përgjigjen e Perëndisë.



Lexo Mateu 7:21-23.

1. Çfarë tha Jezusi në lidhje me disa që profetizuan dhe bënë mrekulli “në emrin e Tij”?
2. Çfarë mund të nxirrni si përfundim?

Në realitet, këta njerëz e përdornin emrin e Jezusit, por nuk kishin një marrëdhënie me Jezusin. Thjeshtë ta mbulosh një veprim me emrin e Jezusit, nuk siguron që Ai është pjesë e tij.

Duke e përdorur emrin e Tij, ne i përkujtojmë vetes tonë “bazat e të drejtës [sonë] për të hyrë në praninë e Perëndisë”⁴ **Ne vijmë tek Perëndia At me lejen e hyrjes dhe me autoritetin që na janë lejuar me anë të veprës dhe autoritetit të Krishtit.**

Kërko me motivet e duhura. Shpesh besimtarët vijnë tek Perëndia sikur me një listë të gjërave për të blerë, duke kërkuar gjërat që ata dëshirojnë që Perëndia t'ua jep atyre. A është kjo mënyra se Perëndia dëshiron që ne t'i qasemi Atij? Lutja nuk është një pullë magjike që shtypim për ta detyruar Perëndinë që të bëjë diçka që ne duam. Kur ne lutemi, ne jemi duke kërkuar për një përgjigje nga një At i dashur dhe jemi duke besuar që Ai do të bëjë atë që është më e mira.

Jakobi shkruan “Ju kërkonit dhe nuk merrni, sepse kërkonit keqas që të shpenzoni për kënaqësitë tuaja” (Jak 4:3). Kur vijmë tek Perëndia në lutje, ne duhet të shqyrtojmë motivet tona të kërkesave. A kërkojë me të vërtetë atë që do të kënaqte Perëndinë në

këtë situatë? A janë motivet e mia të drejta? A janë dëshirat e mia të pastra, apo a janë ato parimisht vetjake, të përqendruara në kënaqësinë personale? Gjëja që kërkoj a është diçka që me të vërtetë kam nevojë, diçka që do ta nderonte Perëndinë?

Kërko në bazë të vullnetit të Perëndisë. Jezusi i mësoi dishepujt e Tij që vullneti i Perëndisë duhej të bëhej. “U bëftë vullneti Yt” nuk është një formulë por është një qëndrim i lutjes. Kjo shpreh dëshirën tonë për të pranuar që njohuria e Atit është më e plotë se sa ajo e fëmijëve të Tij dhe se vullneti i Tij është më i miri. Si një fëmijë që i beson babit të tij, ne mësojmë të dëshirojmë atë që Perëndia na jep.

Kur Maria mori vesh nga një engjëll që ajo do të ishte nëna e Jezusit, ajo pati shumë pyetje me të cilat u desh që të merrej, përfshirë edhe pyetjen se çfarë do të mendonin të tjerët për një grua të re dhe të pamartuar, e cila kishte ngelur me barrë. Përgjigja që ajo i dha angjullit ishte “Ja shërbëtorja e Zotit; le të më ndodhë sipas fjalës sate” (Luk 1:38). Përkundër pyetjeve të saj, ajo e vendosi jetën e saj në duart e Atit të saj qiellor dhe shprehu dëshirën për të parë vullnetin e Tij të plotësohej në jetën e saj.

Në Kopshtin e Gecemanit, Jezusi vuajti në agoni mbi hijen e pamjes së kryqit dhe kërkoj nga Ati që nëse do të ishte e mundur që t’i hiqej kupa e vuajtjes dhe gjykimit që ishte vënë para Tij. Pas ankthit të këtyre orëve në lutje, Ai dorëzoi vullnetin e Tij në vullnetin e Atit. Kur ne nënshtrohemi para Perëndisë, duke thënë “U bëftë vullneti Yt” ne jemi duke u pajtuar me Perëndinë që qëllimet e Tij hyjnore janë të drejta.

Ne nuk kemi nevojë që ta gozhdojmë këtë frazë në secilën lutje. Duhet ta përdorim atë sa here që është e nevojshme. Gjëja më e rëndësishme është se Perëndia e shih qëndrimin që ajo përfaqëson. E shprehur me fjalët të thjeshta, të kërkuash në vullnetin e Perëndisë, është të kërkuash ashtu siç karakteri dhe plani i Perëndisë do të diktonin se është e drejtë në çdo kohë.

Të kërkuash në vullnetin
e Perëndisë, është të
kërkuash ashtu siç karakteri
dhe plani i Perëndisë do të
diktonin se është e drejtë
në çdo kohë.

Sa shpesh dëshirojmë t’i tregojmë Perëndisë se çfarë duhet të bëjë Ai, dhe nuk ia nënshtrojmë jetët tona vullnetit të Tij? Ne duhet ta kujtojmë se Perëndia është nën kontroll dhe se urtësia e Tij e tejkalon atë tonën. Perëndia mund të zgjedh t’i përgjigjet kërkesës sonë ashtu siç dëshirojmë ne, apo në një formë krejt tjetër.

Lutuni pa pushim. Kur lexojmë Ungjijtë, ne shohim që lutja ka përshtetur shërbesën e Jezusit. Para se Ai të zgjidhte dishepujt, Ai ndau kohë për t’u lutur. Ai nuk lejoi që ndonjë gjë të ndërhynte në kohën e Tij të lutjes, pavarësisht nga bezdia e kohës apo presionit nga aktivitetet ditore.

Ky mësim ju ka sfiduar që të ndiqni shembullin e Krishtit në zhvillimin e një jete të vazhdueshme të lutjes. Kjo ishte një sfidë që Pali shpesh e trajtoi në mësimet e tij për besimtarët.



Lexoni Romakëve 12:12, Kolosianëve 4:2, dhe 1Selanikasit 5:17. Cila është tema që përsëritet në këto pasazhe? Për shumë njerëz 1Selanikasit 5:17 tingëllon e pamundur. Çfarë mendoni që Pali mendon me fjalët “pa pushim”?

Kur ne përkushtohemi në lutje, ne zhvillojmë një zakon për të biseduar vazhdimisht me Të. Ndoshta kjo ishte ajo çfarë Pali pati në mendje kur u tha besimtarëve selonikasë që të luteshin pa pushim (1Sel. 5:17). Kur marrëdhënia jonë me Perëndinë arrin në nivel të intimitetit, ne do të dëshirojmë që të bisedojmë me të pa pushim, duke ndarë me Të mendimet dhe ndjenjat më të thella gjatë tërë ditës. Ai na fton për një marrëdhënie të tillë; vendimi na takon neve për t’u afruar pranë Tij sot dhe çdo ditë të re.



Mendo për mënyrën se si i parashtron kërkesat para Perëndisë. Çfarë të ndalon që të mos i sjellësh shqetësimet e tua tek Perëndia? Cilat janë motivet e tua kur lutesh? A i sjell kërkesat e tua në lutje para Perëndisë me besnikëri dhe në mënyrë të vazhdueshme? Kur ke parasysh vlerësimin e lavdërimit, falënderimit, rrëfimit dhe kërkesave, shkruaj disa fusha ku jeta jote e lutjes ka nevojë të ndryshojë.

Pengesat në lutje

Në shqyrtim të jetës sonë të lutjes, është mirë të merren në konsideratë faktorët që na pengojnë në lutje, si dhe arsyet pse Perëndia nuk i përgjigjet lutjeve tona.

Arsyet përse nuk lutemi

Ekzistojnë shumë arsye përse ne nuk lutemi. Ne do t’i shohim disa që janë si më të rëndomtë këtu.

Shumë njerëz thonë që ata janë thjeshtë shumë të zënë për t’u lutur. Ne mund të kemi jetë të zëna dhe mund të jemi të përfshirë në aktivitete që duken të rëndësishme, madje edhe të vlefshme në ndërtimin e marrëdhënies tonë me Perëndinë. Nëse shohim aktivitetet tona javore, ne mund të shohim që ne zakonisht krijojmë kohë për gjërat që me të vërtetë dëshirojmë të bëjmë. Kështu mund të zgjedhim që ta vëmë lutjen në listën tonë të prioriteteve dhe ta ndërtojmë atë në jetë tona përgjatë rrjedhjes së tërë ditës.

Një arsye e dytë se pse nuk lutemi ka të bëjë me mëkatin në jetët tona. Nëse nuk dëshirojmë të ndryshojmë, ne do të kemi shumë pak dëshirë për t’u lutur. Ne mund ta

ndejmë Frymën e Perëndisë duke na bindur për mëkat, por ne i rezistojmë thirrjes së Tij, dhe nuk ndihemi rehat në praninë e Tij.

Ndoshta ne kemi përjetuar një marrëdhënie të lënduar apo të thyer me një mik apo anëtar të familjes, dhe duhet ta rrëfejme mëkatin tonë, dhe të kërkojmë pajtim me atë person. Pjetri mbase do ta ketë pasur këtë mendim në mendje kur i këshilloi burrat që të trajtonin gratë e tyre me nder dhe mirëkuptim, në mënyrë që lutjet e tyre të mos pengoheshin (1 Pet 3:7).

Ndonjëherë ne mund të qëndrojmë larg nga Perëndia sepse ne kemi një ndjenjë të fajit të rremë apo të pavlefshmërisë. Ne mendojmë që nuk vlejme për të ardhur në praninë e Perëndisë, apo që Perëndia nuk mund të na fal pasi që ne vazhdojmë të përpëlitemi me mëkatin. Edhe pse ne rrëfejme mëkatet shumë herë, ne e kemi vështirë ta besojmë se me të vërtetë jemi të falur. Ne ndihemi të turpëruar që të vijmë vazhdimisht tek Perëndia me mëkatin tonë, dhe kështu vijmë në përfundim se Ai me siguri është lodhur nga rrëfimet tona dhe i neveritur nga gabimet tona të përsëritura.

Kjo është pikërisht mënyra se si Satani dëshiron që ne të mendojmë. Kur mendime të tilla na vijnë në mendje, ne duhet t'ia kujtojmë vetes ftesën personale të Perëndisë për t'u afruar pranë Tij dhe të fokusohemi në të vërtetën se ne jemi fëmijët e Tij, plotësisht të pranuar nga Ai dhe të shpallur të drejtë në saje të veprës së Krishtit, dhe jo në saje të veprës sonë.

Asnjëherë nuk do të jemi të denjë që nëpërmjet veprave tona të vijmë tek Perëndia. Hyrja jonë tek Perëndia është një privilegj që na takon neve si fëmijët e Tij, të shpëtuar me anë të hirit të Tij dhe të shpallur të shenjtë dhe të falur. Ai nuk lodhet nga rrëfimet tona mirëpo kënaqet kur shikon zemrën tonë të butë dhe dëshirën tonë për të restauruar marrëdhënien tonë me Të.

Nëse jemi të singertë, një arsye tjetër përse nuk lutemi është se ne mendojmë që lutja nuk do të ndryshojë ndonjë gjë. Mbase jemi lutur për dikë për një kohë të gjatë, dhe nuk kemi parë rezultate; është e lehtë që të humbasim shpresën dhe të vijmë në përfundim se lutja nuk përmbush asgjë apo që kurrë nuk mund të ndryshojë një person për të cilin kujdesemi.

Kur lutemi për një person tjetër, ne duhet të mbajmë mend se në lutje përfshihet edhe vullneti i atij personi. Megjithatë, perëndia dëshiron që ne të vazhdojmë të lutemi me besnikëri dhe të mos humbasim shpresën.

Mona, një grua libaneze, ishte lutur për 30 vjet që burri i saj Franci të bëhej i krishterë. Pas vdekjes së papritur të një miku, ata sikur u shkundën që të dy dhe ajo vendosi t'i flas burrit të saj më drejtpërdrejt për Krishtin. "Atë natë kam qenë kaq e shqetësuar që të flisja me të sa që mezi kam pritur që ai të kthehej nga puna në shtëpi. Po lutesha seriozisht që Zoti të më jepte një mundësi të dytë për të folur me të." Atë mbrëmje ajo i doli para derës dhe i tha atij, "Unë nuk dua që ti të vdesësh pa Zotin." Kur ai e pa se sa serioze ishte ajo, ai u nxit nga dashuria dhe shqetësimi i saj. Ata u ulën

dhe biseduan, dhe ai përfundimisht e besoi Krishtin si Shpëtimtarin e tij. Lutjet besnike të gruas së tij, dhe jeta e saj e vazhdueshme si besimtare luajtën një rol të rëndësishëm në vendimin e tij për të ardhur te Krishti. Sa e lehte do të ishte sikur ajo të humbiste shpresën!



A mendon që Perëndia e kishte dëgjuar Monën kur ajo ishte lutur për herë të parë për Francin? Nëse beson që Ai e kishte dëgjuar atë:

1. Cilat mund të jenë arsyet e mundshme pse Perëndia u ishte përgjigjur lutjeve të saja menjëherë?
2. Si kishte ndikuar kjo përvojë në Monën?
3. Çka nëse Franci nuk do të ishte bërë i krishterë? Si do të ndikonte kjo në kuptimin që ti ke për lutjen?

Arsyet përse Perëndia nuk i përgjigjet lutjeve tona

Bibla jep disa arsye specifike për lutjet e papërgjigjura. Jakobi 4:1-3 na jep dy arsye rrënjësore. E para, në vargun 2, është shumë e thjeshtë, “Ju nuk keni sepse nuk kërkonit.” Nëse duam që Perëndia t’i përgjigjet lutjeve tona, atëherë ne duhet të kërkojmë.

Jakobi e plotëson këtë mendim në vargun 4:3 ku thotë se vetëm të kërkuarit nuk mjafton; kur ne kërkojmë duhet të kërkojmë me motivet e duhura. Ai nuk do t’i përgjigjet lutjeve që priren për përmbushjen e kënaqësive vetjake dhe mëkatare.

Shikoni listën si më poshtë në lidhje me arsyet e tjera pse Perëndia nuk u përgjigjet lutjeve tona:

Mëkatit të parrëfyer (Psalmi 66:18)

Krenarisë dhe egoizmit (Luka 18:10-14)

Lutjeve të pasinqerta, me pretendim shpirtëror mirëpo që në realitet kërkojnë të marrin lavdërimin e të tjerëve (Mateu 6:5)

Mosbindje skandaloze (1 Samuli 15:11; Jeremia 11:11)

Mosbesim që Perëndia do të bëjë çdo gjë që t’i përgjigjet lutjeve të mia (Mateu 17:19-20)

Ritulaizëm i zbrazët në lutje (Mateu 15:8-9)

Shtypjes nga të tjerët (Mikaa 3:1-4)

Mbylljes së veshëve ndaj brënmës së të varfërve (Fjalët e Urta 21:13)

Ngritjes së idhujve në zemrat tona (Ezekieli 14:3-4)

Mosfaljes (Marku 11:25)

Dyshimit (Jakobi 1:5-7)



Teksa mendoni për jetën tuaj të lutjes, cilët nga faktorët e përmendur më sipër, të kanë penguar nga lutja? Çfarë vendime duhet të marrësh për të tejkaluar këto pengesa? Shkruaj vendimet e tua në fletoren tënde. Cilat nga mëkatet e shënuara më sipër mund të pengojnë përgjigjet e lutjeve tuaja. A je gati t'i rrëfesh dhe t'i braktisësh ato?

Kur Perëndia thotë “jo”

Pa marrë parasysh se sa e afërt është marrëdhënia jonë me Zotin, gjithmonë do të ketë periudha kur përgjigjet e Perëndisë ndaj lutjeve tona do të jenë “jo” apo kur Ai nuk përgjigjet fare por kërkon nga ne që të presim. Cili është qëndrimi ynë në kohë të tilla? A do të thotë që Perëndi po i përgjigjet lutjeve tona edhe kur Ai na thotë ‘jo’ apo kërkon nga ne që të presim?

Në një nivel njerëzor ne e dimë që për prindërit nuk është mirë që gjithmonë t'i përgjigjen kërkesave të fëmijëve të tyre. Njëjtë, shumë herë është mirë kur ne nuk marrim atë që kërkojmë nga Perëndia. Më vonë do ta kuptojmë se ajo gjë nuk ka qenë e mirë për ne.

Shpesh ne nuk mund të jemi në dijeni se si jetët e të tjerëve mund të ndikohen nga lutjet tona. Për shembull, një nuse mund të lutet për një ditë me diell për dasmën e saj, teksa në anën tjetër fermerët në ara janë duke u lutur fort që Perëndia të sjell shi mbi arat e tyre të thata. Perëndia në urtësinë e Tij, u thotë ‘jo’ disa kërkesave, dhe do ishte arrogante nga ana jonë të insistonim që Perëndia t'i përgjigjej lutjeve tona ashtu siç ne dëshirojmë. Nëse besimi ynë është në një At të dashur qiellor, ne do të mësojmë të besojmë që ajo që Ai na jep, është për të mirën tonë dhe që përfundimisht Ai do ta përdor atë për qëllimet e Tij hyjnore.

Kur nuk mund të lutemi

A ke përjetuar kohë kur duket e pamundur që të lutesh? Nëse po, atëherë ti nuk je vetëm. Shumë të krishterë e pranojnë që në kohë të ndryshme ata nuk mundur që të luten. Çfarë mund të bëjmë kur të ndihemi të bllokuar?

Të besosh në kohë të errësirës

Ka kohë kur një person është i tejmbushur nga rrethanat që e kërcënojnë për ta dërrmuar atë emocionalisht dhe shpirtërisht. Ne mund të përjetojmë kohë të ankthit shpirtëror, apo siç disa e kanë quajtur “një natë të errët të shpirtit.” Shkaktarët e ankthit shpirtëror dallojnë, prej pikëllimit të thellë dhe nga dhimbja për mëkatin tonë apo mëkatin e të tjerëve, prej persekutimit nga sëmundja e rëndë. Në këso kohë të vuajtjes së thellë, qoftë fizike apo emocionale, një person shpesh mund të përjetojë një ndjenjë të dëshpërimit apo të pikëllimit të thellë.

Shumë lutje tek Psalmet janë shkruar si rezultat i rrethanave të dhimbjes së madhe emocionale dhe pikëllimit për veten dhe të tjerët. Autorët e këtyre psalmeve kanë luftuar me humbje dhe hutime të madha personale, si dhe me ankth fizik dhe mendor. Shumë herë besimtarët luftojnë me një ndjenjë që Perëndia nuk është aty, që Ai nuk i dëgjon ata, apo që Ai nuk merakoset. Pavarësisht nga ndjenjat tona të dëshpërimit, Perëndia është i pandryshueshëm. Edhe kur ne nuk e ndjejmë praninë e Tij, Ai është aty në errësirë. Errësira dhe drita janë të barabarta për Të. Isaia duke u shkruar njerëzve në një situatë të tillë, i këshillon ata që të “të besojnë në emrin e Zotit” (Isa 50:10)



Shikoni psalmet në vijim që trajtojnë ankthin shpirtëror: Psalm 5, 41, 57, or 144 (shiko gjithashtu psalmet 4, 10, 17, 20, 28, 59, 70, 124, 132).

1. Cilin psalm e ke lexuar?
2. Cila është shprehja e ankthit që ke gjetur në të?
3. Po përvoja e ngushëllimit dhe strehimit?

Edhe pse autorët e shumë psalmeve janë ndeshur me rrethana dërrmuese, **ne shohim një linjë të njëjtë që përshkon këto psalme: në mesin e dhembjes dhe vuajtjes autori kthehet tek Perëndia për të gjetur strehim.** Ai kërkon ngushëllim nga Perëndia që është dhënësi dhe ruajtësi i jetës. Ai vrapon tek Perëndia me lëndimet e tija dhe gjen strehë, forcë për të vazhduar, dhe rifreskim për shpirtin e tij. Tek Fjalët e Urta 18:10 ne mësojmë që emri i Perëndisë është si një kala e fortë, dhe se të drejtët turren me vrap drejt Zotit. Kjo kala e fortë është një pamje e sigurisë dhe strehës.

Charles Colson, një autor i mirënjohur i krishterë, përjetoj një natë të errët shpirtërore kur dy fëmijët e tij u diagnostifikuan me kancer. Pas një periudhe të rëndë duke u munduar që të kuptonte përse Perëndia kishte lejuar që kjo të ndodhte, Colson shkroi, “E kuptova që unë nuk kisha nevojë të përpiqesha për t’i kuptuar ankthet që më ishin dhënë, apo të dëgjoja një përgjigje të qartë Besimi forcohet kur jemi pa ngushëllim dhe kur ecim në errësirë të braktisur plotësisht.... dhurata e besimit është më reale kur besojmë edhe kur çdo realitet i jashtëm na thotë që ne nuk kemi asnjë arsye për të besuar.”⁵

Fryma ndërhyr për ne

Në kohë të vuajtjes dhe dobësisë ekstreme, ne shpesh nuk dimë se si të lutemi, çfarë të themi, apo edhe si t'i formulojmë mendimet tona. Qëllimet e Perëndisë janë të fshehura nga ne. Sa ngushëlluese është që Perëndia na ka dhënë Një Person i cili do të ndërhyr për ne në lutje, e që është Fryma e Shenjtë. Ai ndërhyr për ne me rënkitime që janë të pashprehshme dhe të pashqiptuara. Kjo ndërhyrje nga Fryma kuptohet vetëm nga Perëndia, i cili heton zemrat (Rom 8:27).

Kur Fryma ndërhyr për ne, Ai gjithmonë e bënë atë në pajtim me vullnetin e Perëndisë. Ai merr parasysh shqetësimet e thella të një besimtari dhe i përzien ato me planet hyjnore të Perëndisë. Rezultati i premtimit të bukur të Romakëve 8:28 që “Perëndia bënë që të gjitha gjëra bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të tij.” Pasi që Fryma është gjithmonë në detyrë, ne ndonjëherë përjetojmë përgjigje të papritura të lutjeve. Fryma i drejton nevojat tona dhe shqetësimet tona sipas planit dhe kohës së Perëndisë.



Nëse Perëndia duket larg apo nëse je i dërrmuar për shkak të rrethanave tua, çfarë mund të bësh, dhe çfarë ka siguruar Perëndia?



Kur ti ke përjetuar një natë të errët të shpirtit, si je kthyer te Perëndia? Si e ke përjetuar ngushëllimin e Tij dhe si ke gjetur strehë tek Ai në kohë të tilla? Mendo për një përvojë të tillë dhe ndaje atë me grupin në takimin e radhës.



Bisedo me Perëndinë tani, duke e falënderuar Atë që ka ofruar shërbesën e Frymës së Shenjtë për të na ndihmuar kur nuk dimë se si të lutemi. Falënderoje Atë që ka siguruar këtë.

Qëndrimet që Perëndisë i pëlqejnë kur ne lutemi

Ne tani e dimë që Perëndi na pranon plotësisht dhe tërësisht për shkak se jemi në Krishtin. Ne e dimë që jemi gjithmonë të mirëseardhur tek Ai. Ai kënaqet kur ne vijmë tek Ai duke dëshiruar me të vërtetë që qëndrimet tona ta nderojnë dhe kënaqin Atë.

Një zemër e përlur dhe e nënshtuar

Në lutjen e Zotit, Jezusi e theksoi nënshtimin ndaj vullnetit të Atit, “u bëftë vullneti Yt dhe jo i yni”, duke besuar që Ati ynë i dashur e din çfarë është duke bërë dhe që ne t'i nënshtrohemi punës që Ai është duke bërë në dhe nëpërmjet jetëve tona. **Lutjes që Perëndia i përgjigjet ofrohet gjithmonë me një qëndrim të përlulësisë.**



Lexo parabolën e fariseut dhe tagrambledhësit tek Luka 18:9-14, që përshkruan dy njerëz duke u lutur. Vini re dallimin në qëndrimet e tyre, cili ka qenë fokusi i të dyve, dhe çfarë mund të nxirrni si përfundim.

Një dëshirë për t'u bindur

Përderisa lutja e një njeriu të drejtë është e fuqishme dhe efektive, kjo pjesërisht është për shkak të zotimit tonë për t'ju bindur Fjalës së Perëndisë. Lutja dhe bindja janë lidhura shumë ngushtë. Tek Luka 6:45 Jezusi i mësoi disa nga dëgjuesit e tij, “Përse më thirrni, "Zot, Zot" dhe nuk bëni atë që ju them?” Kur lutemi, zemrat tona duhet të jenë të hapura dhe të gatshme që t'i binden Perëndisë nëpërmjet drejtimit të Frymës së Shenjtë.

Kur lutemi për rrethana specifike, ne duhet gjithashtu të kemi dëshirë edhe që të përfshihemi. Për shembull, ne mund të përpiqemi që t'i dëshmojmë personit për të cilin kemi qenë duke u lutur që të shpëtohet. Ne mund t'i japim para personit, për të cilin kemi qenë duke u lutur që Perëndia të sigurojë financa për të. Kur lutemi që ta kuptojmë Biblën, ne mund të fillojmë të studiojmë më thellë dhe më me zell. Kurdo që të lutemi, qëndrimi ynë duhet të jetë, “Zot më trego rrugët e tua. Më trego se si dëshiron që unë të përgjigjem në këtë situatë. Më ndihmo që të bindem ndaj gjërave që më ke mësuar në Fjalën tënde dhe që ndërlidhen me këtë situatë”.

Besim fëmijëror

Kur lutemi, ne vijmë para Perëndisë si një fëmijë që vjen para babait. Jezusi e filloi modelin e Tij të lutjes, me fjalët “Ati ynë.” Këtu Ai përdor terminin aramaik “Abba” me anë të së cilit Ai i adresohet Perëndisë së Plotfuqishëm në kuptimin e besimit të ngushtë dhe afërt të një fëmije që ka ndaj babit të tij. Tek Romakëve 8:15 dhe Galatasve 4:6 ne mësojmë që edhe ne mund të thërrasim “Abba! O At!” Ne vijmë tek Perëndia si një fëmijë që vjen tek një At i dashur dhe i kujdesshëm, i cili dëshiron të ketë një marrëdhënie të ngushtë me ne dhe i cili do të na dëgjojë neve. Ne jemi të sigurt në dashurinë e Tij, dhe ne e dimë që mund t'i besojmë Atit tonë për të bërë më të mirën për ne.



Kini parasysh qëndrimet që Perëndia i dëshiron në lutje: nënshtrim, përulësi, bindje dhe besim. Kërko nga Perëndia që të të zbulojë ndonjë fushë ku ti ke nevojë të rritesh dhe kërkoji Frymë së Shenjtë që të punojë brenda teje për te realizuar këtë rritje.

Një zotim për t'u lutur

Nëse jeta jote e lutjes nuk ka ekzistuar, apo nëse ka qenë sporadike apo e thatë, mbase ti je i sfiduar që ta ripërtërish përkushtimin tënd për t'u lutur. Këtu është ftesa që ti të afrosh më afër Perëndisë sot. Merr parasysh sfidën në vijim që të zotohesh për t'u bërë një burrë apo grua i lutjes.



1. Bëjë një zotim që të kalosh të paktën 20 minuta çdo ditë në lutje. Shiko agjendën tënde për të parë se ku dhe si mund të gjesësh njëzet minuta që të kesh një kohë të qetë me Perëndinë. Gjej një vend ku nuk do të pengohesh nga zhurma dhe apo pengesat vizuale.
2. Shiko për mundësi që të bësh lutej të shkurtra përgjatë ditës.
3. Fillo të mbash një ditar lutjesh ku do të shkruash disa nga lutjet e tua. Ky do të jetë një regjistër shumë personal i kohëve tua intime me Perëndinë. Ti gjithashtu mund të shkruash edhe përgjigjet e lutjeve apo vështirësitë që ti ballafaqon në kohët e thatësirave.
4. Që të kujtosh si të lutesh, mbaj shënime në fletoren tënde kategoritë: “Lavdërim”, “Falënderim”, “Rrëfim”, dhe “Kërkesa”.

Mbajta e një ditari të lutjes mund të jetë një regjistër i mrekullueshëm i shtegtimin tënd me Perëndinë dhe i përgjigjes së lutjeve, një përkujtues i besnikërisë së Tij, të cilat ti mund t'i shikosh shumë vite më vonë.

Mendime përmbyllëse

Ne pamë që Perëndia na ka dhënë privilegjin e madh për t'u lutur, për të hyrë tek Ai, për t'u afruar më pranë në marrëdhënie me Të, për të bashkëpunuar me Të në përmbylljen e qëllimeve të Tij në këtë botë. Vetë Krishti është ndërhyrësi ynë tek Ati, dhe Ai na ka dhënë Frymën e Shenjtë që të ndërhyjë për ne në lutje. Ne shpresojmë që ti të jesh sfiduar për t'u lutur dhe për të thelluar jetën tënde të lutjes teksa zotohesh për t'u bërë një burrë apo një grua e lutjes.

FUSNOTAT

¹ Shën Augusti, *Rrëfime (Confessions)*, 1.1. (Penguin Classics, trans. R. S. Pine-Coffin [New York: Viking Penguin, 1961], 21).

² Bazuar në “Young Tad Lincoln Saved the Life of Jack, the White House Turkey!” [account on-line] (n.p., 1996-2007, accessed 8 March 2007); që mund të gjendet te: <http://members.aol.com/RVSNorton1/Lincoln65.html>; Internet.

³ W. Bingham Hunter, *The God Who Hears* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1986), 114.

⁴ John White, *The Fight: A Practical Handbook for Christian Living* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1976), 28.

⁵ Charles Colson, “Dark Night of the Soul,” *Breakpoint Commentaries*, December 22, 2005 [article on-line] (n.p., 2004-2006, accessed June 24, 2006); që mund të gjendet te: <http://www.breakpoint.org/listingarticle.asp?ID=1521>; Internet

Duke jetuar me anë të besimit

Thuajse para një viti Lili, nëpërmjet një studimi të biblës tek një shoqe e saj, arriti ta njoh Zotin. Ajo e kuptoi që Krishti kishte paguar dënimin e mëkatit të saj dhe gjithashtu i kishte krijuar asaj rrugën për në jetën e përjetshme. Në fillim, çdo gjë dukej e re dhe e mrekullueshme. Megjithatë, këtë vit, duket sikur çdo gjë po rrënohet për të. Së pari, burri i saj e humbi punën dhe ka qenë pa punë që disa muaj. Pastaj motra e saj u diagnostifikua me një sëmundje vdekjeprurëse. Anëtarët e saj të familjes nuk e kuptojnë besimin e saj të ri, dhe ajo e ka shumë pak mbështetjen e tyre. Emocionalisht, ajo shpesh është e shkurajuar dhe në depresion. Ajo mendon se “një i krishterë nuk duhet të veprojë në këtë mënyrë.” Ajo ka vështirësi në besimin e saj për Zotin, të besojë se Ai është i mirë, dhe se Ai me të vërtetë shqetësohet për të. Lutja e saj që Zoti ta shërojë motrën e saj, dhe që burri dhe fëmijët e saj të kthehen tek Perëndia, duket sikur nuk marrin ndonjë përgjigje. “Sikur Perëndia të më jepte vetëm edhe një shenjtë të qartë se Ai ekziston,” mendon ajo “do të ishte më e lehtë për të besuar.”

A ke pasur mall ndonjëherë që të kesh ndonjë provë të qartë mbi ekzistencën e Perëndisë? Çfarë mendoni ju se Lili do të mësojë gjatë kësaj kohe kur besimi i saj po vihet në provë? Si mund të jenë të tjerët një inkurajim për të dhe si mund të tjerët që ta ndihmojnë atë që të merret me dyshimet e saj?



Në Mësimin 1 dhe 2 ne pamë se shpëtimi ynë mbështetet vetëm në veprën e Krishtit, dhe ne nuk mund të sjellim asgjë shtesë tek Perëndia, as veprat apo shërbesat e mira apo veprimet e veçanta apo lutjet, për t'i shtuar asaj që Krishti veç se ka përmbushur për ne. Shpëtimi ynë bazohet plotësisht në vdekjen e Tij sakrifikuese për ne, si Një që jetoj një jetë të përsosur, dhe shpresa jonë për jetë të përjetshme bazohet në ringjalljen e Tij nga të vdekurit. Perëndia mori iniciativën e shpëtimit duke e dërguar Birin e Tij dhe duke na ofruar shpëtimin neve. Shpëtimi kërkon një përgjigje të besimit ndaj Jezus Krishtit, si Biri i Perëndisë dhe Shpëtimtari ynë. Efes.2:8-9 thotë, “Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra,

që të mos mburret askush.” Ky varg flet edhe për hirin e Perëndisë në inicimin e shpëtimit edhe për përgjigjen tonë nëpërmjet besimit.

Sapo të kemi marrë këtë hap të rëndësishëm të besimit, si duhet të jetojmë si besimtarë të Krishtit? Tek Galatasve 5:3-5 ne shohim se ne jo vetëm që jemi të shpëtuar nëpërmjet besimit, mirëpo ne edhe vazhdojmë të jetojmë me anë të besimit. Tek Hebrenjve 10:38 ne gjejmë këto fjalë, “DHE I DREJTI DO TË JETOJË PREJ BESIMIT.” Kjo e vërtetë e madhe shprehet disa herë në Bibël. **Ai që është i drejtë duhet të jetojë prej besimit.**

Në këtë mësim do të bisedojmë në lidhje me atë se çfarë nënkupton të jetuarit me anë të besimit.

Përmbledhje e Mësimit

Çfarë është besimi?
 Besimi i definuar
 Kujt duhet t’i besojmë?
 Besim fëmijëror
 Çfarë nuk është besimi
 Të mësosh t’i besosh Perëndisë
 Duke u rritur në besim
 Mësimet e besimit
 Testimi i besimit
 Stuhia e parë
 Stuhia e dytë
 Testi i madh i besimit
 Rezultati i besimit
 Besimi dhe dyshimi
 Shpërblimi i besimit
 Mendime përmyllëse

Qëllimet e mësimit

Kur ta kesh përfunduar këtë mësim, ti do të jesh në gjendje që:

1. Të përshkruash rëndësinë e besimit në Perëndinë.
2. Të japësh një definicion të besimit biblik dhe të vlerësosh konceptin tënd të besimit.
3. Të shpjegosh tre mënyrat me të cilat ne mund ta forcojmë besimin tonë.
4. Të lidhësh ilustrimet biblike të besimit dhe dyshimit me jetën tënde.
5. Të përshkruash mënyrën se si Jezusi e testoi besimin e dishepujve, mënyrat në të cilat edhe ne testohemi, si dhe rezultatet e testimit.
6. Të studiosh besimin e një karakteri biblik.



Reflektim shqyrtimi: Shqyrto kohën që ke kaluar në lutje dhe në Fjalë që nga koha e fundit e takimit me grupin. A ke filluar të kalosh më shumë kohë në lutje dhe lexim? A mund të vëresh dallimin se si këto zakone po e ndryshojnë jetën tënde të përditshme?

Çfarë është besimi?

Nëse i pyet disa njerëz që të japin një definicion për besimin, ti do të marrësh një sërë përgjigjesh. Besimi është një ndër ato koncepte për të cilat ne mendojmë se i kuptojmë por e kemi mjaft të vështirë t'i shpjegojmë. Thjeshtë, çfarë është besimi? Le t'i shohim disa përkufizime të besimit.

Përkufizimi i Besimit

“Besimi” nuk është vetëm një term i krishterë. Dhe gjithashtu domosdoshmërisht nuk është as edhe ndonjë term religjioz. Fjalori e përkufizon “besimin” si “siguri apo besim në një person apo në ndonjë gjë”¹ Njerëzit kanë besim, për shembull, në bashkëshortin(ten) apo doktorin apo në veturën e tyre.

Si një term i krishterë, besimi biblik, besimi që shpëton, është përkufizuar si “qëndrimi me anë të së cilit një person braktis çdo mbështetje për të fituar shpëtimin në përpjekjet e veta ... është qëndrimi i besimit të plotë në Krishtin, i mbështetjes vetëm në të për gjithçka që shpëtimi nënkupton.”²

Një përkufizim tjetër i besimit që shpëton është ky: “një besim me tërë zemër dhe i jashtëzakonshëm, një zbrazje e plotë nga vetvetja për të vendosur tërë besimin në mëshirën e Perëndisë ... Besimi e braktisë shpresën te njeriu në përmbushjet e sukseseve të veta, i lë të gjitha punët mbrapa, dhe vijë te Krishti i vetëm dhe duarzbrazët, për ta hedhur vetën plotësisht në mëshirën e tij.”³



Lexo Romakëve 4:1-8.

1. Cila mendoni se është çështja kryesore që Apostulli Pal po trajton në këtë pasazh në lidhje me Abrahamin dhe Davidin?
2. Si je mbështetur në veprat e mira specifike për t'ia shtuar ato besimit tuaj?

Këto përkufizime të besimit kanë të përbashkët elementin e të besuarit dhe të vendosjes së besimit në Perëndinë. T'i besosh Krishtit për shpëtimin është hapi i parë që ne duhet të marrim për të filluar jetën e krishterë.

Kujt duhet t'i besojmë?

Gjëja më e rëndësishme në lidhje me besimin, në kuptimin biblik, është siguria ndaj Atij që i besojmë. Jezusi e bëri këtë gjë mjaft të qartë kur Ai tha se mjafton që të kemi besim sa

kokrra e sinapit që të lëvizim malet. Është e qartë se nuk është besimi ynë ai i cili i lëviz malet. Ti mund të kesh besimin e mbarë botës, mirëpo mali nuk do lëviz fare nga vendi. Vetëm Perëndia mund të lëviz një mal. **Besimi i vërtetë, është ai besim i cili fokusohet në personin e duhur – Perëndinë e gjithëpushtetshëm**, që është lëvizësi i maleve. Besimi biblik është rezultat i reflektimit mbi besueshmërinë e Perëndisë. Si të krishterë ne e vendosim besimin tonë në Perëndinë që është plotësisht i besueshëm.

Vetëm “të kesh besim” nuk do të bëjë ndonjë gjë për ty. Dallimi qëndron në personin të cilit i beson. Për shembull, supozo se ke pasur një aksident automobilistik dhe ke qenë i shtrirë në rrugë i lënduar shumë rëndë. Dy njerëz të afrohen, njëri me një çantë me mjete të zdrukthëtarit dhe tjetri me një çantë të doktorit, dhe që të dytë të ofrojnë ndihmë. Nëse ti pranon ndihmën e zdrukthëtarit, i tërë besimi që ti vë në të me siguri që nuk do të ndihmojë në situatën në të cilën ndodhesh. Dhe sigurisht që menjëherë do të vësh besimin tënd në doktorin, duke iu përgjigjur atij shpejtë dhe duke i besuar vetën tënde nën kujdesin e tij. Ne mund të shohim se nuk është besimi, por doktori, ai që zgjedh problemin tuaj. Ajo që besimi kryen është se na vë në kontakt me doktorin.

Një ide tjetër thelbësore e ndërlidhur me besimin në Bibël është besimi në dëshmi. I krishteri është i thirrur të besojë jo vetëm në karakterin e Perëndisë, por edhe në fjalët e Tij. Besimi është një vendim për besuar dhe për t’iu përgjigjur Fjalës së Perëndisë.

I krishteri është i thirrur të
besojë jo vetëm në karakterin e
Perëndisë, por edhe në fjalët e
Tij.

Ky aspekt i besimit në fjalën e tjetrit mund të shikohet nga perspektiva e marrëdhënieve tona njerëzore. Ne ndërtojmë besimin mbi marrëdhënie, duke u mbështetur në besueshmërinë e asaj që personi tjetër thotë. Kur një mik ju kërkon që ta takoni atë diku, ju besoni se ai do të jetë atje, sepse ai ju ka dhënë fjalën e tij. Duke u bazuar në atë që ti din për atë person dhe nga përvojat e kaluara, ju prisni që ai të jetë atje. Ngjashëm ti gjithashtu beson se shoku apo mik u do të jetë i sigurt me ty, nëse po ai person ka treguar sinqeritet në të kaluarën.

Po kështu është në marrëdhënien tonë të vazhdueshme me Perëndinë, Atin tonë. Ne mund t’i besojmë karakterit të Tij ashtu siç Ai na e ka shfaqur në Fjalën e Tij, dhe ne mund të besojmë atë që Ai thotë dhe gjithashtu t’u besojmë premtimeve të Tij të dhëna për ne në Fjalën e Tij.

Besim fëmijëror

Jezusi një herë e ftoi një fëmijë tek vetja dhe u tha ndjekësve të Tij, “në qoftë se nuk ktheheni dhe nuk bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiejve” (Mat 18:3). Në çfarë kuptimi duhet që besimi ynë të jetë “fëmijëror”? Çfarë kuptojmë me këtë?

Një vajzë e vogël shikon prindërit e saj për ndihmë dhe udhëheqje. Kur ajo rrëzohet dhe gërvisht gjurin e saj, ajo menjëherë i kthen sytë e saj të mbushur përplot me lot drejt mamasë, duke kërkuar ndihmë dhe ngushëllim. Kur ajo prish një lodër, ajo e sjell atë tek babai dhe i thotë “babi rregulloje” Ajo beson se babi i saj mund të rregullojë çdo gjë që është e prishur. Kur ajo i shikon një palë shkallë të thepisura, ajo zgjatë dorën e vogël drejt dorës së mamasë apo babait, për t’u lëshuar drejt shkallëve. Ajo vështroon punën e ndonjë makine dhe kërkon nga babai që t’i shpjegojë asaj se si punon ajo. Ajo beson që prindërit e saj do ta ngushëllojnë, do t’ia rregullojnë lodrat e prishura, do t’i ofrojnë asaj siguri, do ta mbrojnë atë nga rreziku, dhe do t’i përgjigjen pyetjeve të saj. Ajo u beson atyre me tërë qenien e vet. Është në natyrën e fëmijëve që t’u besojnë atyre, të cilët kujdesen për ta. Për këtë arsye ne mund të themi që besimi është “fëmijëror.” Perëndia dëshiron që ne të mbështetemi tek Ai automatikisht, me tërë qenien tonë.

Ndonjëherë një baba mund të tradhtojë besimin e fëmijës së tij. Ai e neglizhon apo e abuzon fëmijën. Fëmijët të cilët rriten në një familje të tillë mësojnë se ata nuk mund t’i besojnë babait të tyre. Ai nuk është i pranishëm kur ata kanë nevojë për të. Perëndia, megjithatë, nuk është i tillë. Ai është në dijeni për çdo gjë që ndodh në jetën tonë, dhe për më tepër, Ai na do me një dashuri të pastër dhe të shenjtë, që do të thotë se Ai kurrë nuk pengohet në kujdesin e Tij ndaj nesh, **Ky Perëndi që është Ati ynë dëshiron që ne t’i besojmë Atij.**



Ne mund të kemi tendencën që ta shohim Perëndinë ashtu siç e shohim babanë tonë tokësor. A je në dijeni për ndonjë koncept të rremë që ti mund të kesh për Perëndinë si Atin tënd? Cili do të ishte dallimi në rezultatet e besimit tuaj nëse do të kishe një pikëpamje të saktë për Perëndinë?



Merr kohë për të medituar në besueshmërinë e Atit tuaj qiellor dhe falënderoj Atë për dashurinë e Tij të pafund.

Çfarë nuk është besimi

Shumë njerëz kanë keqkuptime në lidhje me kuptimin e fjalës “besim”. Pasi që besimi është kaq i rëndësishëm në ecjen tonë me Zotin, ne duhet të kuptojmë çfarë është besimi dhe çfarë nuk është besimi.

Një keqkuptim sot e ngatërron besimin me mendimin pozitiv. Njerëzit shpesh besojnë se ata mund t’i ndikojnë rrethanat e tyre me anë të menduarit pozitiv. Ata besojnë se, nëse vendosin të mos mendojnë negativisht atëherë mendimi negativ nuk do të ketë fuqi mbi ta. Është e vërtetë që të krishterët inkurajohen që të mendojnë rreth gjërave pozitive, ashtu siç Pali na përkujton tek Filipianëve 4:7-8. Mirëpo arsyeja përse ne fokusohemi në gjërat pozitive nuk bëhet me qëllimin që ky veprim t’i ndryshojë rrethanat tona, mirëpo që të shpreh besimin tonë se Perëndia është plotësisht nën kontroll përderisa ne zgjedhim të

fokusoheми të dhuratat e Tij të mira, dhe triumfin e Tij përfundimtar mbi të keqen që ndodhet në botë. Qëndrimet tona mund të ndryshojnë teksa zgjedhim të fokusohemi mbi gjërat e mira, megjithatë Bibla këtë proces nuk e përkufizon si besim.

Një keqkuptim i dytë i zakonshëm e përdor fjalën “besim” si një sinonim i mungesës së dëshmisë. Për shumë njerëz, të besosh në diçka “me besim” nënkupton ose të besosh për shkak se nuk ka dëshmi apo në disa raste të besosh pavarësisht nga dëshmia e kundërt. Nga ka ardhur ky koncept i gabuar i besimit? Burimi kryesor i këtij lloj të menduari mund të gjendet në shkencën laike, e cila ka përqafuar një pikëpamje të gjerë të shkakut dhe materializimit natyror që janë plotësisht në kundërshtim me Biblën. Ithtarët e kësaj pikëpamje botërore vazhdimisht pohojnë se ata që besojnë në Bibël e bëjnë këtë në mungesë të dëshmisë së kundërt. Ky i menduar laik ka depërtuar në kaq shumë qarqe të krishtera sa që ka sjell një ndarje të fuqishme në mes të besimit dhe arsyes. Si rezultat disa të krishterë kanë zhvilluar kundër-intelektualizmin në një përpjekje për të mbrojtur pikëpamjet e krishtera përballë këtij sulmi.

Në të vërtetë, **besimi ynë bazohet fuqishëm në dëshmi.** Nuk është qëllimi ynë që këtu të prezantojmë dëshmi të tilla, mirëpo vetëm edhe një shikim i shkurtër regjistrimeve në katër ungjijtë të mrekullive të Jezusit dhe të vdekjes dhe ringjalljes së Tij, tregojnë se kanë ekzistuar shumë dëshmitarë të jetës dhe të vdekjes së Jezusit. Ringjallja e Tij është vërtetuar nga shumë njerëz, mbi pesëqind dëshmitarë në të njëjtën kohë (1Kor.15). Shumë ngjarje të tjera që janë të pranura gjerësisht si ngjarje historike kanë një trup më të vogël të dëshmisë për të provuar ekzistencën e tyre. Ka mjaft evidencë që tregohet se Jezusi ka jetuar me të vërtetë, se ai ka vdekur dhe është ringjallur përsëri në Palestinë dhe se Shkrimet, ashtu siç i kemi ne, në mënyrë të saktë reflektojnë atë që Perëndia dëshiron të na thotë neve. Besimi historik i krishterë është një sistem i të besuarit në dëshmi.

Një keqkuptim i tretë në lidhje me besimin është kur mendojmë se besimi duhet të përcillet me ndjenja të forta. Besimi biblik nuk është i njëjtë me ndjenjat. Besimi mund të përcillet me ndjenja mirëpo jo çdo herë ndodh kjo. Neve na lënë përshtypje shumë shpejtë shfaqjet e fuqishme të emocioneve, megjithatë besimi në Perëndinë mund të shprehet edhe në një mënyrë shumë të qetë. Mendoni në lidhje me tregimin e Jezusit duke ringjallur Llazarin nga të vdekurit (Gjoni 11). Jezusi urdhëroi që guri të rrotullohej nga varri i Llazarit, dhe Marta e shprehu besimin e saj duke lejuar që kjo gjë të bëhej. Besimi nuk është domosdoshmërisht një përgjigje e fuqishme emocionale mirëpo ai është një dëshirë për të besuar dhe për t’ju bindur Perëndisë dhe Fjalës së Tij.

Një keqkuptim i katërt në lidhje me besimin është kur mendojmë se besimi është një fluturim i verbër në errësirë. Përkundrazi, besimi është një bindje që vjen nga dëshmia e vërtetuar.

Për të ilustruar dy mënyrat e ndryshme që besimi mund të vështrohet, ne kemi marrë një ilustrim të filozofit të krishterë Francis Schaeffer.

Supozoni se ne jemi duku u ngjitur Alpeve, dhe jemi ngjitur lart në një shkëmb të thepisur, dhe papritur një mjegull e dendur bie dhe na gëlltit neve. Drejtuesi e vlerëson situatën dhe na thotë neve, “Temperatura është duke rënë aq shumë saqë nuk mendoj se ka ndonjë shpresë për ne. Ne do ngrijmë gjer në vdekje në majën e këtij shkëmbi.” Pas një ore njëri i thotë drejtuesit, “Sikur unë të përkulem dhe të bie në një shpat të shkëmbit që është tre metra nën mjegull. Çfarë do të ndodhte?” Drejtuesi i thotë, “nën strehën e shpatit malor deri në mëngjes ti mund të shpëtohesh.” Kështu, pa ndonjë siguri absolute për ekzistimin e një shpati të tillë, ai person shkon në skaj dhe bie në mjegull. Ky është një shembull i besimit të tillë, i fluturimit të verbër.


Për kundër kësaj, mendo sikur në mes të mjegullës ne dëgjojmë një zë i cili na thërret, “Ju nuk mund të më shihni, mirëpo nga zërat e juaj unë e di saktësisht se ku ju ndodheni. Unë ndodhem në një kreshtë përballë jush. Unë jetoj në male që gjashtëdhjetë vjet, dhe unë e njoh çdo cep të maleve. Ju siguroj që tre metra nën ju është një shpat. Nëse mbaheni dhe bini poshtë, atëherë ju do t’ia dilni mbanë, dhe nesër në mëngjes unë do të vij tek ju.”

Tani ju me siguri që nuk do të vareni dhe nuk do të lëshoheni menjëherë. Ju do t’ia bëni disa pyetje personit që po ju flet. Në Alpe, për shembull, janë disa emra të familjeve vendore që janë të njohura. Nëse e pyetni njeriun për emrin e tij dhe ju e njihni si një emër që i takon asaj pjese të maleve, kjo do të ndikonte në vendimin tuaj për t’i besuar atij. Në një situatë të tillë të pa shpresë ju do t’i parashtronit atij mjaft pyetje për t’u siguruar në lidhje me besueshmërinë e tij. Kur të bindeni se mund t’i besoni atij, atëherë do të vendosni që të vareni dhe të bini.

Edhe ky është besim, mirëpo nuk ka aspak lidhje me përdorimin tjetër të fjalës. Në të vërtetë, nëse një ndër këto veprime quhet besim, atëherë tjetri nuk duhet të përcaktohet me fjalën e njëjtë. **Besimi historik i krishterë nuk është një kërcim në errësirë. Perëndia na ka folur jashtë mjegullës.** Ne kemi zbulimin. Perëndia na ka folur nëpërmjet Fjalës së Tij, që është autoriteti dhe drejtuesi ynë për jetën.⁴

Shikoni diagramin më poshtë i cili ilustron zgjedhjen për të besuar:

T'i besosh Perëndisë dhe Fjalës së Tij



Kur biem në mjegull nga shkëmbi i mosbesimit, ne veprojmë në bazë të besimit në Personin e Perëndisë dhe në atë që Perëndia ka thënë në Fjalën e Tij. Në një anë, ne fillojmë të ecim mbi një urë të padukshme, urë e cila është e bazuar në Personin e Perëndisë dhe në atë që Perëndia ka thënë në Fjalën e Tij. Ne besojmë se kjo urë është aq e fuqishme sa të na mbajë ne dhe të na çoj në një vend të fortë.

Diagrami i më sipërm mund të përdoret për të ilustruar zgjedhjet e vazhdueshme të besimit në jetën e krishterë. Besimi ynë rritet teksa fokusohemi shumë e më shumë në karakterin e Perëndisë dhe në Fjalën e Tij. Ilustrimi i të qenit në mjegull gjithashtu aplikohet përgjatë jetës tonë të krishterë. **Ekzistojnë shumë situata ku ne thirrëmi që thjeshtë t'i besojmë karakterit dhe fjalës së Atij që na ka folur.** Ne mund të dalim dhe të ecim në mjegull sepse e njohim Atë që na ka folur. Sa më gjatë që ta njohim Drejtuesin tonë, aq më shumë mësojmë t'i besojmë Atij. Nga përvojat tona me Të, ne e dimë se Ai ka qenë një strehë për ne në të kaluarën; ne e dimë se Ai ka siguruar për ne; dhe ne e dimë se gjërat që Ai i thotë në Fjalën e Tij janë vërtetuar si të vërteta. Edhe nëse nuk mund ta kuptojmë rrugën që na është shtruar përpara, ne e dimë që mund t'i besojmë Atij dhe të përqafojmë këtë verbëri të besimit, jo në errësirë, por në krahët e Tij të dashur që do të na mbajnë neve të sigurt. Sigurisht që Ai do të jetë aty, për të na shpëtuar dhe për të na ruajtur neve.



Cilat aspekte të besimit të diskutuara këtu, janë të reja për ty?

1. Cilat janë ato keqkuptime të besimit që ti ke pasur?
2. Si mund ta përkufizosh besimin tani?
3. Si mund të të ndryshoj ty dhe kishën ky pranim i kuptimit të besimit?

Të mësosh t'i besosh Perëndisë

Jeta e krishterë fillon me anë të një hapi të besimit nga ana jonë kur i besojmë veprës së Jezus Krishtit në kryq për shpëtimin tonë. **Jeta jonë në Krishtin vazhdon gjithashtu teksa i besojmë Perëndisë hap pas hapi.**

Duke u rritur në besim

Kur një foshnje është gati që të ec, aty kemi momentin e mrekullueshëm kur foshnja nxjerr hapin e parë. Nënati mezi presin për atë moment dhe u tregojnë të tjerëve tregimin se si ka ndodhur një gjë e tillë. Kështu është edhe me besimin. Ekziston hapi i parë, një moment i mrekullueshëm, kur ne e vëmë besimin tonë në Jezus Krishtin dhe biem në krahët e Perëndisë, Abba-s (Atit) tonë. Sa e mjerueshme do të ishte sikur për një foshnje hapi i parë i të ecurit do të ishte hapi i vetëm i tij.

Shumë të krishterë janë të kënaqur me këtë hapin e parë, dhe mjerisht disa ngelin foshnje përgjatë tërë jetës së tyre, duke mos mësuar asnjëherë çfarë do të thotë të ecësh me anë të besimit, hap pas hapi, duke i besuar Perëndisë për çdo ditë në jetët e tyre.

Ashtu si prindërit e shikojnë me krenari dhe me padurim fëmijën e vogël teksa fillon të marr hapin e parë, dhe pastaj një tjetër e një tjetër, po ashtu edhe dizajni natyral i foshnjës së krishterë duhet të mësojë të ec me Krishtin me anë të besimit. Një hap, në fillim hezitues, të çon tek tjetri, dhe gradualisht, si foshnja, ne fillojmë të kemi më shumë besim në Perëndinë në shumë fusha të jetës sonë. Shumë të krishterë janë të kënaqur me këtë hapin e parë, dhe mjerisht disa ngelin foshnje përgjatë tërë jetës së tyre, duke mos mësuar asnjëherë çfarë do të thotë të ecësh me anë të besimit, hap pas hapi, duke i besuar Perëndisë për çdo ditë të jetës së tyre.

Jezusi tregoi se një masë e vogël e besimit mund të arrijë gjëra të mëdha, sepse, ashtu siç e pamë më herët, rezultati varet në Atë që i besojmë – Perëndinë e plotfuqishëm, Krijuesin e qiellit dhe tokës. Nëse Perëndia do që të lëviz një mal, Ai nuk ka asnjë problem që ta bëjë këtë. Ai është krijuesi i maleve, dhe ai mund t'i zhvendos ato siç ia ka dëshira. Ne shohim shumë shembuj në Bibël të veprave të mëdha të kryera nga Perëndia në përgjigje të “besimit të vogël” të ndjekësve të Tij.

Tek 2 Thesalonikasve 1:1-4 Pali i lavdëron besimtarët e Thesalonikut sepse besimi i tyre ishte duke u rritur çdo ditë e më shumë. Bibla na mëson në mënyrë të qartë se është dëshira e Perëndisë që çdo besimtar të rritet në besim. Shkrimet na flasin për “besim të madhë” dhe “besim të vogël”. Besimi i madhë vazhdon t’i besojë Perëndisë edhe në situatat më të vështira. Çfarë mund të bëjmë që të rrisim besimin tonë, që të lëvizim nga “besimi i vogël” në “besimin e madhë”?

Së pari, ne mund të kujtojmë se si Perëndia na ka ruajtur në të kaluarën, në veçanti përgjatë vështirësive më të mëdha që ne kemi pasur si të krishterë. Kur shikojmë përvojat tona, mund të inkurajohemi që të qëndrojmë besnik duke kujtuar si Perëndia na ka nxjerr në kohë të tjera kur kemi qenë në vështirësi dhe pikëllim.



Shiko Jozueu 4:1-24.

1. Cili ishte qëllimi i memorialit prej gurëve?
2. Çfarë roli luajti në zhvillimin e besimit tek izraelitët?
3. Përse do të inkurajonte që të vazhdosh në besim sikur të kuptoje që në kohë të ndryshme Perëndia ka vepruar për ty?

E dyta, ne mund të qëndrojmë të fokusuar në Perëndinë duke u koncentruar në të vërtetat e Shkrimit. Në Fjalën e Perëndisë ne gjejmë ushqim për të na ushqyer, shembuj të grave dhe burrave që besuan në mesin e problemeve të mëdha, dhe gjithashtu gjejmë përkujtues të besnikërisë, mirësisë, dhembshurisë dhe dashurisë së Perëndisë. Këto të vërteta janë spirancat tona në kohë të vështira.

Një mënyrë e tretë për të rritur besimin tonë është t’i njohim dhe t’i eliminojmë zotat e rremë në jetët tona. Shqyrto veten për të parë se në ç’vend tjetër je thelluar. A po mbështetesh në burimet dhe forcat e tua për të zgjidhur një problem apo për t’i plotësuar kërkesat ditore të jetës? A po pret që burri yt, fëmija apo një mike të jetë çfarë vetëm Perëndia mund të jetë për ty?



Çfarë “gurë përkujtimi” ke ndërtuar për të kujtuar furnizimin e Perëndisë apo karakterin e Tij? A mund të mendosh për ndonjë kohë kur fokusi yt në Perëndinë është restauruar me anë të leximit të fjalës së Tij? Shkruaj në lidhje me këtë. Mendo për ata që i do dhe që mbështetsh në ta. Si mund të zëvendësohet varësia jote tek ta me varësinë tënde tek Perëndia?



Në fillim të këtij mësimi lexuam në lidhje vështirësitë e Lilit. Nga ajo që ke mësuar deri më tani, dhe nga përvojat e tua, çfarë mund të ndash me të në lidhje me mënyrën se si ajo mund të forcojë besimin e saj?

Mësimet e besimit

Kur shohim jetën e hershme të Jezusit, menjëherë vërejmë se Ai e koncentroi shërbesën e Tij në trajnimin e dymbëdhjetë burrave të cilët Ai i zgjodhi që të jenë dishepujt e Tij. Qëllimi i Krishtit ishte që të fillonte një lëvizje që të ndryshonte historinë. Mirëpo mënyra se si Ai zgjodhi ta bëjë këtë ishte shumë hutuese. Në vend që të shkonte dhe të merrte një zyrë politike, të ndërmernte kampanja të mëdha ungjillore, apo të bënte çfarëdo gjëje që ndërlidhet me lëvizjet masovike, Jezusi i përkushtoi tre vitet e jetës së Tij dhe shërbesën në tokë thuajse plotësisht në trajnimin e dymbëdhjetë burrave. Këta ishin njerëz të zakonshëm - disa peshkatarë, një tagrambledhës, një fanatik politik. Kjo bëhet më e dukshme kur kuptojmë se cili ishte prioriteti i Tij në trajnimin e të dymbëdhjetëve.

Cila ishte gjëja kryesore në mendjen e Krishtit kur po trajnonte të dymbëdhjetët? Një studim i Ungjijve zbulon se **besimi i tyre** ishte shqetësimi i Tij më i lartë. Për më tepër, ne zbulojmë se Jezusi nuk ishte thjeshtë i shqetësuar që ata të kishin besim, mirëpo që ata të zhvillonin besimin e tyre. Kur lexojmë Ungjijtë, duket qartë që dëshira e Jezusit, pasioni i Tij, ishte që dishepujt e tij të rriteshin në besim. Le t'i shikojmë të dhënat në Ungjijtë për ta kuptuar këtë.



Lexoni Luka 9:1-6, që regjistron dërgimin e dishepujve për të shërbyer.

1. Çfarë kuptoni nga mënyra se si Jezusi i mësoi dishepujt e Tij për t'i besuar Perëndisë?
2. Nëse ti do të ishe një nga dishepujt në këtë rast, çfarë pyetje do të kishe?



Lexoni Mateu 6:25-34.

1. Për çfarë gjëra të zakonshme është duke folur Jezusi këtu?
2. Çfarë përfundime nxjerr Jezusi me anë të ilustrimit të zambakëve dhe zogjve?
3. Çfarë prioritete u vë Jezusi ndjekësve të Tij?
4. Çfarë mendoni, përse i lidh Ai këto dyja bashkë?

Jezusi i mësoi dishepujt e Tij vazhdimisht që ata të mund t'i besonin Atit të tyre qiellor që Ai do të siguronte për ta. Ai gjithashtu i mësoi ata për rëndësinë e të jetuarit të secilës ditë veçmas nga të tjerat: “Mos u shqetësoni për të nesërmen ... sepse ka mjaft probleme me të cilat duhet të merremi sot (Mat 6:34 e parafrazuar). Çdo ditë i mjaftojnë problemet e veta.” Sa shpesh e torturojmë veten tonë duke u shqetësuar dhe frikësuar për të nesërmen. Nëse i besojmë Atit tonë qiellor, ne do të jetojmë çdo ditë veçmas nga të tjerat, duke e lënë të ardhmen në duart e Tij.

Nëse fokusohemi në prioritet për të kërkuar mbretërinë e Perëndisë dhe për të jetuar në drejtësi, Ai do të kujdeset për të gjitha nevojat tona. Në Mësimin 3 ne mësuam rreth drejtësisë së Krishtit dhe se si rritemi si besimtarë për t'u bërë më shumë në ngjasim me Krishtin. Rritja në drejtësi duhet të jetë një prioritet i lartë për të gjithë dishepujt. Një prioritet i njëjtë i lartë është kërrimi i mbretërisë së Tij, duke i përqendruar mendimet dhe jetët tona në themelimin dhe ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë.



Teksa rritesh në jetën e krishterë, ti do të ballafaqohesh vazhdimisht me situata që do të testojnë prioritet e tua në këto fusha.

- Në ç'mënyra po jeton për mbretërinë e Tij dhe si po rritesh në drejtësi?
- A janë prioritet e tua të ngjashme me të Tijat?
- Çfarë vështirësish ke pasur për të besuar që Perëndia do të sigurojë për ty?
- Si ia del mbanë kur fillon të shqetësohesh?
- Përse e ke vështirë të besosh që Perëndia do të sigurojë për nevojat e tua?



Falënderoje Perëndinë që Ai ka siguruar për ty, dhe kërko nga Ai që të të ndihmojë të jetosh çdo ditë në plotësinë e vet, duke e lënë të ardhmen në duart e Tij.

Sprova e Besimit

Teksa Jezusi gjatë tre viteve të shërbesës së Tij derdhi jetën e Tij në dymbëdhjetë dishepujt, prioriteti i Tij më i lartë ishte zhvillimi i besimit të tyre. Ai e përmbushi këtë qëllim me anë të disa metodave. Ai kaloi kohë me ta, si personalisht ashtu edhe në grup, dhe Ai i mësoi ata. Ata mësuam nga udhëzimet dhe nga jeta e Tij. Si një mjeshtër mësues Ai gjithashtu ka dhënë edhe sprovë, mirëpo sprovat e Tij nuk i ngjajnë testeve që shumica e mësuesve japin. Kur Jezusi jepte ndonjë sprovë, ato ndërlidheshin me aplikimin e të vërtetës në jetë. Sprovat që Jezusi jepte ishin sprovë të besimit, duke u dhënë dishepujt të Tij mundësinë për t'i besuar Atij në shumë situata të ndryshme, dhe kështu ata mësuam t'i aplikojnë në jetët e tyre të vërtetat që Ai ia mësoi atyre.

Kur Jezusi jepte ndonjë sprovë, ato ndërlidheshin me aplikimin e të vërtetës në jetë

Gjatë tre viteve që Jezusi i kaloi me dishepujt e Tij, Ai vazhdimisht i testoi ata duke zgjatur besimin e tyre në situatat e zakonshme dhe të përditshme që ata ballafaqonin.

Stuhia e Parë

Ungjijtë i regjistrojnë jo vetëm mësimet e Jezusit, por edhe sprovat e besimit të dishepujve. Ne do të shikojmë një sprovë të tillë tek Marku 4:35-41. Të gjithë ne do të ballafaqohemi me sprova të tilla. “Një sprovë është një përvojë e vështirë nëpërmjet së cilës shfaqen vlerat, zotimet dhe besimet e vërteta të një personi.”⁵



Lexoni Marku 4:35-41 dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim:

1. Si u sprovua besimi i dishepujve tek Jezusi në këtë shembull?
2. Ku ishte Jezusi gjatë kësaj stuhie? Përse është kjo e rëndësishme?
3. Çfarë po bënte Ai? Përse është kjo e rëndësishme?
4. Çfarë pyetje bënë dishepujt? Çka të tregon kjo në lidhje me dishepujt?
5. Cilat ishin mësimet që Jezusi deshi t’ua mësojë dishepujve?

Problemi i menjëhershëm që dishepujt ballafaquan ishte një stuhia fizike që kërcënonte të përmbyste barkën e tyre. Reagimi i dishepujve ndaj stuhisë ishte një reagim i lemerisë dhe tmerrit. Në mesin e frikës së tyre, ata bënë gjënë e duhur: ata u kthyen te Jezusi.

Jezusi u ngrit dhe e qetësoi stuhinë me pak fjalë, “Pusho dhe fashitu,”^a njëjtë sikur kur qetësohet një fëmijë. Menjëherë era u ndal; stuhia mbaroi. Dishepujt vetëm mund ta shikonin Jezusin të mahnitur me fuqinë e Tij të tmerrshme që sapo kishte shfaqur. Përderisa frika është reagim normal i njeriut në një situatë të tillë, Jezusi i qortoi ata pasi që frika e tyre ishte kaq e fuqishme sa që gati i kishte pushtuar ata plotësisht, deri në ata pikë sa të humbisnin shpresën.

Përderisa stuhia e jashtme që po kërcënonte të përmbyste barkën e tyre ishte problemi i menjëhershëm që dishepujt u ballafaquan, në anën tjetër një stuhia brenda mendjeve të tyre po tërbohej. Çfarë mendime mund të kishit në një rrethanë të tillë? Cila stuhia mendoni mund të ishte më e fuqishme? Përse?



Mendo për një kohë kur ti je përballur me një “stuhia” personale.

- Cila ka qenë pjesa më e vështirë që të merresh, vetë problemi apo stuhia e brendshme e krijuar nga frikërat e krijuara brenda teje si dhe shqetësimi i lindur?
- A ke pyetur nëse Perëndia po kujdesej për ty apo nëse do të bënte ndonjë gjë për të të ndihmuar?

^a në përkthim literar nga versioni në anglisht “Qetësohu, ji i qetë” (shënim i përkthyeses)

- Çfarë të ka ndihmuar që ta ballafaqosh këtë stuhi?
- Deri në çfarë shkalle ke besuar që Krishti ka qenë “në anijen tënde dhe me ty” në mesin e kësaj stuhie?

Stuhia e dytë

Çfarë mendoni ju se çfarë note do të merrnin dishepujt në sprovën e stuhisë? Atyre ju dha rasti që të hynin sërish në këtë sprovë. Po kështu ndodh zakonisht edhe në jetë. Nëse nuk e mësojmë një mësim specifik herën e parë që na paraqitet, ajo shpesh do të na vije vërdallë nesh. Para se ata të përballeshin me stuhinë e dytë, ata veçse kishin parë një shfaqje tjetër të fuqisë së Jezusit, kur Ai i ushqeui me një drekë pikniku pesë mijë burra, plus gratë dhe fëmijët, duke përdorur një shportë të drekës me vetëm pesë bukë dhe dy peshq.

Duke qenë aty të pranishëm dhe duke parë këtë çfarë mësim do të duhej të kishin nxjerrë dishepujt? Sigurisht, ata kishin edhe një përkujtues tjetër dramatik se Jezusi ishte Perëndia, që Ai është i plotfuqishmi, dhe se Ai e kontrollon bile edhe krijimin. Mbani mend, këta ishin burrat që kishin shpërndarë drekën dhe që kishin mbledhur dymbëdhjetë shporta me ushqimin e mbetur! Pas kësaj ngjarje të mahnitshme ata u futën në një barkë në bregun e Liqenit të Galileës, ndërsa Jezusi shkoi në mal që të lutej.



Lexoni Marku 6:45-53 dhe vini re disa detaje në këtë tregim të stuhisë së dytë.

1. Përse u futën dishepujt në barkë?
2. Çfarë vërejmë në lidhje me veprimet e Jezusit në vargun 48?
3. Çfarë veprime tjera të Jezusit shohim ne? Si ndikoi kjo tek dishepujt?
4. Çfarë arriti Jezusi në vargun 53?
5. Pse mendoni që dishepujt nuk dolën mirë në këtë sprovë?

Kur Perëndia lejon që të sprovohet besimi ynë, ne mund të jemi të sigurt për disa gjëra:

- Ai e di se ç’jemi duke kaluar Ai ka lejuar që ne të përjetojmë këtë sprovë të besimit tonë. Asgjë nuk ndodh në jetën e besimtarit pa lejen e Atit. Perëndia nuk e çon dëm dhimbjen në jetën e besimtarit, mirëpo e përdor atë për qëllimet e Tij.
- Ai na sheh neve. Ai i njeh rrethanat tona dhe Ai kujdeset.
- Ai vjen pranë nesh. Ai nuk na lë vetëm. Ai premton që kurrë nuk do të na lë dhe kurrë nuk do të na braktis.
- Ai futet në barkë me ne. Ai na ngushëllon me paqen dhe me praninë e Tij.
- Ai na sjell të sigurt në anën tjetër të bregut.

Besimi ynë do të sprovohet vazhdimisht nëpërmjet përvojave të ndryshme ku na jepet rasti që t'i besojmë Perëndisë. Disa nga dishepujt ishin peshkatarë me përvojë, megjithatë ata u ballafaquan me një situatë që tejkaloi burimet e tyre njerëzore. Ata po mbaheshin në vela, dhe erërat ishin kundër tyre. “Vetëm kur ndodhemi jashtë burimeve njerëzore, ne mësojmë të vërtetën që Perëndia është i mjaftueshëm”⁶

Një grua shkruan,

Ky tregim më ka dhënë paqe kur po ballafaqohesha me diagnozën e kancerit. Kur isha në spital pas operacionit, e lexova këtë tregim, dhe ndonjëherë ndodh që gjërat në Bibël bëhen më të qarta gjatë një krize. Kur po mendoja për këtë tregim, e kuptova që kancerin nuk e kisha aksidentalisht; ishte pjesë e planit të Perëndisë për mua. Më kujtoi që Ai kujdeset, që Ai është çdo herë me mua. Pasi kam kaluar një operacion dhe një hemoterapi të vështirë, tani mund të kthej kokën mbrapa të shikoj atë që kam mësuar nga kjo përvojë. E di që për asnjë moment nuk kam qenë e vetme në barkë.⁷

Ashtu siç u ngushëlluan dishepujt nga prania e Jezusit, po kështu mund të kemi edhe ne sigurinë që Ai do të jetë me ne në mesin e çdo stuhie që përballemi. Ai mund të na jap neve një paqe të tillë që ne asnjëherë nuk do të ishim në gjendje ta prodhonim në veten tonë. Teksa Jezusi i përgatiti dishepujt e Tij për kthimin e Tij tek Ati, Ai i qetësoi zemrat e tyre me këtë premtim tek Gjoni 14:27, “Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po ju jap, po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë.”



Lexoni Filipianëve 4:6-7. Si na ndihmojnë këto vargje që të merremi me shqetësimin?



Nëse je duke u ballafaquar me një stuhi, të brendshme apo të jashtme, imagjino Jezusin duke ardhur dhe duke hyrë në barkën tuaj. Kërko nga Ai që të t'i marrë frikërat, ta qetësojë stuhinë, dhe që të të sjellë të sigurt në anën tjetër të bregut. Mendo si mund ta ndash përvojën tënde me të tjerët për t'i inkurajuar ata.

Sprova më e madhe e besimit

Teksa dishepujt po ecnin me Jezusin, papritmas rruga e tyre u kthye drejt Jerusalemit, ku mësuesi i tyre i dashur do të arrestohej, fishkëllehej, dhe të kryqëzohej në një kryq prej druri të fortë.



1. Si mendoni se u sprovua besimi i dishepujve kur Jezusi i tyre i dashur u muar që të mundohej dhe që të kryqëzohej?

2. A mendoni se kjo ishte sprova më e madhe e besimit të tyre? Nëse po, pse, dhe nëse jo, pse?



Lexoni këto të dhëna që përshkruajnë ringjalljen e Jezusit tek Lluca 24:1-27 dhe Gjoni 20:24-31.

1. Përshkruani reagimin e dishepujve ndaj ringjalljes së Jezusit.

2. Mendo në lidhje me ndonjë situatë kur ti e ke pasur të vështirë që të besosh. Shpjego procesin në të cilin ke kaluar

3. Cila mendon se është rëndësia te Gjoni 20:29 për ne sot?

Sprova e besimit të dishepujve vazhdoi përgjatë ditëve të errëta të kryqëzimit dhe edhe përballë realitetit të pranisë së Jezusit të ringjallur. Duket e befasishme që ata e kishin të vështirë të besonin, edhe përkundër gjithë asaj që kishin përjetuar me Krishtin dhe gjithë atyre demonstrimeve të fuqisë së Tij që ata kishin parë. Sikur dishepujt, edhe ne e kemi po aq të vështirë që të besojmë. Sa shumë dëshirojmë që të shohim prova të dukshme, të përjetojmë një mrekulli aq të fuqishme e cila do të na bind që të besojmë, të kemi një përgjigje të lutjes aq të dukshme sa të bindemi që është nga Perëndia, një prani hyjnore për të na bindur neve një herë e përgjithmonë për të vërtetën që jemi thirrur ta besojmë. Në fakt ky është qëllimi i besimit. Të shikuarit nuk është të besuarit. Të shikuarit është të shikuarit. **Besimi kërkon që ne të kemi dëshirë të besojmë kur nuk shohim, dhe Jezusi na quan të “lumtur” kur jemi në gjendje ta bëjmë një gjë të tillë, të mbështetmi në krahët e Tij të përjetshëm dhe thjeshtë të besojmë.**

Dishepujt më në fund e mësuan mësimin. Jezusi pas ringjalljes së Tij, qëndroi mjaft gjatë në tokë që t’i bindte ata. Me plot durim Ai e lejoi Tomain që t’i prekte plagët e duarve të Tij të tejshpuara nga gozhdët. Realiteti i Krishtit të ngritur ishte ngulitur në mënyrë të pashlyeshme në secilin prej tyre. Ata, si rezultat i besimit të tyre në Jezusin, vazhduan duke kryer shumë vepra të mrekullueshme. Ata i besuan Atij deri në atë masë sa që e vunë jetën e tyre në rrezik për kauzën e Tij, duke pritur me padurim ribashkimin e bekuar në qiell me Jezusin. Ata që Jezusi i kishte qortuar për mungesë të besimit, mësuan t’i besojnë Perëndisë. Ata mësuan që, kur burimet e tyre njerëzore nuk mjaftonin, Perëndia ishte i mjaftueshëm. Besimi që ata shfaqën ishte ngjites (*infektues*). Krishterimi u bë një lëvizje që kapërceu shekujt dhe kontinentet me anë të mesazhit të tij të gjallë të shpresës dhe jetës së amshueshme.

Si besimtarë ne kemi thjeshtë shumë raste për t’i besuar Perëndisë dhe Fjalës së Tij. Disa nga këto fusha janë:

- T'i besoj Perëndisë për të siguruar për mua dhe familjen time
- T'i besoj Perëndisë për të bërë më të mirën për mua
- T'i besoj Perëndisë që të punojë në jetët e atyre që dua
- T'i besoj Perëndisë që t'i drejtojë hapat e mi dhe të më tregojë çfarë të bëjë
- T'i besoj që Perëndia është i mirë dhe një At i dashur edhe në mesin e vështirësive
- T'i besoj Perëndisë kur Ai thotë “jo” apo kur nuk i përgjigjet lutjeve të mia ashtu siç dua
- T'i besoj Perëndisë që Ai më fal kur unë pendohem dhe rrëfhem
- T'i besoj Perëndisë kur jam i dobët, kur përballem me vuajtjen apo vdekjen



A mund të mendosh për fusha të tjera ku ti je thirrur që t'i besosh Perëndisë? Cila nga këto fusha paraqesin vështirësinë më të madhe për ty në fushën e besimit? Bazuar në këtë mësim çfarë mund të bësh që ta rrisësh besimin tuaj?

Rezultati i Sprovës

Mënyra se si reagojmë kur ballafaqohemi me problemet, mund t'i sjell nder Jezus Krishtit dhe kjo është një mënyrë se si mund ta lejojmë dritën tonë të shkëlqejë në botën për rreth nesh. Të krishterët përballen me po të njëjtat probleme dhe sëmundje që edhe jobesimtarët përjetojnë, kështu, bota mund të vërejë dallimin në mënyrat se si në reagojmë.



Lexoni Jakobi 1:1-8 dhe 1 Pjetri 1:3-9.

1. Cilat janë rezultat e sprovimit të besimit tonë?
2. Si të inkurajojnë këto vargje?



1. Duke u mbështetur në atë që ke mësuar në këtë mësim, shpjego se si rritet besimi.
2. Përse është sprovimi i besimit i nevojshëm?
3. Si është duke vepruar Perëndia në jetën tënde për të rritur besimin tuaj?

Besimi dhe dyshimi

Shumë njerëz mendojnë që dyshimi është e kundërta e besimit, mirëpo **e kundërta e besimit është mosbesimi, refuzimi kokëfortë për të besuar**. Besimi është të ecurit me Perëndinë pa i pasur të gjitha përgjigjet. Në Bibël ne shohim se ndjekësit e Perëndisë shpesh luftojnë me dyshimin. Davidi dyshoi te Perëndinë, kur e pyeti, “Perëndi, ku je?” në mesin e kohëve të vështira. Shpesh ai fillonte një psalm me pyetje të tilla mirëpo i përmbyllte ato

me një pohim të besimit. Gjon Pagëzori me siguri është përballur me dyshime serioze kur po lëngonte në burg, duke pandehur nëse ishte aty për arsyen e duhur: Në fund të fundit, a ishte Jezusi, Mesia i premtuar?

Si këta ndjekës të Perëndisë, ne të gjithë gjatë përvojës sonë si të krishterë përballemi me kohë të dyshimit. Ne do të kemi shumë pyetje të papërgjigjura. Këto ne vetëm mund t'i sjellim te Perëndia. Elizabeth Elliot ka thënë, **“Besimi nuk i eliminon pyetjet. Por, besimi e din ku t'i kërkojnë ato.”**⁸ Po si psalmisti ne mund të shkojmë vrap tek Perëndia dhe t'i derdhim zemrat tona para Tij, duke kërkuar përgjigje nëpërmjet Fjalës së Perëndisë dhe në lutje. Ne gjithashtu mund kërkojmë këshillën e burrave dhe grave të perëndishëm, të cilët kanë përjetuar sprovat e besimit dhe të cilët inkurajohen dhe ngushëllohen nga përvojat e tyre personale me Perëndinë.



Lexoni Marku 9:14-29.

1. Si e shprehu babai besimin dhe dyshimin e tij?
2. Përse është sinjeriteti me Perëndinë i rëndësishëm kur ne dyshojmë?
3. Si reagoi Jezusi ndaj besimit të kufizuar të këtij babai?
4. Si mendon që Perëndia do të përgjigjet nëse je i singertë rreth dyshimeve tua?



Një shkrimtar – mësues John White komenton, “Kur e dyshoni Perëndinë, ju jeni duke dyshuar dy gjëra rreth Tij: fuqinë e Tij dhe dashurinë e Tij. Ti ose dyshon nëse Ai mund të të ndihmojë, ose dyshon nëse Ai do të të ndihmojë.”⁹

- Reflekto mbi thënien e White-it në lidhje me dyshimin. A mund të kujtosh ndonjë përvojë kur ti e ke vënë në dyshim një ndër këto aspekte të karakterit të Perëndisë? Çfarë të ka ndihmuar gjatë kësaj kohe? Si mendon t'i luftosh dyshimet dhe pyetjet e papërgjigjura?
- Përshtuaj një rast kur ti ke luftuar me dyshimin.
- Shëno një premtim nga Fjala e Perëndisë që të ka forcuar në atë rrethanë të vështirë.
- Si je inkurajuar në kohë të dyshimit nga ndonjë besimtar tjetër apo nga ndonjë shembull i ndonjë karakteri biblik?

Shpërblimi i besimit

Hebrenjve 11 është një ndër kapitujt klasik të Biblës që flet për besimin, që përmban shembuj të shumë burrave dhe grave të besimit të cilët zgjodhën t'i besojnë Perëndisë dhe të cilët përjetuan sprovimin e besimit të tyre.

Tek Hebrenjve 11:1 ne lexojmë, “Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, tregim i gjërave që nuk shihen.” Këto fjalë nuk janë një përcaktim i plotë i besimit. “Ato tregojnë çfarë është besimi, mirëpo nuk tregojnë krejtësisht se çfarë ai është.”¹⁰ Dy aspekte të “gjërave që nuk shihen” janë: besimi në të padukshmen, botën shpirtërore, dhe besimi në premtimet e së ardhmes që akoma nuk janë përmbushur. Besimi përfshinë një bindje të fortë që ekziston një botë e padukshme dhe se ia vlen të jetohet për këtë botë të padukshme, e cila ka më shumë vlerë se sa bota aktuale të cilën e jetojmë.



Lexoni kapitullin 11 të Hebrenjve.

1. Çfarë sprova të besimit ballafaquan këto gra dhe këta burra?
2. Cilat ishin qëndrimet dhe besimet e tyre të përbashkëta?
3. Si të inkurajon Hebrenjve 11 që të rritesh në besim?
4. Çfarë komente bën autori në lidhje me këta burra dhe këto gra (v.38)?



1. Zgjidh një karakteristikë të Hebrenjve 11 për studim të mëtutjeshëm.
2. Lexo pasazhet e Dhiatës së Vjetër mbi jetën e këtij personazhi dhe shkruaj mendimet e tua mbi sprovat e besimit, dyshimeve dhe zgjedhjet që ky individ ballafaqoi.
3. Çfarë e shtyu këtë individ që të rritet në besim?
4. Cilat janë parimet e këtij individi që ti ke identifikuar në lidhje me jetën e tij, parime të cilat ti mund ti aplikosh në jetën tënde?

Përgatitu t’i ndash disa nga përshtypjet tua me grupin.

Autori i Hebrenjve e përsërit çështjen e ngritur më herët që të gjithë këta burra e gra morën miratimin me anë të besimit, edhe pse ata nuk jetuan që të shohin premtimet e Perëndisë që të përmbusheshin gjatë jetës së tyre. Teksa shikojmë këtë kapitull, bëhet e qartë se besimi në Perëndinë është mjeti i vetëm për të fituar miratimin e Perëndisë.

Ne shohim se shumë veprime i atribuohen besimit. Besimi në Perëndinë ishte motivimi për secilën zgjedhje dhe veprim të bindjes nga ana e këtyre burrave dhe grave. Secili nga këto veprime të besimit regjistrohet me shumë kujdes në faqet e Dhiatës së Vjetër, por gjithashtu ato janë të regjistruara në librin e kujtimit të Perëndisë. Në këtë kapitull i shohim lidhjet e ngushta të besimit dhe veprave të bindjes. Në të vërtetë, besimi dhe bindja janë të pandashme. Bindja është dukshmëria e besimit të brendshëm. Besimi i vërtetë shfaqet në veprimet dhe zgjedhjet që bëjmë.

**Besimi në Perëndinë
është mjeti i vetëm për të
fituar miratimin e Tij.**

Këta burra dhe gra bënë zgjedhje, shpesh zgjedhje shumë të vështira, për të ndjekur rrugën e Perëndisë. Ata shikuan përtej rrethanave të vështira të kësaj jete drejt një vendi shumë më të mirë që po i pristte ata. Zgjedhjet e tyre bazoheshin në besimin e tyre në Perëndinë, duke besuar që besimi i tyre do të sillte miratimin dhe shpërblimin e Tij. Për këtë arsye, besimi biblik, duke mos qenë aspak ndonjë përvojë subjektive apo ndjenjë emocionale, është më tepër një vendim i vullnetit. Sprova më e lartë e besimit tonë shihet në zgjedhjet tona.

Një aspekt tjetër i besimit të këtyre burrave dhe grave shprehet në qëndrimin e tyre duke e konsideruar veten si të huaj në këtë tokë. Disa prej tyre vërtetë jetuan në tenda, por të gjithë patën një qëndrim se ata ishin pelegrin, si një që është duke ecur drejt një botë. Ata nuk ishin domosdoshmërisht të varfër, mirëpo nuk ishin aq shumë të lidhur me këtë botë.

Kur Perëndia vërejti secilin akt të bindjes që erdhën si rezultat i besimit, ne mund të jemi të sigurt se Ai e sheh besimin tonë, të shprehur në zgjedhjet e mëdha apo të vogla, të cilat reflektojnë besimin tonë që Perëndia ekziston, që Krishti po na pret në qiell, që bota që do të vijë është një vend i vërtetë, ku ne do të marrim shpërblimin e besimit tonë. Ne do të shpërblehemi për çdo gjë që kemi rezistuar për Krishtin dhe për çdo gjë që kemi bërë me anë të besimit në Të dhe nga dëshira për ta kënaqur Atë.



Nga ajo që ke mësuar në këtë mësim në lidhje me atë se si rritet dhe sprovohet besimi, si mund t'i përshkruash mënyrat se si Perëndia është duke e rritur dhe sprovuar besimin tënd në këtë moment? Si ke reaguar ti?

Çfarë mendime të reja ke në lidhje me të jetuarit si një i huaj në këtë tokë? Kur vështron jetën tënde të krishterë, cilat zgjedhje apo veprime të besimit mund të regjistroheshin në librin e kujtimeve të Perëndisë?



Falëndero Perëndinë për besnikërinë e Tij. Kërko nga Ai që të të ndihmojë që të jetosh jetën me anë të besimit, duke i besuar Atij çdo ditë teksa nxjerr çdo hap të besimit, dhe zgjedh t'i besosh Atij dhe t'i ndjekësh rrugët e Tij.

Mendime përmbyllëse

Ne kemi parë që besimi është thjesht të besuarit në personin e Perëndisë dhe në Atë që Ai thotë dhe që gjithashtu përfshinë edhe një përgjigje nga ana jonë. Besimi ynë është një besim i arsyeshëm, që mbështetet në të vërtetën e Fjalës së Perëndisë dhe dëshmisë objektive të shumë dëshmitarëve mbi vdekjen dhe ringjalljen e Jezus Krishtit. Ne kemi parë që pa besim është e pamundur ta kënaqim Perëndinë dhe që Perëndia dëshiron që besimi ynë të rritet.

Përgjatë jetës sonë teksa ecim me Jezusin, besimi ynë do të sprovohet dhe zhvillohet. Ne do të kemi raste për të marrë shumë hapa të vegjël të besimit, duke shkuar drejt thellimit të besimit. Sa më shumë që arrijmë ta njohim Perëndinë, aq më shumë do t'i besojmë dhe do t'i bindemi Atij. Sa më e thellë që bëhet ecja jonë me Perëndinë, aq më tepër ne do t'i kthejmë sytë tanë drejt qytetit qiellor, ku do të shijojmë të qenët në praninë e Perëndisë përgjithmonë.

Fusnotat

¹ *Random House Dictionary of the English Language* (New York: Random House, 1968).

² Leon L. Morris, "Faith," in *New Bible Dictionary*, ed. J. D. Douglas, 2d ed. (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1982), 366-67.

³ J. I. Packer, *God's Words* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1981), 132-34.

⁴ Francis A. Schaeffer, *The Complete Works of Francis A. Schaeffer: A Christian World View, Vol. 1: A Christian View of Philosophy and Culture, Book 3: He Is There and He Is Not Silent* (Westchester, IL: Crossway, 1982), 351.

⁵ John Ortberg, *The Life You've Always Wanted: Spiritual Disciplines for Ordinary People* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1997), 210.

⁶ Ibid.

⁷ Autorja preferon të ngelet anonime

⁸ Elisabeth Elliot, *A Chance to Die* (Old Tappan, NJ: Revell, 1987), 55.

⁹ John White, *The Fight: A Practical Handbook for Christian Living* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1976), 105.

¹⁰ J. Gresham Machen, *What is Faith?* (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1925), 229.

Duke ecur me Udhërrëfyesin tonë

Marko e la atdheun e tij vitin e kaluar në mënyrë që të sigurojë një jetë më të mirë për veten e tij dhe që t'i ndihmojë familjes së tij në shtëpi, të cilët janë duke jetuar në varfëri të skajshme. Ai ka qenë duke u lutur që Perëndia do t'i tregonte rrugën, duke i siguruar atij një punë dhe një gjendje të mirë për të jetuar. Deri më tani nuk është shfaqur asnjë rast i vërtetë, dhe Marko mezi po e shtyn jetën. Ai ndjehet i zhgënjyer. Mbrëmë në një piceri ai u takua me një grua shumë të këndshme, dhe ajo ishte personi i parë e cila u shqetësua për situatën e tij. Ajo i ofroi atij një vend për të jetuar, një dhomë në banesën e saj të vogël. Ai mendon me vete, nëse ajo është përgjigja e lutjeve të tij. Si mund t'i vinte ndryshe një rast i tillë?

Çfarë pikëpamje të drejtimit ka Marko në fillim? Çfarë rreziqe të mundshme ka ai përballë në këtë situatë? Si do ta inkurajonit Markon që të gjente drejtimin?



Si na drejton Perëndia neve? Si e dallojmë vullnetin e Perëndisë në vendimet që marrim çdo ditë gjatë jetës sonë? A ka Perëndia një vullnet individual për secilin prej nesh në secilin vendim që ne marrim? A u flet Perëndia besimtarëve sot drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë personale? Këto janë pyetjet të cilat do t'i trajtojmë në këtë mësim.

Përmbledhje e mësimit

Premtimi i drejtimit
Mjetet e drejtimit
Fryma e Shenjtë, Udhërrëfyesi ynë
Libri udhëzues i Perëndisë
Disa shtylla për të na drejtuar neve
Kushtet për pranimin e udhëheqjes
Bindja
Përvulësia
Kur nuk vjen asnjë lloj drejtimi
Pyetje rreth drejtimit

Vullneti individual i Perëndisë për besimtarin
Përgjigja ndaj një dere të hapur
Përdorimi jo i duhur i Biblës
Mjetet e ndaluara të drejtimit
Roli i zgjedhjes
Marrja në konsideratë e pasojave të zgjedhjeve tona
Pasoja të zgjedhjeve të gabuara
Hapat për të njohur vullnetin e Perëndisë
Mendime përmbyllëse

Qëllimet e Mësimit

Kur ta keni përfunduar këtë mësim, ju do të jeni në gjendje që:

1. Të bëni një përmbledhje të dëshmisë biblike të premtimit të Perëndisë për të drejtuar fëmijët e Tij.
2. Të diskutoni rreth pesë mënyrave të përcaktimit të drejtimit të Perëndisë dhe kushteve të nevojshme për marrjen e drejtimit.
3. Të vlerësoni gjërat që ndërlidhen në kërkimin e drejtimit nga Perëndia, si: vullneti i Perëndisë për besimtarin individual, përgjigja ndaj një dere të hapur, përdorimi jo i duhur i Biblës, dhe mjetet e ndaluara të drejtimit.
4. Të shpjegoni lidhjen në mes të zgjedhjeve dhe pasojave tona.
5. Të vlerësoni se si e përcaktoni vullnetin e Perëndisë, me anë të aplikimit të sugjerimeve dhe pyetjeve praktike për të të drejtuar në marrjen e vendimeve tuaja.

Premtimi i drejtimit

Mbase e vërteta e parë që ne duhet të nxëmë në lidhje me drejtimin është ky: **Perëndia dëshiron që t'i drejtojë fëmijët e Tij.** Ai nuk na liron nga fuqia e Satanit, vetëm sa për t'u endur nëpër botë të vetëm.



Shikoni vargjet në vijim dhe bëni një përmbledhje në lidhje me atë se çfarë na mësojnë këto vargje rreth udhëheqjes:

- Eksodi 15:13
- Psalmi 32:8-9
- Fjalët e Urta 3:5-6
- Isaia 58:6-11
- Gjoni 10:3

Mjetet e drejtimit

Libri i Eksodit i Dhiatës së Vjetër ofron një pamje të bukur të kujdesit dhe të udhëheqjes së Perëndisë për popullin e Tij. Si robër në Egjipt, populli hebre përjetoi shtypje dhe vuajtje, dhe ata e ngritën zërin e tyre drejt Perëndisë. Ai e dëgjoji vajin e tyre dhe u përgjigj duke u dërguar një shpengues, Mojsiun, i cili është një pamje e Krishtit. Pas një serie plagësh, Faraoni, mbreti i Egjiptit, ra në gjunjë përpara Perëndisë së Izraelit dhe e liroi popullin e Perëndisë që të shkonte. Kur ata e lanë Egjiptin, Perëndia bëri edhe një gjë tjetër të mrekullueshme. Ai u dha atyre një shenjë të dukshme të pranisë së Tij me ta – ditën një kolonë reshë për t'i udhëhequr në rrugë, dhe natën një kolonë zjarri për t'u bërë atyre dritë, që të mund të ecnin ditën dhe natën (Eksodi 13:21-22; Nehemia 9:19-20).

Imagjinoi për një moment sikur ju të ishit një ndër njerëzit e popullit hebre. Kur jeni të frikësuar dhe të shqetësuar në lidhje me qëndrimin në shkretëtirë, në një vend të huaj ku ka shumë rreziqe, ju mund të hapni dritaren e portës suaj dhe të shikoni zjarrin e Perëndisë duke u djegur gjatë natës apo renë e pranisë së Tij përgjatë ditës. Ju mund të flini në paqe, edhe pse e ardhmja është e panjohur, sepse vetë prania e Perëndisë është në mesin tuaj. Kur shikoni se reja fillon të ngrihet dhe të lëviz, ju e dini se ky është drejtimi në të cilin ju duhet të ecni.

Sa do të donim të kishim këtë pamje nga dritarja jonë sa herë që të zgjoheshim çdo mëngjes, duke qenë në gjendje të shikonim dhe vërenim renë që shndritë dhe t'i themi vetes “Ah, Ai është akoma këtu. Unë dhe familja ime do të jemi të sigurt. Perëndia është duke na drejtuar.”

Fryma e Shenjtë, Udhërrëfyesi ynë

Neve nuk na është dhënë një prani e dukshme e Perëndisë, mirëpo Dhiata e Re e bënë të qartë se neve na është dhënë një privilegj shumë më i madh se kaq.



Lexoni Gjoni 14:16-27. Këto vargje regjistrojnë fjalët e Jezusit që u kishte drejtuar ndjekësve të Tij para kryqëzimit.

1. Çfarë premtime u kishte dhënë Ai atyre?
2. Si mendoni që këto premtime i kanë mbajtur ata më vonë gjatë jetës?

Mu në prag të kryqëzimit të Tij, Jezusi po shqetësohej rreth ngushëllimit të dishepujve të Tij, dhe ngushëllimin më të lartë që Ai u ofroi atyre ishte dërgimi i Frymës së Shenjtë, vetë personi i Perëndisë, i cili do të jetonte me ta. Ky ishte një realitet më i lartë se sa kolona e resë në mesin e kampit izraelit. Ky

Një të krishterë i është
dhënë... prania e
Frymës së Shenjtë
përbrenda.

ishte një premtim i Perëndisë së gjallë i cili do të vinte për të jetuar **brenda** besimtarit. Paqja të cilën Jezusi u premtoi dishepujve në prag të kohës më të vështirë të jetëve të tyre ndërlidhej me praninë e Frymës së Shenjtë në jetët e tyre. Një të krishteri i është dhënë më shumë mundësi se sa populli hebre kishte: e që është prania e Frymës së Shenjtë që e drejton përbrenda.

Dhiata e Re na tregon që Fryma e Shenjtë na udhëheq drejt së vërtetës së Perëndisë nëpërmjet së cilës Ai do të drejtojë jetët tona.¹ Fryma e Shenjtë i njeh të gjitha mendimet e Perëndisë. Nëpërmjet Tij ne mund t'i kuptojmë ato mendime të Perëndisë që na janë zbuluar neve, në mënyrë që të kemi mundësi t'i zbatojmë ato në jetën tonë. **Fryma gjithmonë do të na drejtojë në atë drejtim që është në përputhje me të vërtetën e zbuluar në Fjalën e Perëndisë.** Mëkati shpesh na e përdredh perceptimin e së vërtetës, shpesh duke e bllokuar atë plotësisht. Nëse me të vërtetë dëshirojmë të udhëhiqemi nga Fryma e Shenjtë dhe të dallojmë të vërtetën nga gënjeshtra, ne duhet ta njohim Fjalën e Tij si dhe të mbajmë një ecje të ngushtë dhe të qëndrueshme me Perëndinë.

Nëpërmjet shërbesës së Frymës ne rritemi në besim dhe në njohurinë tonë për Perëndinë. Nëpërmjet po kësaj shërbeje ne sillemi ballë për ballë me fushat problematike të jetës sonë. Fryma ndriçon dritën e Tij mbi nevojat, dobësitë dhe mëkatet e jetës sonë, aty ku mund të zbatojmë të vërtetën që Fryma na ka bërë të qartë nëpërmjet Fjalës.

Ne mund ta paramendojmë Frymën e Shenjtë duke ecur nëpër dhomat e jetës sonë me llambën e Fjalës së Perëndisë, duke na tërhequr vëmendjen tek fjala e rëndë që kemi thënë dje apo tek ajo ndjenjë e zemërimit që mund të jetë duke zier brenda nesh. Perëndia dëshiron që ne të kemi një zemër të butë, një zemër të atillë e cila është në gjendje ta dëgjojë zërin e butë të Frymës. Ashtu si psalmisiti edhe ne mund të lutemi: “Më heto, o Perëndi, dhe njëje zemrën time; më provo dhe një mendim të mia dhe shiko në se ka tek unë ndonjë rrugë të keqe dhe më udhëhiq nëpër rrugën e përjetshme.” (Ps 139:23-24).

Si besimtarë, ne duhet ta shikojmë Frymën e Shenjtë si drejtuesin tonë dhe të kërkojmë nga Ai që të drejtojë hapat tonë dhe që të ndriçojë shtegun tonë për çdo ditë. Ai është udhërrëfyesi ynë për tërë jetën.

Libri udhëzues i Perëndisë

Jo vetëm që na është dhënë dhurata e Frymës së Shenjtë, por gjithashtu na janë dhënë edhe vetë fjalët e Perëndisë për të na drejtuar. Udhëzuesi kryesor i Perëndisë për një të krishterë është Fjala e Tij – Bibla. Në këtë libër Ai na ka dhënë parime për të udhëhequr sjelljen dhe të menduarit tonë. Fjala e Tij na tregon se si duhet të jetojmë dhe si t'i japim formë të menduarit tonë. Bibla na jep udhëzime të përgjithshme që

ndikojnë të gjithë jetën dhe i ofrojnë besimtarit një kornizë të qartë për të njohur dhe për të kryer vullnetin e Perëndisë ashtu siç është zbuluar në Shkrim.



Lexoni 2 Pjetri 1:21.

1. Çfarë lidhje ka Fjala e Perëndisë me Frymën e Shenjtë?
2. Çfarë përfundimi mund të nxirrni nga kjo?

Fryma e Shenjtë ishte ndërmjetësi që frymëzoi njerëzit për të shkruar fjalët që ruhen në Bibël, kështu këto fjalë gjithmonë do të korrespondojnë me udhëheqjen e Frymës së Shenjtë brenda nesh, sepse Perëndia nuk mund ta kundërshtojë Vetveten.



Lexoni Psalmin 43:3-4 dhe Psalmin 119:105.

1. Si ndërlidhen këto vargje me drejtimin?
2. A mund të kujtosh ndonjë rast kur Fjala e Perëndisë të ka dhënë dritë në lidhje me atë se si të veprosh në një situatë të caktuar?

Kështu, Bibla është mjeti
primar me anë të së cilit
Perëndia na e zbulon vullnetin e
Tij dhe themelet për zgjedhjet
tona më të rëndësishme.

Kështu, Bibla është mjeti primar me anë të së cilit Perëndia na e zbulon vullnetin e Tij dhe themelet për zgjedhjet tona më të rëndësishme. Kur përballemi me vendimet që kanë të bëjnë me mënyrat se si të kalojmë kohën apo cilat raste t'i pranojmë, atëherë mund ta pyesim veten, “A është ky rast në pajtim me vullnetin e Perëndisë, ashtu siç e kam parë atë në Shkrim?”

Çdo gjë që është në kundërshtim me Fjalën e Tij apo urdhërimet e Tij nuk mund të jetë një komunikim nga Zoti. Ne nuk duhet të pranojmë udhëheqje personale të ndarë apo kontradiktore nga Perëndia në rastet kur drejtimi i Tij specifik veçse është konstatuar qartë në Bibël. Në fushat ku Ai tashmë ka folur, nuk ka nevojë që Ai të flas sërish. Në një pikë të tillë të jetës sonë, Perëndia pret që ne të bëjmë zgjedhjen në pajtim me vullnetin e Tij që na është zbuluar. Ne jemi të thirrur që të marrim vendime të matura, të mençura dhe të përgjegjshme.

Për shembull, Perëndia tanimë na ka udhëzuar që të martohemi “vetëm në Zotin.” Prandaj, që një besimtar të lutet dhe të pyes nëse është e drejtë të martohet me një jobesimtar, pa marrë parasysh se cila mund të jetë rrethana ekzistuese, është e kotë. Në raste të tilla, udhëheqja veçse është dhënë që më përpara. Njëjtë, nuk ka fare kuptim ta

pyesim Perëndinë nëse është në rregull që të kemi një aferë jashtë martesës, sepse Perëndia në mënyrë specifike e ka ndaluar tradhtinë bashkëshortore.



1. Mendo në lidhje me dy apo tre shembuj të tjerë ku udhëzimet e Perëndisë janë të qartë dhe për çka është fare e kotë të lutemi për udhëheqje.
2. A mund të mendosh për ndonjë kohë kur ke kërkuar udhëheqje nga Perëndia, duke e ditur që Fjala e Tij kishte caktuar një standard të qartë që ti t'i bindeshe atij? Shpjego.

Një rregull i mirë për t'u mbajtur mend është ky: **Nëse e kundërshton Fjalën e Perëndisë, atëherë është e qartë se nuk është nga Perëndia, sepse Perëndia asnjëherë nuk e kundërshton Vetveten.**

Në kërkimin e udhëheqjes, ne sërish e shohim rëndësinë e Fjalës së Perëndisë. Bibla është Fjala e pagabueshme e Perëndisë, udhëzuesi ynë në çështjet praktike dhe ato të besimit. Është regjistri i shkruar për atë që Perëndia ka thënë për përfitimin e tërë njerëzimit. Aty mund të gjinden urdhërime të drejtpërdrejta si dhe parime për jetesën. Shumë tregime na shërbejnë për të ilustruar aplikimin e këtyre parimeve. Bibla është aq gjithëpërfshirëse në mënyrat se si ne duhet të jetojmë, sa që duhet të na shërbejë si një manual parësor dhe themelor kurdo që jemi duke kërkuar udhëheqje nga Perëndia apo kurdo që jemi në situata kur jemi të pasigurt se si të veprojmë.

Kur Jezusi u ballafaqua me një situatë në të cilën djalli vendosi disa opsione para Tij, Ai përdori Fjalën e Perëndisë për të kundërshtuar secilin sugjerim të Satanait (Mat 4:1-11). Jezusi sigurisht që nuk i kishte marrë shkrimet me vete në shkretëtire. Ai e kishte studiuar dhe i kishte mësuar përmendësh këto pasazhe të Dhiatës së Vjetër, dhe ato ishin ngulitur në Të deri në atë masë sa që mund të ndikonin edhe të menduarit e Tij.

Nga ky shembull mund të shohim se është e rëndësishme të studiohet Bibla, të mbushet mendja jonë me të, të zhytemi në të deri në atë masë sa të jap formë edhe të menduarit tonë dhe pastaj ta aplikojmë atë në të gjitha situatat e jetës sonë. Kjo është rruga e parë ku ne gjejmë drejtimin dhe kështu vazhdojmë të ecim në rrugët e Perëndisë. Tek Kolosianëve 3:16 Pali thotë: “Fjala e Krishtit banoftë në ju me begatinë e vet.” Në të njëjtën kohë ne mbështetemi në premtimin që Fryma e Shenjtë është me ne dhe kërkojmë nga Ai që të na tërheq vëmendjen drejt gjërave që ne kemi nevojë t'i dimë në lidhje me trajtimin e çdo situatë.



- Sa jeni në dijeni për praninë e Frymës së Shenjtë në jetën tënde për çdo ditë? Si mendon që kjo dijeni ndikon jetën tënde? Çfarë mund të bësh për ta ngritur nivelin e dijenisë tënde për praninë e Tij dhe për të qenë me i/e hapur për drejtimin e Tij?
- Përshkruaj një kohë në të kaluarën e afërt kur një pasazh nga Shkrimi të ka dhënë drejtim në një situatë të caktuar. Përshkruaj se si e ke kuptuar që ka qenë Fryma e Shenjtë që të ka folur përmes Fjalës së Tij.
- Përkushtohu që ta bësh zakon që të kërkossh nga Fryma e Perëndisë për të të udhëhequr ty.



Merr disa minuta dhe falënderoj Perëndinë që të ka dhënë drejtimin nëpërmjet Frymës së Shenjtë dhe Fjalës. Kërko që Fryma e Shenjtë të drejtojë hapat e tua sot.

Disa shtylla për të na drejtuar neve

Teksa Fjala e Perëndisë dhe prania drejtuese e Frymës së Shenjtë ofrojnë mjetet themelore të drejtimit në jetën e besimtarit, Bibla dëshmon se ekzistojnë edhe mjete të tjera që Perëndia përdor për të ndikuar hapat e një besimtari.

Në Dhiatën e Re, tek Hebrenjve 1:1, ne lexojmë, “Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve” Shpesh Perëndia ka përdorur ëndrrat, vizionet, engjëjt dhe fenomene të pazakonshme për t’u dhënë njerëzve porositë e Tij. Bibla regjistron rastet kur Perëndia i ka folur popullit drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet ëndrrave dhe vizioneve. Përkundër kësaj, ne duhet të jemi të kujdesshëm që të mos pandehim se çdo lloj ëndrre është një porosi nga Perëndia.

Bibla potencon se për të na e tërhequr vëmendjen tonë Perëndia nuk përdor normalisht dhe shpesh mjete të këtilla. Kur Perëndia i foli Mojsiut prej shkurre së zjarrtë, ishin bërë 430 vjet prej kur Perëndia kishte folur në mënyrë të drejtpërdrejt kur i ishte shfaqur Jakobit në një ëndërr. Përgjatë tërë historisë biblike, Perëndia duket sikur e ka kufizuar përdorimin e mesazheve të drejtpërdrejta për t’u lidhur me njerëzit, kështu që ne duhet ta ushtrojmë kujdesin se si i interpretojmë përvojat e tilla.

Pasi që ne tani kemi një zbulim më të plotë të Perëndisë në krahasim me atë që besimtarët e Dhiatë së Vjetër kishin, duket sikur roli i ëndrrave, vizioneve dhe fenomeneve të tjera është zvogëluar për shkak të plotësimit të Shkrimeve të Dhiatës së Re. Hebrenjve 1 vazhdon të tregojë se së fundi Perëndia na ka folur në një mënyrë tjetër – nëpërmjet Birit të Tij. Në Krishtin ne kemi pranuar komunikimin e plotë me Perëndinë; njerëzimi pati mundësi ta shoh Vetë Perëndinë të mishëruar. Perëndia, në Personin e Jezus Krishtit ka zbuluar Vetën e Tij më shumë se kurdo herë më parë.

Teksa mendojmë për temën e drejtimit, është shumë e dobishme të shikojmë jetën e Krishtit. Si është drejtuar Ai nga Ati? Jezusi pranoi drejtimin nga Ati me anë të mjeteve të lutjes dhe mbështetjes në Shkrimet, në të njëjtën mënyrë siç bëjmë unë dhe ti. Askund nuk regjistrohet që Ai të ketë përjetuar ëndrra apo vizione. Sa herë që Ai kërkonte vullnetin e Perëndisë, Ai tërhiqej për t'u lutur.

Shumë njerëz pretendojnë të kenë marrë një fjalë të drejtpërdrejtë nga Perëndia apo të kenë pasur ndonjë ëndërr apo vizion ku mund të kenë marrë drejtime specifike. Problemi qëndron në vështirësinë për të bindur të tjerët në lidhje me përvojën personale. Nëse ti ke përjetuar atë që beson se ka qenë një komunikim i drejtpërdrejtë nga Zoti, çështja kyçe ngelet konfirmimi nëse ky lloj komunikimi ka qenë apo jo vërtetë nga Zoti. Për ta bërë këtë, ju duhet të përcaktoni nëse ky komunikim është në përputhje me atë që mësojnë Shkrimet dhe gjithashtu në pajtim me karakterin e Perëndisë. Nëse ke dyshime, do ishte e dobishme të flisni me ndonjë këshilltar të perëndishëm për ta diskutuar përvojën tuaj.

Përveç kërkimit të drejtimit nga Fryma e Shenjtë dhe Fjala e Perëndisë, ekzistojnë edhe disa shtylla të tjera drejtuese që mund të jenë të dobishme në këtë proces, e që janë faktorë si rrethanat, këshillimi i urtë, dhe marrja parasysh e dëshirave personale, aftësive dhe dhuntive shpirtërore.



Drejtim nëpër rrethana. Një njeri nuk ka nevojë të jetë i krishterë për një kohë të gjatë në mënyrë që të mahnet me providencën e Perëndisë dhe mënyrat se si Ai vepron nëpërmjet rrethanave. Bibla i referohet shpesh sovranitetit të Perëndisë mbi të gjitha gjërat (Fjalët e Urta 16:1-4, 9; 19:21). Perëndia duket se shpesh sjell njerëz në shtegun tonë apo organizon rrethana të atilla në mënyrë që të plotësohen qëllimet e Tij

Megjithatë besimi ynë në providencën e Perëndisë apo në vullnetin e Tij sovran nuk do të thotë se ne nuk duhet të planifikojmë me urtësi dhe të mos marrim vendime të kujdesshme dhe të urta, gjithashtu ne nuk duhet të pandehim se një rrethanë e dhënë duhet të jetë faktori i vetëm përcaktues ku ne kemi nevojë për udhëheqje.

Jezusi tregoi disa parabola kur Ai iu referua nevojës për të bërë një planifikim të urtë, siç është parabola e njeriut i cili dëshiroi të ndërtojë një kala (Ll 14:28-30) dhe shëmbëlltyra e dhjetë virgjërëshave (Mat 25:1-13). Është shumë e qartë Ai pret që ne të bëjmë plane.



Lexoni Lluka 12:16-21 dhe Jakobi 4:15.

1. Çfarë parime rreth planifikimit mund të gjeshe në këto pasazhe?

2. Ç'nënkupton të përfshish Perëndinë në planet e tua?
3. Cilat janë sugjerimet që merr nga këto parime në lidhje me planet që mund të jesh duke bërë?

Planifikimin që Jezusi kundërshtoi ishte ai që nuk njohte kontrollin e Perëndisë në jetët tona. Në sovranitetin e Tij, Perëndia mund të ndërhyjë në planet tona apo të lejojë që ato të kalojnë. Përcaktimi sovran i Perëndisë mund të zvogëlojë nevojën apo rëndësinë e planifikimit të urtë.

Kur shikojmë jetën e Palit, mund të shohim shumë raste kur ai kishte qëllime me diapazon të shkurtër, mirëpo edhe qëllime që kapnin një diapazon më të gjerë (Veprat e Apostujve 18:21; 19:21; 20:16; 1 Kor 4:19; 16:5-7). Shpesh Zoti lejoi këto qëllime që të arriheshin; në raste të tjera Perëndia ndërhyri dhe e lëvizi Palin në një drejtim tjetër nëpërmjet atyre rrethanave. Pali planifikoi mirëpo në anën tjetër gjithmonë e merrte parasysh të drejtën e Perëndisë për të ndërhy dhe për t'i ridrejtuar hapat e tij.

Besimi ynë në providencën e Perëndisë nuk ka për qëllim që të eliminojë zgjedhjen dhe përgjegjësinë njerëzore apo që të sugjerojë se ne vetëm duhet të ulemi dhe të presim që Perëndia të kap dhe të na drejtojë në një drejtim të caktuar. Providenca e Perëndisë thjesht vendos përpara nesh një sërë rrethanash, të cilat mund të interpretohen në shumë mënyra, nëse në rastin e kundërt nuk përcillen nga një zbulim i veçantë nga Perëndia apo zhvillime të mëtutjeshme të cilat e bëjnë të qartë se Perëndia dëshiron që ne të shkojmë në një drejtim të caktuar.

Jozefi është një ndër shembujt më të mirë për mënyrën se si punon Perëndia nëpërmjet rrethanave. Tek Zanafilla 29-45 ne e gjejmë tregimin mbi jetën e Jozefit. Si një djalë i ri ai ishte shitur si skllav nga ana e vëllezërve të tij. Duke u dërguar në Egjipt, ai përfundimisht u ngrit në një pozitë të mirë, dhe pastaj padrejtësisht u hodh në burg për shkak të akuzave të rrejshme të gruas së Potifarit.

Gjatë jetës së tij ne shohim shumë pak shenja që Jozefi te këtë pasur mundësi që të kuptonte përse po ndodhnin këto gjëra; ai thjeshte ia besonte veten e tij kujdesit të Perëndisë. Më vonë, kur vëllezërit e tij erdhën tek ai për të blerë ushqim për t'i mbijetuar zisë së bukës dhe kur ai u bashkua me familjen e tij, ai mund të kthente kokën mbrapa jetës së tij dhe t'u thoshte vëllezërve të tij, "Por tani mos u trishtoni dhe mos t'ju vijë keq që më shitët me qëllim që të çohesha këtu poshtë, sepse Perëndia më ka dërguar para jush për të ruajtur jetën tuaj." (Zan 45:5). Vetëm pasi kishin kaluar shumë vite, Jozefi mund të shikonte se si të gjitha gjërat kishin bashkëvepruar për mirë. Ai tani mund të shihte në retrospektivë përfitimin e gjithë asaj ndodhie, sepse Perëndia e kishte bërë një sundimtar në Egjipt në mënyrë që të përmbushte qëllimin e Tij për të shpëtuar popullin e Tij të zgjedhur.

Në retrospektivë Jozefi kishte mundësi të shikonte se si dora e Perëndisë ka qenë duke vepruar përgjatë tërë jetës së tij. **Ne nuk jemi gjithmonë në gjendje të kuptojmë dhe interpretojmë ngjarjet që ndodhin në jetët tona, gjithashtu nuk i shohim ato nga perspektiva e Perëndisë.**

Një shembull tjetër është tregimi i Ruthit dhe Naomit. Rrethanat e vështira e lanë Naomin vetëm, e cila kishte humbur bashkëshortin dhe të dy djemtë e saj. Në një moment ajo i kërkoi popullit të Bethlehemit ta quanin atë Mara, që do të thotë “e mbushur me hidhërim.” Teksa lexojmë tregimin, ne mund të vërejmë se Perëndia ka vazhduar të sigurojë për të dhe duke vepruar në jetën e saj dhe në jetën e Ruthit në atë mënyrë që të mund të përmbushte qëllimet e tij të mira, mirëpo Naomi në mesin e dhimbjes dhe humbjes nuk kishte mundësi ta vërente një gjë të tillë.

Si fëmijë të Perëndisë kur përjetojmë rrethana që Perëndia i lejon, ne duhet të kemi kujdes që të mos interpretojmë kuptimin e tyre në nguti. Shpesh herë këto ngjarje nuk mund të interpretohen deri sa nuk ka kaluar një kohë e mjaftueshme për të treguar qartë se çfarë ka qenë duke bërë Perëndia. Në disa raste, Perëndia mund të mos i zbulojë qëllimet e Tij prapa një ngjarjeje deri sa ta shohim atë sy më sy.

Jetët tona, secila prej tyre është si një qilim ithurur, me shumë fije të kryqëzuara dhe me shumë ngjyra të vendosura mbi vegun e mjeshtrit tëthurjes së qilimave. Këtu në tokë ne e shohim këtë qilim nga ana e kundërt, dhe shpesh duket se i mungon dizajni, duket si njëthurje e ngatërruar pa ndonjë bukuri apo qëllim. Mirëpo Perëndia është dukethurur diçka të një bukurie të rrallë, me një model të ndërlikuar i cili është unik për ne, dhe kur ta takojmë Atë ballë për ballë, ne do ta shohim këtë pjesë tëthurjes dhe ta kuptojmë se është i mbushur përplot me qëllim, hir dhe bukuri të paparë.



- Si të ka drejtuar Perëndia në të kaluarën nëpërmjet rrethanave? Cilat rrethana t'u janë dukur të vështira që t'i kuptosh apo shikosh si pjesë të planit të Perëndisë për jetën tënde?
- Si mund të inkurajohesh nga tregimet e Jozefit dhe të Naomit?
- Kur reflekton mbi qilimin e jetës tënde, çfarë mendon se Perëndia mund të jetë duke parë nga ana tjetër?



Falënderoj Perëndinë për mënyrat se si Ai e ka drejtuar shtegun tënd përgjatë rrethanave të jetës tënde personale.



Drejtimi nëpërmjet këshillimit të urtë. Një instrument tjetër që Perëndia përdor për të na drejtuar është këshillimi i urtë që marrim nga të tjerët. Ndonjëherë një grua apo një i burrë i perëndishëm mund të na ndihmojnë shumë, duke na ofruar të kuptuar të hollësishëm dhe biblik, që ne mund të mos e kemi, dhe gjithashtu duke na dhënë një perspektivë të freskët në mesin e problemeve tona.



Lexo tregimin e Nathanit dhe Davidit tek 2 Samueli 12:1-14.

1. Çfarë roli luajti profeti në këtë rast në jetën e Davidit?
2. Si do të kishte përfunduar ky tregim po qe se Nathani nuk do ta kishte konfrontuar Davidin?

Davidi vetë ishte ai që e kuptoi rëndësinë e shfrytëzimit të këshillimit të urtë (2 Sam 15:12, 31-37; 17:1-14), megjithatë në këtë rast ai ka ndjekur një rrugë të zgjedhjeve të liga dhe ka dështuar t'i drejtohet këshilltarëve të perëndishëm të cilët do t'i kishin ndihmuar atij që të mënjanonjë katastrofat në rrugën që ai kishte zgjedhur. Shumë mbretër të tjerë kishin përjetuar rezultate tragjike për shkak se kishin zgjedhur këshilltarë të gabuar (1 Mbret. 12:1-24), kështu ne shohim rëndësinë e zgjedhjes së dikujt që është i zgjuar në rrugët e Perëndisë, dhe jo thjeshtë një person i cili është shumë inteligjent apo i mençur.

Të kesh një këshilltar të mençur të cilit mund t'i drejtohesh, apo dikë që mund të na mësoj dhe të na mbajë të përgjegjshëm, është një përfitim shumë i lartë për çdo të krishterë. Tek 2 Mbretërve 12:2 ne lexojmë, “Joasi bëri atë që ishte e drejtë në sytë e Zotit për tërë kohën që udhëhiqej nga prifti Jehojada.” Prania e një këshilltari të mençur ishte një ndikim pozitiv në mbretëri për shumë vite.

Si të krishterë ne jo çdo herë do të kuptojmë çfarë Perëndia do që ne të bëjmë apo të dimë se cili është vullneti i Tij në një situatë të caktuar. Prandaj, ne kemi nevojë për këshillime të matura nga anëtarët e tjerë të trupit të Krishtit. Ne duhet të marrim në konsideratë çfarë këta burra dhe gra të perëndishme na thonë sepse ata mund të përdoren si instrumentet e Perëndisë për të na dhënë neve drejtim.

Si mund të gjejmë një këshilltar të mençur? Ju mund të kërkonit këshillim nga një pastor apo ndonjë burrë të perëndishëm apo grua të perëndishme, të cilin Perëndia e ka vendosur që të kujdeset për delet e Perëndisë. Në përzgjedhjen e një këshilltari, ju duhet të kërkonit dikë që ka karakter të perëndishëm, është i/e pjekur shpirtërisht, që është i gjinisë së njëjtë, dhe është plotësisht besnik për të mbajtur fshehtësitë e tua.



- Në kërkim të udhëheqjes nga Perëndia, në çfarë mënyra ke përdorur këshilltarë të mençur?
- Çfarë mund ta pengojë çdonjërin për të kërkuar këshilla nga të tjerët në disa situata?
- Si ka ndikuar ky studim në të menduarit tuaj në lidhje me këshilltarët?
- Si të ka përdorur Perëndia që t'i këshillosh të tjerët me mençuri?



Drejtimit nëpërmjet dhuntive, aftësive dhe dëshirave frymore. Një ndihmë përfundimtare në fushën e drejtimit është marrja në konsideratë e dhuntive, aftësive dhe dëshirave frymore, që Perëndia të ka dhënë. Tek 1 Korintasve 12:4-11 Pali na tregon se secili besimtar ka pranuar një dhunti frymore nga Perëndia, një dhunti e cila është e dizajnuar që të përdoret për

të mirën e përbashkët të njerëzve të Perëndisë, trupit të Krishtit.

Si shtesë, ne kemi edhe aftësi natyrore dhe interesa që Perëndia i ka vendosur në secilin prej nesh, dhe Ai kënaqet kur ne i shfrytëzojmë këto aftësi për lavdinë e Tij. Teksa Perëndia ndonjëherë na thërret të shërbejmë në mënyrat që janë jashtë këtyre fushave, Ai shpesh na jep raste që t'i përdorim dhuntitë dhe aftësitë tona për t'i shërbyer trupit të Krishtit dhe gjithashtu që të shërbejmë në mision për botën.

Kështu, kur jemi duke kërkuar udhëheqje nga Zoti, ne mund t'ia parashtrojmë vetes disa nga pyetjet në vijim:

- A e kuptoj se kjo është me të vërtetë një thirrje nga Perëndia për t'ju përgjigjur një nevojë e cila do ta zgjerojë më tutje mbretërinë e Tij?
- Teksa e konsideroj këtë mundësi apo rast veprimi, si do të jem në gjendje të përdor dhuntitë dhe aftësitë frymore që Perëndia më ka dhënë?
- A ndjej ndonjë etje apo kënaqësi kur mendoj që ta bëjë këtë gjë?
- Cili është motivimi im kur mendoj për këtë rast? A kam dëshirë ta bëjë këtë për t'i shërbyer Perëndisë dhe të tjerëve apo që të marr aprovim, miratim apo status?

Psalmi 37:4-5 thotë, “Gjej kënaqësinë tënde në Zotin dhe ai do të plotësojë dëshirat e zemrës sate. Vendose fatin tënd tek Zoti, ki besim tek ai dhe ai ka për të vepruar.” **Kur kërkojmë vullnetin e Perëndisë dhe teksa rritemi në dashurinë tonë për Të, ne do të zbulojmë se dëshirat tona çdo herë e më shumë janë të njëjta me dëshirat e Tij për ne.**

Sigurisht, **testimi i dëshirave tona nuk mjafton për të përcaktuar nëse një veprim është në vullnetin e Perëndisë.** Dukshëm, profeti Jona nuk ishte i ngazëllyer në lidhje me idenë për t'i shërbyer popullit që ai nuk e pëlqente në Ninive. Perëndia e

urdhëroi qartë që të bëjë diçka që ishte në kundërshtim me dëshirat e tij personale. Fillimisht Mojsiu nuk ishte i ngazëllyer që të kthehej në Egjipt dhe ta konfrontonte faraonin, por megjithatë Perëndia e thirri atë që të kryente këtë detyrë specifike. Shpesh herë Perëndia na thërret në detyra që nuk na pëlqejnë fare, dhe Ai dëshiron që ne t'i besojmë Atij dhe të mësojmë të rritemi në besimin tonë teksa mbështetemi tek Ai përgjatë përvojave të tilla.

Ne mund të gjendemi në aso situata ku jemi duke luftuar me një dëshirë për të cilën Perëndia në mënyrë të qartë e ka shprehur se nuk është vullneti i Tij për ne. Në raste të tilla, ne duhet t'i japim prioritet urdhërimeve të qarta të Fjalës së Tij dhe t'i kërkojmë Atij që të ndryshojë dëshirat tona, në mënyrë që të duam atë që Ai mendon se është më e mira për ne.



- Si i ke gjykuar dhuntitë, aftësitë dhe dëshirat frymore kur je përballur me një vendim në lidhje me udhëheqjen e Perëndisë? A mund të mendosh për ndonjë situatë ku Perëndia të ka drejtuar në një drejtim të caktuar që ka qenë harmoni me dhuntitë, aftësitë dhe dëshirat e tua frymore?
- Në ç'mënyra e ka zgjeruar Perëndia besimin tuaj, teksa të ka thirrur që të bësh gjëra që janë përtej aftësive dhe përvojave tua?

Kushtet në pranimin e udhëheqjes

Ne kemi parë që ekzistojnë shumë mënyra nëpërmjet të cilave Perëndia komunikon me ne dhe na drejton neve. Shpesh ngrihen pyetje në lidhje me udhëheqjen: A merr secili besimtar udhëheqje nga Perëndia, apo ekzistojnë kushtet të caktuara që janë të nevojshme për të përjetuar drejtimin e Tij?

Ndonjëherë udhëheqja e Perëndisë është e qartë dhe ne zgjedhim që t'i bindemi asaj. Po pastaj çfarë? Jona është një shembull i një besimtari të pabindur të cilit i flet Perëndia. Edhe pse duket qartë se Jona nuk kishte dëshirë dhe nuk ishte i entuziazmuar në lidhje me detyrën që Perëndia i kishte dhënë, prapëseprapë Perëndia vazhdoi me qëllimin e Tij për ta përdorur Jonën si lajmëtarin e Tij të zgjedhur. Ne mund të inkurajohemi që Perëndia nuk heq dorë nga ne, mirëpo vazhdon të punojë në jetët tona edhe kur ne i shmangemi Atij.

Ata që vazhdimisht e kanë përjetuar udhëheqjen e Perëndisë në Bibël, si Abrahami, Davidi, Danieli dhe Pali, ishin ata jetët e të cilëve reflektuan cilësi të caktuara. Le t'i shikojmë disa nga këto cilësi.

Bindja

Kushti i parë i drejtimit është bindja ndaj drejtimit apo dritës që tani më kemi pranuar.

Tregimi i Saulit në Dhiatën e Vjetër tek 1 Samueli 15:1-29 dhe 28:1-19, jep një shënim paralajmërues për ne në lidhje me drejtimin. Pasi që Sauli refuzoi t'i bindej urdhërimeve të qarta që iu ishin dhënë atij, më vonë iu ndalua marrja e udhëzimeve. Rënia e gjendjes së tij të tmerrshme shpirtërore karakterizohet me faktin që ai më vonë kërkoi që të ketë një mediokritet në jetën e tij duke u përfshirë në praktika të ndaluara qartë si në magji, thyerjen e ligjeve të mbretërisë së tij dhe duke ikur sa më larg nga Perëndia. **A jemi të përgatitur që t'i bindemi asaj që tanimë e dimë se është vullneti i Perëndisë, apo do t'i injorojmë urdhërimet e Tij dhe të vazhdojmë në një rrugë që na çon drejt shkatërrimit?**

Jeta jonë në Krishtin duhet të karakterizohet nga një dëshirë që t'i bindet Perëndisë. Vetë Jezus Krishti është shembulli më i lartë i Atij që deshi të kryej vullnetin e Perëndisë. Në të vërtetë, Ai tha, “Ushqimi im është të bëj vullnetin e atij që më dërgoi dhe të kryej veprën e tij.” (Gjoni 4:34). Kjo është një deklaratë shumë e lartë në lidhje me prioritetin e kryerjes së vullnetit të Perëndisë në jetën e Jezusit. Ai mendonte në lidhje me të, ashtu siç ne mendojmë për ushqimin tonë të përditshëm, pa çka nuk do të mund të jetonim as edhe një ditë.

Ai që do të ecte në hapat e Jezusit, është ai, jeta e të cilit mund të karakterizohet nga dëshira për t'u bindur – ai dëgjon me plot etje Fjalën e Perëndisë dhe vazhdimisht kërkon për mënyrat e aplikimit të saj në jetën e përditshme. Kryerja e vullnetit të Perëndisë është një çështje e zgjedhjeve të përditshme për ta nderuar dhe për t'i shërbyer Perëndisë.

Ligjërisht ne nuk mund të kërkojmë për më shumë drejtim kur ne nuk kemi dëshirë t'i bindemi asaj që veçse na është dhënë më përpara.

Kur të zbulojmë një fushë të mosbindjes ndaj vullnetit të zbuluar të Perëndisë, ne duhet të jemi të shpejtë që të pendohemi dhe të rrëfejmë mëkatin tonë. Ligjërisht ne nuk mund të kërkojmë për më shumë drejtim kur ne nuk kemi dëshirë t'i bindemi asaj që veçse na është dhënë më përpara. Imagjinoni Jonën duke i kërkuar Perëndisë që t'i jep një derë të hapur për të shërbyer diku tjetër. Jo, drejtimi i Perëndisë ishte i qartë; Jona duhet të shkonte në Ninive.

A ndalet Perëndia së drejtuari ne, kur ne i shmangemi atij? Shkrimi thekson se Fryma e Perëndisë vazhdon t'i flas një personi edhe kur ai nuk është duke jetuar në bindje ndaj Perëndisë. Qëllimi pse Perëndia i flet një personi edhe kur ai nuk është duke jetuar në bindje është për të bërë fajtor atë, për ta paralajmëruar dhe për ta qortuar, në

mënyrë që ai person të kthehet sërish tek Zoti (Jobi 33:14-22). Ne shohim se si shtrihet hiri i Perëndisë në këto paralajmërime. Psalmi 139 na kujton se pa marrë parasysh se sa larg mund të shkojmë, Perëndia do të jetë aty, duke na tërhequr për plot mëshirë tek vetja e Tij. Megjithatë, në anën tjetër ne mund të përjetojmë pikëllim dhe humbje të mëdha kur të ikim nga Perëndia, dhe Ai na nxit që ne të zgjedhim një rrugë të bindjes, e cila sjell bekime.

Përlësia

Një kusht paraprak i udhëheqjes është përlësia. Psalmi 25:9 thotë, “Ai do të udhëheqë njerëzit zemërbutë në drejtësi dhe do t’u mësojë të përlurve rrugën e tij.” Ata që janë të përlur kanë dëshirë që të drejtohen dhe t’i nënshtrohen qëllimeve të Perëndisë për jetët e tyre. Ne e shohim se si shprehet ky lloj qëndrimi tek Lutja e Zotit: “Ardhtë mbretëria jote. U bëftë vullneti yt.”

Shpesh kërkohet nga ne që të presim me përlësi që Perëndia të na tregojë se çfarë të bëjmë. Në kohë të tilla të pritjes, ashtu siç trajnohet një kalë i egër të përdor frerët, po ashtu edhe jemi duke u trajnuar që të udhëhiqemi. Nëse e dëshirojmë udhëheqjen e Perëndisë, ne duhet të përlim veten përpara Tij, t’i përgjigjemi veprës së Frymës së Shenjtë teksa Ai kërkon që të na pastrojë dhe të na trajnojë neve.



1. Shkurtimisht shpjego kushtet për pranimin e udhëheqjes së Perëndisë.
2. Si ndikojnë secila prej tyre në marrëdhënien tënde me Perëndinë dhe me të tjerët?
3. Çfarë vendime apo hapa duhet të marrësh në mënyrë që të plotësosh këto kushte?



Si je përgjigjur ndaj udhëheqjes së Perëndisë në të kaluarën? A ekzistojnë fusha në jetën tënde ku ti nuk je i bindur apo i përlur? Çfarë ke mësuar gjatë kohëve të pritjes për udhëheqje?



Pusho për një çast dhe falënderoje Zotin për interesin e Tij të thellë dhe personal në jetën tënde, si dhe për dëshirën e Tij që jeta jote t’i sjell lavdi Atij. Kërko nga Ai që të të përl dhe të të bëjë të presësh për udhëheqjen e Tij dhe që t’i bindesh dhe përgjigjesh udhëheqjes që Ai tanimë të ka dhënë.

Kur mungon udhëheqja

Ndonjëherë mund të lutemi për udhëheqje dhe të mos marrim asnjë përgjigje të qartë nga Perëndia me anë të asnjërës prej mjeteve të diskutuara si më lartë. **Heshtja e udhëheqjes mund të nënkuptojë thjeshtë që Zoti dëshiron që ti të presësh në Të.** Ky është një ndër mësimet më të vështira për t'u mësuar pasi që kërkon besim dhe jo mbështetje në të kuptuarit tonë. Në anën tjetër, kur nuk shihet asnjë udhëheqje e qartë, kjo mund të nënkuptojë se ti ke mjaft informacion për të marrë një vendim të urtë, të matur dhe kuptimplotë.

Ekzistojnë disa opsione që mund të jenë mundësi po aq të mira sa që Perëndia do të ishte i kënaqur që ju t'i ndiqni, dhe nëse jeni duke ecur ngushtë me Të, ju mund të provoni të merrni një vendim. “Nëse më parë e kërkojmë Perëndinë me të vërtetë, atëherë do të bëjmë çdo herë vullnetin e Perëndisë, pa marrë parasysh ku na çojnë zgjedhjet tona, sepse vullneti i Perëndisë është të kërkojmë më parë mbretërinë e Tij. Kur vijmë pranë një udhëkryqi pa asnjë shenjë për të na drejtuar rrugën tonë, atëherë kemi lirinë të zgjedhim atë që duam, besimi që njohim Perëndinë do të shkoj me ne, dhe siguria e besimit në vendimet tona, bëhen vullneti i tij.”²

Një vendim i drejtë nuk do të thotë se ti nuk do të përballesh me barriera. Davidi, si një burrë i ri, u vajos për mbret nga profeti Samuel, dhe ai e dinte se ky ishte plani i Perëndisë për jetën e tij, megjithatë ai u përball për vite të tëra me shumë barriera para se me të vërtetë të kurorëzohej mbret i Izraelit.

Pyetje rreth udhëheqjes

Mbase ke luftuar që të përcaktosh vullnetin e Perëndisë në një situatë të caktuar dhe mbase ke pyetje në lidhje me mënyrën e udhëheqjes së Tij. Le t'i shikojmë disa nga pyetjet më të zakonshme në lidhje me udhëheqjen.

Vullneti individual i Perëndisë për një besimtar

A i flet Perëndia besimtarëve sot në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe personale, dhe a ka Ai një vullnet individual³ për secilin prej nesh? Këto janë çështje të cilat debatohen nga teologët. Ne e dimë se Perëndia ka një plan për të gjithë besimtarët, ku përfshihet shpëtimi i tyre dhe rritja e tyre në shenjtëri, por vallë sa shqetësohet Ai me detajet e jetëve tona?



Lexo Luka 12:4-7, 22-34. Çfarë përfundime mund të nxjerrësh në lidhje me përfshirjen e Perëndisë në jetën tënde?

Tek Efesianëve 2:10 Pali shkruan që ne jemi paracaktuar që të kontribuojmë në trupin e Krishtit dhe në shërbesën e Perëndisë në botë duke kryer këto vepra të

mira që Perëndia ka përgatitur për ne që më parë. Asnjë person tjetër nuk e ka natyrën e njëjtë, për sa i përket personalitetit, dhuntive dhe aftësive që ti ke, dhe Perëndia të ka vendosur në një vend të caktuar për sa i përket kulturës, mjedisit, dhe arsimimit, në mënyrë që të përdoresh për qëllimet e Tij. Ekzistojnë vepra specifike të mira që Ai ka paracaktuar për ty.

“Perëndia ka sigurisht një plan për jetët tuaja. Ne do ta zbulojmë këtë plan... të cilin e dimë në momentin kur thjeshtë jemi duke e bërë vullnetin e Perëndisë.”⁴ Teksa ecim çdo ditë me Krishtin dhe kërkojmë që të bëjmë mbretërinë dhe drejtësinë e Tij prioritetin tonë më të lartë, ne mund të kemi besim se vendimet që marrim do të jenë vullneti i Tij për ne.

Duke iu përgjigjur një derë të hapur

Një pyetje tjetër për të menduar në fushën e udhëheqjes është pyetja se “si të përgjigjemi kur një derë hapet përpara nesh?” Shpesh në Bibël, një mundësi referohet si “një derë e hapur”, Pali i referohet këtyre dyerve të hapura në një sërë rastesh (shiko 1 Kor 16:9; 2 Kor 2:12; Kol 4:3). Kur jemi në kërkim të vullnetit të Perëndisë, si e interpretojmë një derë të hapur? A ekziston gjithmonë treguesi që ne duhet të hyjmë brenda? Po për dyert e mbyllura? A janë ato gjithmonë shenja që ne duhet të zgjedhim një opsion tjetër? Deri në ç’skallë duhet të provojmë që me forcë të hapim një derë të mbyllur?



Tek 2 Korintasve 2:12-13 Pali shkruan se atij i ishte hapur një derë për Zotin, mirëpo për shkak se nuk kishte gjetur prehje në frymën e tij ai kishte zgjedhur që të udhëtonte për në Maqedoni. Ne shpesh ndihemi të motivuar që të lutemi që Perëndia të na hapë një derë. Megjithatë, ne edhe Palin e shohim se si ai nuk iu përgjigj derës që ishte hapur për të.

Një shkrimtar vë re se, nëse Pali besonte se një derë e hapur ishte një shenjë nga Perëndia, ai me siguri do ta shfrytëzonte rastin. Ai e sheh një derë të tillë si një mundësi për t’u marrë në konsideratë dhe peshuar nga një vendim-marrës, e që është mu ajo që Pali bëri në këtë situatë. Ai thotë se shumicën e herëve dyert e hapura duhet shfrytëzohen, mirëpo “nëse një mundësi më e madhe apo një punë më e madhe paraqitet, atëherë është e pranueshme dhe me vend që të tejkalohet dera e hapur.”⁵ Prandaj, një derë e hapur nuk është gjithmonë një shenjë e drejtpërdrejtë dhe providenciale nga Perëndia që ne duhet të ecim përmes saj.

Në disa raste Pali e pranoi faktin se ai nuk ka pasur mundësi që të ndikojë në një plan të caktuar. Megjithatë ai ka vazhduar të ketë dëshirën për të kompletuar atë plan dhe të lutet deri në fund. Një shembull i tillë është dëshira e Palit për të vizituar Romën, e cila dëshirë është ndërprerë disa herë, mirëpo e cila ka vazhduar të jetë dëshirë e një qëllimi afat-gjatë për Palin.



Teksa mendon për jetën tënde, vendndodhjen dhe mjedisin tënd, dhuntitë dhe aftësitë e tua, cilat mendon se janë ato vepra specifike dhe të mira që Perëndia i ka paracaktuar për ty? A e keni përmbushur vullnetin specifik të Perëndisë që të përdorësh për këto fusha?

- Çfarë udhëzues të ka dhënë Perëndia me anë të përdorimit të një dëre të hapur apo të mbyllur?
- Si e keni konfirmuar udhëheqjen e Tij në një drejtim të dhënë?

Përdorimi jo i duhur i Biblës

Një pyetje tjetër për të menduar në fushën e udhëheqjes është pyetja ‘si të përdoret Bibla për të gjetur vullnetin e Perëndisë në jetët tona?’ Disa të krishterë e përdorin një formë të udhëheqjes që gabimisht ata mendojnë se është formë biblike, e njëjtë me hedhjen e fatit. Ata e hapin Biblën kudo dhe e lexojnë vargun e parë që sytë e tyre zënë. Çfarëdo që lexojnë, ata mendojnë se ajo është çfarë Perëndia po ju flet në lidhje me situatën e tyre. Disa thonë se ata në mënyrë të mahnitshme marrin një drejtim të qartë dhe të saktë mu në kohën e duhur. Ata thonë që vargu që kanë lexuar u është përshtatur aq shumë situatës së tyre sa që padyshim u ngelet në mendje se Perëndia u ka folur atyre. Ne asnjëherë nuk e shohim Jezusin apo dishepujt e tij t’i qasen Shkrimit në këtë mënyrë. Pasi që kjo metodë përdor rastisjet kuturu apo të rastit për të kërkuar një drejtim, atëherë kjo metodë konsiderohet e papërshtatshme për të kërkuar drejtim.



1. Në çfarë situata ke parë që Bibla është përdorur në këtë mënyrë?
2. Cilat janë ato probleme që mund të dalin si rezultat i kësaj praktike?

Mjetet e ndaluara të udhëheqjes

Ne i kemi parë mjetet biblike mbi kërkimin e udhëheqjes së Perëndisë. Ne gjithashtu kemi parë mënyrat e mundshme të përcaktimit të drejtimit të Perëndisë. Tani do t'i shqyrtojmë mjetet e udhëheqjes që Bibla i ndalon në mënyrë absolute. Këto asnjëherë nuk duhet të konsiderohen si të mundshme për një besimtar, pa marrë parasysh se sa shumë ndihmë mund të duhet se ofrojnë në një situatë të caktuar.

Përgjatë viteve të tëra njerëzit kanë përdorur metoda të ndryshme për të kërkuar udhëheqje, dhe kështu kanë kërkuar të dinë të ardhmen nëpërmjet burimeve të tjera jashtë Perëndisë. Një njeri i tillë ishte Mbreti Saul. Në mesin e një urgjence kombëtare, Sauli tmerrësisht kishte nevojë për udhëheqje (1 Sam 28:1-25). Profeti Samuel kishte vdekur, dhe Sauli vetë i kishte urdhëruar të gjithë spiritistët dhe mediumet* të largoheshin nga vendi. Edhe pse Sauli kishte kërkuar udhëheqjen e Perëndisë, ai nuk kishte marrë asnjë përgjigje. Në dëshpërim e sipër ai i kthehet magjisë, duke rënë në kontakt me një shtrigë nga Endori, dhe kështu duke arritur në një rezultat të tmerrshëm.

Bibla vë në dukje se mjetet të tilla për marrjen e drejtimit janë të neveritshme për Perëndinë. **Bibla qartë e ndalon parashikimin e së ardhmes, që i referohet përdorimit të ndodhive të rastit për të përcaktuar të ardhmen.** Kjo mund të përfshijë leximin e shenjave në shuplakë të dorës apo gjethet e çajit, përdorimin e astrologjisë apo letrave Tarrot për udhëheqje, dhe mjete të tjera të ngjashme me këto. Bibla fuqimisht i mallkon praktikën e tilla: “sepse të gjithë ata që merren me këtë punë [përfshirë edhe parashikimin e së ardhmes] janë të neveritshëm për ZOTIN” (Ligj. i Përt. 18:12)



- Cilat janë ato metoda që përdorin njerëzit në kulturën tuaj për të marrë vendime apo këshilla? A mallkon apo i fal Bibla këto metoda?
- Si përdoren ngjarjet e rastit si mjete të udhëheqjes?



Mendo në lidhje me Markon (djali i ri në fillim të mësimi) teksa mendon për rrugën e Perëndisë për jetën e tij. Çfarë parime mund të ndani me të në lidhje me mjetet e udhëheqjes dhe pyetjet rreth udhëheqjes? Bëni një përmbledhje të shkurtër në lidhje me atë që do të ndanit me të, në mënyrë që t'i ndihmoni atij të kuptoj se si na udhëheq Perëndia.

Roli i zgjedhjes

Teksa mendojmë për temën e udhëheqjes, ne kemi nevojë të jemi në dijeni se zgjedhjet që ne bëjmë na çojnë në një drejtim të caktuar, ose më pranë Perëndisë ose më larg Tij. Veç kësaj, Perëndia na mban të përgjegjshëm për zgjedhjet që ne bëjmë.

Marrja në konsideratë e pasojave të zgjedhjeve tona

Për secilën zgjedhje që ne bëjmë do të ketë pasoja. Përderisa disa nga pasojat nuk mund të parashihen, disa të tjera mund të parashikohen. Urtësia bënë pyetje paraprakisht për të parë se cilat mund të jenë disa nga këto pasoja. Për shembull ne mund të pyesim:

Për secilën zgjedhje
që ne bëjmë do të
ketë pasoja.

1. A jam duke marrë përsipër më shumë se sa duhet?
2. Si do të ndikojë kjo zgjedhje në mua?
3. Si do të ndikojë kjo zgjedhje në familjen time?
4. A do të më afrojë kjo zgjedhje më pranë Perëndisë apo më larg Tij?
5. Cilat janë arsyet që unë dëshiroj ta bëjë këtë?
6. A është motivi im t'i sjell lavdi Perëndisë, apo ekziston ndonjë joshje më e madhe për të fituar respekt apo admirim nga të tjerët?

Pasojat e zgjedhjeve të gabuara

Çfarë ndodh kur ne bëjmë një zgjedhje të gabuar, kur humbasim vullnetin e Perëndisë në lidhje me një zgjedhje të caktuar? A jetojmë duke besuar në një rast “të dytë” që mbase do jetë më i mirë? Nëse vendimi i gabuar është relativisht i vogël, pasojat do të jenë të vogla, edhe pse një seri e zgjedhjeve të vogla të gabuara mund të na çojnë larg nga rruga e Zotit.

Në anën tjetër, nëse zgjedhja jonë ka të bëjë me një vendim të madh në jetë, atëherë pasoja mund të jetë shumë e madhe dhe atë për tërë jetën. Për shembull, nëse një i krishterë shkel kurorën, atëherë pasojat mund të kenë një ndikim për tërë jetën dhe gjithashtu mund të kufizojnë shërbimin ndaj Perëndisë. Mëkati i Davidit me Bethshebën kishin pasoja tepër të mëdha që ndikuan në marrëdhëniet e tij me familjen dhe bënë që shumë veta ta vënë në pikëpyetje udhëheqësin e tij?

Edhe kur të kemi mëkatuar rëndë, Perëndia në dashurinë dhe hirin e tij na ofron falje dhe një marrëdhënie të ripërtërirë me Të. Ne kemi nevojë që të pendohemi dhe të rrëfejmë mëkatin tonë para Zotit. Të kthehemi tek Ai, dhe ta vëmë veten tonë nën kujdesin e Tij. Ai do të na restaurojë dhe do të na udhëheq përsëri në rrugën e drejtësisë. Ne gjejmë ngushëllim në Shkrimin kur shohim se si Perëndia ka përdorur njerëz që kishin mëkatuar rëndë – Jakobi ishte një mashtrues; Mojsiu ishte një vrasës; Davidi bëri tradhti bashkëshortore dhe vrasje; Pali persekutoi dhe vrau të krishterët para konvertimit të tij. Perëndia asnjëherë nuk i harroi mëkatet e tyre, mirëpo Ai e përdori këtë ngjarje në jetët e tyre për t'u mësuar atyre mësimet e paharrueshme në lidhje me faljen dhe hirin e Tij, mësimet që i përulën ata dhe i përshtatën në atë formë

që të përdroreshin në shërbimin e Tij. Perëndia në hirin e Tij e restauroi bashkësinë e Tij me Davidin, dhe kur foli për të me pasardhësit e tij, Ai e quajti atë njeri sipas zemrës së Tij, i përkushtuar plotësisht ndaj Tij (1 Mbretërve 14:8; 11:4; 15:5; Veprat e Apostujve 13:22).

Megjithatë, ne duhet ta kuptojmë se ky restaurim ndoshta nuk do të fshijë të gjitha pasojat e zgjedhjeve tona të gabuara, ashtu si Davidi mësoi pas mëkatit të tij me Bethshebën. Ne ndoshta do të kemi nevojë të pranojmë vendimet tona të gabuara në një mënyrë të përgjegjshme dhe të perëndishme.



Shpjego marrëdhënien e zgjedhjeve të gabuara, faljen e Perëndisë, dhe pasojat. Jep një shembull nga jeta jote apo nga jeta e dikujt që njeh, që është falur mirëpo që vazhdon të jetojë nën pasojat e zgjedhjeve të gabuara.

Hapat për të njohur vullnetin e Perëndisë

Bazuar në atë që kemi mësuar në këtë mësim, le të shqyrtojmë disa sugjerime praktike se si të njihet vullneti i Perëndisë.

1. Përkushtohu që të kryesh vullnetin e Perëndisë, të kërkossh mbretërinë e Tij dhe drejtësinë e Tij dhe çdo ditë të zgjedhësh t'i bindesh Atij.
2. Për çdo vendim që dëshiron të marrësh, shiko nëse Perëndia ka thënë ndonjë gjë në Shkrim e që aplikohet në atë çështje. Urdhërimet e zbuluara dhe parimet e Perëndisë duhet të jenë burimi i parë i urtësisë dhe gjithmonë duhet t'u bindemi atyre. Në ato fusha ku Bibla nuk jep ndonjë parim apo urdhërim të qartë, së pari kërko udhëheqje nga Zoti, në lutje dhe në Fjalën e Tij.
3. Këshillohu me Zotin për çdo situatë dhe asnjëherë mos u drejto tek mjetet e ndaluara për të përcaktuar vullnetin e Perëndisë. Lutu dhe tregoji Perëndisë për situatën tënde, dhe kërko nga Fryma e Shenjtë që të të udhëheq të bësh atë që do t'i sjell kënaqësi Atij.
4. Kërko që Ai të zbulojë fushat e mëkatit në jetën tënde dhe që të të transformojë nëpërmjet Fjalës së Tij. (Rom 12:1-2).
5. Nëse nuk vjen asnjë lloj udhëheqjeje nëpërmjet këtyre mjeteve, atëherë merr në konsiderim mjetet e tjera të udhëheqjes që Perëndia ka ofruar; rrethana providenciale, siç janë një derë e hapur; biseda me një person të perëndishëm që ti e respekton; dëshirat e tua personale për këtë situatë, nëse janë në të njëjtën linjë me standardet e Perëndisë të sjelljes së një besimtari; si dhe dhuntitë dhe talentet që Perëndia të ka dhënë. Cili do të ishte një hap i mençur veprimi në këtë situatë?
6. Mendo për çmimin e zgjedhjeve tuaja, duke shikuar ndërlikimet e një zgjedhje në dritën e ndikimit të saj në ty, në familjen tënde, në kishën tënde, në punën tënde, apo në marrëdhënie të tjera.



Zgjedh një vendim të madh me të cilin je duke u përballur aktualisht apo me të cilin je përballur në të kaluarën, trego se si i ke përdorur hapat e mësipërm për ta trajtuar çështjen dhe nxjerr disa përfundime. Përdor pyetjet në vijim për të të drejtuar:

1. Cilat vargje të Biblës mund të kenë ndihmuar në lidhje me vendimin tuaj?
2. Si ia ke përkushtuar këtë situatë Zotit dhe si e ke kërkuar vullnetin e Tij?
3. Çfarë faktorë tjerë ke marrë në konsideratë kur ke marrë këtë vendim?
4. Cilat mund të kenë qenë pasojat e këtij vendimi?
5. Çfarë këshilla ke marrë nga të tjerët?
6. Si të kanë ndikuar rrethanat në procesin e vendim-marrjes?
7. Çfarë roli kanë luajtur dhuntitë, aftësitë dhe dëshirat e tua në këtë vendim?

Merr kohë që të lutesh në lidhje me këtë vendim, duke ia dorëzuar atë Perëndisë, teksa pret që Ai të të tregojë shtegun e Tij.



Falënderojë Zotin që Ai është një Perëndi, i cili është i interesuar në vendimet e tua, dhe i cili dëshiron të të udhëheq në vullnetin e Tij, dhe i cili do të të udhëheq teksa kërkon vullnetin e Tij.

Mendime përmbyllëse

Është vullneti i Perëndisë që ta bëjmë Atë qendrën kryesore të jetëve tona dhe që të bëjmë zgjedhje të përditshme për t'i shërbyer dhe për ta nderuar Atë. Perëndia dëshiron që ne të bëjmë zgjedhje të mira dhe të kërkojmë udhëheqjen e Tij në ecjen tonë të përditshme me Të. Për të na ndihmuar, Ai na ka dhënë Fjalën e Tij dhe dhuratën e Frymës së Shenjtë si udhëheqësin tonë të brendshëm. Perëndia shpesh e konfirmon udhëheqjen e Tij në jetët tona me anë të përdorimit të rrethanave dhe me anë të përdorimit të Tij të dhuntive tona shpirtërore, aftësive natyrore, dhe konfirmimit të dëshirave tona. Ai gjithashtu përdor këshilltarë të urtë, të cilët mund të na ndihmojnë të mendojmë rreth vendimeve të vështira, me të cilat jemi duke u përballur. Shpesh kërkohet nga ne që të presim në Zotin dhe t'i besojmë Atij dhe jo të provojmë të kuptojmë diçka në mënyrat tona apo të përdorim mënyra që nuk janë prej Tij. Kur jemi duke ecur me Krishtin, dhe jemi duke kërkuar që ta kënaqim Atë, atëherë mund të dalin shumë shtigje të mundshme të cilat ne mund t'i ndjekim.

Teksa mendojmë për këtë mësim, ne kthehemi sërish tek mendimi me të cilin edhe filluam. Perëndia dëshiron t'i drejtojë fëmijët e Tij. Ai nuk e fsheh vullnetin e Tij nga ne dhe nuk na dërgon gjetiu që ta kërkojmë atë. Përshkrimi tek Gjoni 10:4 i një bariu të mirë nga Lindja e Afërt, përmbushet plotësisht në Jezusin, Bariun tonë të Mirë: “Dhe, pasi i ka nxjerrë delet e tij, shkon para tyre; dhe delet e ndjekin, sepse njohin zërin e tij.” Çfarë siguri e madhe të dimë që bariu ynë shkon përpara nesh, duke u kujdesur për sigurinë tonë, duke ofruar për nevojat tona, dhe duke na thirrur përpara që ta ndjekim Atë. Ne e kemi një Udhëheqës, i cili është i përkushtuar ndaj nesh për jetë dhe i cili e njuh rrugën që të çon në shtëpi.

FUSNOTAT

¹ Pasazhet kyqe janë Gjoni 16:12-15 dhe 1 Kor 2:9-16.

² Jerry Sittser, *The Will of God as a Way of Life: How to Make Every Decision with Peace and Confidence*, rev. ed. (Grand Rapids, MI: Zondervan, 2004), 39.

³ Shiko Garry Friesen, *Vendimmarrja dhe Vullneti i Perëndisë (Decision Making and the Will of God): Një alternative biblike ndaj pikëpamjes tradicionale* (Portland, OR: Multnomah, 1980), 35: “Vullneti **individual** i Perëndisë është plani ideal dhe i detajuar i jetës, të cilin e ka dizajnuar Perëndia për secilin besimtar” (theksim i autorit).

⁴ Sittser, 39

⁵ Friesen, 220.

* Medium (ang) = një person që besohet se ka fuqinë të komunikojë me frymërat e të vdekurve

Duke jetuar si administratorë të Perëndisë

Stivën dhe Lidia punojnë që të dy në mënyrë që t'u ofrojnë fëmijëve të tyre një jetë më të mirë nga ajo që ata kishin përjetuar në fëmijëritë e tyre. Ai ndihet i turpëruar për varfërinë dhe statusin e ulët shoqëror që ai kishte përjetuar duke u rritur. Bile edhe tani me dy të ardhura, duket sikur në shtëpinë e tyre nuk mbetet asnjë para. Djali dhe dy vajzat e tyre gjithnjë kanë nevojë për diçka që u duhet për në shkollë apo diçka të re për të veshur.

Të dielën pastori lajmëroi se grupi i të rinjve kishte nevojë për një shtëpi ku të takoheshin, dhe Lidia po mendonte nëse mund t'u ofronin shtëpinë e tyre, e cila dhomën e ditës e ka shumë të madhe. Mirëpo, mendimi që këta të rinj mund të bënin rrëmujë në shtëpi e bëri atë që të hezitonte. Çka nëse ata do të derdhnin ushqimin në divanin apo qilimin e saj të ri? Për të kjo do të nënkuptonte punë shtesë në fund të ditës pasi të ketë mbaruar punën kur mezi pret të kthehet në mbrëmje dhe të pushojë. Para se të martoheshin, Stivën kishte punuar me të rinjtë, mirëpo tani as njëri as tjetri nuk kanë kohë apo energji.

Çfarë qëndrime kanë Stivën dhe Lidia për përvojat e tyre në të kaluarën? Për burimet e tyre materiale? Për punën e tyre? Çfarë prioritete kanë caktuar ata për veten e tyre si besimtarë? Si janë duke i përdorur aftësitë dhe dhuntitë e tyre shpirtërore që Perëndia u ka dhënë si besimtarë për ndërtimin e mbretërisë së Krishtit? Si do t'i sfidoje ata?



Ne kemi parë një sërë aspektesh mbi të jetuarit e jetës së krishterë. Në këtë mësim ne duam të fokusohemi mbi atë se si të jemi administratorë të të gjitha gjërave që Perëndia na ka dhënë. Ndonjëherë ne fokusohemi vetëm në administrimin e burimeve tona financiare. Mirëpo të jetosh si një administrator i Perëndisë do të thotë më shumë se kaq. Ne dëshirojmë t'i trajtojmë disa pyetje kyçe që ndikojnë në mënyrën se si jetojmë si të krishterë, por që ndikojnë edhe në qasjen tonë të përgjithshme rreth jetës. Le të shikojmë sfidën e të qenit administratorë të **çdo gjëje** që rrethon jetët tona.

Përmbledhje e mësimit

E kujt është jeta?

Të krijuar për të qenë administratorë të Perëndisë

Kuptimi i administrimit

Administrimi i burimeve materiale

Një shembull nga Dhiata e Vjetër

Mësimi i Dhiatës së Re mbi dhënien

Parimet e administrimit të burimeve tona

Kujdesi për trupat tonë

Kujdesi ndaj dhuntive dhe aftësive

Administrimi i përvojave jetësore

Administrimi i kohës

Përcaktimi i prioriteteve

Përcaktimi i qëllimeve

Administrimi: Përshkrimi i punës sonë

Qëllimet e mësimit

Kur ta keni përfunduar këtë mësim, ju do të jeni në gjendje që:

1. Të shpjegoni rolin dhe përgjegjësinë e besimtarit si një administrator i burimeve të Perëndisë.
2. Të shikoni evidencën biblike në lidhje me administrimin e burimeve materiale dhe parimet që ndërlidhen me administrimin
3. Të vlerësoni se si ju i shfrytëzoni dhuntitë dhe aftësitë shpirtërore që Perëndia ju ka dhënë për ndërtimin e trupit të Krishtit dhe mbretërinë e Krishtit në botë.
4. Të shqyrtoni përvojat e tua të jetës dhe historinë e familjes për të parë mënyrat se si Perëndia dëshiron të thellojë besimin tuaj apo të të përdorë për t'ju shërbyer të tjerëve.
5. Të vlerësoni se si e përdorni kohën tani, t'i përcaktoni prioritetet e juaja, dhe t'i përcaktoni qëllimet që do të ju ndihmojnë ta shfrytëzoni kohën me urtësi.

E kujt është jeta?

Shumë njerëz jetojnë pa menduar shumë në lidhje me qëllimin e jetës. Ata zgjohen dhe kalojnë ditën me aktivitetet e zakonshme, duke u marrë me problemet dhe me dhimbjen, duke pritur me padurim për rastet e këndshme dhe të ardhmen, me shpresën se ajo mund të sjellë gjëra më të mira. Për një dishepull të Krishtit jeta merr një qëllim dhe një kuptim të ri. Përderisa rrethanat e jetës së një të krishteri mund të mos ndryshojnë fare, tani zgjedhjet dhe aktivitetet e tij/saj janë të mbushura me kuptim dhe

me shpresë. Jeta e besimtarit nuk duhet të jetohet më vetëm për vete, por për qëllime shumë më të mëdha.

Tek 1 Korintasve 6:19-20, Pali mëson për një të vërtetë të rëndësishme në lidhje me jetën e krishterë: trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë që është në ju. Ai u thotë besimtarëve, “Ju nuk i përkisni vetvetes.” Besimtari është blerë me një çmim, me çmimin më të shtrenjtë që është paguar ndonjëherë, e që është: vdekja e Jezus Krishtit. **Kur ne marrim dhuratën e Perëndisë për shpëtim me anë të besimit në Birin e Tij, ne më nuk i takojmë vetës sonë, por Perëndisë, dhe qëllimi ynë është që ta përlëvdojmë Atë me anë të jetëve tona.**



Lexoni Kolosianëve 3:17 dhe Romakëve 12:1-2 dhe bëni një përmbledhje në lidhje me atë se cili është qëllimi i besimtarit në jetë.

Në pasazhet e tilla sikurse ky ne marrim një pamje të jetës së krishterë. **Këto vargje na sugjerojnë pronësi të re dhe qëllim të ri në jetën e besimtarit.** Perëndia dëshiron që t’ia ofrojmë Atij tërë jetën tonë, duke përfshirë çdo pjesë të tërë qenies sonë. Ai na do krejtësisht, dhe Ai dëshiron që ne të jetojmë për lavdinë e Tij, dhe jo për qëllimet tona. Mbani mend definicionin e zotësisë së Krishtit – gjithçka që kam dhe gjithçka që jam i takojnë Krishtit.

Të krijuar për të qenë administratorë të Perëndisë

Që nga fillimi i krijimit, Perëndia kishte një plan për ne, një plan që do t’i sillte Atij lavdi dhe një jetë përplot kuptim dhe qëllim për tërë njerëzimin.

Tek Zanafilla, Perëndia urdhëroi Adamin dhe Evën që të jenë të frytshëm dhe që të rriteshin në numër; ta nënshtonin tokën dhe të sundonin në të; dhe të punonin e të kujdeseshin për botën e Perëndisë dhe për krijesat që Ai kishte krijuar (Zan 1:26-28; 2:15). **Ne jemi dizajnuar që të menaxhojmë atë që Perëndia posedon.** Pjesë e urdhërit të parë të Perëndisë që i dha Adamit dhe Evës ishte që ata të bëheshin kujdestarë të krijimit të Tij.

Ne së pari duhet ta kemi të qartë se krijimi i takon Perëndisë dhe jo neve. Ne nuk e posedojmë atë; ne jemi këtu që të kujdesemi për të në emër të Poseduesit të drejtë. Psalmi 24:1 thotë, “Zotit i përket toka, dhe të gjitha gjërat që janë mbi të, bota dhe banorët e saj.” Profeti Hagai shkroi, “Argjendi është imi, ari është imi”, thotë Zoti i ushtrive.” (Hag 2:8). Toka dhe gjithë pasuritë e saj i takojnë Perëndisë, dhe neve na është dhënë privilegji dhe përgjegjësi shumë e lartë që të kujdesemi për të, për ta zhvilluar atë dhe për t’i shfrytëzuar me mençuri pasuritë e Tij.

Tek Kolosianëve 1:16-17 ne mësojmë se të gjitha gjërat janë krijuar nëpërmjet Perëndisë dhe për Perëndinë. Jo vetëm që është Perëndia Krijuesi i çdo gjëje, Ai gjithashtu është Mbajtësi i çdo gjëje, Ai mban universin në veprim. Të gjitha gjërat janë

krijuar për Të. Edhe pse ne kënaqemi me burimet e botës së Perëndisë, ato nuk na takojnë neve, e as nuk jemi në qendra kontaktuese e universit.

Kur ne marrim në konsideratë dy fakte – pafundësinë e detyrës së administrimit të krijimit të Perëndisë dhe Atë për të cilin punojmë – përgjegjësia jonë si kujdestarë të botës së Perëndisë vije në fokus të qartë. Është një privilegj tepër i madh, përplot dinjitet dhe vlefshmëri, për shkak se ne përfaqësojmë vetë Zotin. Ne jemi krijuar për të qenë kujdestarë në botë, botë e cila zotërohet dhe ruhet nga Perëndia. Ky privilegj bartë me vete gjithashtu edhe bekime të mëdha dhe ata që janë kujdestarë të mirë, shpërblehen në këtë jetë dhe në jetën që do të vijë.

Ne jemi krijuar për të qenë kujdestarë në botë, botë e cila zotërohet dhe ruhet nga Perëndia.



Si ndikon në jetën tënde të përditshme të kuptuarit se e tëra jeta jote dhe gjithçka që të takon ty, i takojnë Perëndisë dhe se ti je krijuar për të qenë kujdestar i krijimit të Perëndisë?

Kuptimi i administrimit

Çfarë do të thotë të jesh një administrator i botës së Perëndisë? Fjalori e definon fjalën administrator (kujdestar) si “një person i cili menaxhon apo mbanë nën kontroll pronën apo punët e tjetërkujt”¹ **Administrimi është menaxhimi i diçkaje që nuk është e jotja.**

Kur mendojmë në lidhje me menaxhimin e botës, është e qartë se detyra është tepër e madhe për një individ të vetëm. Vetëm mendimi në lidhje me të, të huton. Administrimi i botës së Perëndisë është një detyrë e cila duhet të ndahet, teksa çdo njëri prej nesh menaxhon burimet që Ai na ka dhënë si individë. Çdo person ka pranuar disa “asete” nga Perëndia:

Dhuratën e burimeve materiale, përfshirë financat dhe posedimet

Dhuratën e trupave tanë dhe kapaciteteve fizike

Dhuratën e kapaciteteve tona mentale, emocionale dhe shpirtërore

Dhuratën e përvojave tona të veçanta të jetës

Dhuratën e kohës, pavarësisht nëse është një kohë e shkurtër apo e gjatë mbi këtë tokë.

Si shtesë ndaj këtyre dhuratave që janë të zakonshme për të gjithë njerëzit; Perëndia u jep dhunti të gjithë besimtarëve – dhunti shpirtërore që të përdoren për ndërtimin e trupit të Krishtit dhe zgjerimin e mbretërisë së Tij në tokë. Perëndia dëshiron që ne t'i

shikojmë të gjitha këto gjëra si asetet e Tij, për t'u investuar dhe përdorur me mençuri, dhe jo si të drejtat dhe posedimet tona.

Le të shikojmë secilën nga këto aspekte të administrimit tonë.

Administrimi i burimeve materiale

Shumica e njerëzve kanë tendencë të mendojnë se puna e tyre e rëndë dhe përcaktimi i tyre, janë gjërat që u sjellin atyre rezultate të merituar në formën e gjërave materiale.



Lexoni Ligji i Përtërirë 8:17-19 dhe vini re se çfarë na mësojnë këto vargje në lidhje me sigurimin e pasurisë. Si mund të ndryshojë të menduarit tuaj një kuptim i tillë?

Këto vargje na përkujtojnë se **është Perëndia Ai i cili na ka dhënë talentet dhe fuqinë për të kryer punën tonë dhe për të siguruar pasurinë**. Në fakt, ne as që mund të marrim frymë nëse Perëndia nuk na jep atë. Perëndia jo vetëm që na jep fuqinë për të kryer punën tonë, por Ai gjithashtu ofron shiun dhe diellin, që janë ushqim për dheun, dhe gjithçka që nevojitet për të prodhuar rritjen (Zan.27:28; Isa.30:23; Vep.14:16-17). Perëndia dëshiron që ne të jetojmë me vetëdijen se burimet tona materiale vijnë nga Ai dhe i takojnë Atij dhe t'i përdorim këto burime në mënyrat që ndërtojnë mbretërinë e Tij dhe që i sjellin nder Atij.



Çfarë asete të ka dhënë Perëndia për t'i gëzuar? A ke fusha në jetën tënde ku ti ke menduar se ke rolin e pronarit dhe jo të administratorit të aseteve të Perëndisë? Cilat janë ato fusha të jetës tënde, të cilat ke nevojë t' i dorëzosh nën zotërimin e Perëndisë?

Një shembull nga Dhiata e Vjetër

Për t' i kujtuar popullit të Tij, Izraelit, faktin se të gjitha gjërat vijnë nga Perëndia, Perëndia u kërkoi atyre që të ndanin për Të të dhjetën e tërë prodhimit të tyre për çdo vit (Lev.27:30-33; Ligji i Përt.14:22), në mënyrë që ata të mësonin të kishin gjithnjë frikë nga Zoti Perëndi (Ligj. i Përt.). Populli i Izraelit duhej të jepte këtë dhjetë përqindje – të dhjetë – për Perëndinë si veprimin e parë, pa pritur për të parë nëse të gjitha nevojat e tyre ishin plotësuar në rend të parë dhe nëse të gjitha faturat e tyre ishin paguar. **E dhjeta ishte një përkujtues se çdo gjë që ata kishin vinte nga Perëndia dhe se Ai do të ishte furnizuesi i tyre.** Edhe pse kjo ishte kërkuar, e dhjeta (si çdo sakrificë apo dhuratë tjetër) duhej të jepej me gëzim (Ligji i Përt.12:1-19; 14:26). Teksa ata do të ishin besnik në ofrimin e kësaj të dhjete për Zotin, po ashtu Perëndia kishte premtuar se do t' i bekonte ata. Tek Fjalët e Urta 3:9-10 ne lexojmë, “Ndero Zotin me

pasurinë tënde dhe me prodhimet e para të çdo të ardhure që ke; hambarët e tu të grurit do të jenë plot e përplot dhe vozat e tua do të gufojnë me musht.”

Perëndia e zbuloi një program për të bekuar popullin e Tij dhe priti që ata do të dëshironin ta mbështetnin financiarisht këtë program. Shtëpia e Perëndisë, tempulli, kërkonte mbështetje financiare në mënyrë që bekimet të gëzoheshin nga populli që vinte aty për adhurim. Nevojat e priftërinjve dhe levitëve që punonin në tempull duhej të plotësoheshin.

Teksa lexojmë historinë e Izraelit në Dhiatën e Vjetër, ne shohim se kombi vazhdimisht e harroi Perëndinë dhe u largua nga Ai. Këto qëndrime të zemrës ndaj Perëndisë gjetën shprehje gjithashtu edhe në zakonet e tyre të së dhënies.



Lexo Malakia 3:7-10.

1. Si e kishin vjedhur njerëzit Perëndinë?
2. Cila ishte përgjigja e Perëndisë?
3. Si mund ta aplikosh këtë të vërtetë në jetën tënde?

Ne shohim se Perëndia ishte ofenduar nga refuzimi i izraelitëve për t’ju bindur urdhërimeve të Tij që u ishte dhënë atyre për të mbështetur punën e Tij. Plani i Tij për t’i bekuar ata ishte penguar nga qëndrimet e zemrave të tyre që rezultoi në dështimin për t’i dhënë punës së Perëndisë nga burimet e tyre.

Mësimi i Dhiatës së Re mbi dhënien

Mësimi i Dhiatës së Re mbi dhënien është gjithashtu i lidhur ngushtë me të kuptuarit e besimtarit që **dhënia që kënaq Perëndinë buron nga dashuria e madhe për Perëndinë.**



Lexoni 2 Korintasve 8:1-15 dhe 9:6-15. Çfarë parime rreth dhënies mësoni në këto pasazhe?

Pali i lavdëroi të krishterët maqedonas për dhënien e tyre bujare, duke theksuar se ata “dhanë veten më përpara te Perëndia” (2Kor.8:5). Sipas mësimit të Dhiatës së Re, asnjë përfitim nuk rrjedh për besimtarin nga vetë akti i dhënies. Dhënia shihet si një përgjigje e dashurisë së besimtarëve ndaj sigurimit të hirshëm të Atit të tyre qiellor dhe nevojave të të tjerëve. Duke

Dhënia shihet si një përgjigje e dashurisë së besimtarëve ndaj sigurimit të hirshëm të Atit të tyre qiellor.

krahasuar të kuptuarit e burimit të pasurisë, Pali u shkruan besimtarëve në Korint, “Çfarë ke ti që nuk e ke marrë?” (1 Kor 4:7)

Dhiata e Re askund nuk mëson në mënyrë të drejtpërdrejtë për të dhjetën e kishës. Ajo e përmend të dhjetën vetëm në kontekst të Dhiatës së Vjetër.² Kjo e vërtetë e lirisë sonë në Krishtin nuk nënkupton se ne më nuk kemi nevojë të ofrojmë mbështetjen tonë ndaj punës së Perëndisë, mirëpo që **dhënia jonë duhet të motivohet nga një dashuri e çiltër për Perëndinë, e cila na shpie drejt dhënies bujare, dhënies me dëshirë dhe me gëzim, për aq sa kemi mundësi të japim.** Në disa raste kjo e dhënë mund të tejkalojë kërkesën e dhjetë përqindëshit, që kërkohet nga Dhiata e Vjetër.

Marrëdhënia e besimtarit me paranë. Një nga gjërat që mund të na pengojë në ndjekjen e Perëndisë me gjithë zemër, është kërkimi i pasurisë. Bibla flet për rreziqet që përfshihen kur ne fokusojmë jetët tona në kërkimin e parave.



Lexo 1 Timoteu 6:9-10.

1. Shpjego çfarë mësojnë këto vargje.
2. Si mund të jetë dashuria për paranë një lak për të pasurit? për të varfrit?

Paraja në vetvete është amorale, as e mirë dhe as e keqe. Mund të përdoret për qëllime të mira apo për qëllime vetjake dhe të këqija. Paraja është një mjet të cilin duhet ta përdorim me urti për qëllimet që do ta nderojnë Perëndinë. Bibla flet për përdorimin e urtë të parave, duke na mësuar që t’i shmangemi borxheve, që të jetojmë me aq sa kemi, dhe të planifikojmë të ardhmen. Këto janë përdorime korrekte të parasë.

Ekzistojnë një sërë paralajmërime në Bibël në lidhje me qëndrimet jo korrekte për paranë. Në shëmbëlltyrën e katër llojeve të tokës, Jezusi i paralajmëroi ndjekësit e Tij për rrezikun e mashtrimit të pasurisë dhe lakmitë për gjërat e tjera në botë, të cilat hynë dhe e mbytin Fjalën e Perëndisë, në mënyrë që ajo të bëhet e pafrytshme (Marku 4:19).



Lexo Mateu 6:24 dhe 1 Timoteu 6:17-19.

1. Çfarë mendoni se nënkuptoi Jezusi kur Ai tha, “Ju nuk mund t’i shërbeni Perëndisë dhe pasurisë”?
2. Për çfarë rreziqe paralajmëroi Pali tek 1 Timoteu 6:17-18?
3. Çfarë qëllime kishte përcaktuar Pali për ata që kishin burime materiale?
4. Si mund t’i aplikosh këto vargje në jetën tënde?

Pali u rikujtoi besimtarëve të Dhiatës së Re të cilët ishin të pasur në këtë botë të tanishme që të mos i mbanin shpresat e tyre në pasuritë e tyre por në Perëndinë, “i cili na jep çdo gjë bujarisht për ta gëzuar.” Ky pasazh nënkupton se **dashuria për paranë mund të jetë një lak për besimtarët, si për ata që janë të pasur ashtu edhe për ata**

që janë të varfër, një lak i cili i çorienton dhe i shpie larg nga Perëndia. Pjesa tjetër e medaljes është se paraja është një aspekt bekimi nga Perëndia, dhe mund të përdoret për të ndihmuar në qëllimet e Tij në botë, teksa i ofrojmë ato tek Ai për t'i bekuar të tjerët me anë të dhënies sonë.

Një shembull i kësaj shihet në grupin e grave të cilat e ndoqën Jezusin dhe e mbështetën Atë me mjetet e tyre. Njëra ndër këto gra, Joana, kishte një pozitë të mirë në shtëpinë e Herodit, dhe kështu ajo kishte dhënë nga burimet e saja personale për nevojat e Jezusit dhe të dishepujve në mënyrë që ata të ishin të lirë për të shërbyer (Luka 8:1-3).

Shembuj të bujarisë janë të shumtë në historinë e kishës së hershme. Besimtarët në kishën e hershme ishin urdhëruar që të jepnin për të mbështetur punën e Perëndisë. Tek Veprat 2:45 ne lexojmë që besimtarët “i shisnin pronat e pasuritë dhe ua ndanin të gjithëve, sipas nevojës së çdonjërit.” Ata e bënë këtë në mënyrë të vazhdueshme, dhe jo vetëm një herë. Teksa nevojat rriteshin në mesin e tyre, besimtarët ishin gati të shisnin diçka, të merrnin paratë për atë, dhe të plotësonin nevojën e një personi. Kështu ne shohim se dhënia bëhej sipas nevojës.

Përfitimet e dhënies. Shumë njerëz mendojnë se ndarja e parave për qëllimet e Perëndisë mund të të lejë pa para të mjaftueshme për veten. Mirëpo në ekonominë e Perëndisë, e kundërta e kësaj është e vërteta. Tek 1 Mbretërve 17 ne gjejmë tregimin e të vesë së varfër të Sereptas, e cila e futi profetin Elia në shtëpinë e saj, gjatë kohës së zisë së bukës. Gjithçka që asaj i kishte ngelur ishte një dorë me pak miell në një enë dhe pak vaj në një qyp, ndërsa kishte një djalë që të kujdesej për të, ajo prapë se prapë i dha këto pak gjëra që i kishin mbetur për njeriun e Perëndisë, dhe kështu Perëndia bëri që mielli dhe vaji të mos mbaronin për disa ditë, duke ofruar kështu për nevojat e të treve.³



Lexo tregimin tek 1 Mbretërve 17.

1. Përse ishte gati kjo e ve që t'i jepte edhe burimet e saj të fundit Elias?
2. Ç'farë e vërtete na duhet që të bindemi për të dhënë?

Tek Fjalët e Urta 11:24 ne lexojmë, “Ka nga ata që shkapërderdhin bujari dhe bëhen më të pasur, dhe ka nga ata që kursejnë më tepër se duhet dhe bëhen gjithnjë e më të varfër.” Tendencia jonë është që të kujdesemi tepër për burimet tona, posaçërisht kur ato janë shumë të vogla. **Në ekonominë e Tij, Perëndia është në gjendje që të shumojë burimet e atyre që japin bujarisht.**

Tek 2 Korintasve 9:6, Pali na tregon se ai që mbjell me kursim, do të korrë po me kursim; dhe ai që mbjell dorëhapur edhe do të korrë dorëhapur.

Zgjedhja është e qartë për ndjekësit e Krishtit: të nderojnë Perëndinë me anë të dhënies, në mënyrë që dashuria e Tij të mund të tregohet në botë dhe të mund të shpallet ungjilli.



- Si mund ta përshkruash qëndrimin tuaj ndaj parasë?
- Përshkruaj modelet e tua aktuale të dhënies dhe motivimin tuaj për të dhënë. A ke një tendencë të tërhiqesh kur vije puna për të dhënë apo jep në mënyrë bujare?
- Si të ka sfiduar kjo pjesë që të mendosh në lidhje me dhënien?

Parimet e administrimit të burimeve tona

Mënyra se si i përdorim burimet tona materiale është një indikator i qëllimit tonë të jetës. Ekziston një lidhje e ngushtë në mes të administrimit të burimeve materiale dhe të burimeve shpirtërore.



Shiko Luka 16:10-12.

1. Çfarë tha Jezusi në lidhje me përkujdesjen ndaj pasurive të botës?
2. Çfarë mendoni se Ai nënkuptoi me pasuritë e vërteta?

“Pasuritë e vërteta” për të cilat foli Jezusi janë burimet shpirtërore, të cilat gjithashtu janë një dhuratë nga Perëndia. Kështu, planifikimi dhe administrimi ynë me urtësi i burimeve fizike që kemi nga Perëndia, në një kuptim janë një përgatitje për përkujdesjen e këtyre pasurive të vërteta. Ne do të shohim katër parime që mund të na ndihmojnë për të qenë administratorë të mirë të burimeve materiale.

Parimi i planifikimit me urtësi. Jezusi përdori një sërë ilustrime që tregojnë nevojën për të planifikuar me urtësi në shumë fusha të jetës, si tek shëmbëlltyra e ndërtuesit të mençur dhe e ndërtuesit budalla (Luka 6:46-49), shëmbëlltyra e ndërtuesit të kalasë (Luka 13:28-30), dhe shëmbëlltyra e mbretit i cili bënë planet e luftës (Luka 14:31-32).



Lexoni Fjalët e Urta 21:5, 20 dhe 24:3-4. Çfarë thonë këto vargje në lidhje me konceptin e planifikimit me urtësi?

Kur aplikohet parimi i planifikimit me urtësi në administrimin e burimeve që Perëndia na ka dhënë, ne shohim nevojën për të krijuar një buxhet, për të përcaktuar listën e prioriteteve në harxhime, dhe gjithashtu për të regjistruar çdo shpenzim të

financave tona. Perëndia dëshiron që ne të jemi të përgjegjshëm për burimet që na jep, pa marrë parasysh a janë ato të mëdha apo të vogla.



- Çfarë roli luan planifikimi në administrimin tuaj të burimeve të Perëndisë?
- A ke një plan të shpenzimeve i cili funksionon për familjen tuaj? Nëse jo, mendo rreth të ardhurave tuaja, bëjë një listë të nevojave tuaja duke i radhitur sipas prioriteteve, dhe fillo një sistem të regjistrimit të shpenzimeve tuaja.

Një aspekt i planifikimit me mençuri është ndarja e parave dhe burimeve tjera për nevojat e së ardhmes. Përderisa mbështetemi në Perëndinë që Ai do të sigurojë për ne për çdo ditë, Ai gjithashtu pret nga ne që të shpenzojmë me urtësi si dhe të ndajmë për nevojat e së ardhmes. Ashtu si ketri që mbledh lajthi dhe i deponon për t'i ruajtur për vitin tjetër kur asnjë nuk mund të gjendet, po kështu edhe ne duhet të planifikojmë më përpara për kohët e vështira apo për humbjet që mund të ndodhin.

Jozefi ishte një shembull i planifikimit me mençuri (Zan 4:1). Perëndia e lejoji atë që të interpretojë ëndrrat e Faraonit: që do të vinin shtatë vite të begatshme dhe shtatë vite të zisë së bukës. Faraoni e vuri Jozefin në krye të gjithë Egjiptit, dhe gjatë shtatë viteve të begatisë, ai mbledhi dhe rezervoi ushqim. Egjipti ishte i përgatitur për vitet e zisë së bukës.

Parimi i dhënies për Perëndinë dhe të tjerët. Ne diskutuam programin dhe furnizimin e Perëndisë për shtëpinë e Perëndisë dhe për ata që i shërbejnë Atij. Veç kësaj, Bibla përmban shumë referenca rreth furnizimit për të varfrit dhe nevojtarët si dhe për të vejat dhe jetimët. **Kisha e hershme ishte e inkurajuar që të jepte të përgjigjej ndaj nevojave, për të mbështetur nevojtarët në kishë, për të mbështetur drejtuesit e kishës dhe misionarët që ishin dërguar jashtë në mision nga kisha.** Shumë nga letrat e Palit përmbajnë falënderime për kishat individuale për mbështetjet që ato i kishin dhënë për shërbesën e tij.



Shiko vargjet në vijim: Veprat e Apostujve 4:34-35; 11:27-29, 1 Korintasve 16:2, dhe 2 Korintasve 9:7. Çfarë mësoni në lidhje me konceptin e dhënies për Perëndinë?

Ne shohim nga këto vargje që dhënia jonë duhet të jetë e rregullt, bazuar në të ardhurat dhe nevojat, si dhe në qëllim.

Parimi i përgjegjësisë. Një sërë shëmbëlltyrash të treguara nga Jezusi, e bëjnë të qartë se besimtarëve do t'u kërkohet llogari për mënyrën se si i kanë përdorur pasuritë e tyre.



Lexo shëmbëlltyrën e tre shërbëtorëve tek Mateu 25:14-30.

1. Sa talenta të argjendit kishte marrë secili shërbëtor?
2. Përshkruaj ç'bëri secili shërbëtor me talentën e vet.
3. Çfarë përgjigje pati mjeshtri për dy shërbëtorët e parë?
4. Përse mendoni se ishte kaq e ashpër përgjigja e tij ndaj shërbëtorit të tretë?

Qëllimi i kësaj shëmbëlltyre është që të na mësojë se neve do të na kërkohet llogari për mënyrën se si i kemi përdorur ato gjëra që na ka dhënë Perëndia. Konteksti i shëmbëlltyrës është kthimi i Krishtit. **Kur Krishti, Mjeshtri ynë, të kthehet, ai do të na kërkojë llogari për mënyrën se si i kemi përdorur ato gjëra që na ka dhënë Ai.** A i kemi harxhuar ato pa ndonjë hesap, a i kemi neglizhuar ato, apo i kemi investuar për mbretërinë e Tij? Në atë ditë ne do ta kuptojmë plotësisht vlerën e pasurive që ne kemi poseduar në tokë dhe qëllimin e duhur për të cilin Perëndia i kishte menduar.

Parimi i kënaqësisë. Kur ne mendojmë për burimet tona materiale, është e lehtë të ngatërrohen dëshirat me nevojat. Perëndia dëshiron që ne të zhvillojmë një shpirt të kënaqur.



Lexo Isaia 55:2, Filipianëve 4:11-13, 1 Timoteu 6:8, dhe Hebrenjëve 13:5.

1. Çfarë po mësoni në lidhje me kënaqësinë?
2. Cili ishte çelësi i kënaqësisë së Palit?
3. Cila e vërtetë e ndihmoi atë që të arrijë këtë nivel të kënaqësisë? (Fil 4:13)?

Kur Pali e shkroi pasazhin e Filipianëve, ai ishte në burg, por sidoqoftë ai shprehu kënaqësinë e tij edhe në mesin e vështirësisë. Çelësi i kënaqësisë së Palit nuk ishte në gjërat materiale; fokusi i tij ishte në Krishtin. Me anë të fuqisë së Krishtit ne mund t' i mbajnë sytë tanë të fokusuar në gjërat me vlera të përjetshme.

Pjesa e dytë e Hebrenjëve 13:5 na përkujton se Perëndia është i pranishëm me ne dhe asnjëherë nuk do të na lë. Pasuria më e madhe që ne posedojmë nuk është shtëpia jonë, apo vetura jonë apo të hollat tona në bankë, por marrëdhënia jonë me Atin. Ne duhet t'ia përkujtojmë vetes se në Të ne kemi të gjitha pasuritë që mund të na nevojiteshin ndonjëherë si dhe të kërkojmë nga Ai që të na çlirojë nga qëndrimet e xhelozisë apo nga tundimi për të krahasuar ato që kemi me ato që të tjerët mund të posedojnë.



- Si planifikoni t'i aplikoni parimet e sipërshënuara në jetën tuaj?
- A karakterizohet jeta juaj nga kënaqësia apo nga dëshira për të pasur më shumë dhe nga një shpirt garues apo nga xhelozia? Shpjego.
- Nëse fillojmë t'i shohim të gjitha pasuritë tona si pasuritë e Perëndisë, si do të ndikojë kjo në mënyrën se si i përdorim ato ne? Mendo rreth disa gjërave që ti i posedon. Si mund ta përdorësh shtëpinë tuaj, veturën tuaj, enët tuaja, apo kompjuterin tënd për qëllimet e Perëndisë dhe për nderimin e Tij?



Falënderoje Perëndinë për gjithçka që të ka dhënë. Bisedo me Të rreth qëndrimeve tua që ke për paratë. Kërko nga Ai që të të ndihmojë që të besosh se Ai do të sigurojë për nevojat e tua, të të ndihmojë të mësosh të jesh i kënaqur me atë që Ai të ka dhënë, që të japësh bujarisht i shtyrë nga dëshira për ta kënaqur Atë, dhe të përdorësh atë që Ai të ka dhënë.

Kujdesi për trupat tanë

Jo vetëm që kemi marrë bekime financiare dhe materiale nga Perëndia, mirëpo neve na është dhënë edhe dhurata e jetës vetë. Perëndia fryu jetë në secilin prej nesh dhe na ka dhënë një trup me aftësi fizike, kapacitete mendore, kapacitete emocionale, dhe kapacitete shpirtërore. Perëndia dëshiron që ne t'ia japim Atij secilën nga këto fusha. Ne mund të kemi një mendje të ndritur apo jo të mprehtë, një trup të shëndoshë apo një trup të pllakosur nga problemet shëndetësore, një gjuhë të artikuluar apo një gjuhë të belbëzuar, megjithatë **Perëndia mund të na përdorë nëse e ofrojmë vetën tonë para Tij.**

Ndonjëherë ne nuk jemi të gatshëm që ta lejojmë Perëndinë të përdorë atë që Ai ka krijuar. Mojsiu nuk dëshiroi të flas për Zotin. Mirëpo Zoti i përkujtoi Atij se Ai e kishte krijuar atë, duke nënkuptuar se Ai mund të përdorte atë që Ai kishte krijuar për të arritur qëllimet e Tij (Eksodi 4:10-12).

Krijuesi e di mënyrën se si na ka krijuar, dhe Ai nuk është i kufizuar nga kufizimet tona që mund të merren me mend, pasi që Ai ka tërë fuqinë dhe mençurinë dhe Ai është në gjendje që të na japë gjithçka që kemi nevojë për të qenë instrumentet e Tij. Në fakt, Perëndia kënaqet kur përdorë gjërat e marra të kësaj bote për t'i hutuar të mençurit, dhe fuqia e Tij përsoset në dobësi (1 Kor 1; 2 Kor 12). **Perëndia nuk është duke kërkuar për mjete të mprehta; Ai është duke kërkuar mjete, të cilat janë në dispozicion dhe të cilat Ai do të mund t'i mpreh.**

Ne lexojmë tek 1 Korintasve 6:19-20 që ne jemi tempulli i Frymës së Shenjtë dhe që nuk i takojmë vetvetes. Perëndia u jep disa udhëzime specifike besimtarëve në lidhje me kujdesin për trupat tanë.



Lexo vargjet në vijim, dhe trego se ç'mësojnë secila prej tyre rreth këtij koncepti:

- 1 Korintasve 6:15-18
- Efesianëve 5:29
- Filipianëve 1:20
- Kolosianëve 3:5-10
- 2 Timoteu 2:22

Ne kemi nevojë që ta kuptojmë se ne jemi të lidhur me Krishtin dhe se mënyra se si i përdorim trupat tanë, Zotit do t'i sjell ose nderim ose çnderim. **Çdo besimtar ballafaqohet me çështjen e zgjedhjes morale/amorale dhe mendimeve të pastra/të pista.** Ne jetojmë në një botë ku pastërtia seksuale nuk vlerësohet, kur martesat shpesh përfundojnë në divorc, dhe ku marrëdhëniet seksuale jashtë martesës shpesh përkrahen dhe pranohen.

Si besimtar vallë si lundrojmë mbi këto ujëra të pabesa pa u fundosur për të përfunduar në një ishull të shkretuar? Gjëja e parë që duhet të bëjmë është të **flakim tundimin**. Pali u thotë besimtarëve që të flakin tundimin, të ikin larg, të largohen nga situatat tunduese sa më shpejtë që të kenë mundësi. E dyta, ne duhet **t'i vdesim impulset dhe mendimet që i takojnë natyrës sonë tokësore**. Sapo që një mendim i gabuar të lind, ne duhet ta vrasim atë para se ai të gjejë shprehjen e vet në veprim.

Tek Lluca 6:43-45 Jezusi na mëson se burimi i së mirës dhe i së keqes është brenda nesh në zemrat tona. Përderisa farisenjtë ishin të fokusuar në bindjen e jashtme në një listë rregullash, Jezusi ua rikujtoi dëgjuesve të Tij se problemi i mëkatit shkon shumë më thellë – në natyrën mëkatore brenda nesh, e cila na largon tutje nga rruga e Perëndisë. Në anën tjetër ne kemi mësuar se ky largim nuk ka më fuqi absolute sepse Fryma e Shenjtë jeton brenda nesh dhe na jep burimet e Perëndisë vetë për t'i rezistuar fuqisë së mëkatit dhe Satanit dhe që të zgjedhim rrugët e Perëndisë.



- Si po e lejon Perëndinë që të përdorë trupin tënd me kapacitetet e tij fizike, mendore, emocionale dhe shpirtërore?
- Cilat janë vështirësitë më të mëdha në fushën e moralit personal dhe jetën tënde të mendimeve?

- Çfarë faktorë të kanë ndihmuar apo nxitur që të bësh zgjedhje me të cilat është nderuar Perëndia? Kërko nga Perëndia që të të ndihmojë të flakësh tundimin dhe t'i bësh të vdesin mendimet që nuk e nderojnë Atë.



Merr disa minuta kohë dhe falënderoj Perëndinë që je i bashkuar me Krishtin dhe përkushtohu që ta nderosh Atë me anë të trupit tënd.

Kujdesi ndaj dhuntive dhe aftësive

Kur Perëndia na solli në jetë, Ai në lindje na dha secilit prej nesh aftësi potenciale dhe mundësi për t'i zhvilluar këto aftësi dhe të tjera përgjatë jetës. Mbase ti ke një zë të ëmbël për të kënduar, një mendje që i kap shpejtë konceptet matematikore, apo një aftësi për të punuar me dru. **Të gjitha këto talente dhe aftësi vijnë nga Krijuesi, dhe dëshira e Tij është që ne t'i përdorim ato në ato mënyra që Atij i sjellin lavdi.**

Dhiata e Vjetër ofron një pamje të bukur të popullit të Perëndisë duke i përdorur talentet dhe kreativitetet e ndryshme teksa punonin së bashku për të ndërtuar tabernakullin e Perëndisë. Ata përdorën materialet më të mira që kishin dhe aplikuan mjeshtërinë më të mirë të mundshme në krijimin e shtëpisë së adhurimit. Ku Vetë Perëndia do të jetonte.

Në Dhiatën e Re ne shohim se besimtarit i janë dhënë dhunti shpirtërore nga Fryma e Shenjtë për të kontribuar në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë.



Lexo listat e dhuntive tek Romakëve 12:4-8 dhe 1 Korintasve 12:4-11.

1. Cilën nga dhuntitë në këtë listë, mendon se Perëndia ta ka dhënë ty?
2. Shkruaji këto dhunti në fletoren tënde dhe mendimet që mund të kesh në përdorimin e tyre.

Ashtu si mjeshtrit kanë përdorur dhuntitë e tyre për të ndërtuar shtëpinë e Perëndisë, po ashtu Perëndia dëshiron që ne t'i përdorim për lavdinë e Tij të gjitha dhuntitë dhe aftësitë, që Ai na ka dhënë. Ne duhet t'i përdorim këto dhunti për të inkurajuar dhe ndërtuar trupin e Krishtit, për t'i treguar botës dashurinë e Perëndisë dhe për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë në botë (1 Kor 12:7, 25-26; Ef 4:12-16).



Lexo 1 Korintasve 12:14-27.

1. Çfarë krahasimi të zgjeruar bënë Pali?
2. Çfarë përfundime mund të nxjerrësh nga ky pasazh i Shkrimit në lidhje me përdorimin e dhuntive dhe aftësive tuaja?

Ashtu si çdo pjesë e trupit tonë fizik luan një rol të rëndësishëm në funksionimin efikas dhe të shëndetshëm të tij, po kështu çdo pjesëtar i trupit shpirtëror është thelbësor në funksionimin e shëndetshëm të trupit të Krishtit. Nëse një pjesëtar nuk është duke i përdorur dhuntitë e tij/saj, atëherë si rezultat i kësaj trupi i Krishtit vuan. Pali thotë: “Syri nuk mund t’i thotë dorës ‘Unë nuk kam nevojë për ty.’” Në fakt, ato pjesë të trupit që duken të jenë më të dobëta janë më të domosdoshme. Nëse nuk e beson një gjë të tillë, përpiqu t’i lashë rrobat apo të gatuash një ushqim pa i përdorur fare gishtat e mëdhenj të duarve. Përpiqu të vraposh në një garë me një gisht të lënduar të këmbës. Ashtu si trupi ynë fizik funksionon më së miri kur të gjitha pjesët e tij janë në funksion, po kështu edhe trupi i Krishtit, mund të funksionojë mirë vetëm kur të gjithë kontribuojmë.




Si i ke shfrytëzuar aftësitë dhe dhuntitë shpirtërore që Perëndia të ka dhënë për ndërtimin e trupit të Krishtit dhe për ndërtimin e mbretërisë së Krishtit në këtë botë? Çfarë hapa mund të marrësh që të fillosh t’i përdorësh këto pasuri për qëllimet e Perëndisë dhe për lavdinë e Tij?



Tani ndalu dhe falënderojë Zotin për dhuntitë dhe aftësitë që të ka dhënë ty. Kërko nga Ai që të të ndihmojë të gjesësh mënyra për t’i përdorur aftësitë dhe dhuntitë për lavdinë e Tij në ndërtimin e mbretërisë së Tij; që të ndihmojë t’i mundësh ndjenjat e pamjaftueshmërisë; dhe që të mbështetesh në fuqinë e Tij.

Administrimi i përvojave të jetës

Edhe pse ndoshta nuk mund ta vërejmë, përvojat tona në jetë, mund të jenë gjithashtu mjete që Perëndia mund t’i përdorë. Ne kemi pasur mundësi të zgjedhim për vendin e lindjes apo familjen, mirëpo këto janë elemente që Perëndia i ka paracaktuar për secilin prej nesh. Jeta jonë mund të karakterizohet nga momente të lumtura apo të pikëlluara marrëdhënie të dashura apo jo të dashura, nga pasuria po varfëria. **Jetën që e kemi, nuk e kemi**



aksidentalisht, por atë e kemi nga providenca e Perëndisë. Mbase nuk mund ta kuptojmë pse është kështu dhe përse nuk mund të jetë ndryshe. Sidoqoftë Perëndia dëshiron që ne të fokusojmë mendjet tona për t'i shërbyer Atij dhe për të përlëvduar Atë në atë vend ku Ai na ka caktuar.

Perëndia na ka dhënë neve mundësi unike për ta kërkuar Atë, për ta gjetur Atë, për të na ndihmuar që të rritemi në Të, dhe për të përdorur mjedisin ku jetojmë dhe historinë tonë për ti sjellë Atij lavdi. Ashtu si diamantet më të bukura formohen nën një presion të tmerrshëm, po kështu Perëndia na jep formë neve nën presion duke na shndërruar në persona që reflektojmë lavdinë e Tij. Ai na gdhend përgjatë përvojave tona të jetës, dhe Ai mund të përdorë presionin dhe problemet dhe varfërinë për të krijuar një enë të bukur, e cila do t'i japë Atij lavdi. Perëndia nuk e çon dëm vuajtjen e një besimtari, por Ai dëshiron që ta përdorë atë për qëllimet e Tij. Nëse ke një fëmijë rebel, mendo se ç'ngushëllim mund të jesh për një prind që ndihet krejtësisht i vetmuar pasi që ka një djalë apo vajzë plëngprishëse. Nëse ke një martesë të vështirë, Perëndia mund të të përdorë që të mbështetësh dhe inkurajosh të tjerët që janë duke luftuar në këtë fushë.

Tek Jeremia 18 ne kemi përshkrimin e një poçari duke punuar një poç me argjilë, mirëpo argjila prishet, dhe kështu, duke e filluar përsëri punën, poçari bëri me të një poç tjetër, që iu duk i mirë atij. Në këtë pasazh Perëndia ishte duke folur për popullin e tij Izraelin, mirëpo Ai dëshiron që ne ta lejojmë poçarin t'i jep formë jetëve tona, dhe si pjesë e procesit të formimit Ai përdor gjithashtu rrethanat e jetës sonë.

Ky ilustrim mund ta ketë shtangur Jeremian, një profet i thirrur për të qenë lajmëtari i Perëndisë në Jude në një kohë kur kombi ishte gati të dërgohej në mërgim si rezultat i mëkatit. Jeremia vuajti shumë ndërsa po bënte atë që Perëndia e kishte thirrur që të bënte. I quajtur profeti vajtues, ai kaloi një periudhë në një pus të mbushur me baltë, kur mbreti Juda e refuzoi këshillën e tij. Përvojat e vuajtjes dhe dhimbjes ishin pjesë e planit të Perëndisë për t'i dhënë formë Jeremisë dhe për ta përdorur atë si një mjet të tij. Edhe pse dora e Perëndisë ishte me të, jeta e tij ishte tepër e vështirë, por sidoqoftë ai i qëndroi besnik Zotit.



Si e ke parë Perëndinë të përdorë përvojat e jetës tënde apo rrethanat aktuale për të thelluar besimin tënd apo për të inkurajuar të tjerët? Si ka ndikuar mësimi që sapo e ke studiuar, në perspektivën tënde në disa nga vështirësitë me të cilat ti përballlesh? Kërko nga Perëndia që Ai të përdorë përvojat e jetës tënde për t'ju ndihmuar dhe për t'i inkurajuar të tjerët.

Administrimi i kohës

Imagjino sikur jeni zgjuar një mëngjes dhe dikush të ka sjellë një zarf me 86,400 \$. Aty të është thënë që t'i shpenzosh të gjitha brenda një dite dhe që të mos ruash as edhe një cent. Nga mesnata sërish do të ngeleshe pa asnjë para. Por kur dita e re do të lindte, zarfi do të shfaqej rishtas me 86,400 \$ për t'i harxhuar. Tingëllon si çmenduri, apo jo? Çdo ditë ne marrim nga një zarf nga Perëndia me 86,400 sekonda në të, me mundësinë për të bërë çfarëdo që duam me to. Nga këto sekonda ne nuk mund ta kursejmë as edhe një për ta përdorur në të ardhmen. Nëse ne nuk i përdorim në mënyrë produktive këta sekonda, minuta dhe orë të jetës sonë si administratorë të mirë të kohës që Perëndia na ka dhënë, atëherë këto njëzetekatër orë konsiderohen të humbura përgjithmonë.

Ndonjëherë njerëzit mund të thonë, “Sikur dita të kishte më shumë orë!” Askush nuk i ka njëzetepesë orë në ditë; ne të gjithë kemi numrin e njëjtë të orëve brenda një dite, jave, muaji dhe viti.

Tek Efesianëve 5:15-16 neve na është thënë që ta shfrytëzojmë kohën me mençuri. Si besimtarë ne mund të mësojmë ta përdorim me më shumë mençuri dhuratën e kohës. Shpesh duket se koha “fluturon”. Hamendemi se ku ka shkuar ajo, dhe përse ne nuk i kemi kryer disa punë të caktuara që është dashur të kryhen, për t'i ndihmuar vetes në lidhje me përdorimin e kohës, bëjë ushtrimin në vijim për të regjistruar mënyrat se si ti në të vërtetë e përdor kohën tënde.



Inventari i kohës personale: Për një javë mbaj në shënim shpenzimin e kohës tënde. Shëno aktivitetet ku merr pjesë në baza ditore dhe ato që janë shfaqur në mënyrë spontane. Shkruaj shumën e përafërt të kohës në këto aktivitete të ndryshme.

Faqja e planifikimit javor

	E diele	E hënë	E marte	E mërkure	E enjte	E premte	E shtune
Mëngjesi							
Dreka							
Darka							



- Si e kalon kohën gjatë një jave të zakonshme?
- Cilat gjëra do t'i konsiderojë si të parëndësishme apo si shpenzim i kotë i kohës?
- Cilat aktivitete do t'i mendojë më mirë, në mënyrë që ta përdorësh kohën në mënyrë më efikase?
- Bëjë një plan të ri për javën e ardhshme, duke filluar me aktivitete fikse të cilat duhet të përfshihen duke i shtuar ato që reflektojnë prioritet.
- Merr kohë çdo javë dhe vlerëso aktivitetet e javës së kaluar dhe kështu planifiko orarin e javës së ardhshme.


Përcaktimi i prioriteteve

Një frustrim në përdorimin e mençur të kohës është se ne jemi të bombarduar nga një rresht i përgjegjësi dhe aktiviteteve të cilat që të gjitha duket se kërkojnë vëmendjen tonë. Cilat janë gjërat më të rëndësishme? Si vendosim se si ta përdorim kohën tonë?

Shumë gjëra duken të rëndësishme, por jo të gjitha e kanë vlerën e barabartë për besimtarët. **Perëndia dëshiron që ne t'i vendosim prioritetet tona në marrëdhënien tonë me Të dhe në kërkimin e mbretërisë dhe drejtësisë së Tij** (Mat 6:33). Pali tha: “Sepse për mua të jetuarit është Krishti” (Fil 1:21). Sapo t'i kemi pranuar këto prioritete, si ato për të cilat duhet të luftojmë, ne përballemi me një tension të

vazhdueshëm për të jetuar sipas këtyre prioriteteve. Teksa kuptojmë se disa gjëra të caktuara janë më të rëndësishme se të tjerat, ne shpesh kemi tendencën që të marrim vendime bazuar në “tiraninë e urgjencës.”

Të zgjedhësh në mes të prioriteteve nuk është gjithmonë një detyrë e lehtë. Ne çdo ditë konfrontohemi me shumë zgjedhje dhe shumë lloje të përgjegjësive, të cilat kërkojnë kohën dhe vëmendjen tonë. Pikëpamja e një personi në lidhje me atë se cila fushë e përgjegjësive është më e rëndësishme, mund të dallojë dukshëm nga pikëpamja e një personi tjetër. Për një periudhë kohore, një prioritet i caktuar, mund të paraprijë një prioritet tjetër, dhe kështu stinë të ndryshme të jetës kërkojnë prioritete të ndryshme. Për shembull, një nënë me fëmijë të vegjël, duhet ta bëjë prioritet të lartë që të shpenzojë kohë me fëmijët e saj dhe t’i shikojë ata si dishepujt e saj. Kjo nënkupton se në këtë stinë të jetës asaj i mbetet më pak kohë për aktivitete tjera të krishtera.



Ne mund të shohim se përcaktimi i prioriteteve kërkon më shumë se sa thjeshtë përpilimi i një liste të gjërave që ne vlerësojmë më së shumti. Si të krishterë, ne kemi përgjegjësi në disa fusha: për Perëndinë, vetveten, familjen tonë, kishën tonë, punën tonë, shoqërinë tonë, ambientin tonë. Përderisa Bibla na jep disa udhëzues për qëndrimet dhe veprimet në secilën nga këto fusha, mbetet pyetja: si do t’i urdhërojmë jetët tona që t’i arrijnë kërkesat që ka secila fushë? Në vend se të mendojmë në lidhje me prioritetet tona si një listë, le t’i vizualizojmë ato si një qark.⁴

Për një besimtar, Perëndia është në qendër të këtij qarku, duke reflektuar mësimin e Jezusit që urdhërimi më i madh është ta duam Zotin tonë me gjithë zemrën tonë, me gjithë forcën tonë dhe me tërë mendjen tonë. Duke pasur Perëndinë në qendër si pikë referimi për tërë jetën, ne mund të përcaktojmë prioritetet në secilën prej këtyre fushave.

Ky diagram tregon se, kur besimtarët kanë një marrëdhënie personale me Perëndinë, Perëndia mund të prekë secilën fushë të jetës së tyre. Shigjetat që tregojnë në të dyja anët, shfaqin komunikimin që është në mes të besimtarit dhe Perëndisë në këtë marrëdhënie, kryesisht nëpërmjet studimit të Biblës dhe lutjes, aktivitete të cilat e pasurojnë jetën e besimtarit dhe e sjellin atë në një marrëdhënie më të ngushtë me Perëndinë.


Diagrami gjithashtu tregon se duke pasur Perëndinë si prioritet parësor në jetë ndikon në shumë fusha të jetës së besimtarit, si marrëdhënia me familjen, kishën, punën, shoqërinë, e bile edhe rrethin ku jeton. Vini re se të gjitha këto fusha janë të rëndësishme; nuk ekziston një rend i caktuar i kategorive.



Merr ca kohë dhe mendo në lidhje me fushat e identifikuara si dhe shkallën e jetës tënde. Bëjë një listë të pesë prioriteve më të larta.

Ndonjëherë problemet vijnë pasi që ne nuk arrijmë të kuptojmë përgjegjësitë tona në të gjitha fushat. Për shembull, nëse një njeri harxhon shumë kohë në punë, një fushë tjetër, siç është familja e tij, mund të vuaj, siç është ilustruar në diagram.

Arritja e një bilanci të arsyeshëm në mes të prioriteve të ndryshme, na lejon që t'ia adresojmë Perëndisë, si pika e referimit për çdo gjë që bëjmë, të gjitha fushat e rëndësishme të jetës sonë.



Merr pak minuta dhe vlerëso

mënyrën se si ti menaxhon bilanci e përgjegjësi kryesore në jetën tënde.

- Si i reflektton prioritet e tua përdorimi yt i kohës?
- A është Perëndia pika e referimit e të gjitha gjërave që ti bënë? Shpjego.
- Cilat fusha të marrin më së shumti vëmendje dhe kohë? Cilat fusha ke tendenca t'i neglizhosh? Çfarë efekti ka në ty ky mosbalancim? Po në familjen tënde? Po tek bashkëpunëtorët e tu?
- Çfarë hapa mund të marrësh që të sjellësh një bilanci më të madh në jetën tënde?

Përcaktimi i qëllimeve

Jetët tona, për ne si besimtarë, i takojnë Perëndisë, dhe Perëndia duhet të jetë pika referuese në gjithçka që bëjmë. Jeta duhet të jetohet me qëllimin për ta përlëvdur Perëndinë, dhe ky qëllim duhet të reflektohet në zgjedhjet që bëjmë, mënyrën se si e shpenzojmë kohën, dhe në atë se si i shfrytëzojmë pasuritë tona. Sapo të kemi vendosur se këto janë prioritetet tona, është e rëndësishme që të marrim hapin tjetër për të përcaktuar qëllimet që do të na ndihmonin të jetonim në bazë të prioriteve tona.

Ndoshta ti si prind, si punëtor i kishës, apo si një punëtor tjetër ke disa qëllime të përgjithshme në mendjen tënde, mirëpo shpesh, ne kemi tendenca që të pushtohemi nga aktivitetet e ditës dhe kështu mund të humbasim shumë raste për të përmbushur qëllimet tona të vërteta. Shumë prindër, për shembull, kur fëmijët e tyre arrijnë moshën e adoleshencës, e kuptojnë se ata i kanë neglizhuar shumë aspekte të caktuara të trajnimit të fëmijëve të tyre. Një pastor mund ta kuptojë se nuk ka arritur të jap mësim në lidhje me të vërteta kyçe në kishë për shkak se ka qenë i nxënë me shumë aktivitete apo me zgjidhjen e problemeve. Për këtë arsye është e rëndësishme që ne të mendojmë rreth qëllimeve të jetës sonë.



1. Merr ca minuta për të menduar se çfarë do që Perëndia të bëjë në ty dhe nëpërmjet teje gjatë jetës tënde.
2. Shiko përsëri listën e dhuntive dhe aftësive që Perëndia të ka dhënë ty në rrethanat dhe vendndodhjet e caktuara të jetës tënde.
3. Shiko secilën prej shtatë fushave të përgjegjësisë të cilat i diskutuam tek pjesa me titullin “Përcaktimi i prioriteteve” dhe mundohu që të shkruash një qëllim të jetës për secilën nga këto fusha. Një shembull nga fusha e jetës tënde familjare mund të jetë *t’i trajnosh fëmijët e tu që ta duan Zotin dhe që t’i ndjekin rrugët e Tij*.

Pasi t’i kesh shkruar këto shtatë qëllime të jetës, hapi tjetër është që t’i transmetosh këto qëllime të jetës në plane specifike duke krijuar kështu qëllime të ndërmjetme të cilat do të na shpien në drejtim të përmbushjes së këtyre qëllimeve të jetës. Këto qëllime të ndërmjetme të jetës tregojnë se çfarë duhet të bësh gjatë vitit të ardhshëm për të shkuar në drejtim të qëllimeve të jetës tënde. Për shembull, ti mund të kesh dëshirë që gjatë vitit të ardhshëm t’i mësosh fëmijëve të tu rreth karakterit të Perëndisë, çka do të ishte një hap në procesin e trajnimit të tyre për ta dashur Perëndinë. Një qëllim në lidhje me punën mund të ishte të kesh një qëndrim më të mirë në punë, duke punuar për t’i sjell Perëndisë lavdi.

Hapi tjetër është që t’i transmetojmë qëllimet tona të ndërmjetme në qëllime të menjëhershme, të cilat reflektohen në mënyrën se si e shpenzojmë kohën tonë. Për shembull, nëse qëllimi yt është t’i trajnosh fëmijët e tu që ta duan Zotin, atëherë çfarë plane do të marrësh, gjatë javës apo muajit të ardhshëm, për ta zbatuar planin tuaj? Shiko tabelën e planifikimit tuaj javor për të vlerësuar se çfarë ndryshime ke nevojë të bësh në përdorimin e kohës për të përmbushur këto qëllime të menjëhershme.

Ne kemi diskutuar më herët që disa prioritete në stinë të ndryshme të jetës janë më të rëndësishme. Nevoja të veçanta në familjen tënde mund të kërkojnë që ju të fokusoheni në një fushë dhe të ndërprisni fokusin nga të tjerat. Si të krishterë është e

rëndësishme të vlerësojmë ku janë më së shumti të nevojshme koha dhe vëmendja jonë aktualisht, si dhe të shqyrtojmë qëllimet dhe prioritetet tona në baza ditore.

Bëje zakon që të marrësh kohë çdo vit, mbase në fillim të vitit, për të vlerësuar vitin e kaluar nën dritën e qëllimeve të jetës tënde dhe të planifikosh qëllime të mëdha për vitin e ardhshëm. Shqyrto veten për të parë se ç'progres është zhvilluar në ty. A ke nevojë që t'i ndryshosh disa nga qëllimet e jetës tënde? Burrat dhe gratë, duke praktikuar këtë shembull si çift, mund të përfitojnë mjaft shumë, po ashtu pastorët mund të kenë dëshirë të zbatojnë një kohë të njëjtë për të shqyrtuar prioritet dhe qëllimet e tyre së bashku me udhëheqjen e kishës së tyre.



Lavdëroje Perëndinë për dhuratën e kohës. Kërko nga Ai që të të ndihmojë të bëhesh një administrator më i mirë i kohës, dhe që prioritetet e Tij, t'i bësh prioritetet e tua.

Administrimi: Përshkrimi i punës sonë

Ne e kemi shikuar gjithë jetën e besimtarit si një jetë e administrimit të Perëndisë, duke përfshirë çdo fushë të jetës sonë, që nga përdorimi i pasurive materiale deri në përdorimin e trupave tanë, kohës tonë, talenteve, dhuntive, dhe bile edhe përvojave të jetëve tona. Ne jemi thirrur që t'i paraqesim trupat tanë si fli të gjalla dhe të vazhdueshme për Perëndinë. Kjo nënkupton t'i japim Atij gjithçka që jemi dhe gjithçka që kemi dhe ta lejojmë Atë që të na përdorë.

Tek 1 Korintasve 4:2 Pali përcakton kërkesat për punën e një administratori: “E tjetra që kërkohet nga administratorët, është që secili të gjendet besnik.” Teksa Perëndia i jep secilit besimtar detyrën për të qenë administratorë të pasurive që Ai na ka dhënë. Ai nuk është duke i kërkuar njerëzit më të mençur, më të arsimuar, më të bukur, më energjetikët, apo më të fuqishmit. **Ai është duke kërkuar një person, i cili do të jetë një administrator besnik.** Ai është duke i kërkuar ata që do të punojnë me përlësi të qetë dhe që do të jenë besnik ndaj detyrave për të cilat i ka thirrur.

FUSNOTAT

¹ *Random House Dictionary of the English Language* (New York: Random House, 1968).

² Mat 23:23 (krahaso Luka 11:42); Luka 18:12; Heb 7:1-10.

³ Shiko gjithashtu Fil.4:15-19.

⁴ J. Grant Howard, *Balancing Life's Demands: A New Perspective on Priorities* (Portland, OR: Multnomah, 1983), 51-54.

Ta kuptosh vuajtjen

Përafërsisht para gjashtë muajve, Xhorxhi e humbi punën e tij, edhe pse ka qenë mjaft i zellshëm për të kërkuar punë, ai prapë se prapë nuk ka pasur mundësi të gjej ndonjë punë. Ai dhe gruaja e tij i kanë harxhuar të gjitha kursimet e tyre; teksa faturat vazhdojnë të vijnë në shtëpi, ata tani më nuk dinë se si të vazhdojnë të jetojnë dhe si ta mbështesin familjen e tyre. Gruaja e tij Ivana sapo është diagnostifikuar me një sëmundje në zemër dhe ajo mund të punoj vetëm ndonjë punë të vogël. Nëna e Ivanës është keqësuar fizikisht dhe nuk mund të jetojë më vetëm, andaj ata e kanë ftuar atë që të jetojë me ta, edhe pse në anën tjetër shtëpia e tyre është e vogël dhe kjo nënkupton se atyre u duhet një nevojë më e madhe për t'u përshtatur. Xhorxhi dhe Ivana luten çdo ditë që Perëndia të furnizojë për nevojat e tyre, mirëpo situata e tyre duket se çdo herë po përkeqësohet më shumë. Vëllai i madh i Xhorxhit, i cili nuk është besimtar, ka komentuar më shumë se një herë, “Çfarë keni përfituar nga besimi? Si ju ka ndihmuar ai?”

Si mendoni se të kesh një pikëpamje biblike për vuajtjen mund të inkurajonte Xhorxhin dhe Ivanën që të durojnë dhe të rezistojnë gjatë vuajtjeve që ata janë duke u ballafaquar?



Ky mësim paraqet një perspektivë biblike mbi vuajtjen, duke e shikuar në mënyrën se si Perëndia e inkorporon atë sot në planin që Ai ka për jetët tona. Ne do ta kthejmë vëmendjen tonë në ditët e ardhme, kur për të krishterët, e tërë vuajtja dhe dhimbja do të largohen dhe ne do të marrim shpërblimet për besnikërinë tonë kur kemi qëndruar në mesin e vuajtjes. Pasi t'i kemi marrë parasysh këto perspektiva themelore të vuajtjes, ne do të shqyrtojmë gjashtë mënyra të mundshme që Perëndia përdor vuajtjen në jetët tona dhe në jetët e të tjerëve. Përfundimisht, ne do të fokusohemi në atë se si përcakton qëndrimi ynë, që kemi ndaj vuajtjes, atë çfarë do të përfitojmë prej vuajtjes.

Përmbledhje e mësimit

Perspektivat biblike mbi vuajtjen

Origjina e vuajtjes

Përdorimi i vuajtjes nga Perëndia

Fundi i vuajtjes

Gjashtë qëllimet e vuajtjes

Vuajtja mund të ofrojë një platformë për ungjillëzim

Vuajtja mund të ofrojë një mundësi për ndërtimin e besimtarëve

Vuajtja mund të rafinojë karakterin dhe prioritetet tona

Vuajtja mund të rafinojë pikëpamjen tonë për Perëndinë

Vuajtja mund të na dispiplinojë për mosbindje

Vuajtja mund të na mësojë që të kujdesemi dhe të ngushëllojmë

Reagimi ynë ndaj vuajtjes

Përgatitja për vuajtjen

Luftimi i vuajtjes

Mendime përmbyllëse

Qëllimet e mësimit

Kur ta keni përfunduar këtë mësim, ju do të jeni në gjendje që:

1. Të shpjegoni origjinën e vuajtjes
2. Të bëni një përmbledhje në lidhje me gjashtë qëllimet përse Perëndia e lejon vuajtjen
3. Të analizoni së paku një shembull për secilin qëllim se si Perëndia e ka përdorur vuajtjen në jetën tënde apo në jetën e dikujt tjetër për të ilustruar përfitimin tënd apo të dikujt tjetër dhe se si Perëndia është përlëvduar.
4. Të vlerësoni përgatitjen dhe reagimin tuaj ndaj vuajtjes, bazuar në atë që ke mësuar nga Fjala e Perëndisë teksa edhe e keni studiuar këtë mësim.

Perspektivat biblike mbi vuajtjen

Sa më i qartë që të
jetë perceptimi i
realitetit dhe i
Perëndisë dhe botës
së Tij, aq më lehtë ju
do të mund të merreni
me dhimbjen dhe me
vuajtjen.

Çdo qenie njerëzore në një kohë apo tjetër ka luftuar me realitetin e dhimbjes dhe të vuajtjes në botë. Pikëvështimi nga i cili ti e shikon vuajtjen do të ndikojë në reagimin tënd ndaj saj. Sa më i qartë që të jetë perceptimi i realitetit dhe i Perëndisë dhe botës së Tij, aq më lehtë ju do të mund të merreni me dhimbjen dhe me vuajtjen.

Mendoni rreth Jobit. Teksa pikëpamja e tij për Perëndinë kishte nevojë të zgjerohej më shumë, ai e dinte se të gjitha gjërat vijnë nga Perëndia dhe se Ai ka një të drejtë të përkryer që të bëjë me atë që është e Tij çfarëdo që t'i pëlqejë Atij. Ai gjithashtu e dinte se Perëndia nuk ndryshon kurrë, dhe se nëse Perëndia është i denjë për t'i shërbyer në kohëra të mira, ai po ashtu është i denjë t'i shërbehet edhe në kohëra të vështira (Jobi 1:21; 2:10). Ajo që i dha forcë Jobit për të qëndruar një ndër kohërat më të vështira të imagjinueshme, ishin kuptimi që ai kishte për Perëndinë dhe besimi i tij në karakterin e Perëndisë.

Fatkeqësisht, një perspektivë e balancuar në mes të dhimbjes është më e lehtë të thuhet se sa të ruhet. Vuajtja ka një mënyrë të tillë që zbeh pamjen tonë që kemi për Perëndinë dhe realitetin. Kur vuajtja vazhdon, ne ngadalë mund të fillojmë të zhytemi në rërën e cekët të vetë-keqardhjes dhe të shndërrohemi dukshëm në analizues të brendshëm të vetes. Ne mund të fillojmë të humbasim idenë tonë për të vërtetën. Ne mund të fillojmë të shpikim gënjeshtër, si “Askush nuk e di dhe nuk shqetësohet në lidhje me atë që jam duke kaluar,” “Zoti nuk më do më,” apo “Perëndia është duke më dënuar me më shumë dhimbje nga që mund të duroj.” Ne mund të kemi ndjenjën se askush nuk ka vuajtur më shumë se sa ne në këtë moment. Le t'i shohim disa aspekte të vuajtjes, të cilat do të na ndihmojnë që të sqarojmë perspektivën tonë.

Origjina e vuajtjes

A ju kanë pyetur ndonjëherë, “Si mundet një Perëndi i drejtë dhe i dashur të lejojë kaq shumë vuajtje në botë?” Zakonisht, diku mbrapa kësaj pyetje ekziston nocioni se vuajtja ka ekzistuar gjithmonë dhe se Perëndia është drejtpërsëdrejti përgjegjës për ekzistencën e saj. Mirëpo, Bibla e shpall të rrejshme një deklaratë të tillë. “Pastaj Perëndia tha, ‘Le të bëhet vuajtja dhe vdekja,’” Gjithçka që Ai kishte krijuar ishte shpallur si shumë e mirë. Ne duhet të shohim diku tjetër për ekzistencën e vuajtjes.

Në faqet e para të Biblës ne shohim se para se gjithash Adami ishte ai, i cili ishte përgjegjës për vuajtjen dhe dhimbjen! Gjithçka ishte shkaktuar nga ai (Zan.3:1-19). Perëndia jo vetëm që dëshiroi ta parandalojë atë që të mos e përjetojë vuajtjen dhe dhimbjen, Ai madje shkoi aq thellë sa që e paralajmëroi atë në lidhje me të. Mirëpo, ai

insistoi që të luajë me zjarrin e mosbindjes dhe përfundoi jo vetëm duke djegur vetveten, mirëpo ia vuri zjarrin tërë krijimit.¹ Rënkimin e dhimbshëm të botës, që Pali përmend tek Romakëve 8:22 kishte filluar atë ditë, mijëra vite më parë, kur Adami dhe Eva morën një hap, i cili rezultoi në agoninë njerëzore përtej çdo kalkulimi.

Tek Zanafilla 3:4-5, Satani, duke folur nëpërmjet gjarprit, kishte vënë një kurth duke treguar gënjeshtrenë më të madhe të të gjitha kohërave. Ai jo vetëm që premtoi se Adami dhe Eva nuk do të vuanin dhe nuk do të vdisnin, por ai u tha atyre që jetët e tyre do të ishin shumë më të mira nga që kishin pasur deri atë kohë. Duke u ofruar atyre prospektin e parajsës, ai i joshi ata me epërsinë e humnerës së ferrit.

Megjithatë, në një mënyrë të prishur, ajo që Satani premtoi, edhe u bë realitet. Sytë e tyre **u hapën**. Ata **u bënë** si Perëndia, duke e njohur të mirën dhe të keqën. Ama çfarë perëndi të mjerë dhe të paafte që u bënë! Dhe çfarë çmimi ishte vënë për tërë njerëzimin: mijëra vite të vuajtjes dhe vdekjes dhe një përjetësi me vuajtje, dhe vdekje e pambarim në ferr. Në mëshirën e Tij të madhe, Perëndia përplot hir ndërhyri për të shpëtuar ata që kthehen tek Ai në besim.

Prandaj, e tërë vuajtja dhe vdekja e kanë origjinën e tyre nga mëkati.² Ekzistenca e vuajtjes dhe vdekjes, dëshmon mbi rezultatin e tmerrshëm të rebelimit kundër Perëndisë, Krijuesit. Kështu, sa herë që dëgjojmë apo përfetojmë ndonjë vuajtje dhe dhimbje të madhe, reagimi ynë i parë nuk duhet të jetë “Shih sa i padrejtë është Perëndia!” por e kundërta “Shih sa i keq që është mëkati!” Çfarëdo tjetër që të mësojmë nga vuajtja, ajo vazhdimisht duhet të na kujtojë pasojën e deklaratës së pavarësisë se Adamit nga plani i Perëndisë.

Reagimi ynë i natyrshëm ndaj vuajtjes dhe vdekjes është ose të pretendojmë se ato nuk ekzistojnë ose t’i shmangemi me çdo kusht ballafaqimit të tyre. Kur jemi të detyruar të luftojmë me vuajtjen dhe vdekjen, ne mundohemi të zbusim realitetin apo ta zbukurojmë atë sa më shumë që të mundemi. Për shembull, tek disa kultura, në funerale kufomat vishen ashtu që të duken sikur janë thjeshtë duke fjetur në paqe. Duket sikur thellësisht përbrenda e dimë se diçka nuk është në rregull me botën, mirëpo ne mundohemi ta anashkalojmë këtë. Shumë shpesh edhe ne besimtarët në po të njëjtën mënyrë merremi me vuajtjen dhe me vdekjen. Ne do ta shohim më afër këtë çështje në pjesën e fundit të këtij mësimi.

Përdorimi i vuajtjes nga Perëndia

Edhe pse bota vazhdon akoma të tundet nga ajo ditë tragjike në kopshtin e Edenit, Perëndia vazhdon të jetë nën kontroll! Gjithçka nuk ka humbur! Perëndia në urtësinë e Tij e ka përfshirë mëkatën dhe vuajtjen në qëllimin e Tij për t'i sjell Vetes lavdi duke rritur reputacionin e Tij në mesin e njerëzve. Vuajtja është një megafon të cilin Perëndia e përdor për të tërhequr vëmendjen tonë dhe për të na mësuar më shumë rreth Vetes së Tij. Ai dëshiron që të gjithë njerëzit t'i shohin atributet e Tij qartë dhe të pranojnë madhësitë e Tij.

Vuajtja është një
megafon të cilin
Perëndia e përdor për
të tërhequr vëmendjen
tonë dhe për të na
mësuar më shumë rreth
Vetes së Tij.

Satani në anën tjetër mundohet ta kthejë këtë efekt të megafonit (duke tërhequr vëmendjen), duke përdorur vuajtjen për të zvogëluar Perëndinë në sytë e botës. Kur jemi duke vuajtur, ai mundohet të na bind që Perëndia e ka humbur kontrollin dhe se vuajtja jonë është një rezultat i menaxhimit të Tij të dobët i ngjarjeve të universit. Ai gjithashtu mundohet të na bind se Perëndia është një Perëndi i ashpër dhe që gjen kënaqësi duke na bërë neve të vuajmë apo që Ai është i dobët dhe i paaftë që të parandalojë vuajtjen. Prandaj, ne e shohim potencialin e lartë të vuajtjes ose për të zmadhuar pikëpamjen tonë për Perëndinë ose për ta shtrembëruar atë.

Le të shkojmë tek libri i Jobit për të shqyrtuar këtë më me kujdes.



Lexo Jobi 1:6-2:10.

1. Çfarë dëshmon leja që Perëndia i dha Satanit për ta munduar njeriun më të mirë të kësaj kohe në lidhje me qëndrimin e Perëndisë ndaj Jobit?
2. Bëjë një përmbledhje të përgjigjes së Jobit ndaj mundimeve të tij dhe çfarë tha ai në lidhje me Perëndinë?

Që nga fillimi i tregimit të Jobit, është e qartë se Perëndia ka qenë nën kontroll të plotë të situatës. Satani nuk bëri asgjë pa lejen e Perëndisë. Perëndia i përcaktoi kufijtë e vuajtjes së Jobit në bazë të urtësisë dhe mirësisë së Tij.³ Duke i njohur këto gjëra, ne mund të ngushëllohemi shumë në mesin e mundimeve tona.

Jo vetëm që Perëndia vazhdon të jetë nën kontroll, mirëpo dashuria e Tij për ne kurrë nuk ndryshon, bile as edhe në mesin e vuajtjeve. Ashtu siç do ta shohim më vonë, edhe nëse njëra nga qëllimet e vuajtjes është për të na disiplinuar neve për shkak të mosbindjes sonë, prapë se prapë dashuria e Perëndisë mbetet e pandryshuar. Ky fakt është vendimtar për të kujtuar nëse shpresojmë ta ruajmë besimin në mesin e vuajtjes. **Asgjë nuk hynë në jetën e besimtarit nëse së pari nuk ka kaluar nëpër duart e urta dhe të dashura të Perëndisë (Rom 8:28).**

Kur ne vuajmë, Perëndia na pëshpëritë në njërin vesh, “Unë akoma të dua dhe vazhdoj të kem besim në aftësinë tënde për t’u rritur nëpërmjet kësaj me anë të vënies së besimit në Mua.” Por, në të njëjtën kohë Satani pëshpërit në veshin tjetër, “Perëndia të urren! Për çfarë tjetër do të të vendoste nëpër tërë këtë dhimbje dhe pse do ta shkatërronte jetën tënde? Çfarë Perëndie do të lejonte që një gjë e tillë të të ndodhte ty?”

Kështu, në masë të madhe rritet reputacioni i Perëndisë në sytë e atyre që janë përreth nesh, teksa na shohin duke ndjekur shembullin e Jobit dhe duke kaluar me durim vuajtjen. Ata e shohin se Perëndia jonë është aq i madh sa që ne vazhdojmë ta adhurojmë dhe lavdërojmë Atë pa marrë parasysh se sa e vështirë mund të jetë rrethana në të cilën jemi duke kaluar. Mu për këtë arsye, Perëndia shpesh **nuk** do të na çlirojë ne nga ndonjë mundim, në mënyrë që njerëzit të kenë mundësi të lavdërojnë Atë teksa edhe shohin hirin e Tij që na mundëson të qëndrojmë me plot durim.

Ndonjëherë është vullneti i Perëndisë që ne të mbetemi në situata të vështira dhe të dhimbshme në vend se të na çlirojë në mënyrë të mrekullueshme nga ato situata. Pyetja nuk është se a mundet apo jo të na çlirojë, mirëpo si mund të marrë Ai lavdinë më të lartë nga e tërë kjo situatë?



Lexo 2 Korintasve 12:7-10.

1. Gjembim mbeti, por çfarë ndryshoi në jetën e Palit?
2. Si e rrisin mundimet dhe dobësitë hirin dhe fuqinë e Perëndisë?

Kështu, ne e shohim se Perëndia nuk ka nevojë të na shërojë neve në mënyrë të mrekullueshme apo të na çlirojë nga ndonjë mundim i caktuar në mënyrë që njerëzit të shohin fuqinë e Tij. Është e vërtetë që fuqia e Tij e madhe manifestohet kur Ai kryen këto shërime të mrekullueshme, mirëpo kjo nuk nënkupton se fuqia e Tij nuk mund të demonstron në mënyrë të barabartë apo edhe në masë më të madhe, kur na mundëson t’i përgjigjemi plot gëzim edhe testeve më të vështira.

Fundi i vuajtjes

Jo qëndrueshmëria e kësaj jete bëhet më e dukshme kur ne përballemi me vuajtjen. **Vuajtja ka një mënyrë të humbjes së lidhjeve tona me këtë botë dhe të fokusimit të syve tanë në pritje të shtëpisë sonë të vërtetë në parajsë, atje ku më nuk ka nevojë të ketë dhimbje.**

Realiteti i shpërblimeve të parajsës na bënë që të qëndrojmë në mesin e vështirësive tona. Vuajtjet tona nuk kalojnë të pavërejtura nga Perëndia. Ne pamë tek Hebrejët 11 se Ai regjistron çdo reagim tonin ndaj vuajtjeve, pa marrë parasysh nëse janë të mëdha apo të vogla, dhe në bazë të tyre edhe do të na shpërblejë. Një atlet, i nxitur nga shpresa për të

fituar çmimin, është i gatshëm që të kalojë të gjitha llojet e mundimeve fizike. Një nënë, e nxitur nga shpresa për të sjellë në botë një jetë të re, në të njëjtën mënyrë është e gatshme të durojë dhimbjen dhe vështirësitë e lindjes. Sa shumë inkurajim që mund të gjejmë në vuajtje, duke ditur që shpërblimi ynë është shumë më i lartë nga ajo që kemi përjetuar.

Dhiata e Re, gjatë diskutimit të saj në lidhje me vuajtjen dhe persekutimin, shpesh na e paraqet konceptin e qiellit dhe të shpërblimeve. Në anën tjetër, shpërblimet nuk paraqiten si arsyeja më e lartë e durimit të vuajtjeve. Perëndia ynë i madh meriton besnikërinë dhe bindjen tonë, pa marrë parasysh se sa shpërblime do të marrim ne. Më saktë, shpërblimet duhet të shikohen thjeshtë si shenja të mirënjohjes së Perëndisë për shërbim me besnikëri. Ato ofrojnë një stimulim shtesë kur kohët të bëhen të vështira.⁴



Lexoni Romakëve 8:18-25, një ndër pasazhet klasike që ndërlidhin vuajtjen me të ardhmen tonë, apo gjendjen tonë të lavdishme, dhe 2 Korintasve 4:16-18.

1. Përse krijimi i tanishëm është duke pritur me padurim zbulesën e bijve të Perëndisë?

2. Si na inkurajon Pali në këto pasazhe që të këmbëngulim në vuajtjet tona?

Sa i përket vuajtjeve të së ardhmes, Dhiata e Re e bënë të qartë që për besimtarët dhimbja dhe vuajtja, si dhe vetë vdekja, janë të dënuara dhe nuk do të ekzistojnë më. Për ne vuajtja është e përkohshme ashtu siç është edhe kjo botë e tanishme. Vuajtja nuk është pjesë e planit të përsosur të Perëndisë për të ardhmen tonë.⁵



Supozo që dikush vjen tek ti dhe të pyet, “Nëse Perëndia është i drejtë dhe i dashur, përse në botë ka kaq shumë vuajtje?” Bazuar në materialin që ke lexuar në këtë mësim, si do t’ju përgjigjeshe kësaj pyetje?

Gjashtë qëllimet e vuajtjes

Vargu i mirënjohur tek Romakëve 8:28 “Dhe ne e dimë se të gjitha gjëra bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të tij” nënkupton se Perëndia e përdor edhe vuajtjen në një mënyrë të mirë dhe kuptimplote në jetët tona.⁶ Ky fakt është parë qartë në diskutimin tonë rreth asaj se Perëndia e përdor vuajtjen. Tani dëshirojmë t’i shikojmë më nga afër gjashtë qëllimet përse Perëndia ndonjëherë lejon që vuajtja të na prekë neve.

Perëndia ka një qëllim në çdo gjë që Ai bënë. Kur reagojmë ndaj vuajtjes me pranim dhe me besim në sovranitetin e Perëndisë, ne bashkëpunojmë me Perëndinë për të përmbushur qëllimet e Tij përderisa Ai lejon që ne të kalojmë nëpër vuajtje. Kjo nuk do të

thotë se sa herë që të na ndodh diçka, Ai domosdoshmërisht është duke u përpjekur të na mësoj diçka. Sigurisht që ne duhet të kërkojmë urtësi në mesin e vështirësive tona, në mënyrë që të mund të bëjmë dallimin, me aq sa të kemi mundësi, nëse Perëndia është duke u munduar të na e tërheq vëmendjen për ndonjë qëllim specifik. Mirëpo, ne nuk duhet të presim që Perëndia të na japë një llogari të plotë dhe të detajuar në lidhje me veprimet e Tij.

Ky ishte edhe momenti kur Jobi filloi të humbas rrugën e tij.⁷ Perëndia është Sovran, që do të thotë se Ai është nën kontroll të secilit detaj në jetët tona dhe Ai ka një qëllim specifik dhe të mençur në çdo gjë që do të na dal në rrugën tonë. Mirëpo, Ai jo çdo herë zgjedh që të na e bëjë të ditur qëllimin e Tij specifik. Zakonisht, ne duhet të jemi të kënaqur nëse i kemi të njohura qëllimet e përgjithshme të Perëndisë në lejin e vuajtjes.

Një gjë e rëndësishme për të kujtuar është se vuajtja, ashtu si jeta vetë, e humb tërë kuptimin nëse një Perëndi i dijshtëm dhe i plotfuqishëm nuk do të ishte nën kontroll.⁸ Në të vërtetë, tragjeditë më të vështira për t'u pranuar janë ato që në sipërfaqe duken të kenë qenë gabime kolosale dhe absolutisht të pakuptimta. Mirëpo në këto kohëra ne duhet ta pezullojmë gjykimin deri në atë ditë kur të gjitha faktet do të dalin në dritë. Atëherë ne do ta kuptojmë se Perëndia e ka ditur çfarë ka qenë duke bërë.

Perëndia është Sovran, që do të thotë se Ai është nën kontroll të secilit detaj në jetët tona dhe Ai ka një qëllim specifik dhe të mençur në çdo gjë që do të na dal në rrugën tonë. Mirëpo, Ai jo çdo herë zgjedh që të na e bëjë të ditur qëllimin e Tij specifik.



Merr disa minuta, para se të fillosh të lexosh më tutje, dhe mendo në lidhje me një vështirësi të tanishme në jetën tënde apo të dikujt tjetër, që ty të duket se është një “aksident” mizor.



Pusho për një minutë dhe falënderoj Zotin që Ai është Sovran dhe një Zot të cilit mund t'i besosh. Kërkoj që ta rifreskojë besimin tënd nën kontrollin e Tij sovran dhe të qëllimshëm të situatës.



Teksa i studion “Qëllimet e Vuajtjes” të paraqitura në këtë mësim, ndaj disa faqe në fletoren tënde dhe shkruaj një paragraf që përmbledh të kuptuarit tënd të secilit qëllim që studion. Do të kthehesh më vonë tek ky informacion dhe do të japësh shembuj në lidhje me secilin prej tyre.

Vuajtja mund të ofrojë një platformë për ungjillëzim

Kur dikush vuan, si të krishterët ashtu edhe jo të krishterët priren që t'i vërejnë ata. Sa më e rëndë që të jetë vuajtja, njerëzit janë aq më të vëmendshëm ndaj çdo fjale që thuhet dhe ndaj çdo reagimi që bëhet. **Nëse të pëlqen apo jo, vuajtja të nxjerrë në skenë para një bote që të vështron.**



Lexo Veprat e Apostujve 16:19-34, ku regjistrohet burgimi i Palit dhe Silas

1. Sipas të gjitha gjasave, cilat fakte i shtyn të burgosurit t'i dëgjojnë me më shumë vëmendje Palin dhe Silan teksa po luteshin dhe po këndonin?
2. Si mendoni, çka e kishte përgatitur zemrën e rojtarit të burgut që ta kërkonte dhe të besonte në Krishtin?

Duke parë një njeri duke vuajtur pafajësisht dhe me plot durim, ishte ngjallur edhe interesi i një jobesimtari (shiko Veprat 7). Ky lloj reagimi është aq i rrallë në botë sa që bota nuk ka një kategori nën të cilën t'i klasifikojë ata. Kur ne "i kthejmë faqen tjetër" dhe lutemi e i duam armiqtë tanë, jobesimtari detyrimisht do të pyes, "Çfarë lloj njeriu është ky? Ku e gjen forcën të përgjigjet në këtë mënyrë? Hamendem, a thua si mund ta duan Zotin në mesin e një vuajtje aq të padrejtë!" Jobesimtari mund të fillojë të mendojë se më në fund ka diçka të vërtetë tek krishterimi dhe thotë, "Perëndia yt duhet të jetë i madh nëse ti vazhdon t'i shërbesh Atij edhe kur duket se Ai është duke të dënuar pa asnjë arsye!"

Satani dhe persekutorët tanë në botë e shohin vuajtjen si një mjet për ndalimin e përhapjes së ungjillit. Mirëpo zakonisht ndodh e kundërta. **Historia e kishës vazhdimisht ka dëshmuar se gjaku i martirëve është fara e kishës. Aty ku ka ndodhur persekutimi i madh, aty është përhapur ungjilli fuqishëm.**

Vuajtja mund të ofrojë një mundësi për ndërtimin e besimtarëve

Kur një besimtar vuan, besimtarët e tjerë e kanë mundësinë që të mësojnë nga një shembull i gjallë mbi tejkalimin e vështirësive të jetës me durim.



Lexo 1 Pjetri 2:11-25.

1. Për çfarë qëllime thotë Pjetri se jemi thirrur ne?
2. Përse mendoni se Pjetri e paraqet shembullin e vuajtjes së Krishtit në këtë diskutim?
3. Në çfarë mënyra do të mund të inkurajonte vuajtja jonë besimtarët e tjerë?

Nga shembulli i Jezusit, dishepujt mësuan shumë në lidhje me durimin e vuajtjeve, dhe rrjedhimisht edhe ata u bënë një shembull i tillë për të tjerët.

Vuajtja e besimtarëve ka një efekt tepër të madh tek besimtarët. Një shembull të tillë ne kemi tek Veprat e Apostujve 17:1-10 dhe 1 Thesalonikasve 1:1-2:2. Pali dhe Silas, pasi që ishin burgosur dhe rrahur rëndë në Filipi, vazhduan të jenë besnik në shpalljen e ungjillit. Shpërblimi i tyre ishte në kontrast shumë të madh në Selanik. Mirëpo, ata vazhduan të papërkulur, duke ndjekur hapat e Krishtit.

Reagimi i Palit dhe Silas nuk kaloi pa u vënë re nga Selanikasit. Ata besnikërisht imituan shembullin e Palit dhe të shokëve të tij, kur vetë u përballën me persekutimin. Mirëpo gjithçka nuk mbaroi këtu. Reagimi i Selanikasve ndaj persekutimit u bë i njohur tek njerëzit në mbarë atë regjion. Vetë Pali, teksa udhëtoi dhe foli anembanë nëpër kisha, me krenari e përmendi qëndrueshmërinë dhe besimin e tyre në mesin e vuajtjeve që kishin kaluar.

Vini re reagimin zinxhiror që ofron shpesh vuajtja. Ashtu siç përhapen lajmet sikur valëzimet e ujit në një liqe, po kështu shumë besimtarë kanë rastin të mësojnë për Perëndinë si dhe rreth mënyrave se si të reagojnë ndaj vuajtjeve të tyre. Disa, sikurse Jobi, bile e kanë edhe privilegjin, t'u regjistrohet vuajtja e tyre në mënyrë të përhershme, në mënyrë që efekti i saj t'i arrij gjenerata të tëra. Ashtu si Jobi, i cili qe ulur i qetë mbi një grumbull me hi diku në tokën e Uzit dhe nuk e pati as edhe një ide që një ditë pas shumë shekujsh durimi i tij dhe reagimi përplot adhurim ndaj vuajtjes së madhe do të inkurajonte besimtarët dhe do të vazhdonte kështu t'i sillte lavdi Perëndisë! Qofshim edhe ne ashtu sikurse Jobi, besnik në mesin e vuajtjeve tona! Le të shpresojmë se do t'i japim syve të botës që na vështron, një shembull, i cili do të jetë i denjë për t'u ndjekur!



Çfarë shembuj të vuajtjes, në jetën besimtarëve apo jobesimtarëve që t'i njeh kanë ndikuar në besimin tënd? Si të sfidon ky mësim?



Falënderoj Perëndinë për ata që kanë kaluar para teje nëpër shtegun e vuajtjes, duke të dhënë një shembull të besimit dhe besnikërisë ndaj Krishtit.

Vuajtja mund të rafinojë karakterin dhe prioritetet tona

Perëndia shpesh e përdor vuajtjen për të rafinuar dhe pastruar karakterin tonë. Ai gdhend ato pjesë të karakterit tonë, të cilat nuk reflektojnë imazhin tonë, dhe për këtë Ai përdor vuajtjen si një mjet. Në një kuptim apo tjetër, secili prej nesh është akoma në ndërtim e sipër.



Lexo Jakobi 1:2-4 dhe 1 Pjetri 1:6-7. Si mendoni që kontribuon testimi në zhvillimin e karakterit të perëndishëm?


Këto cilësi dhe perspektiva të karakterit, janë diçka që ne si të krishterë të gjithë i dëshirojmë. Ama, vini re çmimin, i cili është i ngjitur pas tyre. **Ne duhet të jemi gati që të vuajmë dhimbjen në ndonjë mënyrë para se të ndodh rritja në jetët tona.** E parë në këtë dritë, vuajtjet mund dhe duhet të prodhojnë gëzim, në vend të ankthit, hidhërimit dhe zemërimit.

Perëndia dëshiron të ndërtojë karakterin tonë nëpërmjet vuajtjes.

Perëndia dëshiron të ndërtojë karakterin tonë nëpërmjet vuajtjes. Satani dëshiron ta shkatërroj atë. Nën këtë ndriçim, çdo vuajtje mund të vështrohet nën kategorinë e testimit të besimit tonë. Në mësimin 6 ne e definuam testin si “një përvojë të vështirë nëpërmjet së cilës zbulohen vlerat, zotimet dhe besimet e vërteta të një personi.”⁹ Jo çdo test përfshin në vete vuajtje, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, mirëpo çdo vuajtje mund të shikohet si një lloj testimi i besimit. Kur ne vuajmë, ne kemi zgjedhjen për t’ju bindur Perëndisë në besim apo ta dëgjojmë Satanin në mosbesim. Ne mund ta lejojmë Perëndinë që të përmbush qëllimet e Tij për të zhvilluar durimin dhe qëndrueshmërinë në jetët tona, apo në të kundërtën ne mund të zgjedhim që të zemërohemi. Ne mund të rritemi, të stagnojmë, apo të zbrapsemi. Reagimi ynë është zgjedhja jonë.

Vetëm vuajtja nuk e prodhon karakterin në jetët tona; më saktë, është mënyra se si reagojmë ndaj vuajtjes, ajo që në të vërtetë e prodhon karakterin. **Pra, një mënyrë për ta parë vuajtjen dhe tundimin është si një mundësi për t’u rritur. Perëndia e lejon vuajtjen, tundimin dhe testimin që të vijnë në jetët tona, me shpresën që rritja do të tregojë rezultatin e saj teksa ne përgjigjemi në besim. Sapo të kalohet një test, ne duhet të jemi të sigurt, se një tjetër test është rrugës duke ardhur për të na nxitur në rritje të mëtutjeshme.**

Reagimet ndaj Vuajtjes



Vuajtja gjithashtu bënë që ne të shqyrtojmë prioritetet tona në jetë. Shpesh herë kur jemi shumë të zënë në jetë, Perëndia mund të lejoj që ndonjë vuajtje të të ndodhë, vetëm sa për të na dhënë pak pushim. Kjo na ndihmon më shumë që t'u kushtojmë më shumë vëmendje prioritetëve tona në jetë dhe na parandalon që të mos përfshihemi në aktivitete periferike që na largojnë nga marrëdhënia e ngushtë me Perëndinë.

Vuajtja gjithashtu na mbanë të zgjuar. Shpesh inxhinierët e autostradave dizajnojnë kthesa nëpër rrugë, për t'i parandaluar ngasësit e makinave nga rënia në gjumë, gjë që shpesh ndodh në udhëtimet nëpër rrugë të gjata dhe të drejta. Rënia në një rehati shpirtërore është gjithmonë një rrezik për të krishterët, mirëpo **vuajtja na motivon për t'u thelluar në Perëndinë më fuqishëm, dhe jo në vetën tonë.**

Vuajtja mund të rafinojë pikëpamjen tonë për Perëndinë

Me anë të vuajtjes, Perëndia na lejon që ta njohim Atë më mirë. Një ndër qëllimet kyçe të Perëndisë kur lejoji Jobin që të vuaj, ishte që të rafinonte pikëpamjen e tij për Perëndinë. Kur u godit nga tragjedia, Jobi dha dëshmi të mjaftueshme që ai e njohte dhe i besonte Perëndisë. Ai e pranoi që Perëndia ishte Zoti i çdo gjëje dhe se ishte i denjë për t'u adhuruar në çdo kohë. Le të shikojmë më tutje përvojën e Jobit për të parë se çfarë mësoi ai rreth Perëndisë teksa kaloi nëpër këtë vuajtje të madhe.



Lexoni Jobi 38:1-11; 40:1-9; dhe 42:1-6.

1. Duke u mbështetur tek Jobi 38:1-4 dhe 40:1-9, bëjë një përmbledhje në lidhje me atë që Perëndia tha për reagimin e Jobit ndaj vuajtjeve të tij.

2. Si mendoni që ndryshoi perspektiva e Jobit për Perëndinë?

Nga fundi i librit duket qartë se Jobi kishte akoma për të mësuar për Perëndinë, rrugët e të cilit janë përtej të kuptuarit *njerëzor*. Jobi, si rezultat i përvojës së tij të dhimbshme kishte arritur ta njoh Perëndinë në një mënyrë shumë më të thellë.



Lexoni 2 Korintasve 1:8-10. Çfarë kishte mësuar Pali gjatë kësaj kohe të vështirë të testimit?



Si e ka zhvilluar vuajtja karakterin apo perspektivën tënde për Zotin?



Fol me Zotin për t'i treguar Atij besimin tënd në qëllimet e Tij të mira që ka për jetën tënde.

Vuajtja mund të na disiplinojë për mosbindje

Në disa raste, vuajtja mund të jetë rezultat i mëkatit në jetët tona, mirëpo jo çdo herë është kështu. Tre shokët e Jobit ishin të shpejtë për të pandehur se vuajtja e Jobit kishte ardhur si rezultat i mëkatit në jetën e tij. Ata menduan se një tragjedi e një përmase të tillë mund të ishte vetëm një dënim nga Perëndia. Mirëpo mendimi i tyre doli se ishte i gabuar, dhe Perëndia e shfaqti bezdinë e Tij për qëndrimet e tyre gjykuese që kishin kundrejt Jobit. Për kundër kësaj, Bibla na tregon se ka kohëra kur vuajtja vije si rezultat i mëkatit.

Në Dhiatën e Vjetër, bekimi përgjithësisht vinte si rezultat i bindjes, ndërkaq mjerimi dhe vuajtja si rezultat i mosbindjes.¹⁰ Perëndia e përdor vuajtjen për t'i vetëdijesuar njerëzit për mëkatet e tyre në mënyrë që ata t'i lënë ato. **Si për besimtarët ashtu edhe për jobesimtarët, kjo lloj vuajtjeje, është me të vërtetë një dëshmi e dashurisë dhe dëshirës së Perëndisë që asnjë njeri të mos vazhdojë të qëndrojë në një gjendje të mospendesës dhe të rebelimit kundër Tij.**¹¹

Ati ynë qiellor është mjaft i shqetësuar për ne si besimtarë që të na disiplinojë kur na mungon bindja.



Lexoni Hebrenjve 12:5-13.

1. Çfarë na kujtojnë këto vargje që të mos na lëshojë zemra kur jemi duke u disiplinuar për mëkatet tona?
2. Sipas shkrimtarit të letrës së Hebrenjve cilat qëllime i ka në mendje Perëndia rreth disiplinës?
3. Përse mendoni se ne i harrojmë shumë lehtë përfitimet e disiplinës kur jemi duke u disiplinuar? Si mund ta kujtojmë këtë?

Nëse i nënshtrohemi programit për trajnim disiplinor të Perëndisë në jetët tona, atëherë ne do të fillojmë t'i ngjajmë më shumë Krishtit, i cili edhe iu nënshtroi vullnetit të Atit. Kjo nënkupton të refuzojmë të jemi kokëfortë, rebel, apo të zemëruar atëherë kur Perëndia merr vendimin për të na treguar se ne kemi nevojë për një “fishkullim” të mirë. Nëse vazhdojmë të jemi rebel, atëherë “fishkullimet” e Tij do të bëhen më të fuqishme.

Kur vuajmë ne duhet të shqyrtojmë veten tonë që të sigurohemi se Perëndia nuk është duke u munduar të na e tërheq vëmendjen për ndonjë mëkat.¹² Fryma e Shenjtë do të na i zbulojë mëkatet tona. Reagimi ynë duhet të jetë i atillë që të kërkojmë falje nga Perëndia si dhe fuqinë e Tij për të na ndihmuar që ta braktisim mëkatin. Ne duhet të përmbahemi dhe të mos gjykojmë kur të tjerët vuajnë pasi që Perëndia ka shumë qëllime kur lejon vuajtjen që të ndodhë, dhe gjykimet e tilla duhet t'ia lëmë Perëndisë, i cili është i vetmi që i njeh zemrat tona.

Ne duhet të përmbahemi dhe të mos gjykojmë kur të tjerët vuajnë pasi që Perëndia ka shumë qëllime kur lejon vuajtjen që të ndodhë, dhe gjykimet e tilla duhet t'ia lëmë Perëndisë, i cili është i vetmi që i njeh zemrat tona.

Lena, një nënë e re, tregoi rrëfimin e saj të dhimbshëm rreth asaj që kishte përjetuar. Ajo kishte lindur një vajzë të hendikepuar, dhe përderisa ajo dhe burri i saj ishin të tejmbushur me realitetin se duhet të kujdeseshin për të dhe të siguronin për nevojat e saja të veçanta, shumë njerëz në kishën e saj kishin deklaruar se arsyeja se pse fëmija i saj kishte lindur e hendikepuar ishte një dënim i Perëndisë për mëkatin. Në mesin e një periudhe shumë të vështirë në jetën e saj, dhimbja iu shtua dhimbjes, sepse në vend të mbështetjes dhe lutjeve, ata morën mallkim nga kisha e tyre lokale.

Ne duhet t'u afrohemi në dhembshuri atyre që janë duke vuajtur dhe të refuzojmë të gjykojmë për arsyet që u thanë më sipër. Në mesin e vuajtjeve tona ne duhet të kërkojmë nga Perëndia që na jep urtësi dhe perspektivë në mënyrë që të mund të përcaktojmë, me aq

sa të jetë e mundur, nëse jemi duke përjetuar “dhimbje të rritjes” apo “dhimbje të ffishkullimit.” Dhe nëse Perëndia zgjedh që të mos na jep asnjë “arsye” për vështirësitë tona, atëherë ne duhet ta ndjekim shembullin e Jobit dhe të qëndrojmë, duke besuar se Perëndia është nën kontroll dhe se vazhdon të na dojë.

Vuajtja mund të na mësojë që të kujdesemi dhe të ngushëllojmë

Fatkeqësisht, shumë shpesh duhet që ne të vuajmë në mënyrë që të na hapen sytë për nevojat e njerëzve të tjerë përreth nesh si dhe për rëndësinë e tyre. Gjërat dhe aktivitetet shumë lehtë e megjullojnë pamjen tonë, mirëpo vuajtja mund ta largojë megjullën dhe mund ta lejojë Perëndinë dhe njerëzit rreth nesh që të duken si gjërat e vetme me vlerë të vërtetë.

Kur të kemi përjetuar vuajtjen, ne gjithashtu bëhemi më përgjegjës ndaj të tjerëve që vuajnë.



Lexo 2 Korintasve 1:3-7, 11 dhe 7:5-7.

1. Përshkruani ciklin e ngushëllimit në këto vargje.
2. Kur ne vuajmë, çfarë është duke u zhvilluar në ne e që na mundëson ne t'i ngushëllojmë të tjerët?

Teksa ngushëllohem nga Perëndia në mesin e vuajtjes sonë, ne mësojmë t'i ngushëllojmë të tjerët. Kur shohim dikë tjetër duke vuajtur, ne mund të bëhemi më të përgjegjshëm dhe më të kujdesshëm se më parë. Shpesh herë kur vuajmë, ne takojmë dikë që ka kaluar të njëjtën situatë, dhe mu aty krijohet një lidhje në mes nesh.

Për shembull, një pacient me kancer mund të lidhet me një tjetër; një grua e cila ka përjetuar një abort spontan, mund t'i përgjigjet shumë një gruaje tjetër që është duke kaluar nëpër një përvojë të tillë; një njeri që ka përjetuar një jetë të rëndë në familje mund të ketë një “antenë” për të tjerët që vijnë nga familje të tilla.

**Teksa ngushëllohem
nga Perëndia në mesin
e vuajtjes sonë, ne
mësojmë t'i
ngushëllojmë të tjerët.**



1. Shqyrto përmbledhjet e tua rreth “Qëllimeve të Vuajtjes.” Për secilën prej tyre, jep nga një shpjegim nga jeta juaj apo nga jeta e dikujt tjetër që ti e njeh në lidhje me faktin se si Perëndia e ka përdorur vuajtjen për të arritur qëllimin.
2. Për secilin shembull, trego se cili ka qenë përfitimi i vuajtjes? Si është përlëvduar Perëndia në këtë situatë?
3. Teksa e keni studiuar këtë material, si ka ndryshuar pikëpamja jote mbi vuajtjen?



Shiko mbrapa në disa kohë kur ti ke vuajtur.

- Cili mendon se ka qenë qëllimi i Perëndisë për ty? A kanë qenë qëllimet e Tij gjithmonë të qarta? A mund t'i shikosh tani gjërat në retrospektivë, në atë mënyrë që nuk ke mundur t'i shikosh në mesin e vuajtjes?
- Çfarë përvojash ke pasur, të cilat Perëndia mund t'i ketë përdorur për t'i ngushëlluar të tjerët?
- Çfarë ngushëllimi ke marrë nga Perëndia apo nga trupi i Krishtit, të cilin ngushëllim mund ta kalosh te të tjerët? Teksa shikon rreth vetes, çfarë rrethana sheh, me anë të së cilave do të mund t'i ngushëlloje të tjerët? (Shembuj mund të jenë të falësh dhe t'i ofrosh ndihmë praktike dikujt që të ka bërë keq, t'i ofrosh ndihmë dikujt që personalisht nuk e njeh, apo të mbrosh diçka që ti mendon se është e drejtë kur ata për rreth teje mendojnë se është gabim).
- Si ke bashkëpunuar me Perëndinë për ta lejuar që qëllimet e Tij për vuajtjen të përmbushen në jetën tënde?



Ndalu për një çast dhe falënderoj Perëndinë për ngushëllimin e Tij në jetën tënde, si dhe për të tjerët që të kanë ngushëlluar në kohë të dhimbjes dhe të pikëllimit. Kërkoi Atij që të të përdorë për t'i ngushëlluar të tjerët.

Reagimi ynë ndaj vuajtjes

Si reagon ndaj vuajtjes në jetë? Ashtu siç e vumë re në fillim të mësimit, reagimi ynë përcakton nëse do të mësojmë dhe do të rritemi gjatë vuajtjes. Theksimi që bëhet përgjatë Biblës është se ne jemi përgjegjës për zgjedhjet që marrim. Ne mund të jemi apo të mos jemi përgjegjës për situatën në të cilën mund të ndodhemi, mirëpo ne **gjithmonë** jemi përgjegjës për mënyrën se si zgjedhim të reagojmë ndaj situatës. Kur vuajtja na del në rrugë – ne duhet të jemi të sigurt se ajo do të na del – ne nuk duhet të kalojmë orë apo ditë të tëra duke menduar në lidhje me arsyet mbrapa asaj vuajtje. Fokusi ynë kryesor duhet të jetë se si do të reagojmë.

Përgatitja për vuajtjen

Kur sulmohemi nga ndonjë krizë, është shumë vonë që të përgatitemi për të. Në atë pikë, perspektiva jonë dhe veprimet tona rezultuese do të jenë në pajtim me modelet që veçse i kemi zhvilluar në mendjet tona. Çelësi për t'u përballur me vuajtjen me durim dhe me hir, është përgatitja paraprake, e cila fillon me anë të transferimit të mendjeve tona nëpërmjet Fjalës së Perëndisë.

Çelësi për t'u përballur me vuajtjen me durim dhe me hir, është përgatitja paraprake, e cila fillon me anë të transferimit të mendjeve tona nëpërmjet Fjalës së Perëndisë.

Paramendojeni hapësirën në mes të mendjes tënde, sikur të jetë e mbuluar me një rrjetë. Sa më mirë ta kuptosh realitetin e portretizuar në Fjalën e Perëndisë, aq më të ngjeshura do të bëhen fijet e rrjetës. Tani imagjinoni gënjeshtër nga i ligu sikur të ngjanin me gurë apo guralecë. Sa më e imët të jetë rrjeta, aq më pak gënjeshtër do të kalojnë në mendjen tënde, gënjeshtër të tilla si “Perëndia nuk kujdeset për mua,” “Sigurisht se kam bërë ndonjë mëkat,” “Nuk ka shpresë.”

Këto janë disa nga gënjeshtër që trokasnin në derën e mendjes sonë, duke kërkuar që të futen brenda. Mirëpo, sa më shumë që ta thellojmë mendjen tonë me Fjalën e Perëndisë dhe të vërtetat e sovranitetit, dashurisë dhe mirësisë së Perëndisë, aq më mirë do të jemi të përgatitur për t'u përballur me vuajtjen. Ajo që besojmë përbrenda do të përcaktojë atë që e jetojmë nga jashtë.¹³

Perëndia na jep mundësi që të përgatitemi për stuhitë e mëdha të jetës, duke na lejuar që të ballafaqohemi me një numër të sprovave të vogla, zemërime, acarime dhe probleme të përditshme. Kur mësojmë të reagojmë ndaj këtyre gjërave duke u fokusuar në Perëndinë, ne do të formohemi dhe do të transformohemi në mënyrë që kur të vijë stuhi më të mëdha të mos shkatërrohem prej tyre.

Luftimi i vuajtjes

Çfarë bëjmë kur rastësisht përballemi me situata të vështira dhe të dhimbshme? Si i luftojmë frikërat tona dhe dhimbjen tonë? Nga kthehemi kur përballemi me vuajtjen, kur jemi tmerresisht të lënduar, kur emocionet na pushtojnë, kur zbrazëtia duket sikur do të na gëlltisë? Ku e gjejmë ne një vend të fuqishëm të shpresës?

Të mbështetesh në Perëndinë. Kur jemi të lënduar, është e vështirë të besojmë se Perëndia mund të të vijë në ndihmë. Në mesin e vuajtjes, shumë njerëz bërtasin, “O Zot ku je? A nuk shqetësohesh për mua?” Edhe Davidi kishte një betejë të tillë. Tek Psalmi 13:1 ai shkruan, “Deri kur do të më harrosh, o Zot? Vallë kështu do të jetë përjetë? Deri kur do të më fshehësh fytyrën tënde?”

Psalmi 34:18 na siguron se “Zoti qëndron afër atyre që e kanë zemrën të thyer dhe shpëton ata që e kanë frymën të dërmuar. Psalmisiti e kishte përjetuar se Perëndia kishte qenë për të një strehë dhe një forcë, një ndihmë gjithnjë e gatshme në fatkeqësi (Ps 46.1). Tek Hebrenjve 13:5b ne lexojmë premtimin e Perëndisë për besimtarët, “Nuk do

të të lë, nuk do të të braktis.” Ku është Perëndia kur ne vuajmë? Ai është mu aty pranë nesh. Ai e njeh situatën tonë. Ai kujdeset për ne. Ai na premton që të na jep forcë për të qëndruar dhe shpresë për të nesërmen. Ai dëshiron të na mbajë me vete si një bari i butë që mbanë delet e tij të dobëta dhe të plagosura. Ai dëshiron që ne t’i dorëzojmë Atij shqetësimet tona dhe të përjetojmë rehatinë, besimin e qetë dhe shpresën që fillojnë të rriten në ne kur e dorëzojmë të ardhmen tonë në duart e Tij të fuqishme.

Ku është Perëndia kur ne vuajmë? Ai është mu aty pranë nesh.

Në mesin e vuajtjes Perëndia dëshiron që ne të kthehemi te Ai, ta përjetojmë Atë si Strehën tonë, Kalanë tonë, Mburojën tonë, dhe Shpenguesin tonë. Davidi përjetoj intimitetin e mbështetjes në Perëndinë në këtë mënyrë kur po kalonte nëpër shumë rrethana të vuajtjes. Vazhdimisht ne shohim se si Davidi i mbushi lutjet e tij me frazat “Më mëso,” “më drejto,” “më trego,” “më ndihmo”- fraza të cilat shprehin varësinë e tij në Perëndinë.

Linda Rutzen, si një grua e një pastori tridhjetetë vjeçar, me dy fëmijë, u diagnostifikua me kancer në sistemin limfatik dhe u përball për një vit të tërë me hemoterapi dhe trajtime të rrezatimit. Ajo shkruan:

Gjatë atij viti, teksa trajtimet shkaktuan dëmet e tyre, jeta ime u kthye tek gjërat bazë. Duke vështruar vdekjen time, unë fillova të vlerësoj marrëdhënien time të gjatë me Krijuesin tim dhe e kuptova se sa të cekëta dhe të zbrazëta kishin qenë perceptimet e mia për Të. Më e thellë ishte kur e kuptova se dimensione të caktuara të dashurisë dhe karakterit të Perëndisë vijnë në pah vetëm gjatë vuajtjes. Unë arrita të kuptoj se ne nuk mund ta kuptojmë plotësisht konceptin e një Krijuesi intim, të Perëndisë Emanuel me ne – përderisa nuk e kemi ndjerë Perëndinë pranë nesh në kohë të fatkeqësive sepse atëherë ndodhin ndryshime të përjetshme në ato pjesë të fshehura të zemrës.

Linda luftoi që të afrohej më pranë Perëndisë, i cili e kishte lejuar atë që të vuante në këtë mënyrë.

Unë ndjeva se duke lejuar mjerimin tim të rëndë Ai ishte duke dorëzuar rolin e Tij si Perëndi; duke refuzuar që të përdorte fuqinë e Tij që të më nxirrte nga dhimbja, Ai kishte treguar një mospërfillje kolosale kundër meje. Më vonë, e përulur nga dhembshuria hyjnore, unë arrita të kuptoj se vetëm në thyerjen time unë mund të gjeja një intimitet të ri me Të.¹⁴

Prej dhimbjes së gjembit buroi bekimi i një intimiteti më të thellë me Perëndinë. Kur përballemi me një natë të errët të vuajtjes, ne shpesh duhet të fokusohemi në dashurinë dhe dhembshurinë e Atit për ne dhe të mbahemi fort ngushtë për Të, duke pushuar në njohurinë

se edhe kur jemi shumë të dobët për t'u mbajtur, krahët e Tij të përjetshëm janë aty për të na mbajtur.

Ta luftosh frikën. Një aspekt i durimit të vuajtjes së rëndë ka të bëjë me luftimin e shqetësimit dhe frikës. Frika mund ta bëjë një situatë të duket e papërballueshme. Ajo mund të na gjymtojë psikologjikisht, e bile edhe psiqikisht. Fjalët “mos ke frikë” shfaqen shpesh në faqet e Biblës, teksa Perëndia mundohet t'i mësojë bijtë e Tij që t'i besojnë Atij. Frika shpërthen në mënyrë të natyrshme në zemrën e njeriut kur ai është në praninë e rrezikut apo kur konfrontohemi me rrethana të dhimbshme dhe kërcënuese. Edhe Jezusi e shprehu frikën në kopshtin e Getsemanisë. Por, si duhet të trajtojmë frikën ne?

Psalmet mund të na ngushëllojnë shumë dhe të na inkurajojnë kur jemi duke u përballë me shqetësime, pasi që në to ne shohim se si të tjerët kanë reaguar me besim në luftimin e frikës. Davidi shkroi, “sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë nga asnjë e keqe, sepse ti je me mua” (Ps 23:4a). Përse? “Sepse Ti je me mua.” Një mënyrë se si Davidi e luftoi frikën ishte t'i kujtonte vetes për praninë e vazhdueshme të Perëndisë me të.¹⁵



Lexo Psalmin 27:1-8, 13-14.

1. Çfarë besimi shpreh Davidi në vargjet 1-3?
2. Si e zhvilloi Davidi besimin e tij në Zotin deri në atë pikë sa që më nuk kishte frike as edhe në kohë të vështirësisë (vargjet 4-8)?

Davidi e kërkonte praninë e Perëndisë dhe e fokusonte mendjen e tij në karakterin e Perëndisë. Tek Psalmi 27:13-14 ne shohim se si ai zgjedh të vendos mendimet e tij në mirësinë e Zotit, dhe e lë zemrën e tij të marrë guxim nga Zoti. Tek Psalmi 56:3-4 Davidi shkroi, “Kur të kem frikë, do të mbështetem te ti. Me ndihmën e Perëndisë do të kremtoj fjalën e tij; kam vënë besimin tim te Perëndia, nuk do të kem frikë.”



Lexo Isaia 41:10; 43:1-3 dhe Filipianëve 4:5b-7.

1. Sipas këtyre vargjeve pse nuk duhet të frikësohemi?
2. Çfarë premtime na jep Perëndia në këto vargje?
3. Çfarë veprime u përshkruan Pali besimtarëve në këto vargje?
4. Çfarë rezulton kur zgjedhim këto veprime?

Teksa përballemi me testet e vuajtjes që Perëndia lejon në secilin prej nesh, Ai dëshiron që ne ta shikojmë Atë, në mbështetemi në Të, t'ia dorëzojmë Atij frikërat tona, dhe të pushojmë në Të dhe sigurinë e dashurisë së Tij për ne.



Si ke reaguar ndaj problemeve të zakonshme të jetës? Si të kanë përgatitur reagimet e tua për vuajtjet më të mëdha?

- Si ka ndryshuar pikëpamja jote mbi vuajtjen si rezultat i këtij studimi?
- Çfarë do të bësh që të përgatitesh për vuajtjen, dhe si do të të ndihmojë kjo në situatat e së ardhmes?

Duke i mbajtur sytë drejt qiellit. Një faktor përfundimtar që mund të na inkurajojë është shpresa jonë e qiellit, e cila na kujton se gjithçka që kalojmë këtu është e përkohshme. Kur fokusohemi në realitetin e qiellit dhe kënaqësisë së përjetshme që do të përjetojmë në praninë e Perëndisë, do të kemi mundësi të pushojmë në Të dhe në qëllimet e Tij të mira për ne. Kur fillojmë t'i heqim sytë nga e ardhmja, shpresa e qiellit, vuajtjet tona do të fillojnë të na pushtojnë.

Pjetri na përkujton që të “mbani shpresë të plotë në hirin që do vijë mbi ju në zbulesën e Jezus Krishtit” (1 Pjet 1:13). Një ditë do të ndryshohemi plotësisht dhe të veshim përjetësinë; ne të gjithë do të jemi fitimtarë mbi vdekjen dhe vuajtjen. Pali shkruan tek 1 Korintasve 15:55-58,

O VDEKJE, KU ËSHTË GJËMBA JOTE? O FERR, KU ËSHTË FITORJA JOTE? Edhe gjemba e vdekjes është mëkati; dhe fuqia e mëkatit është ligji. Por ta falënderojmë Perëndinë që na jep fitoren me anë të Zotit tonë Jezus Krisht. Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin.



Shpreh falënderimet e tua ndaj Perëndisë për fitoren që Krishti ka arritur mbi vdekjen dhe për të ardhmen e sigurt që ke në të në qiell.

Mendime përmbyllëse

Ne pamë perspektivat biblike mbi vuajtjen dhe origjinat e vuajtjes. Vuajtja hyri në univers pas rebelimit të Adamit kundër Perëndisë. Ai bëri që vuajtja të bie mbi veten e tij. Mirëpo, Perëndia, në sovranitetin e Tij, është duke e përdorur me urtësi vuajtjen në kohën e tanishme për të arritur qëllimet e Tij të mira. Një ditë Ai do ta heq atë krejtësisht, së bashku me mëkatin dhe vdekjen, nga jetët e atyre që e pranojnë Atë si Zot mbi të gjitha.

Vuajtja na nxjerr në podium dhe i kthen dritat mbi ne. Ne kemi mundësinë që të reagojmë ndaj vuajtjes në atë mënyrë që do të mund t'i sillnim shumë lavdi Perëndisë dhe t'i ofrojmë të tjerët pranë Tij. Ashtu sikurse Jobi edhe ne e lavdërofshim mirësinë e Tij në botë, me anë të mbështetjes në Zotin dhe durimit të vuajtjeve me durim dhe me hir!

FUSNOTAT

¹ Flakët e gjykimit, si tek 2 Pjet.3:12 dhe Zbu.19:20, ekzistojnë vetëm për shkak të mëkatit.

² Pali i jep Adamit meritat tek Rom.5:12-21 për hyrjen e mëkatit, vuajtjes dhe vdekjes në botën e tokës. Akti i mosbindjes i Satanit, do të ishte burimi i vuajtjes dhe vdekjes në botën engjëlllore. Kjo nuk nënkupton se Satani nuk pati një rol aktiv në mëkatin e Adamit apo që ai aktualisht nuk sjell vuajtje në tokë, ashtu siç kishte bërë tek Jobi 1 dhe 2.

³ Jobi 1:12; 2:6. Tek 1 Gjoni 5:18 sipas një domethënieje thuhet që Satani nuk mund t'i "prek" besimtarët. Perëndia lejoi që Satani të prekte familjen e Jobit, pasurinë dhe shëndetin e tij, mirëpo jo edhe jetën e tij. Apostulli Gjon me sa duket e ka parasysh faktin që Perëndia nuk e lejon Satanin të "prek" apo të shkatërrojë jetën e përjetshme të besimtarëve (shiko gjithashtu Gjoni 10:28-29 dhe Rom.8:37-39).

⁴ Për pasazhe shtesë mbi vuajtjen dhe shpresën tonë për të ardhmen, shiko vargjet në vijim: Mat.5:10-12; Gjoni 14:1-3; 16:20-22; 1Kor.9:24-27; 15:50-58; Fil.2:16; 1Thes.4:13-18; 2Thes. 1:4-10; 1Tim.4:6-8; Heb.10:32-39; 11:32-40; 12:1-3; Jak.1:12; 5:7-11; 1Pjet.1:3-13.

⁵ Pasojat për jobesimtarin janë një çështje tjetër. Pasi që vuajtja i ka rrënjët e veta në mëkatin dhe jobesimtarët refuzojnë që të vijnë tek Krishti për falje, ata duhet të vazhdojnë të durojnë vuajtjen dhe vdekjen e dytë përjetësisht.

⁶ Shiko gjithashtu Efesianëve 1:11-12.

⁷ Shiko gjithashtu Jobi 31:35; 19:7; 30:20-21.

⁸ Disa argumentojnë se "të gjitha gjërat" tek Rom.8:28 dhe Ef.1:11 i referohen vetëm gjërave të rëndësishme. Mirëpo në mënyrë që Perëndia të bëjë që "gjërat e mëdha" të kthehen për mirë në jetën tonë, Ai patjetër që duhet të ketë dorën e Tij edhe në gjërat e vogla që i përbëjnë ato.

⁹ John Ortberg, *"Jeta që gjithmonë e keni dëshiruar: Disiplinë shpirtërore për njerëz të thjeshtë"* (*The Life You've Always Wanted: Spiritual Disciplines for Ordinary People*) (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1997), 210.

¹⁰ Shiko, p.sh., Lev.26; Ligj. i Përt.28; Gjyqtarët; Amosi 1-2.

¹¹ Shiko Amosi 4:6-11; Ezek.18:32; gjithashtu Rom.2:4; 2Kor.7:9-10; 2Pjet.3:9. Shumica e jobesimtarëve jo vetëm që qëndrojnë të pabindur kur Perëndia i dënon për mëkat (Zbu.16:9-11) mirëpo ata vazhdojnë të qëndrojnë të pabindur edhe kur Perëndia e heq gjykimin e Tij (Pred. 8:11).

¹² Jobi e bëri këtë dhe deklaroi që Perëndia, me aq sa mund të përcaktonte ai, nuk ka qenë duke e disiplinuar atë për ndonjë mëkat (shiko, p.sh, Jobi 27:1-6).

¹³ Shiko gjithashtu Fj. e Ur.4:23; Marku 7:20-23.

¹⁴ Linda Rutzen, "Gruri Dimëror," *Fokus në Gazetën Familjare*, Nëntor 1999, 7.

¹⁵ Kur Zoti Jezus ishte duke ecur mbi ujë drej dishepujve, Ai tha, "Qetësohuni; jam unë, mos kini frikë (Mat.14:27; Mk.6:50; shiko Gjoni 6:20; gjithashtu Isaia 43:1-2; Veprat 18:9-10).

Jeta në familje

Erika ka shkuar në kishën e saj për tetë vite, mirëpo së voni ajo nuk ka asnjë dëshirë që të shkoj atje. Para disa muajve, ajo i tregoi një shoqeje për vështirësitë në jetën e saj personale, dhe kjo shoqja u tregoi disa të tjerëve në kishë. Erika u ndie e tradhtuar. Ajo tash i shmanget kësaj gruaje sa herë ta sheh atë në kishë. Ajo mendon me vete, “vallë çfarë lloj kishe është kjo, nëse njerëzit merren me thashetheme?”

Edhe gjëra të tjera e kanë zhgënjyer atë. Ajo u jep sugjerime pastorit dhe pleqve të kishës, por si duket ata asnjëherë nuk e dëgjojnë atë apo nuk zgjedhin që të ndryshojnë ndonjë gjë. Ajo nuk ka shkuar në kishë që disa javë, dhe askush deri më tani nuk e ka thirrur që ta pyes se pse nuk ka shkuar në kishë. Ajo mund të jetë e sëmurë rëndë, dhe si duket askush nuk dëshiron të kujdeset. Ajo hamendet nëse do të duhej të kërkonte për ndonjë kishë tjetër, mirëpo është shumë e vështirë që të fillojë një kërkim të tillë. Ajo arrin në një përfundim “Ma do mendja se mund të lexoj Biblën dhe të lutem në shtëpi.”

Për çfarë karakteristika të bashkësisë është duke vuajtur Erika? Si mendoni se është duke kontribuar ajo në bashkësinë e vërtetë në vendin e saj? Çfarë qëndrime do të duhej të ndryshonin tek ajo? Çfarë hapa do të duhej të merrte Erika drejt restaurimit të marrëdhënies së prishur me shoqen e saj, e cila nuk i ka qëndruar besnike?



Kur ne bëhemi fëmijë të Perëndisë, ne pranojmë një familje të re, familjen e Perëndisë. Kjo familje përbëhet prej besimtarëve nga shumë kombe dhe është e mbështetur në besimin tonë të përbashkët në Jezus Krishtin. Ndjekësi i Jezus Krishtit duhet të kërkojë një kishë lokale dhe të bëhet pjesë e një trupi lokal të besimtarëve, ku ai apo ajo mund të ushqehet në besim dhe mund të përdorë dhuntitë që Perëndia i ka dhënë secilit prej tyre për t'i shërbyer Atij dhe të tjerëve. Në këtë mësim ne do të hulumtojmë çfarë nënkupton të jesh pjesë e familjes së Perëndisë.

Përmbledhje e mësimit

Bashkësia e besimtarëve

Çfarë është bashkësia e krishterë?

Bazat e bashkësisë

Përkushtimi ndaj anëtarëve të familjes

Të gjesh bashkësinë në një trup lokal

Karakteristikat e jetës në familje

Uniteti

Dashuria

Qëllimet e përbashkëta

Përgjegjësitë tona në familje

Nxitja

Qortimi

Zgjedhja e konfliktit në familje

Mendime përmbyllëse

Shtesë: një qasje biblike për të zgjedhur konfliktin në mesin e besimtarëve

Qëllimet e mësimit

Kur ta keni përfunduar këtë mësim, ju do të jeni në gjendje që:

1. Të shpjegoni se si dallon bashkësia e krishterë nga shoqëria që përjetojmë në rrethet e tjera shoqërore.
2. Të shpjegoni bazat e bashkësisë së vërtetë dhe arsyet përse është thelbësor përkushtimi ndaj një trupi lokal të besimtarëve.
3. Të përshkruani karakteristikat e jetës në familje: uniteti, dashuria, dhe qëllimet e përbashkëta. Si dhe të tregoni se si çdo njëra prej tyre kontribuon për dëshminë e trupit lokal.
4. Të përshkruani mënyrat për të inkurajuar dhe për të qortuar besimtarët dhe të shqyrtosh praktikën e tua në këto dy fusha.
5. Të dëshmoni rreth mënyrave që je përpjekur të zgjidhësh konfliktet dhe të restaurosh marrëdhëniet e thyera në trupin e Krishtit.

Bashkësia e besimtarëve

Bashkësia zhvillohet në nivele të ndryshme me njerëz të ndryshëm. Për shembull, ne mund të përjetojmë një masë të caktuar të bashkësisë me bashkëpunëtorët në vendin e punës, me anëtarë të tjerë të klubit sportiv, të kursit të gjuhës, apo njësisë ushtarake. Por, çfarë e bënë unike bashkësinë e krishterë? Si dallon ajo nga shoqëritë që mund të përjetojmë në rrethet e tjera shoqërore?

Çfarë është bashkësia e krishterë?

Veprat 2:42-47 zbulojnë se bashkësia ishte shumë e rëndësishme në kishën e hershme; ajo radhitet bashkë me mësimin, thyerjen e bukës, dhe lutjen apo adhurimin, si një element kyç në jetën e besimtarëve të hershëm. Besimtarët e hershëm u zhvilluan shpejtë në një komunitet që gjente kënaqësi në marrëdhëniet e ngushta dhe mbështetëse në mes vete. Ata adhuruan, hëngrën dhe e lavdëruan Perëndinë së bashku.

Çfarë ishte rezultati? Në vargun 47 ne lexojmë se Zoti i shtonte kishës çdo ditë ata që ishin shpëtuar. Një ndër arsytet e rëndësishme për këto kthime në besim mund të ketë qenë një komunitet besimtarësh që kujdeseshin për njëri-tjetrin dhe që demonstrome dashurinë e Perëndisë në mënyra praktike.

Në Dhiatën e Re, fjala greke *koinonia* shfaqet për here të parë tek Veprat e Apostujve 2:42, ku thuhet: “Ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimin të apostujve, në *koinonia* në thyerjen e bukës dhe në lutje”. *Koinonia* ka tre kuptime kryesore në Dhiatën e Re: (1) marrëdhënie e ngushtë (p.sh 1 Gjoni 1:3, 6, 7); (2) ndihmë, apo kontribut (p.sh. Rom 15:26) dhe (3) pjesëmarrje (p.sh., 2 Kor 8:4).¹



Lexoni Veprat e Apostujve 2:37-47.

1. Bazuar në vargjet 42-47, cilin nga kuptimet kryesore të fjalës *koinonia* mendoni se ka përdorur Luka në vargun 42? Ju lutem, potenconi se si kanë ndikuar vargjet 42-47 në vendimin tuaj.
2. Nëse do të kishit qenë një anëtar i asaj kishe të hershme, përshkruaj se çfarë do të kishit bërë për të jetësuar të kuptuarit tënd të *koinonia*-s në atë kishë dhe në atë komunitet.

Idea e përfshirjes së përbashkët apo e ndarjes së të mirave dhe përvojave është e pamjaftueshme për të shpjeguar bashkësinë dinamike që pikturohet në Dhiatën e Re.

Bazat e bashkësisë

Që të kemi një kuptim më të plotë të fjalës bashkësi, ne duhet të hulumtojmë më tutje për të parë themelin për këtë marrëdhënie.

Ne jemi pajtuar me Perëndinë. Tek 1 Korintasve 1:9 ne zbulojmë se është Perëndia, Ai që na ka ftuar në një bashkësi me Birin e Tij Jezus Krishtin. Tek 1 Gjoni 1:1-3, Gjoni shpjegon se bashkësia e besimtarëve është në të vërtetë një bashkësi me Atin dhe me Zotin Jezus. **Bashkësia e vërtetë është “një fortifikim i një marrëdhënieje të restauruar me Perëndinë”**² Kjo bazohet në lidhjen tonë të përbashkët me Krishtin. Vetëm në Krishtin ne jemi një me besimtarët e tjerë. Për ta kuptuar rëndësinë e bashkësisë së krishterë, ne së pari duhet të kuptojmë se çfarë do të thotë të kesh bashkësi me Perëndinë.



Lexo 2 Korintasve 5:17-21.

1. Çfarë është përmbushur nga ana e Perëndisë nëpërmjet Krishtit?
2. Çfarë shërbese i është dhënë besimtarëve?

Bashkësia e besimtarëve bazohet mbi pajtim individual të një të krishteri me Perëndinë. Që të ndodh bashkësia në mes të dy njerëzve, që të dytë duhet të kenë përjetuar një marrëdhënie të restauruar me Perëndinë. Ky restaurim i marrëdhënies sonë me Perëndinë është baza e përbashkët që të krishterët ndajnë së bashku. Ne që kemi qenë shumë larg Perëndisë, të ndarë nga Ai për shkak të mëkatit, jemi sjellë më pranë Tij. Ne që dikur ishim armiqtë e Tij, jemi pajtuar tash me Perëndinë. Meshkuj dhe femra, hebrenj dhe jo hebrenj, njerëz fetarë dhe paganë, njerëz të të gjitha kombeve dhe racave, jemi bërë një nëpërmjet besimit në Jezus Krishtin (Gal 3:27-28; Ef 1:3-14; 2:13-18).

Si rezultat i pajtimit me Perëndinë, besimtari në Krishtin gëzon shumë përfitime. Tek 2 Korintasve 5:17, si më sipër, ne mësuam që ai apo ajo tani është një krijesë e re. Tek 2 Pjetri 1:4 ne lexojmë që besimtarët mund të bëhen “pjesëtarë të natyrës hyjnore.” Besimtarët janë të lidhur me Perëndinë dhe janë pjesëtarë të natyrës hyjnore. Kjo nuk nënkupton se njerëzimi bëhet hyjnor, që ne jemi perëndi, mirëpo kjo nënkupton që ne kemi një natyrë të re brenda nesh e cila është nga Perëndia dhe e cila na lidh me Të.



Lexo 1 Gjoni 1:5-7. Çka i shtojnë këto vargje kuptimit tënd që ke për bashkësinë me Perëndinë?

Gjoni thotë se bashkësia me të tjerët në Krishtin është e pamundur kur diçka nuk është në rregull me marrëdhënien tonë me Perëndinë. Perëndia është dritë, dhe qëllimi i besimtarit është që të ec në po atë dritë që është Perëndia. Në të vërtetë, nëse pretendojmë se jemi në bashkësi me Perëndinë dhe jetojmë në mëkat, pa ardhur në dritë, atëherë ne jemi duke gënjyer. Në fund, Gjoni na thotë se të ecësh në dritë, dhe kështu në bashkësi me Perëndinë, bënë që ne të kemi bashkësi me njëri tjetrin. Marrëdhënia jonë me njëri tjetrin në trupin e Krishtit varet në marrëdhënien tonë me Perëndinë.

Gjoni flet për nevojën tonë që të ecim në dritë në mënyrë që të restaurojmë marrëdhëniet tona me njëri tjetrin. Çfarë do të thotë të ecësh në dritë? Të ecësh në dritë do të thotë të ruash marrëdhënien me Perëndinë me anë të lutjes dhe Fjalës, duke i lejuar Frymës së Shenjtë që të na mësojë dhe të nxjerr në pah mëkatet dhe dështimet tona, do të thotë të reagojmë me rrëfim dhe pendim, si dhe të marrësh hapa për të restauruar marrëdhëniet me ata të cilët mbase i kemi ofenduar në ndonjë mënyrë.

Vetëm kur ta kemi bërë marrëdhënien tonë me Perëndinë prioritetin tonë të parë, marrëdhëniet tona me të tjerët do të jenë ato që duhet të jenë. Kur marrëdhëniet jonë me Perëndinë është e dobët për shkak të mëkatit, ajo do të ndikojë në marrëdhëniet tona me besimtarët e tjerë deri në atë pikë ku edhe pengohet bashkësia e vërtetë. Ne duhet t'i kërkojmë Perëndisë që të na ndihmojë që të ecim në dritë dhe ta lejojmë Frymën që ta bëjë punën e Tij të restaurimit.

Ne jemi adaptuar në familjen e Perëndisë. Kur i besojmë Krishtit si Shpëtimtarin tonë, ne jo vetëm që pajtohemi me Perëndinë, por edhe adaptohemi në familjen e Perëndisë (Rom.8:15; Gal.4:5; Ef.1:5). Perëndia në urrejtjen dhe mëshirën e Tij nuk na ka lënë bonjakë në këtë botë, por për më tepër na ka vënë në familjen e Perëndisë. Dëshira e Tij është që ne gjejmë inkurajim, mësim, ngushëllim, kënaqësi dhe mundësi për t'ju shërbyer të tjerëve nëpërmjet marrëdhënieve tona me besimtarët e tjerë.




Lexoni Efesianëve 4:4-7 dhe 1 Korintasve 12:12-14. Çfarë ndajmë së bashku me besimtarët e tjerë si ndjekës të Krishtit? Çfarë konkluzione mund të nxirrni nga kjo?

Pasi që ne jemi anëtarë të adaptuar të familjes së Perëndisë, ne kemi të njëjtin At, ne kemi një marrëdhënie me Të nëpërmjet Jezus Krishtit, dhe ne kemi Frymën e Shenjtë që jeton brenda nesh. Ne ndajmë të njëjtin besim, me anë të pagëzimit në trupin e Krishtit. Ne gjithashtu ndajmë të njëjtat qëllime të adhurimit dhe të shërbesës teksa kërkojmë të ndërtojmë njëri tjetrin në bashkësinë e motrave dhe vëllezërve në familjen e Perëndisë. Lidhjet e ngushta familjare që kanë motrat dhe vëllezërit në familjen natyrore, në familjen e Perëndisë bëhen akoma më të forta për shkak të natyrës së përjetësisë që ka kjo marrëdhënie.

Një aspekt i të jetuarit së bashku në një familje është se ti arrin t'i njohësh anëtarët e familjes bukur mirë. Ti i njeh si anët e forta ashtu edhe ato të dobëta që ata kanë. Zakonisht ekzistojnë gjëra në lidhje me anëtarët e familjes tënde që të acarojnë apo që do të dëshiroje që ata t'i ndryshonin, por prapë se prapë ata janë familja jote. Po kështu është edhe në familjen e Perëndisë. Perëndia dëshiron që ne të njohim njëri – tjetrin dhe ta pranojmë njëri – tjetrin.

Natyra jonë mëkatore e bënë të vështirë që të kemi marrëdhënie të harmonishme në familjen e Perëndisë. Marrëdhëniet e Adamit dhe Evës ndryshoi në mënyrë drastike pas rënies, kur mëkati dhe fajti hynë në botë. Ashtu siç e dëmtoi mëkati aftësinë tonë për ta njohur Perëndinë, po ashtu e dëmtoi edhe aftësinë tonë për ta njohur njëri-tjetrin.



Vetëm të krishterët në marrëdhënie të duhur me Perëndinë mund të njohin me të vërtetë njëri-tjetrin në plotësinë që synon Perëndia. Ne të gjithë e kemi dëshirën që të njihemi në këtë mënyrë, të jemi në gjendje të hapemi me një person dhe të ndajmë me të mendimet dhe ndjenjat tona më të thella, duke pritur që ai person të na dojë pa kushte. Tek 1 Korintasve 13:12 Pali, duke folur me mall për të ardhmen kur ai do të jetë në praninë e Perëndisë, shkruan “atëherë do të njoh thellë, **ashtu sikurse edhe njihem**” (theksim i shtuar). Ajo do të jetë një bashkësi e përsosur, e papenguar nga natyra jonë mëkatore.

Kur bashkohemi si të krishterë, një aspekt i rëndësishëm i kësaj bashkësie duhet të jetë qëllimi për të njohur njëri-tjetrin. Ne nuk mund të kemi një marrëdhënie të ngushtë me secilin person në kishë, por ne mund të bëjmë përpjekje që të njohim të tjerët dhe gjithashtu t’i lëmë të tjerët që të na njohin. Shumica e njerëzve hapen gradualisht në një ambient ku ndihen të sigurt, kur ta kuptojnë se do të trajtohen me dashuri dhe me mirësi. Ndarja dhe kujdesi i ndërsjellë duhet të zhvillohet në mesin e besimtarëve teksa njerëzit arrijnë të njohin njëri-tjetrin. Shoqëritë e ngushta dhe të mrekullueshme mund të zhvillohen në mesin e besimtarëve për shkak të lidhjes së tyre në Krishtin. Kjo shpjegon faktin se pse ne ndonjëherë ndihemi më të afërt me besimtarët e tjerë se sa me anëtarët e familjes sonë.



Mendoni rreth disa njerëzve në bashkësinë tënde, të cilët tani i njeh më mire se sa vitin e kaluar. A të njohin edhe ata ty më mirë? Nëse nuk ke vërejtur rritje në këtë fushë, çfarë mendoni se është duke e penguar zhvillimin e këtyre marrëdhënieve? Në çfarë mënyra u ofron të tjerëve dashuri, mirësi dhe pranim?



Pusho për një minutë dhe falënderoj Perëndinë që të ka pajtuar me Të dhe që të ka adaptuar në familjen e Tij. Kërkoi Perëndisë që të të ndihmojë të zhvillohesh në këtë fushë të ndërtimit të marrëdhënieve me të krishterët e tjerë, që të mësosh të kujdesesh me të vërtetë për ta dhe t'i pranosh ata ashtu siç janë.

Përkushtimi ndaj anëtarëve të familjes

Që të përjetohet bashkësia e vërtetë e krishterë, atëherë ne duhet t'i njohim ata me të cilët adhurojmë, si vëllezër dhe motra në Krishtin si të bëjmë një përkushtim ndaj tyre. Ashtu siç nuk e kemi të lejuar që të zgjedhim motrat dhe vëllezërit tanë biologjik, po kështu nuk kemi asnjë mundësi për të zgjedhur motrat dhe vëllezërit tanë në Krishtin. Ne mund të joshemi prej tyre; por edhe mund të neveritemi prej tyre. Mund të acarohemi prej tyre, të kemi dëshirë që t'ju shmangemi atyre, apo të mos kemi asnjë ndjenjë për ta. Por në anën tjetër, ne u takojmë atyre, dhe ne duhet t'i duam ata, të kujdesemi për ta, dhe të jemi përgjegjës për ta – për të gjithë.

Për ta parë trupin e Krishtit në këtë mënyrë kërkohet një përkushtim i fuqishëm nga ana jonë. **Ashtu si marrëdhënia jonë me Perëndinë bazohet në qëllimin dhe përkushtimin e Tij të fuqishëm, po kështu marrëdhënia jonë me të tjerët duhet të bazohet në këtë përkushtim për njëri-tjetrin.** Ashtu siç është Krishti i përkushtuar ndaj neve, duke na premtuar se kurrë nuk do të na lejë dhe kurrë nuk do të na braktisë, po kështu duhet të përkushtohemi që të qëndrojmë në marrëdhënie me besimtarët e tjerë, që t'i zgjidhim problemet që shfaqen dhe jo të ikim prej tyre. Vetëm kur arrijmë të kemi një përkushtim të tillë ndaj njëri-tjetrit, marrëdhëniet tona do të rriten dhe do të lulëzojnë.

Përkushtimi ndaj njëri-tjetrit nënkupton se ne jemi një trup njerëzish të cilët gjithmonë do ta pranojnë dhe do të kujdesen për njëri-tjetrin

Përkushtimi ndaj njëri-tjetrit nënkupton se ne jemi një trup njerëzish të cilët gjithmonë e pranojnë dhe kujdesen për njëri-tjetrin. Ashtu si Perëndia i kupton dobësitë tona dhe brishtësinë tonë, po kështu ne mund të mësojmë të kuptojmë dobësitë e vëllezërve dhe motrave tona në Krishtin dhe t'i duam ata pavarësisht prej këtyre dobësive. Ata që janë pjesëtarë të bashkësisë sonë duhet ta dinë që ne jemi të përkushtuar ndaj tyre, që ne nuk do t'i mohojmë apo braktisim ata, por që do t'i duam dhe do t'i pranojmë ashtu siç janë, duke i inkurajuar që të zhvillohen dhe rriten në Krishtin.

Të gjesh bashkësinë në një trup lokal

Rëndësia dhe vlera e bashkësisë së krishterë shihet përgjatë Dhiatës së Re. Përgjatë librit të Veprave të Apostujve dhe letrat e tjera të Dhiatës së Re, ne shohim rritjen e kishave individuale dhe përfshirjen e tyre të madhe në ungjillëzim dhe në ndërtimin e trupit të Krishtit.

Tek Hebrenjve 10:25 ne gjejmë një urdhër specifik në lidhje me bashkësinë: që të mos heqim dorë nga të mbledhurit bashkë, por që të nxisim njëri-tjetrin. Ata që mendojnë se nuk kanë nevojë për një bashkësi të tillë dhe që mund ta ruajnë ecjen e tyre me Zotin pa një inkurajim të tillë, me siguri që janë duke humbur një ndër nevojat më të mëdha për të jetuar jetën e krishterë. Perëndia në urtësinë e Tij na ka dizajnuar që të jetojmë në marrëdhënie me Të dhe me të tjerët. Ne kemi nevojë për nxitjen, kujdesin, dhe shprehjen e mirësisë nga ana e anëtarëve të tjerë të familjes. Njëjtë, ecja jonë me Perëndinë varet në mësimin dhe shembullin e të tjerëve të cilët janë më të rritur në Krishtin. Perëndia gjithashtu dëshiron që ne të rritemi në Krishtin dhe të fokusohemi që t'u shërbejmë të tjerëve në trupin e Krishtit.

Për këto arsye, **është themelore që të krishterët të lidhen me një kishë lokale.** Ne duhet të gjejmë një kishë ku Fjala e Perëndisë mësohet qartë dhe me dobi, ku mund të gjendet bashkësia dhe të bëhet studimi i Biblës, për t'u inkurajuar në rritjen tonë shpirtërore, dhe ku mund t'i përdorim dhuntitë tona që Perëndia na ka dhënë për t'u shërbyer të tjerëve. Kur jemi në kërkim të një kishë, hapi ynë i parë duhet të jetë që të lutemi dhe të kërkojmë drejtimin e Perëndisë. Pyetni miqtë e juaj të krishterë të cilëve u besoni për rekomandime. Kur ta vizitoni një kishë, para se të merrni një vendim, kaloni mjaft kohë me njerëzit në atë kishë. Nëse është e mundur takojeni pastorin dhe bisedoni me të. Zbuloni se çfarë janë mundësitë për rritje dhe për të shërbyer.

Kini në mendje faktin se asnjë kishë nuk është e përsosur. Në secilin trup të besimtarëve do të ketë probleme, dallime, dhe dobësi, por edhe pika të forta. Kisha lokale përbëhet prej njerëzve mëkatarë, të shpëtuar nga hiri i Perëndisë, të cilët vazhdojnë të luftojnë me zakonet e mëkatit në jetët e tyre. Kisha, pa dyshim, që do të na zhgënjej dhe kohë pas kohe do të na

Kisha lokale përbëhet prej
njerëzve mëkatarë, të shpëtuar
nga hiri i Perëndisë, të cilët
vazhdojnë të luftojnë me zakonet
e mëkatit në jetët e tyre

irritojë, dhe kjo sepse kisha është një institucion njerëzor. Kur ajo është duke funksionuar me dashuri dhe unitet dhe qëllim të përbashkët, asnjë entitet tjetër nuk e ka atë potencial për të tërhequr të tjerët pranë Krishtit dhe për ta përlëvduar Atë. Bukuria e kishës është se Krishti i ka bashkuar në një familje njerëz nga shumë raca, klasë shoqërore, gjuhë dhe kultura. Ne mund të kemi tendencën që të kërkojmë një kishë ku çdonjëri është sikurse ne: nga një kulturë e njëjtë, klasë shoqërore apo racë. Megjithatë, Krishti na ka ftuar në një familje të shumëllojshme, ku Ai na njofton me

motra dhe vëllezër nga shumë kultura të ndryshme. Vetëm Ai mund të sjell harmoni në një familje kaq të shumëllojshme.



Falënderoj Perëndinë për bukurinë e planit të Tij për të krijuar një familje të shumëllojshme të përbërë nga shumë kombe. Kërko nga Ai që të të ndihmojë të thellosh përkushtimin tënd ndaj një trupi lokal të besimtarëve.



- Përkruaj veçantinë e familjes së Perëndisë.
- Si e ke përjetuar shumëllojshmërinë e trupit të Krishtit? Në çfarë mënyrë e ka pasuruar jetën tënde një përvojë e tillë?
- A do ta përshkruaje bashkësinë tënde, si të karakterizuar nga toleranca apo jo toleranca ndaj atyre që dallojnë prej teje?
- Si mund të kontribuonit për të përforcuar këtë fushë?



1. Shkruaj në fletoren tënde mendimet e tua se si bashkësia e të krishterëve të hershëm kishte reflektuar besimin e tyre në Krishtin?
2. Si kishte ndikuar ideja e komunitetit në stilin e tyre të jetesës?
3. Çfarë paralele shihni në përvojën tuaj të bashkësisë?
4. Shkruaj mendimet e tua mbi atë që ofron bazën e bashkësisë së vërtetë dhe shpjego se përse është thelbësor përkushtimi ndaj një kishe lokale?
5. Shkruaj një definicion të shkurtër të bashkësisë bazuar në atë që ke studiuar deri më tani.
6. Si dallon bashkësia e krishterë nga shoqëritë që përjetojmë në rrethet e tjera shoqërore?

Karakteristikat e jetës në familje

Ne kemi parë se bashkësia me besimtarët e tjerë bazohet në ndarjen e besimit tonë të përbashkët në Krishtin. Për shkak të shpengimit që kemi në Krishtin, ne hyjmë në një lidhje unike me vëllezërit dhe motrat tona që janë gjithashtu besimtarë. Ne do t'i shikojmë disa nga karakteristikat e jetës në familjen e Perëndisë.

Uniteti

Uniteti i besimtarëve është shumë i rëndësishëm për Perëndinë dhe është vendimtar në dëshmimin e kishës në botë.

Tek Gjoni 17 ne kemi lutjen e fundit që Jezusi bëri me dishepujt e Tij në dhomën e sipërme, vetëm disa orë para se të përballej me vdekjen e Tij.



Lexoni Gjoni 17:20-26. Çfarë shqetësimi ndodhej në zemrën e Jezusit? Përse mendoni se kjo ishte e vërtetë?

Uniteti i tërë besimtarëve ishte prioritet shumë i lartë në mendjen e Jezusit në orët e fundit të jetës së Tij, dhe Ai tregoi se sa i rëndësishëm ishte ky unitet për të para se të përballej me kryqin. A e kemi këtë pasion për unitet në mesin e besimtarëve të tjerë?

Dishepujt e kuptuan që ishte thelbësor uniteti në mesin e besimtarëve. Tek Filipianëve 2, Pali i urdhëroi të krishterët filipianë që të kenë unitet. Ne e ndjejmë urgjencën dhe shqetësimin e tij teksa ai u flet me tërë zemër.



Lexoni Filipianëve 2:1-11.

1. Cilat janë ato katër fusha në të cilat ata duhet të jenë të unifikuar?
2. Cilat qëndrime janë të domosdoshme që të arrihet uniteti?

Si mund të aplikojmë atë që Pali është duke mësuar këtu? Kur tundohejmë që të mendojmë se jemi më të mirë se të tjerët, ne mund t'i bëjmë vetës këtë pyetje, “çfarë kam, e, që nuk e kam marrë nga Zoti?” Nëse jemi më inteligjent, më të pasur, kemi të mira më të larta fizike apo shoqërore, nuk është se ne jemi më të mirë, por se jemi më me fat. Reagimi ynë ndaj dhuratave të Perëndisë duhet të jetë një mirënjohje e përlulur.

Pali e përfundon këtë thirrje për unitet me shembullin më të lartë të vetë-sakrificës së përlulur – Zoti Jezus. Ne jemi të thirrur që të kemi po të njëjtën mendje që kishte Krishti kur Ai la tërë lavdinë e qiellit dhe e përuli Vetveten që të vuante një vdekje poshtëruese në kryq. Shpirti që krijon unitet është në një shpirt i vetë-sakrificës, dhe që në rend të parë kujdeset për mirëqenien e besimtarëve.



Pusho për një minutë dhe reflekto në lidhje me mësimin tek Filipianëve 2:1-11.

A ke në jetën tënde qëndrime që janë në kundërshtim me qëndrimet e paraqitura këtu?

Deri në ç'nivel mund t'i vendosësh nevojat e të tjerëve para nevojave të tua? A mund të thuash me sinqeritet se është dëshira e jote që t'i shohësh duke përparuar vëllezërit dhe motrat e tua në Zotin? Nëse jo, përse?

Nëse identifikon ndonjë qëndrim të gabueshëm apo mungesë të shqetësimit nga ana jote, shkruaji ato në fletoren tënde.



Merr kohë dhe lutu në lidhje me qëndrimet që ke vërejtur gjatë këtij ushtrimi. Kërkoi Perëndisë që të të jep një frymë të përlësisë dhe një dëshirë për t'i vendosur nevojat e të tjerëve para nevojave të tua.

Dashuria

Në orët e fundit me dishepujt e Tij, Jezusi u ngrit, mori një enë me ujë, dhe u lau këmbët dishepujve të Tij, duke u dhënë atyre një shembull të paharrueshëm të shërbimit dhe përlësisë (Gjoni 13). Duke ndjekur këtë shembull, Ai u tha atyre, “Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin. Prej kësaj do t'ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:34-35) Dashuria është shenja dalluese e ndjekësve të Krishtit.

Shërbesa e Jezusit ishte shembulli i përsosur i dashurisë: Ai shpenzoi kohë me njerëz nga të gjitha kulturat dhe klasat shoqërore. Në fillim të shërbesës së Tij, Jezusi e pyetën se cili ishte urdhërimi më i madh. Siç lexojmë tek Mateu 22:37-39, Ai u përgjigj "DUAJE ZOTIN, PERËNDINË TËNDE ME GJITHË ZEMRËN TËNDE, ME GJITHË SHPIRTIN TËND DHE ME GJITHË MENDJEN TËNDE". Dhe pastaj shtoi “Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: "DUAJE TË AFËRMIN TËND PORSI VETVETEN. Nga këto dy urdhërime varet i tërë Ligji dhe Profetët".

Kur e duam Perëndinë me të vërtetë, dashuria jonë për të tjerët do të rritet.

Dashuria dhe uniteti janë të ndërlidhura. Teksa mësojmë t'i duam besimtarët e tjerë, ne do të zbulojmë se kemi një fokus më të madh për të jetuar në unitet me ta. Të jetuarit në harmoni me besimtarët e tjerë nuk është gjithnjë e lehtë. Ekziston një ironi ndaj faktit që ne mezi presim të kalojmë përjetësinë me njerëzit që shpesh nuk mund t'i durojmë këtu në tokë. Në anën tjetër jemi të urdhëruar që të duam, dhe kështu ne mund të zgjedhim që të duam.



A pajtoheni me thënien që ne mund të zgjedhim që të duam? Pse ose pse jo? Si e keni parë të rritet dashuria jote për Perëndinë që kur je bërë një i krishterë? Si është rritur dashuria jote për të tjerët? Si e keni parë mungesën e dashurisë të distancojë njerëzit nga Krishti apo edhe nga kisha?

Qëllimet e përbashkëta

Teksa dashuria dhe uniteti janë dy karakteristika që Jezusi i theksoi si shenja dalluese të dishepullizimit, Dhiata e Re e bënë të qartë që besimtarët duhet të marrin pjesë gjithashtu edhe në qëllimet e tyre të përbashkëta. Ne do t'i shikojmë shkurtimisht këto dy qëllime të përbashkëta: adhurimi dhe shërbesa. Mësimi ynë i radhës do të zhvillojë temën e shërbesës më tërësisht.

Adhurimi. Gjatë tërë Biblës ne shohim që Perëndia gjithmonë ka dëshiruar të ketë një popull që do t'i takonte Atij, që do të ishte i përkushtuar ndaj Tij dhe që do të t'i sillte lavdi Atij. Qëllimi ynë i parë i përbashkëta si besimtarë është pra adhurimi i Perëndisë.

Adhurimi i vërtetë i drejtohet Perëndisë. Ne shpesh mendojmë për adhurimin të kënduarit dhe të luturit së bashku, mirëpo adhurimi në të vërtetë reflekton një qëndrim të brendshëm dhe përgjigje ndaj Perëndisë. Bibla është e mbushur me skena të adhurimit, ku shohim individë të përkulur plot frikë dhe edhe të shtrirë përpara Perëndisë. Njerëzit e urtë u përlënë përpara Jezusit (Mat.2:11), ashtu siç veproi edhe Jairo (Mk.5:22)^b, lebrozi i shëruar (Mat.8:2), dhe dishepujt e Jezusit pas ringjalljes së Tij (Mat.28:17).

Një ndër konceptet kyçe të lidhura me adhurimin në Bibël, është përkulja apo shtrirja para Perëndisë. **Në një kuptim, “adhurimi është qëndrimi i duhur i një njeriu para Perëndisë së Gjallë.”**³ Gjesti i përkuljes apo shtrirjes është një akt simbolik që paraqet një përgjigje të brendshme të përlësisë, nënshtrimit, respektit dhe varësisë ndaj Perëndisë. Ish kryepeshkopi i Canterbury William Temple shkruan, “Adhurimi është nënshtrimi i tërë natyrës sonë para Perëndisë.”⁴ Përkulja e kokës sonë apo gjunjëzimi duhet të tregojnë atë që është duke ndodhur në shpirtin tonë. Që të ndodh adhurimi i vërtetë, gjithçka që ne jemi duhet të përkulet – mendja jonë, vetëdija jonë, vullneti ynë. Perëndia ka shpallur që një ditë çdo gju do të përulet para Tij (shiko Isa.45:23; Fil.2:10; Zbu.15:4).



Si dëshiron Perëndia që ne ta adhurojmë Atë? Lexo Gjoni 4:23-24. Çfarë i tha Jezusi në lidhje me adhurimin gruas tek pusi? Çfarë nënkuptoi Ai me këtë?

Jezusi e bëri të qartë se adhurimi i vërtetë ndodh brenda nesh. Ne mund ta adhurojmë Perëndinë pa marrë parasysh nëse jemi duke u lutur, duke e lavdëruar Perëndinë në këngë, duke e lexuar dhe shpjeguar Shkrimin, duke dhënë nga të ardhurat tona apo duke marrë pjesë në darkën e Zotit. Adhurimi ynë mund të ndodh dhe mund të shpjegohet

në forma të ndryshme. Adhurimi i vërtetë nuk varet në kombinimin e duhur të muzikës dhe predikimit apo në vetë format.

Kur ne adhurojmë, mendimet tona duhet të fokusohen në Perëndinë.

Ne mund ta pyesim veten çfarë duhet të ndodhë në vendin tonë të adhurimit, në mënyrë që Perëndia të mund të thotë, “Sot më adhuruan këtu.” Adhurimi i vërtetë ndodh atëherë kur besimtarët kërkojnë të përmbushin qëllimet e adhurimit: duke mbajtur qëndrimin e duhur para Perëndisë me një qëndrim të brendshëm të përlësisë, nënshtrimit, respektit dhe varësisë ndaj Perëndisë, si dhe përgjigja për t’i shërbyer Atij me gatishmëri.⁵

Çfarëdo praktika që përdorim në adhurim, ato duhet të na nxisin që të zhvillojmë këto reagime ndaj Perëndisë.

Përderisa adhurimi pikë së pari dhe para se gjithash i drejtuar Perëndisë dhe për Të, ai gjithashtu na ndryshon edhe neve. Adhurimi na transformon teksa ndjejmë praninë e Perëndisë dhe përjetojmë një reagim të dashurisë për Të, teksa përjetojmë një dëshirë për ta ndjekur Krishtin më afër dhe për t’u bërë më shumë si Ai, dhe teksa ndjejmë përgjegjësitë tona për t’i dashur dhe për t’u kujdesur për të tjerët si dhe për t’i arritur të humburit.

Adhurimi i vërtetë shprehet në lutje. Kur Jezusi e filloi shërbesën e Tij në tokë, një ndër aktet e Tij sapo hyri në Jerusalem ishte të nxirrte nga tempulli ata të cilët e kishin shndërruar tempullin në një vend tregu dhe të cilët po shtypnin të varfrit duke i mbingarkuar me çmime të larta për kafshët e sakrifikuara. Pasioni i Jezusit për tempullin si vendin e adhurimit ishte shumë i dukshëm kur ai thirri me zë të lartë, “ËSHTË SHKRUAR: "SHTËPIA IME DO TË QUHET SHTËPI LUTJE", por ju e keni kthyer në një shpellë kusarësh`. (Mat.21:13)

Sot në shumë kisha, lutja luan një rol shumë të vogël në adhurim. Ne shumë shpesh jemi të fokusuar të plotësojmë nevojat tona dhe jo të adhurojmë Perëndinë me anë të lutjes. Por ashtu siç e pamë edhe më herët, lutja për ne si besimtarë është një privilegj i madh; ajo është pjesë thelbësore e adhurimit të vërtetë dhe një shprehje e marrëdhënies sonë me Perëndinë. Sa e këndshme që është për Perëndinë kur njerëzit e Tij e adhurojnë Atë së bashku por edhe në mënyrë private në lutje.

Adhurimi i vërtetë rezulton në shërbim. Koncepti themelor, i cili lidhet me adhurimin si në Dhiatën e Re ashtu edhe në atë të Vjetrën, ka të bëjë me shërbimin. Kur i shërbejmë Perëndisë, ne në fakt jemi duke e adhuruar Atë. Gjithçka që bëjmë për Perëndinë është pjesë e adhurimit tonë.



Çfarë e ka sfiduar mendjen tënde gjatë diskutimit të sipërm për adhurimin? A karakterizohet adhurimi yt nga qëndrimet e respektit dhe nënshtrimit ndaj Perëndisë? Si të ka transformuar adhurimi i vërtetë?

Shërbimi. Përderisa qëllimi ynë i parë si besimtarë është ta adhurojmë Perëndinë, një qëllim i dytë që ne ndajmë si besimtarë, është të marrim pjesë në shërbesë. Besimtarët duhet të marrin pjesë në përhapjen e mbretërisë së Perëndisë duke e ndarë ungjillin dhe duke e ndërtuar trupin e Krishtit, që është kisha.

Arritja e botës së humbur është një qëllim kyç, të cilin e kanë të gjithë besimtarët. Teksa Jezusi u ngrit për në qiell, fjalët e Tij të fundit që u dha dishepujve të Tij, ishin një porosi për ta dhe këto fjalë qysh atëherë janë quajtur “Porosia e Madhe.”



Lexoni këto fjalë tek Mateu 28:19-20.

1. Çfarë urdhërime i dha Jezusi dishepujve të Tij?
2. Çfarë premtimi u dha gjithashtu?
3. Çfarë ndikimi pati kjo ngjarje në dishepujt? Po në botën?

Gjatë jetës së hershme të Jezusit, Ai tregoi dhembshuri për të humburit, ata që ishin shumë larg nga Perëndia dhe që kishin nevojë të restauroheshin prej Tij. Ai vazhdimisht i paralajmëroi dëgjuesit e tij për realitetin e ferrit dhe ndarjen e përjetshme nga Perëndia. Ai rrëfeu tregime për një dele të humbur, për një drahmi (qindarkë) të humbur, për një djalë të humbur, duke u përkujtuar dëgjuesve të tij se Ai kishte ardhur që të kërkonte të humburit (Luka 19:10). Ai kërkoi njerëz të thyer, siç ishte gruaja tek pusi. Ai qau për qytetin e Jerusalemit dhe për ngurtësinë e tij që kishte kundërshtuar Perëndinë. Përfundimisht, Ai erdhi tërë jetën e Tij dhe duroi peshën e mëkatit të të gjithë botës, duke i shtrirë krahët e Tij në kryq për t'i arritur të humburit.

Kur i kishte trajnuar dishepujt, Ai i dërgoi ata që të bënë të njëjtën gjë, të arrin të humburit me një mesazh të shpresës dhe të faljes. Sot Ai vazhdon të kërkojë punëtorë që të shkojnë dhe të sjellin të tjerë në mbretërinë e Tij, në mënyrë që të mund të marrin pjesë në sofrën e ahengut të Tij të madh. Ai dëshiron që ne të kemi po të njëjtën dhembshuri për të humburit dhe të shkojmë e t'i kërkojmë ata.

Perëndia e përdor kishën si instrumentin e Tij në botë për t'i sjellë të tjerët pranë Krishtit. Një ndër dëshmitë më të fuqishme të hirit të Perëndisë në një botë të grisur nga egoizmi dhe grindja, është uniteti i dashur i familjes së Perëndisë. Kur ky unitet shkatërrohet, humbet gjithashtu edhe dëshmia e Perëndisë në botë.

Një ndër dëshmitë më të fuqishme të hirit të Perëndisë në një botë të grisur nga egoizmi dhe grindja, është uniteti i dashur i familjes së Perëndisë.

Më herët ne pamë në Dhiatën e Re një fotografi të komunitetit të besimtarëve si një familje. Një metaforë e dytë për familjen e Perëndisë në Dhiatën e Re është ai i tempullit që ndërtohet si vendbanim për Perëndinë. Tek Efesianëve 2:21-22 Pali shkruan se “gjithë ndërtesa, e lidhur mirë, rritet për të qenë një tempull i shenjtë në Zotin, në të cilin edhe ju jeni bashkëndërtuar për të qenë një banesë e Perëndisë në Frymë.” Krishti i ka vendosur të gjithë besimtarët në një trup, dhe Ai është duke na ndërtuar që të bëhemi një tempull i shenjtë, të dedikuar për ta adhuruar Atë dhe që të përdoremi për lavdinë e Tij.

Besimtarët duhet të jenë të përgatitur që të bëjnë vepra të shërbimit në mënyrë që trupi i Krishtit të ndërtohet dhe besimtarët individual të rriten në maturi. Kur besimtarët bëhen më të pjekur ata demonstrojnë çdo herë e më shumë karakterin e Krishtit, dhe të tjerët do të tërhiqen nga Krishti nëpërmjet jetëve të tyre.



- Si je duke i arritur të humburit me mesazhin e dashurisë së Krishtit për ta?
- Çfarë mundësi ekzistojnë në kishën tënde që besimtarët të rriten në pjekuri në Krishtin dhe që t'ju shërbejnë të tjerëve? Si ke përfituar nga këto mundësi?
- Si mund të jesh pjesë e procesit për të inkurajuar ndërtimin e trupit të Krishtit?



1. Shkurtimisht shpjego secilën karakteristikë të jetës në familje: unitetin, dashurinë dhe qëllimet e përbashkëta të adhurimit dhe të shërbesës.
2. Trego se si secila karakteristikë kontribuon në dëshminë e trupit lokal?
3. Si i ke parë këto karakteristika, apo mungesën e tyre, të ndikojnë në dëshminë e kishës në botë?



Kërkoji Perëndisë që të të përdorë tani si instrumentin e Tij për të ndërtuar familjen e Perëndisë dhe për t'i shpallur dashurinë e Tij botë së humbur.

Përgjegjësitë tona në familje

Shkrimtarët e Dhiatës së Re u kanë dhënë besimtarëve shumë udhëzime në lidhje me atë se si të duan dhe si të shërbejnë. Një frazë në veçanti përsëritet shumë shpesh, fraza “njëri-tjetrin.” Nëse studiohen dhe kategorizohen të gjitha përdorimet e kësaj marrëdhënieje të veçantë mes besimtarëve, atëherë ato mund të grupohen në dymbëdhjetë veprime, të cilat besimtarët do të duhet t’i bënin për njëri-tjetrin.⁶ Këto dymbëdhjetë veprime janë rezultat i aktit më të madh që bëhet për “njëri-tjetrin” - e që është dashuria për njëri-tjetrin.



Për të fituar një mbresë të këtyre gjërave që bëhen për “njëri-tjetrin”, shënoje në fletoren tënde aktin e parë për “njëri-tjetrin.” Shiko referencën dhe shkruaj një përmbledhje të shkurtër se si e kupton ti këtë koncept. Pastaj cito një shembull se si mund ta aplikosh këtë në kishën tënde. Vazhdo këtë proces për secilin akt për “njëri-tjetrin.”

Gjymtyrë të njëri-tjetrit	Romakëve 12:5; 1 Korintasve 12:14-27
Jini të përkushtuar për njëri-tjetrin	Romakëve 12:10; Filipianëve 2:3-4
Tregoni kujdes për njëri-tjetrin	Romakëve 12:10; Gjoni 13:12-15
Jini të një mendje me njëri-tjetrin	Romakëve 15:5; Veprat e Apostujve 4:32
Pranoni njëri-tjetrin	Romakëve 15:7; Jakobi 2:1-13
Këshilloni njëri-tjetrin	Romakëve 15:14; 1 Korintasve 4:14
Përhëndetni njëri-tjetrin	Romakëve 16:3-16; 1 Pjetri 5:14
Shërbeni njëri-tjetrit	Galatasve 5:13-15; Mateu 20:25-28
Mbani barrët e njëri-tjetrit	Galatasve 6:2
Tregoni tolerance për njëri-tjetrin	Efesianëve 4:2; Kolosianëve 3:13
Nënshtrohuni njëri-tjetrit	Efesianëve 5:21; Filipianëve 2:3-4
Nxisni njëri-tjetrin	1Thesalonikave 5:11; Hebrenjve 10:24-25

Kur i lexojmë këto vargje, është e qartë që ne kemi përgjegjësi për të krishterët e tjerë. Jeta e krishterë, siç e thamë edhe më herët, është një jetë në familjen e Perëndisë. Ne nuk duhet të jetojmë të izoluar, të ndarë nga ky komunitet i ndjekësve të tjerë të Krishtit. Ne do t’i shohim më nga afër këto dy koncepte: nxitjen dhe qortimin për njëri-tjetrin.

Nxitja

Një përfitim nga të qenët në familjen e Perëndisë është nxitja e ndërsjellë që besimtarët mund t’i japin njëri-tjetrit. Jo vetëm që është nxitja një privilegj, mirëpo një gjë e tillë kërkohet nga besimtarët teksa ata i binden Perëndisë dhe jetojnë besimin e

tyre në Krishtin. Tek Hebrenjve 10:19-25 ne shohim se një nga kriteret e shpengimit në Krishtin dhe kësaj qasje që kemi në Perëndinë (v 19-22), është të mbajmë fort shpresën e jetës së përjetshme dhe të mendojmë seriozisht në lidhje me atë se si mund t'i nxisim besimtarët e tjerë që të rriten në dashuri dhe në bindje. Shumë larg nga të qenët një element i izoluar i shërbesës, që është i rezervuar për pastorin dhe këshilltarët profesional, **nxitja është një detyrë dhe privilegj për secilin besimtar.**

Pasi që Fryma e Perëndisë jeton në ne dhe pasi që ne kemi një njohuri personale për Perëndinë dhe Fjalën e Tij, ne të gjithë posedojmë potencialin për t'u shërbyer besimtarëve të tjerë në këtë mënyrë. Në anën tjetër teksa kisha mund të jetë një rezervuar i forcës shpirtërore, shpesh konflikti dhe ndarja janë karakteristika më të mëdha se sa nxitja. Si mund të bëhemi nxitës?

Që të bëhemi nxitës efektiv, ne duhet të jemi të përkushtuar për të nxitur, dhe gjithashtu duhet t'i zhvillojmë disa aftësi specifike. Kur fillon të bëhesh një nxitës duhet të nisësh me përkushtimin për të kërkuar më të mirën për të tjerët. Ashtu siç e pamë tek Filipianëve 2, duhet të jetë dëshira jonë që t'i vëmë të tjerët para nesh, t'i shohim nevojat e të tjerëve teksa plotësohen, edhe nëse tonat nuk plotësohen. Pa këtë perspektivë themelore, ne gjithmonë do t'i lëmë dëshirat dhe nevojat tona egoiste që të na pengojnë në shërbesën efektive ndaj të tjerëve.

T'i vësh të tjerët përpara duket si një qëllim i paarritshëm, apo edhe i pashëndetshëm, sepse nëse i vëmë nevojat e të tjerëve gjithmonë përpara, atëherë nevojat tona shpirtërore janë në rrezik që të dobësohen. T'i vëmë të tjerët përpara nuk do të thotë të vëmë shërbesën tonë për të tjerët përpara zhvillimit tonë shpirtëror. Në të kundërtën, ne duhet të ruajmë një marrëdhënie të shëndoshë me Perëndinë nëse duam të kemi fuqinë dhe dashurinë që janë të nevojshme për të inkurajuar të tjerët.

Të jesh një nxitës do të thotë që në marrëdhënien tonë me të tjerët ne kërkojmë t'i plotësojmë nevojat e tyre dhe nuk presim që ata t'i plotësojnë tonat. Qëllimi yt si një nxitës është që t'u shërbesh të tjerëve dhe të bësh çfarëdo që të mundesh për t'i ndërtuar ata. Mund të jetë dëshira jote që të tjerët t'i plotësojnë nevojat e tua, por kjo duhet të konsiderohet një çështje për t'u lutur mbase. Ne nuk mund të presim apo të kërkojmë që të tjerët të na shërbejnë.

Merr në konsideratë shembullin në vijim. Të dielën në mëngjes ti shkon në kishë duke ndjerë një nevojë për t'u rifreskuar shpirtërisht. Kur arrin atje, ti e sheh një grua, të cilën e njeh dhe e cila është dukshëm e zemëruar. E tërë mënyra e sjelljes së saj tregon se ajo është në një luftë të brendshme; ajo duket sikur çdo çast do të shpërthej në vaj. Në atë moment ti ke një zgjedhje: A do të provosh të flasësh me të dhe ta inkurajosh atë, apo do t'i vësh nevojat e tua para nevojave të saj? Ne përballemi me shumë zgjedhje të tilla sa herë që mbledhemi bashkë.

Në mënyrë që t'i vëmë shqetësimet e të tjerëve mbi shqetësimet tona, ne gjithashtu duhet të zhvillojmë aftësi të caktuara. E para është **të bëhemi dëgjues të mirë.** Ne të

gjithë e kemi përjetuar frustrimin e të biseduarit me dikë që nuk na dëgjon fare. Mosdëgjimi, jo vetëm që të shpie drejt kuptimit të dobët, por ai gjithashtu të jep ndjesinë se ti nuk je i interesuar në atë person fare. Kur jemi dëgjues të mirë, duke krijuar kontakt të mirë me sytë dhe duke i kushtuar vëmendje shenjave jo-verbale, ne i bëjmë njerëzit të mendojnë se ajo që ata janë duke ndarë është e rëndësishme dhe se ne shqetësohemi për problemet e tyre. Të dëgjuarit e vëmendshëm është një mënyrë e shfaqjes së kujdesit rreth nevojave të të tjerëve.

Kur njerëzit e kuptojnë se ne kujdesemi mjaft sa t'i dëgjojmë, ata janë më të gatshëm që të hapen me ne. Shumë njerëz kanë frikë t'i bëjnë të njohura nevojat e tyre apo t'i ndajnë mendimet dhe ndjenjat e tyre të brendshme. Frika se mos na marrin për joshpirtërorë, përvojat e këqija në të kaluarën, si dhe faktorë të tjerë, i mbajnë njerëzit brenda guaskave ku edhe fshihen. Dëgjimi me durim i ndihmon shumë njerëzit që të ndihen aq të sigurt sa t'i heqin maskat e tyre.

Ai që është nxitës duhet të dijë **të bëjë pyetje të mira**. Pyetjet e menduara mirë mund të jenë çelësi që njerëzit të hapen ndaj nesh dhe të na lejojnë që t'u shërbejmë atyre. Pyetjet duhet të reflektojnë kujdes dhe mirëkuptim, duke i bërë ata të kuptojnë se në ne mund të gjejnë një dëgjues mirëpritës.

Jo vetëm që duhet të mësojmë se si të dëgjojmë dhe të bëjmë pyetje të mira, ne gjithashtu duhet **të mësojmë të flasim fjalë inkurajimi**. Fjalët janë të fuqishme dhe kanë aftësinë të shkatërrojnë apo të ndërtojnë. Fjalët e Urta 18:21 thonë, “Vdekja dhe jeta janë nën pushtetin e gjuhës; ata që e duan do të hanë frytet e saj.” Bibla ka shumë për të thënë rreth fuqisë së fjalëve.⁷

Pos që mund t'i inkurajojmë të tjerët me fjalët tona, ne mund të inkurajojmë ata me anë të veprave të mirësisë dhe të kujdesit. Ne mund ta inkurajojmë një vëlla të vetmuar duke e vizituar atë, një vëlla të rënduar duke i mbajtur barrën atij, një koleg të mbingarkuar me punë duke i ndihmuar në ndonjë mënyrë, apo thjeshtë duke i dërguar një kartë inkurajimi apo mirënjohjeje. Veprat e menduara mirë mund të jenë mjete të fuqishme të inkurajimit.



Si ke përfituar nga nxitja e të tjerëve? Si i ke nxitur të tjerët? Çfarë përparimi ke parë në aftësitë e tua për të dëgjuar, për të bërë pyetje të mira, dhe për të folur fjalë inkurajuese? Çfarë të është dukur e dobishme në këtë diskutim?

Qortimi

Të gjithë besimtarët e kanë të vështirë të shikojnë një vëlla apo motër të mëkatojnë. Ofendimi mund të ndikojë tek ne drejtpërsëdrejti, apo ne thjeshtë mund të informohemi rreth tij. Cili duhet të jetë reagimi ynë? Cilat janë përgjegjësitë tona në një situatë të tillë?

Qortimi përfshinë këshillimin, udhëzimin, korrigjimin, apo paralajmërimin. Shpesh të krishterët e keqkuptojnë se çfarë do të thotë qortimi i të tjerëve. Qortim nuk do të thotë t'i gjykosësh të tjerët, gjithashtu nuk nënkupton që ne kemi lejen për t'ju gjetur gabimet të tjerëve apo për t'i kritikuar lirisht të tjerët. Në të vërtetë, **motivi ynë për të qortuar një besimtar tjetër duhet të jetë dashuria jonë për atë person dhe dëshira jonë për të mirën e atij personi.**



Lexo Mateu 7:3-5, Romakëve 15:14, dhe Galatasve 6:1.

1. Çfarë paralajmërimi u dha Jezusi ndjekësve të Tij?
2. Çfarë kushte paraprake janë të nevojshme për ata që marrin përsipër t'i korrigjojnë të tjerët?
3. Në ç'mënyrë duhet t'i qortojmë të tjerët?

Mësuesi i famshëm i Biblës dhe pastori Gene Getz thotë,

“Qortimi duhet të bazohet në vullnetin dhe mënyrat specifike të Perëndisë – jo në çfarë mendojmë ne se të krishterët e tjerë duhet apo nuk duhet të bëjnë ... Nëse i këshillojmë të krishterët në fushat që janë jashtë-biblike – fusha që specifikisht nuk përmenden në Shkrim apo gjëra të tjera specifike që përfshijnë standarde dhe praktika kulturore – atëherë ne jemi në rrezik që të imponojmë standarde që janë në kundërshtim me Shkrimin.”⁸

Ndonjëherë të krishterët kanë një tendencë që të ngatërrojnë absolutësinë biblike me jo-absolutësinë. Ne duhet të jemi të kujdesshëm që të mos imponojmë tek të tjerët standardet tona në lidhje me atë që është e drejtë apo gabim. Shumë të krishterë janë tepër të shpejtë që të qortojnë të tjerët, duke pretenduar të jenë shumë të drejtë dhe në proces e sipër shfaqin shumë pak dashuri.

Në ekstremin tjetër janë njerëzit të cilët janë shumë të druajtur apo shumë të papërfshirë që të rrezikojnë t'i thonë ndonjë gjë ndokujt. Rezultati mund të jetë që mëkati i madh tolerohet në bashkësinë tonë, duke dhënë një shembull të keq për të tjerët brenda trupit. Në kontrast të këtyre dy ekstremeve, Bibla na prezanton një pikëpamje të balancuar. Fakti që ne jemi të urdhëruar të qortojmë njëri-tjetrin na ndalon nga të ndenjurit në heshtje përgjithmonë.

Si duhet të qortojmë një besimtar tjetër? Së pari, ne gjithmonë duhet të qortojmë me kujdes dhe dashuri të vërtetë. Pa pasur sigurinë se ne i duam ata me të vërtetë, gjasat janë shumë të vogla që ata të cilët i paralajmërojmë t'i fshijnë barrierat e tyre dhe të pranojnë atë që kemi për t'u thënë. Motivi ynë nuk duhet të jetë për t'i shkatërruar apo

poshtëruar ata, mirëpo për t'i ngritur dhe ndrequr ata (Gal.6:1). Sikurse për Palin, qëllimi ynë në qortimin e besimtarëve të tjerë duhet të jetë që t'i paraqesim ata të plotë në Krishtin (Kol.1:28-29).

Ne gjithashtu duhet të jemi të përkushtuar për t'i ndihmuar atij vëllai apo asaj motre, duke kërkuar që të përkrahim rritjen dhe mirëqenien e tij/saj shpirtërore me anë të nxitjes dhe qortimit të mëtutjeshëm. Kur pjesëtarët e trupit të Krishtit funksionojnë në këto fusha të nxitjes dhe qortimit, ashtu siç Perëndia i ka dizajnuar, atëherë kisha rritet fuqishëm.



- Si praktikohet qortimi në kishën tënde?
- Si je qortuar nga ndokush brenda trupit? Si ka ndodhur dhe cili ka qenë rezultati?
- Si i ke qortuar të tjerët? Si mund t'i aplikosh parimet e qortimit të dhëna në këtë mësim?

Zgjidhja e konfliktit në familje

Ashtu siç shfaqen konfliktet në familjen tonë njerëzore, po kështu mund të presim që të shfaqet konflikti edhe në familjen e Perëndisë. Një vështrim i shpejtë në faqet e historisë së kishës na përkujton që konflikti ka qenë i pranishëm në çdo gjeneratë. Ata që janë në familjen e Perëndisë janë akoma të ndarë nga lloji Adamik. **Ne jemi njerëz me dobësi dhe shpesh jemi të përqëndruar tek vetja, dhe pa marrë parasysh se sa të pjekur që jemi, natyra jonë mëkatore do ta shfaq veten e saj kohë pas kohe.** Ne do të reagojmë në zemërim apo mërzi apo do të veprojmë me egoizëm. Ne jo gjithmonë do të pajtohemi, dhe mund të shtyjmë që mendimi ynë të fitoj. Shpesh do të jemi vetjak dhe të padashur. Në kishat më të mira, konflikti do të lind. Mënyra se si do ta trajtojmë atë konflikt do të jetë një dëshmi e pjekurisë sonë.



Shikoni Jakobi 4:1-2 dhe Jakobi 3:1-12. Sipas këtyre pasazheve, cilat janë disa nga shkaqet e mos unitetit në trupin e Krishtit?

Shpesh konfliktet lindin për shkak të egoizmit, krenarisë dhe mungesës së dëshirës për t'i marrë në konsideratë pikëpamjet e të tjerëve. Konflikti shpesh fillon dhe përshkallëzohet nga fjalë të rënda, të cilat i fryjnë flakëve të debatit. Kur ne nuk e shohim veten si pjesë të një entiteti më të madh, familjes së Perëndisë, dhe e mbajmë fokusin në dashurinë dhe unitetin, atëherë konflikti bëhet shkatërrues për bashkësinë.

Zgjidhja e konfliktit është një pjesë themelore e ruajtjes së unitetit në trupin e Krishtit. Një i krishterë duhet të marrë iniciativën për t'u pajtuar, pa marrë parasysh nëse ai është pala e ofenduar apo ofenduesi (Mat.5:23-24; Mat.18:15). Ne nuk mund

t'i shpallim botës së humbur një mesazh të pajtimit, nëse ne nuk jemi në gjendje të pajtohemi me anëtarët e familjes sonë. **Kur të jemi pajtuar me njëri-tjetrin, atëherë i tregojmë botës se çfarë nënkupton pajtimi.**⁹



Lexo Mateu 5:23-24. Shkruaj mendimet e tua në lidhje me kuptimin e këtij pasazhi dhe implikimet e tij për ty personalisht dhe për kishën.

Adhurimi ynë për Perëndinë dëmtohet nga marrëdhëniet e prishura në mesin e besimtarëve. Prandaj, ndarja në mesin e vëllezërve është një shkelje e rëndë. Si të krishterë ne duhet “të kërkojmë paqe me të gjithë” (Heb.12:14) dhe gjithashtu të jemi të përkushtuar që t'i zgjidhim dallimet me anëtarët e tjerë në familjen e Perëndisë.



Bazuar në atë që ke mësuar në këtë mësim, si do ta inkurajoje Erikën në lidhje me dëshirën e saj për një bashkësi më të thellë dhe në lidhje me zhgënjimin e saj nga besimtarët e tjerë?



Çështja e restaurimit të marrëdhënieve brenda trupit është e rëndësishë shumë të madhe. Për shkak të kësaj, merr kohë tani dhe vlerësoje jetën tënde. Para se të fillosh mësimin e radhës, nëse ekzistojnë marrëdhënie me besimtarët e tjerë, të cilat janë të lënduara apo dëmtuara për shkak të mëkatit, merr një hap dhe kërko pajtim. Ji i përgatitur të ndash një ndryshim pozitiv në jetën tënde (ose brenda karakterit tënd ose brenda një marrëdhënieje), që është rezultat i dëshirës tënde për pajtim.

Nganjëherë, pajtimi nuk është i mundur nëse personi tjetër nuk ka dëshirë që të pajtohet, Ne i kemi bashkangjitur këtij mësimi një shtojcë në mënyrë që të japim disa udhëzues biblik se si të kërkohet pajtueshmëria.

Mendime përmbyllëse

Si besimtarë ne jemi të bashkuar me njëri-tjetrin sepse Krishti na ka pajtuar dhe na ka vendosur në familjen e Perëndisë. Si pjesëtarë të familjes ne kemi një përgjegjësi dhe përkushtim për njëri-tjetrin. Ne jemi thirrur që t'i shfaqim dashurinë e Perëndisë botës duke u dhënë mundësinë që të shohin dashurinë dhe unitetin që ne gëzojmë në familjen e Perëndisë. Si shtesë, ne ndajmë të njëjtat qëllime, për ta adhuruar Perëndinë dhe për t'ju shërbyer të tjerëve, teksa kërkojmë t'i sjellim të tjerët te Krishti dhe të ndërtojmë trupin e Krishtit.

Për t'i përmbyllur këto qëllime dhe për t'i sjellë lavdi Perëndisë, ne duhet të mësojmë të nxisim njëri-tjetrin, të trajtojmë mëkatin në trupin lokal të besimtarëve, dhe

të zgjidhim konfliktet, të cilat, teksa jetojmë së bashku në komunitet, shfaqen në mënyrë të pashmangshme. Kur një kishë funksionon në këtë mënyrë, ajo do të jetë si një fanar deti në një botë të errësuar, e cila do t'i ngrejë shumë drejt dashurisë së Krishtit të cilën e shohin të reflektuar në ta. Mënyra se si jetojmë së bashku si familje e Perëndisë, lë një trashëgimi të përhershme në botë.

FUSNOTA

¹ Walter Bauer, *A Greek-English Lexicon of the New Testament and Other Early Christian Literature*, ed. William F. Arndt, F. Wilbur Gingrich, 2d ed., ed F. Wilbur Gingrich and Frederick W. Danker, 2d ed. (Chicago: University of Chicago Press, 1979), s.v. “koinonia.”

² John White, *The Fight: A Practical Handbook for Christian Living* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1976), 143.

³ Ibid., 83.

⁴ William Temple, *Readings in St. John’s Gospel*, 2 vols. (London: Macmillan, 1939, 1940; reprint, 2 vols. in one [Wilton, CT: Morehouse Barlow, 1985], 67).

⁵ Lawrenz, 92.

⁶ Shiko Gene A. Getz, *Sharpening the Focus of the Church* (Wheaton, IL: Victor, 1984), 163-64.

⁷ Shiko Fjalët e Urta 12:25; 15:1, 2, 4; 16:24; 25:11, 23; Jak.3:2-12.


⁸ Gene A. Getz, *Building Up One Another* (Wheaton, IL: Victor, 1988), 53-54.

⁹ Shiko Richard Halverson, *The Living Body* (Gresham, OR: Vision House, 1994), 54.

Shtojcë

Një qasje biblike për zgjidhjen e konfliktit në mesin e besimtarëve

Konfliktet që fillojnë si çështje të vogla, në rast se nuk trajtohen, mund të shpërthejnë në luftëra të mëdha. Nganjëherë ky është rezultat i mungesës së dëshirës për të zgjidhur konfliktin, por shpesh buron nga mungesa e një plani të përcaktuar të veprimit. Diagrami në vijim ilustron disa shkaqe të mos unitetit në bashkësinë e besimtarëve.



SHKAQET E MOS UNITETIT

Bibla jo vetëm që na këshillon që të kërkojmë pajtim, por gjithashtu na sugjeron mënyrat se si ta realizojmë atë. Nga mësimi i Shkrimit ne kemi nxjerr një plan katër pikësh për zgjidhjen e konflikteve. Kur ndiqen këta hapa, ne do të fillojmë të shohim një rritje të dashurisë në kishë.

1. **Shqyrto veten.** Kontrolllo qëndrimin tënd. Pyete veten: A është marrëdhënia ime me Perëndinë e fortë? A e kam rrëfyer mëkatin tim, në veçanti atë mëkat që ndërlidhet me problemin të cilin po mundohem ta ballafaqojë tani? A jam i përkushtuar ndaj nevojave të personit apo personave tjerë të involvuar? A është dëshira ime në këtë situatë që bëjë timen se s'bënë ndryshe, të hakmerrem, apo ndreq unitetin? Kur merremi me qëndrimet dhe motivet tona, atëherë ne jemi gati që të vazhdojmë tutje (Mat.7:1-5; Gal.6:1).
2. **Shko dhe takojë atë person në mënyrë private.** Dy gjëra janë të rëndësishme këtu. E para, merr iniciativën. Ti nuk duhet të presësh që personi tjetër të vijë tek ti; ti duhet të shkosh tek personi tjetër. Kjo është e vërtetë edhe nëse ti nuk je burimi i problemit. E dyta, arsyeja pse ti shkon ta takosh vetëm për vetëm është që të përfshihen vetëm ata që janë përgjegjës për problemin. Një ndër shkaqet kryesore pse lindin përçarjet në kishë është se pse ne kërkojmë mbështetje nga të tjerët për mosmarrëveshjet tona. (Mat.18:15).
3. **Vazhdo ta duash atë person dhe kërko mënyra për t'i shërbyer dhe për të ndërtuar personin tjetër,** edhe nëse ke shkuar tek personi tjetër dhe je munduar të zgjidhësh konfliktin dhe personi tjetër nuk është përgjigjur pozitivisht. Duke vepruar kështu, ti do të mbjellësh farë për pajtim të mëvonshëm (Rom.15:1-7; Gal.6:1a).
4. **Duke u lutur ndiq hapat e Mateut 18:15-17** kur personi tek i cili shkon, refuzon t'i përgjigjet iniciativës tënde dhe problemi është aq i rëndë sa të ndikojë funksionimin e tërë trupit.


Lexoni këto vargje. Cili duhet të jetë motivi yt gjatë kërkimit të këtij veprimi? Ky pasazh na jep udhëzime se si të trajtojmë një të krishterë tjetër që është në mëkat, por është i aplikueshëm edhe kur një konflikt ndërpersonal kërcënon trupin si tërësi.

Këta janë hapat:

- a. Merr një besimtar tjetër të rritur me ty. Ky person mund të kërkojë të bëhet ndërmjetës dhe të punojë për të sjellë restaurimin e unitetit. Si shtesë, ky person shërben si një dëshmitar për përpjekjet e tua për restaurim.
- b. Nëse kjo nuk funksionin, atëherë paraqite çështjen para kishës. Presioni mbi individin që të dëgjojë rritet kur sillen më shumë njerëz në procesin e restaurimit. Fokusi i këtij hapi duhet të jetë qëllimi për të kërkuar restaurim.
- c. Nëse akoma nuk ndodh pajtimi, personi që ka mëkatuar duhet të trajtohet si një i huaj. Këtij personi nuk i lejohet që të marrë pjesë në bekimet dhe përfitimet e asamblesë

së Perëndisë. Duke vepruar kështu, personi konfrontohet me seriozitetin e mëkatit dhe përkushtimin e kishës për shenjtëri. Kjo nuk do të thotë se njerëzit e kishës duhet ta trajtojnë jo mirë personin që ka mëkatuar. Në të kundërtën, ata duhet të kërkojnë që ta kthejnë atë person përsëri në bashkësi me Perëndinë dhe në kishë.

Një fjalë paralajmërimi është në rregull. Këta hapa të fundit duhet të merren vetëm pasi të kesh kaluar një kohë të gjatë në lutje dhe kur funksioni dhe dëshmia e kishës janë duke u penguar.



TË ZGJIDHËSH KONFLIKTIN

Një jetë e shërbesës

Hana shkon në kishë për disa vite dhe çdo javë kënaqet me studimin e Biblës. Së fundi i kanë kërkuar që të ndihmojë rreth takimit të fëmijëve në kishën e saj, por ajo ndihet sikur nuk është e kualifikuar. Ajo asnjëherë nuk ka bërë ndonjë trajnim formal dhe mendon se nuk ka ndonjë gjë për të ofruar. Ajo e shqetësuar mendon “Çfarë nëse dikush më bënë ndonjë pyetje, të cilës nuk do të mund t’i përgjigjem?” Prindërit, motra dhe vëllezërit e saj nuk janë besimtarë, dhe sa herë që mundohet t’i ftoj që të vijnë në kishë me të, ata nuk tregojnë ndonjë interes, gjë që e bënë atë të ndjehet se ka dështuar në dëshmim.

Si do ta inkurajonit Hanën që të bëhej një pjesëmarrëse më aktive në jetën e kishës së saj? Çfarë ndihme do të mund t’i ofronit në mënyrë që ajo të ndante besimin e saj me familjen e saj?



Kur ne bëhemi të krishterë, ne fitojmë një qëllim të ri për jetën. Ne më nuk jetojmë për veten tonë, por për Krishtin. Kur Pali i urdhëroi besimtarët e Romës që ofronin trupat e tyre si fli të gjalla, të shenjtëruar dhe të pëlqyer tek Perëndia, ai e përshkroi këtë si shërbesën e tyre të mençur (Rom.12:1). Perëndia dëshiron që ne t’i ofrojmë jetët tona për t’i shërbyer Atij. Shërbesa jonë për Të është aktualisht një akt adhurimi për Të. Jo vetëm kaq, Perëndia ka punë specifike të shërbesës, të cilat i ka përgatitur për secilin prej nesh (Ef.2:10). Jetët tona, si ndjekës të Krishtit, duhet të jenë jetë të shërbesës për Perëndinë dhe të tjerët. Në këtë mësim ne do të shqyrtojmë aspekte të ndryshme të jetës së shërbesës.

Përmbledhje e mësimit

Të shërbyerit: Platforma për shërbesë

Çmimi i të qenët dishepull

Një shembull i shërbesës

Shërbesa: Përgjegjësia e çdo besimtari

Kush duhet të shërbejë”

Motivimi për shërbesë
Përfitimet nga shërbesa
Fokusi i shërbesës
Arritja e të humburve
Ndërtimi i Trupit të Krishtit
Forca për shërbesë
Mendime përmbyllëse

Qëllimet e mësimit

Kur ta kesh përfunduar këtë mësim, ti do të jesh në gjendje që:

1. Të krahasoni standardet e botës për madhështoren si dhe standardet e Krishtit për madhështoren.
2. Të shpjegoni çmimin e dishepullimit, bazuar në mësimin e Jezusit.
3. T'i krahasoni motivet e juaja me tri motivet e shërbesës së Palit të identifikuar në 2 Korintasve 5:9-15.
4. Të identifikoni disa nga përfitimet e shërbesës për atë që shërben dhe të ilustroni se si i keni përjetuar ato.
5. Të definoni shkurtimisht shpalljen, depërtimin, përmbushjen dhe praninë si ndërlidhen me ungjillëzimin.
6. Të shpjegoni se ç'është thotë të dishepullizosh dikë në besim.
7. Të marrësh pjesë aty ku të jepet rasti për të shërbyer dhe të vlerësosh përfshirjen tënde aty.

Të shërbyerit: Platforma për shërbesë

Teksa Jezusi po ecte bashkë me turmën drejt Jerusalemit për t'u ballafaquar me ngjarjet e fundit që do ta çonin drejt kryqëzimit të Tij, Ai i mori dishepujt e Tij anash diku për t'ju treguar se çfarë do t'i ndodhte Atij (Marku 10:32-23). Ai u shpjegoi atyre në detaje të zymta se çfarë do të ndodhte në vazhdim: Atë do ta tallin, do ta fshikullojnë, do ta pështynë dhe do ta vrasin. Fjalimi i Tij për vdekjen që po e priste ishte shqetësues për të dymbëdhjetët, pasi që një fjalim i tillë po prishte ëndrrat e tyre për fuqinë perandorake në qeverinë e Mesias.

Kështu, në ta ishte rrënjësuar kjo shpresë e prestigjit sa që edhe kur ecnin me Të, ata kishin filluar të ziheshin me njëri-tjetrin në lidhje me atë se kush do të ishte më i madhi në mesin e tyre. Jakobi dhe Gjoni shpresonin të merrnin pozita të larta të autoritetit në anën e majtë dhe në anën e djathtë të Jezusit. Imagjinoni sikur të ishit në vendin e Jezusit. Përderisa Ai po mundohej t'i mësonte ata rreth natyrës së vërtetë të shërbesës së Tij mesianike, Jezusi akoma nuk kishte arritur t'i bënte as ndjekësit e Tij më të

devotshëm që të mendonin përtej përfitimeve personale që lidhja e tyre me Të mund t'ju sillte atyre. Sa fëmijërore dhe egoiste do të jetë dukur kur ky grup i liderëve të pashpresë ka filluar të zihet në lidhje me pozitat e tyre në një administratë të re. Tek Ungjilli sipas Markut, Jezusi dha një përgjigje të shkurtër, por precize, për problemin e xhelozisë së tyre rivale. Kjo përgjigje zbuloi natyrën e lidërshiptit në mbretërinë e Perëndisë.



Lexo Marku 10:42-45.

1. Si e definoi Jezusi madhësinë në mbretërinë e Perëndisë?
2. Si e përshkroi Jezusi qëllimin për të cilin kishte ardhur?
3. Si është përshkrimi i Tij për madhësinë ndryshe nga pikëpamja e botës për madhësinë?

Nuk është e vështirë të imagjinohet reagimi i dishepujve për këtë qortim: kokët e ulura, sytë që vështrojnë tokën apo pikë periferike në horizont, duke shikuar gjetiu dhe jo në vështirimin bindës të Mësuesit. Motivet e tyre të kota dhe vetjake u ekspozuan nga zbulimi i motivit të mësuesit për të shërbyer.

Jezusi u shpjegoi dishepujve të Tij kuptimin e vërtetë të madhësisë. Ai që do të jetë i madh në mbretërinë e Perëndisë, duhet të jetë shërbëtor i të gjithëve. Shërbimi ynë për të tjerët është një shprehje e dashurisë sonë për Perëndinë dhe dashurisë sonë për të tjerët, dhe si e tillë, ajo i tërheq njerëzit për te Ati. Në zemër të madhësisë së vërtetë shtrihet një dashuri e pakusht që ka një qëllim qendror – për t'ju shërbyer të tjerëve.

Në zemër të madhësisë së vërtetë shtrihet një dashuri e pakusht që ka një qëllim qendror – për t'ju shërbyer të tjerëve.

Është e lehtë të jemi shumë të ashpër për t'i gjykuar dishepujt. Por qëndrimet e tyre janë shumë normale. Nëse jemi të sinqertë, ne shpesh mund ta zëmë veten me qëndrime dhe motive që janë egoiste. Në mënyrë të natyrshme, njerëzit nuk i vendosin nevojat e të tjerëve para nevojave të tyre. **T'u shërbesh të tjerëve është rezultat i dashurisë që prodhohet në ne nga Fryma e Perëndisë.** Apostulli Gjon foli për lidhjen e ngushtë në mes të dashurisë së Perëndisë dhe dashurisë për të tjerët (1Gjoni 4:7-12).

Çmimi i të qenët dishepull

Kur Jezusi u foli ndjekësve të Tij rreth jetës së dishepullimit dhe shërbesës për Të, Ai e bëri të qartë se një shërbesë e tillë ka një çmim.



Lexo Luka 9:23-26 dhe Gjoni 12:24-26.

1. Çfarë na mësojnë këto vargje rreth kuptimit të çmimit të dishepullizimit?
2. Çfarë vendime duhet të marrë një dishepull?

Një shembull i shërbesës

Pavarësisht nga çmimi, një shembull i shkëlqyer i shërbesës besnike, mund të shihet në jetën e Palit. Le t'i shohim disa nga ngjarjet kryesore të shërbesës së tij.



Lexo 1 Thesalonikasve 2:1-12.

1. Çfarë karakteristika të shërbesës së Palit vëreni këtu?
2. Si mund ta aplikoni këtë në jetën tuaj?

Përshkrimi i Palit për jetën e tij reflekton të vërtetën se **t'u shërbesh të tjerëve ka një çmim për ne personalisht**. Mund të nënkuptojë një ndryshim në stilin e jetës apo sakrifikim të parave, kohës, intimitetit apo reputacionit.



- Çfarë mendime ke teksa reflekton rreth mësimin të Jezusit në lidhje me dishepullizimin?
- Çfarë karakteristika të shërbesës së Palit shfaq ti në shërbesën tënde për të tjerët? Çfarë karakteristika mungojnë në shërbesën tënde?
- Pushoni për një moment dhe reflektoni rreth qëndrimeve tua ndaj shërbimit të të tjerëve. Sa je i gatshëm që të mohosh vetveten? Mendo rreth një shembulli specifik nga përvoja jote kur ti nuk ke arritur të shfaqësh zemrën e një shërbëtori. Si do të reagoje tjetër ndryshe po qe se do të zgjidhje të praktikojë lidërsipin e shërbëtorit?



Falënderojë Perëndinë që Ai mund të ofrojë burimet e nevojshme për të të ndihmuar të vazhdosh edhe përkundër çmimit të lartë të dishepullizimit. Kërkoi Perëndisë që të shqyrtojë qëndrimet dhe motivet e tua për shërbesë. Kërkoi

Atij që të të ndihmojë të shërbesh me dashuri të vërtetë për të tjerët, pa pretekste apo dëshirë për lavdi personale.

Shërbesa: Përgjegjësia e çdo besimtari

Një pikëpamje e zakonshme për shërbesën brenda trupit të Krishtit është se shërbesa duhet të përmbushet nga ata që punojnë me kohë të plotë në punë të krishterë. Pastori zakonisht shikohet si ai të cilin kisha e paguan që të “kryej shërbesën.” Kjo është puna e tij. Në fakt, fjala “shërbesë” tani tregon aktivitetet e shërbesës profesionale. Ne i quajmë ata bile edhe “shërbestarë.”


Kush duhet të shërbejë?

Dhiata e Re portretizon një pamje tjetër të shërbesës, e cila përfshinë pjesëmarrjen e çdonjërit në kishë, secili sipas dhuntisë që i është dhënë. **Çdo besimtar** është i thirrur që t’i shërbejë njëri-tjetrit në kishë.



Lexo Efesianëve 4:7-16. Shikoje këtë pasazh me shumë kujdes, dhe shkruaj një përmbledhje në një paragraf, në lidhje me atë që këto vargje na mësojnë rreth shërbesës së kishës.

Liderë të talentuar – apostuj, profetë, ungjilltarë, dhe pastorë-mësues – të cilët ekzistojnë për përsosjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit. Ne mund ta ilustrojmë këtë si në vijim:



Duke pajisur njëri-tjetrin për veprën e shërbimit, trupi ndërtohet, ashtu që arrin unitetin e besimit dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, dhe kështu arrin rritjen në Krishtin (Ef.4:12, 13, 16).

Instrumenti i cili duhet të përdoret për të **pajisur besimtarët** është Fjala e Perëndisë. Ungjilltarët dhe pastorët-mësuesit duhet të shpallin, mësojnë dhe zbatojnë Fjalën e Perëndisë. Ungjilltarët e përdorin Fjalën e Perëndisë për të sjellë njerëzit te Krishti, ndërsa pastorët-mësuesit, e përdorin atë për të ushqyer kopënë e Perëndisë (1Pjet.5:2).¹

Është e rëndësishme të zihet e vërteta e shtruar në këto vargje. **Nëse e shohim shërbesën si diçka vetëm për profesionalistët, ne do të jemi të kënaqur të ulemi dhe të shndërrohemi në spektatorë, dhe jo pjesëmarrës në jetën e shërbesës.** Ne mund të zhvillojmë pritje të larta për ata që kanë pozita të caktuar në kishë, ndërsa në anën tjetër nuk arrijmë t'i përdorim dhuntitë shpirtërore dhe aftësitë që Perëndia na ka dhënë secilit prej nesh.

Ne e kemi parë më herët se secili anëtar në trupin e Krishtit është i nevojshëm për mirëqenien dhe funksionimin normal të të gjithë trupit (1Kor.12:12-18). Secili prej nesh ka një pjesë të rëndësishme në trupin e Krishtit. Perëndia i ka dhënë secilit besimtar një apo më shumë dhunti që t'i përdorë në mënyrë që të tjerët të bekohen duke përfitur në fushën shpirtërore. Nëse ne nuk jemi duke i përdorur dhuntitë dhe aftësitë që Perëndia na ka dhënë, atëherë diçka është duke munguar në tërë trupin. Asnjë anëtar i trupit nuk është i parëndësishëm ose i panevojshëm. Secili e ka vendin e vet që askush tjetër nuk mund ta zëvendësojë. Ne kemi nevojë për njëri-tjetrin në mënyrë që të plotësojmë qëllimet e Perëndisë për kishën e Tij.

Perëndia i ka dhënë secilit besimtar një apo më shumë dhunti që t'i përdorë në mënyrë që të tjerët të bekohen duke përfitur në fushën shpirtërore

Si një person laik ju do të thoshit, “Çfarë mund të bëjë? Duhet të fitoj për të jetuar.” Shumica e njerëzve i çojnë jetët e tyre duke punuar në punë laike. Jo të gjithë janë të thirrur që të jenë pastorë, ungjilltarë, apo mësues të Biblës, mirëpo Perëndia e thërret secilin besimtar që të shërbej kudo që ai apo ajo ndodhet dhe në çfarëdo rrethana. Shërbesa nuk është diçka që ndahet nga jeta jonë normale; ajo duhet të jetë pjesë e natyrshme e përvojave të jetës sonë të përditshme.

Shërbesa jonë për Të është diçka që ndodh kudo që të jemi. Ne mund të ndajmë lajmin e mirë gjatë pushimit të drekës në punë, të flasim me dikë rreth faljes teksa jemi duke ngarë makinën, të lutemi me ndonjë njeri teksa pimë një filxhan kafe në kuzhinë, t'i lexojmë një tregim ndonjë fëmije, të vizitojmë dikë që është sëmurë, apo të kalojmë kohë me adoleshentët tanë dhe t'i dëgjojmë brengat e tyre. **Shërbesa rrethon jetën në tërësi.**



A je një spektator apo një pjesëmarrës në shërbesë? Çfarë mundësi ke për t'ju shërbyer të tjerëve në vendin e punës apo shkollën tënde? Po në lagjen tënde? Po në shtëpinë tënde? Si i ke shfrytëzuar këto raste për të shërbyer?

Motivimi për shërbesën

Kur e shikojmë jetën e Apostullit Pal, ne shohim një njeri të përkushtuar për t'i arritur të tjerët. Ai gjatë tërë kohës ka kërkuar rrugë për të shpallur ungjillin dhe për t'i

ndërtuar të tjerët në maturi. Çfarë e kishte motivuar atë? Përse do ta vinte jetën e tij në rrezik, përse do të hiqte dorë nga mundësia për të pasur një shtëpi dhe një jetë normale, dhe të duronte çdo punë të vështirë dhe mundim për t'ju shërbyer njerëzve? Përgjigja shtrihet në pikëpamjen që kishte ai për jetën që Perëndia i kishte dhënë atij.

Le të shqyrtojmë dy pasazhe të Shkrimit, të cilat dëshmojnë për qëndrimin e Palit rreth jetës, duke vështuar qasjet e tij për jetën dhe shërbesën.



Lexoni Filipianëve 1:12-26.

1. Përshkruaj rrethanat e Palit. Çfarë mund të themi rreth qëndrimit të tij për shërbesën?
2. Çfarë efekti pati dëshmia e tij mbi të tjerët (v. 14, 18)?
3. Një varg kyç në këtë pasazh është vargu 21. Përshkruani atë që ju nënkuptoni me fjalët që Pali thotë se “të jetuarit është Krishti dhe të vdekurit fitim.”
4. Vargjet 22-26 janë një reflektim mbi vargun 21. Përshkruaj konfliktin e brendshëm që Pali ndjeu në këtë kohë dhe regjistro qëndrimet rreth filozofisë së tij për jetën dhe shërbesën që ju mund të gjeni në këtë predikim.

Për Palin jeta ishte një detyrë e shenjtë e mbushur me një qëllim, e që është qëllimi i Perëndisë. Edhe pse ai i gëzohej mendimit për të shkuar në qiell dhe për ta takuar Zotin ballë për ballë, ai e kishte kuptuar se Perëndia kishte akoma punë për të. Me zemrën e tij të qëndrueshme në lavdinë e parajsës që e priste, ai vazhdoi me zell të punonte në punën që Perëndia i kishte caktuar që të kryente.

Le të shikojmë më tutje pikëpamjen e Palit për shërbesën në një nga letrat e tjera të Palit.



Lexoni 1 Timoteu 1:12-17

1. Cili është burimi i falënderimi të Palit? Çfarë qëndrimi, mund të thoni, se e karakterizon Palin në këtë pasazh?
2. Çfarë mendoni se e kishte formuar bazën e shërbesës së Palit për të tjerët (v. 13-16)?
3. Çfarë qëllime shihte Pali për jetën e tij?
4. A ka ndonjë gjë në këtë pasazh që përcakton qëllimin e Perëndisë për të gjithë besimtarët?

Pali e kishte kuptuar se ishte zgjedhur nga Perëndia dhe se i ishte dhënë bekimi dhe privilegji i lartë për të shërbyer. Duke folur për veten e tij si për mëkatarin më të madhë,

ai reflekton përlulësi dhe një pranim të qartë se Perëndia, i cili e kishte shpëtuar atë dhe e kishte ndryshuar jetën e tij në një mënyrë aq dramatike, mund të shpëtonte çdo njeri.

Teksa shikojmë pasazhe të tilla, ne kuptojmë se **jeta për Palin ishte shërbesë**. Ai e kuptoi qartë se Perëndia e kishte zgjedhur atë për të qenë shërbëtor dhe shërbëstar. Pasi që ai vetë ishte shpenguar nga Perëndia prej një jete të karakterizuar nga një kundërshtim plot urrejtje kundër ungjillit të Krishtit, Pali u bë një ilustrim i gjallë i hirit të Perëndisë, i dëshirës dhe fuqisë së Perëndisë për të shpëtuar çdo person. Pali digjej nga dëshira që të tjerët ta njihnin këtë hir të mahnitshëm që ai kishte njohur.



1. Lexo 2 Korintasve 5:9-15. Cilat janë tre motivet që Pali përshkruan për shërbesën e tij?
2. Më parë ne kemi shikuar shërbesën e Palit në Selanik tek 1 Thesalonikasve 2:1-12. Shikoni përsëri vargjet 3, 5, dhe 6. Çfarë motive **nuk** e kanë karakterizuar shërbesën e Palit?

Kur mendojmë për shërbesën tonë për Perëndinë dhe të tjerët, është e rëndësishme që rregullisht t'i shqyrtojmë motivet tona. Kur i shërbejmë Perëndisë apo të tjerëve për lavdinë tonë personale, ndjenjat tona do të lëndohen në mënyrë të pashmangshme kur diçka nuk do të shkojë sipas planit tonë apo kur të tjerët nuk janë mirënjohës për atë që ne kemi bërë. Ne mund të përjetojmë një dëshirë që ta ndërprejmë shërbesën kur mendojmë se puna jonë nuk është vërejtur. Indikatorë tjerë të shërbesës për lavdi personale mund të jenë xhelozia dhe krahasimi me të tjerët që janë duke shërbyer, sarkazmi dhe kritika ndaj të tjerëve, apo ekspozimi dhe modestia e rreme.



Ndaluni për një moment dhe reflektoni mbi idetë e juaja rreth jetës dhe shërbesës. Si do t'i krahasoni motivet e tua me ato të Palit? Vini re ndonjë paralele apo dallim.

Si reflektojnë jeta dhe dëshmia jote hirin e Perëndisë dhe si shërbejnë ato si një shembull i hirit të Tij tek të tjerët? Si je i ndikuar që të shërbesh me anë të tre motiveve të lartpërmendura? Çfarë motive të rreme keni përjetuar në lidhje me shërbesën? Çfarë mendime të vijnë në mendje kur reflekton mbi atë se çfarë nënkupton të jesh një ambasador për Krishtin?

Përfitimet e shërbesës

Kur fillojmë t'u shërbejmë të tjerëve, ne shumë shpejtë e mësojmë çmimin e dishepullizimit. Ne e kuptojmë se t'u shërbesh të tjerëve, mund të na marrë mjaft shumë nga koha jonë, jeta private, rehatia jonë dhe nga koha e lirë. Mirëpo një sërë përfitime mund të dalin gjithashtu nga puna për Zotin. Edhe pse ne nuk i shërbejmë Perëndisë vetëm për të përfituar, kjo nuk e zvogëlon efektin pozitiv që mund të ketë shërbesa në

jetët tona. Ne do të fokusohemi në katër nga këto përfitime. Ju ndoshta mund të identifikoni edhe përfitime të tjera, të cilat nuk janë përmendur këtu, mirëpo këto janë ilustrime për mënyrën se si shërbimi që u bëjmë të tjerëve ka ndikim pozitiv në jetët tona.

Ne mësojmë të rrisim besimin tonë dhe varësinë tonë në Perëndinë. Një ndër gjërat e para që përjetojmë, kur fillojmë t'i shërbejmë Zotit, është një ndjenjë e papërshtatshmërisë për të kryer atë punë. Shërbesa ngulmon që ne të japim maksimumin e aftësive tona si dhe edhe përtej këtyre aftësive. Për shkak të kësaj, ne mësojmë t'i besojmë Perëndisë për forcën, urtësinë, dhe fuqinë e nevojshme për t'i plotësuar nevojat e të tjerëve. Ashtu sikurse Pali edhe ne e përjetojmë se kur jemi të dobët jemi të fortë, sepse hiri i Tij është i mjaftueshëm për ne (2Kor.12:9-10). Kur e shohim Perëndinë duke vepruar në ne dhe nëpërmjet nesh në situata të ndryshme të shërbesës, edhe përkundër dobësive tona, besimi dhe varësia jonë në Perëndinë rriten.

Ne rritemi në ecjen tonë me Zotin. Një përfitim i dytë është se shërbesa na ndihmon që të rritemi në ecjen tonë me Zotin. Asgjë nuk e motivon të mësuarit tonë dhe rritjen tonë, sikurse bënë përfshirja në shërbesë aktive. Shërbesa na shtyn që të rrisim njohurinë tonë për Perëndinë dhe Fjalën e Tij, si dhe dhembshurinë tonë për njerëzit.

Shërbesa na shtyn që të rrisim njohurinë tonë për Perëndinë dhe Fjalën e Tij, si dhe dhembshurinë tonë për njerëzit.

Veç kësaj, ne pranojmë rëndësinë e aplikimit të asaj që mësojmë, në mënyrë që të kemi çfarë t'u ofrojmë atyre që u shërbejmë. Teksa rritemi në ecjen tonë me Perëndinë, ne gjithashtu mund të përjetojmë një ndikim më të madh të shërbesës tonë.

Duke i shërbyer Perëndisë ne përjetojmë një ndjenjë të përmbushjes. Një përfitim i tretë është ndjenja e përmbushjes që vjen nga të jetuarit e jetës të mbushur me qëllim. Perëndia na ka krijuar që të jemi njerëz produktiv, të cilët kontribuojnë si administratorë të fjalës së Tij. **Çfarë mund të jetë më dobiprurëse se sa të jesh pjesë e vetë punës së Perëndisë?** Kur Pali tha se ai ishte mirënjohës për shkak se Perëndia e kishte parë atë si të denjë për të shërbyer, ai arriti të kuptojë privilegjin e mahnitshëm për të qenë në rrjedhën qendrore të qëllimeve të Perëndisë në histori. Kur jemi duke u shërbyer të tjerëve, ne mund të gjejmë kënaqësi në përdorimin e dhuntive që Perëndia na ka dhënë për të përmbushur qëllimet e Tij në ndërtimin e trupit të Krishtit dhe arritjen e botës.

Ne i zhvillojmë aftësitë dhe dhuntitë tona shpirtërore. Jo vetëm që shërbesa na motivon që të rritemi në njohuri, ajo gjithashtu na shërben si bazë trajnimit për zhvillimin e aftësive dhe dhuntive tona shpirtërore. Një thënie angleze thotë "Praktika bënë të përsosurën." Me fjalë të tjera, sa më shumë që bëjmë diçka, do mësojmë ta bëjmë më mirë. Për shembull, një atlet i praktikon të njëjtat rutina vazhdimisht deri sa

të arrijë të luaj nga reflekset pa menduar fare. Orë të tëra të përsëritjeve sigurojnë që në momentin e garës, veprimet e tij vijnë në mënyrë të natyrshme dhe të rrjedhshme.

E njëjta gjë vlen edhe për shumë aftësi të shërbesës. Nëpërmjet përvojës ne mund të mësojmë të dëshmojmë më mirë, të jemi mësues më të mirë, të kujdesemi për të tjerët me më shumë dhembshuri, të organizojmë dhe administrojmë, t'i dëgjojmë ata që janë të lënduar, dhe t'u shërbejmë të tjerëve. Fakti që ne zhvillojmë aftësi më të larta në këto fusha, asnjëherë nuk duhet të ndikojë që ne të mbështetemi në aftësitë tona. Besimtarët gjithmonë duhet të mbështeten në fuqinë e Frymës së Shenjtë, e cila i përdorë gojët tona, duart tona, aftësitë tona për të përmbushur qëllimet e Perëndisë.

Katër përfitimet e sipërsënuara janë një mostër e mënyrave se si ne përfitojmë nga të qenët të përfshirë në shërbesën e Zotit. Këto përfitime, pa marrë parasysh se sa të mira të jenë, nuk do të mjaftojnë për të qenë motivi për shërbesën. Ballafaqimi me kërkesat e rënda të punës së shërbesës, bënë që shumica prej nesh të rrëzohemi, në rast se nuk jemi të motivuar nga dashuria e sinqertë për Perëndinë dhe të tjerët.



Për secilin përfitim të shërbesës, të përmendur këtu, cito një shembull nga përvoja jote se si je rritur dhe je zhvilluar gjatë kohës sa ju ke shërbyer të tjerëve.



Rikujto të vërtetën që Perëndia dëshiron që jeta jote të jetë një jetë e shërbesës. Falënderojë Atë që të ka dhënë privilegjin dhe mundësinë për t'i shërbyer Atij. Pastaj, kërkoji Atij që të të ndihmojë të shërbesh në çfarëdo rrethana që Ai do të vendos dhe që të kesh një pasion si të Palit për t'i shërbyer Atij. Lavdëroje Atë për përfitimet e shërbesës që ke përjetuar.

Fokusi i shërbesës

Fokusi i shërbesës sonë është t'i sjellim lavdi Perëndisë në çfarëdo që bëjmë. Jeta e besimtarit duhet të jetë në shërbim të të tjerëve në emrin e Krishtit, në mënyrë që në fund të fundit Perëndia të përlevdohet. Ajo çfarë do të mbajmë mend nga ky mësim do të jenë shërbesat kyçe që Jezusi përcaktoi për ndjekësit e Tij. Në fund të këtij mësimi, do t'ju jepen disa detyra specifike të shërbesës, që t'i kryeni, në mënyrë që të vini praktikë atë që keni mësuar rreth shërbesës.

Arritja e të humburve


Jezusi u foli dishepujve të Tij fjalët e Tij të fundit para se Ai të ndahej prej tyre nga toka dhe të kthehej tek Ati i Tij në qiell. Këto fjalë i gjejmë të regjistruara në

Ungjillin sipas Mateut dhe në librin e Veprave të Apostujve. Jezusi tha, “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë.” (Mat. 28:18b-19). Luka, autori i Veprave të Apostujve, regjistron këto fjalë të Jezusit, “Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jerusalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut” (Veprat e Apostujve 1:8).

Shpesh herë fjalët e fundit të njerëzve përcaktojnë prioritetet e tyre, kështu që edhe fjalët e fundit të Jezusit na tregojnë me të vërtetë se çfarë ka qenë në zemrën e Tij. Dëshira e Tij ka qenë që çdonjëri ta njihte lajmin e mirë të shpëtimit, të cilin Ai e kishte përmbushur për ta. Fjalët e Tij tregojnë prioritetin e shpërndarjes së lajmit të mirë. Jezusi i **urdhëroi** ndjekësit e Tij që “të shkonin” në mënyrë që të arrinin “të gjitha kombet.” Ne që sot besojmë, jemi pjesë e mbretërisë së Perëndisë për shkak se dishepujt e Tij ishin besnik për t’ju bindur urdhërimit të Tij.

Si ndjekës të Krishtit ne jemi të thirrur që të shkojmë tek të humburit, por jo vetëm t’i sjellim në kishë për të dëgjuar ungjillin. Ndjekësit e Krishtit duhet të jenë dëshmitarët e Tij në botë. **Misioni i kishës si e tërë por edhe i besimtarëve si individë është që botës që nuk beson t’i shpallin lajmin e mirë të shpëtimit në Jezus Krishtin.** Prandaj, misioni i çdo besimtari është që të gjejë mënyra për të përmbushur këtë qëllim në sferën e tij/saj të ndikimit.

Vini re se Jezusi kishte pritje që ndjekësit e Tij do të dëshmonin për Të në shtëpitë e tyre, si dhe “gjer në skajin e dheut.” Ne mund ta shohim referencën Veprat e Apostujve 1:8 si një seri të rrathëve bashkërendorë, duke filluar me dëshmimin në shtëpi (Jerusalem), duke u zgjeruar në një zonë të afërt (Judea), duke dalë në fushat e huaja për ne (Samari) dhe përfundimisht duke arritur gjer në skajet e dheut.



Programet e misionit i zhvillojmë që të bartin këtë mandat, duhet të marrin në konsideratë prioritetet e përcaktuara nga Jezusi. Përderisa është tepër e rëndësishme të dëshmojmë në komunitetin tonë, është mirë të balancojmë atë që bëjmë në “shtëpi” me atë që bëjmë jashtë vendit.

Çfarë do të thotë të jesh një dëshmitar i Krishtit? Një dëshmitar është një person i cili ka parë një ngjarje që ka ndodhur dhe për atë jep llogari të vërteta për atë që ai apo ajo ka parë. Si besimtarë ne jemi të thirrur të dëshmojmë për të vërtetën në lidhje me Jezusin.

Fjala greke e përkthyer në “dëshmitar” në Dhiatën e Re, është ajo fjalë prej së cilës buron në gjuhën shqipe fjala “dëshmor.” Të krishterët e hershëm shumë shpesh kanë vdekur si rezultat i dëshmimit të tyre, gjë që ka ndikuar që në shekullin e dytë, këto dy koncepte, të dëshmuarit dhe rënia dëshmor të gërshetohen njëra me tjetrën.

Çdo anëtar i trupit të Krishtit duhet të jetë dëshmitar. Ne nuk duhet ta fshehim faktin që jemi të krishterë apo të jetojmë në dy botë, në mënyrë që shokët tanë në punë apo fqinjët tanë të mos e kenë idenë se ne i takojmë Krishtit. Jezusi u tha dishepujve të Tij, “Sepse, nëse dikujt i vjen turp për mua dhe për fjalët e mia, edhe Birit të njeriut do t’i vijë turp për të, kur të vijë në lavdinë e vet.” (Luka 9:26)

Të jesh një dëshmitarë për Të nuk do të thotë t’i ftosh të tjerët të bashkohen me kishën tonë apo të kërkosh prej tyre t’i adaptojnë standardet tona morale, mirëpo do të thotë t’u prezantosh atyre personin e Jezus Krishtit. Shumë shpesh ne u komunikojmë të tjerëve sikur ata duhet të pranojnë një sistem të tërë të besimit në mënyrë që të bëhen të krishterë. **Ne duhet t’i prezantojmë jobesimtarëve personin e Jezus Krishtit, si Birin e Perëndisë dhe si një person me të cilin ata do të mund të kenë një marrëdhënie.**

Nëse ne kemi përjetuar një marrëdhënie personale me Krishtin dhe nëse i kemi besuar Atij që të na shpëtojë nga mëkati, ne jemi të kualifikuar për të qenë dëshmitarë. **Ne nuk duhet të jemi të përsosur apo të pastrojmë çdo fushë të jetës sonë para se të bëhemi dëshmitarë.** Ne mund të jemi të sinqertë rreth jetës sonë, defekteve tona, dhe të metave tona. Ne nuk kemi pse pretendojmë për të qenë dikush që nuk jemi apo që nuk mund të jemi, për t’ju përgjigjur të gjitha pyetjeve që dikush mund të ketë. Kur jemi gati të pohojmë nevojën tonë dhe mëkatin tonë, ne atëherë komunikojmë hirin e Perëndisë në shpëtimin tonë.

Ne kemi parë këtë shembull në jetën e Palit, kur foli për veten e tij se ishte mëkatar i madh. Shpesh jemi të prirur që paraqesim veten në anën e kundërt, si të atillë që më nuk luftojnë me mëkatin. Kur e bëjmë këtë, rezultati gjithmonë do të jetë zhgënjim nga ana e atyre që vijnë tek Krishti. Kur ata e kuptojnë më vonë se të krishterët vazhdojnë të luftojnë me mëkatin, ata shpesh na etiketojnë si hipokritë. Kur e pranojmë se jemi mëkatarë, të shpëtuar me anë të hirit të Perëndisë, të cilët vazhdojnë të luftojnë me mëkatin dhe të kenë nevojë për hirin e Tij të përditshëm, në këtë mënyrë ne shkruajmë me shkronja të mëdha, hirin e Perëndisë në dëshminë tonë.

Sigurisht që dëshmia jonë do të rritet në efektshmërinë e saj kur të tjerët rreth nesh të shohin një ndryshim në jetët tona e që vjen si rezultat i besimit tonë. Ne nuk jemi vetëm të thirrur që të tregojmë të vërtetën rreth Krishtit, por edhe ta jetojmë këtë të

vërtetë. Të tjerët do të tërhiqen apo sprapsen nga mënyra se si ne përfaqësojmë Krishtin. Kur dëshmojmë, ne mund t'i përgjigjemi me ndershmëri dhe në mënyrë të natyrshme personit me të cilin jemi duke ndarë.



Lexoni 1 Pjetri 3:15-16. Si të ndihmojnë këto vargje rreth mendimeve për mënyrën e dëshmimit tek të tjerët?

Ne nuk jemi vetëm të
thirrur që të tregojmë të
vërtetën rreth Krishtit,
por edhe ta jetojmë këtë
të vërtetë.

Ky pasazh na tregon disa gjëra. **Njerëzit rreth nesh duhet të shohin një ndryshim në ne. Ata duhet të shohin shpresë në ne.** Pjetri përshkruan edhe mënyrën se si ne duhet të ndajmë ungjillin. **Ne duhet t'u dëshmojmë të tjerëve me butësi dhe respekt dhe të jetojmë jetët tona në atë mënyrë që të tjerët të mos kenë asnjë arsye për të na fyer.** Të dëshmuarit me butësi do të thotë që ne nuk duhet të manipulojmë, të përdorim forcën apo të jemi të ashpër apo të sulmojmë gjatë dëshmimit tonë. Të krishterët shpesh pretendojnë t'i japin të drejtë vetes kur dëshmojnë dhe atë sidomos në shtëpi. Ne duhet të kemi kujdes që të mos i nxjerrim mëkatet e të tjerëve në pah, por t'ju tregojmë të tjerëve po të njëjtën mëshirë dhe durim që Krishti na ka treguar neve.

Le ta shikojmë shkurtimisht rolin tonë për të ndihmuar në përhapjen e ungjillit. Teksa ky mësim nuk do të ofrojë udhëzime të detajuara në ungjillëzim, nëse ju keni nevojë shtesë në këtë fushë, atëherë ne ju rekomandojmë një kurs mbi Ungjillëzimin dhe Dishepullimin.

Pastori dhe shkrimtari i njohur Richard Halverson tregon se ekzistojnë së paku **katër aspekte të dëshmimit**. Ai i ka emëruar këto si **shpallje, depërtim, përmbushje, dhe prezencë**. Ne do t'i shkojmë të katër këto aspekte të dëshmimit tonë.²

Shpallja. Nëse duhet të vijmë të tjerët te Krishti, atëherë ata duhet të dëgjojnë se çfarë ka bërë Ai për ta dhe të kuptojnë dhuratën e shpëtimit. Përderisa ne mund t'ju tregojmë të tjerëve dashurinë e Krishtit me anë të veprave të mirësisë dhe dhembshurisë, ne gjithashtu kemi nevojë që të hapim gojët tona dhe të flasim diçka.



Lexoni Romakëve 10:8-15. Çfarë tregon ky pasazh në lidhje me nevojën tonë për të proklamuar të vërtetën rreth Krishtit?

Në mënyrë që të tjerët ta pranojnë ungjillin, ungjilli duhet t'ju prezantohet atyre. Ata kanë nevojë ta dëgjojnë të vërtetën, e cila do t'i çlirojë ata. **Perëndia mund të na jep guximin dhe fuqinë për të tejkaluar frikët tona dhe për t'u bërë të guximshëm në ndarjen e ungjillit dhe dëshminë tonë personale me të tjerët.** Ne mund t'i

shfrytëzojmë mundësitë që na paraqiten, dhe gjithashtu ne edhe mund të krijojmë mundësi.

Një shembull i tillë për ne është Thomasi, i cili ishte shtrirë në spital për një seri të trajtimeve të hemoterapisë. Ai kishte vendosur që të shfrytëzonte çdo rast për të folur me shokët e dhomës rreth besimit të tij në Krishtin. Edhe pse do të kishte qenë e lehtë sikur ai të fokusohet vetëm në problemet e tij, ai e shfrytëzoi këtë mundësi që të ndante me pacientët e tjerë që vuanin nga kanceri, dhe shumica e të cilëve ishin shumë të hapur ndaj ungjillit.

Çfarë duhet të themi kur të na dalin mundësitë që të shpallim ungjillin? Ne duhet të jemi të qartë në thelbin e ungjillit.



Lexoni 1Korintasve 15:1-10. Si e definon Pali ungjillin?

Për t'u bërë të krishterë, jobesimtarët nuk kanë nevojë të besojnë që Perëndia krijoi botën për gjashtë ditë, apo të mbajnë anën tonë në lidhje me abortin, politikat e kishës, apo ngjarjet profetike. Ata kanë nevojë të kuptojnë (1) nevojën e shpëtimit – ata janë mëkatarë të ndarë nga një Perëndi i shenjtë (Rom.3:23); (2) dhurimi plot hir i Perëndisë i Birit të Tij si zëvendësim, i cili mori mbi vete dënimin për mëkatet tona në mënyrë që ne të pajtoheshim me Perëndinë (Gjoni 3:16; 2Kor.5:21); dhe (3) rëndësinë e ringjalljes së Krishtit, i cili na ofron jetë të përhershme dhe shpresë për të ardhmen (1Kor.15:14-22, 51-55).

Jobesimtarët nuk mund ta kuptojnë pikëpamjen e të krishterëve në shumë çështje të tjera sepse ata nuk e kanë Frymën e Shenjtë brenda tyre që t'i bind ata. Çdo argument i mundshëm në botë do të ketë pak ndikim në ndryshimin e mendimit të tyre deri sa ndryshimi të mos vije nga brenda.

Kur përfshihemi në argumente të tilla, ne mund të rrezikojmë të fitojmë atë argument por të dëmtojmë marrëdhënien me ta, gjë që mund të çojë drejt rasteve më të pakta të ndarjes së ungjillit me ta.

Depërtimi. Si besimtarë ne jemi të thirrur që të depërtojmë në të gjitha pjesët e shoqërisë me ungjillin e Krishtit. Të gjithë ne nuk do të bëhemi shërbetarë profesional apo të kemi mundësinë të punojmë në shërbesë me kohë të plotë, mirëpo të gjithë ne kemi kontakte me një grup të atillë njerëzish qoftë në vendin e punës apo në studime, e që profesionistët e tillë kurrë nuk do t'i kishin.

Halverson pyet ku e arrin kisha botën me ndikimin më të lartë.

[Kjo bëhet nëpërmjet] ndikimit të një grumbulli të besimtarëve individë të përkushtuar ndaj Krishtit nën kontrollin e Frymës së Shenjtë, të cilët punojnë kudo që janë, duke depërtuar në të gjitha njësitë shoqërore dhe institucionale të botës sonë në mes të së dielave ... Kuptimi i vërtetë i ndikimit të kishës shihet kur ndërtesat e kishave janë të

zbrazura, programet janë bosh, dhe njerëzit janë të shpërndarë nëpër komunitetet e tyre, zonat metropolitane dhe nëpër botë.³

Krishti i ka njerëzit e Tij kudo, duke depërtuar nëpër botë dhe duke pasur një ndikim të qetë, të vazhdueshëm, dhe efektiv për mbretërinë e Tij, e cila do të njihet plotësisht vetëm kur të qëndrojmë përpara Krishtit.




Besimet tona të vërteta shpesh shihen në vendin e punës, në mënyrën se si i trajtojmë kolegët tanë. A u shërbejmë të tjerëve me dëshirë? A i trajtojmë të tjerët me respekt dhe përulësi apo me arrogancë dhe zemërim? A punojmë aq sa të meritojmë një pagesë të plotë të ditës, apo mundohemi t'i shmangemi punës? A drejtohet biznesi ynë nga parimet e perëndishme, apo bëjmë hile, gënjejnë dhe paraqesim veten ndryshe? A e depërtojmë botën tonë me kripë, duke i shtuar shije, apo depërtimi ynë në botë i jep një shije të keqe gojëve të njerëzve? Shkruaji mendimet e tua teksa mendon për rolin tuaj në arritjen e botës me ungjillin.

Përmbushja. Dëshmia jonë në botë shihet gjithashtu në veprat e mirësisë dhe dhembshurisë. Veprat tona të mira dëshmojnë për atë që ka ndryshuar jetët tona. Libri i Jakobit trajton temën e rolit të besimit dhe veprave të mira. Veprat e mira që ne kryejmë janë evidencë e besimit të vërtetë në Krishtin.

Jezusi u tha dishepujve të Tij, “Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiell” (Mat.5:16). Drita e Krishtit që është në ne ka fuqi të ndryshojë botën.

A ka errësira ndonjë fuqi mbi dritën? Nëse hap një derë në mes të dy dhomave, njëra e errët dhe tjetra me dritë, a do të vraponte errësira për ta përmbytur dritën, apo do të vraponte drita për ta larguar errësirën? Errësira është e pafuqishme përpara dritës. Edhe shkëndija më e vogël e dritës është e pathyeshme kundër errësirës, dhe dëshmia



më e vogël e një të krishteri, do të ketë efektin e vet në botë.⁴

Si e reflekton jeta jote dritën e Krishtit? A e shohin të tjerët Krishtin në ty? Dikush ka thënë, “Ti mund të jesh ungjilli i vetëm që njerëzit mund të lexojnë ndonjëherë.” Çfarë është “ungjilli sipas jetës tënde?”

Prezenca. Shpesh mund të jemi dëshmitar për Krishtin thjeshtë me anë të pranisë sonë. Ne mund t'i shtrijmë duart tona drejt nevojtarëve. Ne mund të kalojmë kohë me ndonjë njeri që

ka humbur një njeri të dashur, duke ofruar ngushëllim, kujdes dhe merakosje. Vetë prania jonë mund të jetë një dëshmi. Ndonjëherë dëshira jonë për të qëndruar pranë dikujt që ka nevojë për ne mund të flas më tepër se sa çdo gjë tjetër. Shumë njerëz së pari janë afruar pranë Krishtit nga vetë prania e një personi i cili ka komunikuar dashurinë dhe kujdesin e Perëndisë në mënyra të prekshme.

Kur lexon gazetën apo dëgjon lajmet, çfarë nevoja sheh? A ekziston ndonjë mënyrë për të qenë dashuria e Krishtit për ndonjë njeri? A ekziston ndonjë nevojë që kisha juaj mund të plotësoj?



Bëjë një përmbledhje të katër elementeve të dëshmisë sonë: shpalljes, depërtimit, përmbushjes, dhe prezencës.



Vlerësoni arritjet tuaja në këto katër fusha duke iu përgjigjur pyetjeve në vijim:

- Cilat raste i ke shfrytëzuar për t'ju shpallur ungjillin jobesimtarëve?
- Çfarë po bënë për të depërtuar në sferat e ndikimit ku je tani?
- Cilat janë veprat e tua të mira që tregojnë dashurinë e Krishtit? (qëndrimet, veprimet, marrëdhëniet).
- Në ç'farë mënyre ke qenë ti “prania e Krishtit” për të tjerët? Çfarë mendoni se mund të bëni për t'u rritur në këtë fushë? Çfarë ndihme të nevojitet? Ku mund ta merrni këtë ndihmë?

Vlera e dëshmisë sonë në botë reflektohet në përshkrimin e Gjonit për vizionin e tij të një skene qiellore (Zbu.7:9-12). Një turmë të madhe, të cilën askush nuk mund ta numëronte, prej të gjitha kombeve, fiseve, popujve dhe gjuhëve qëndronin në këmbë përpara fronit dhe përpara Qengjit. Ata janë të veshur me rroba të bardha dhe mbanë palma në duart e tyre. Dhe Gjoni i dëgjoji si thërrisnin me zë të madh, duke thënë: “Shpëtimi është i Perëndisë tonë që është ulur mbi fron dhe i Qengjit” (v. 10).

Kjo skenë pushtuese ku nderi, lavdia dhe lavdërimi i drejtohen Perëndisë nga njerëzit e çdo kombi do të ndodhë për shkak se ndjekësit e Krishtit i japin një prioritet shumë të lartë arritjes së të gjitha kombeve të botës *me ungjillin*.



Merr disa minuta për ta lavdëruar Perëndinë për shpëtimin që të ka ofruar. Kërko nga Ai që të të ndihmojë që të shpallësh dashurinë e Tij tek të tjerët dhe të të përdorë për të depërtuar në sferën tuaj të ndikimit me anë të veprave të mirësisë dhe të pranisë tënde.

Ndërtimi i trupit të Krishtit

Në Porosinë e Madhe të Krishtit tek Mateu 28:19-20 ne gjejmë jo vetëm urdhërimin për të predikuar ungjillin, por gjithashtu edhe urdhërimin për “të bërë dishepuj nga të gjithë popujt dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar.” Prandaj, besimtarët kanë mandat që të përfshihen në ndërtimin e dishepujve. Dishepullimi është procesi i të ushqyerit të besimtarëve drejt pjekurisë shpirtërore.



Shikoni përsëri tek Efesianëve 4:7-16. Sipas vargjeve 12, 13 dhe 16 çfarë qëllime përcakton Pali për besimtarët?

Përderisa ungjillëzimi duhet të jetë një prioritet shumë i lartë për ne si të krishterë, Pali gjithashtu flet për prioritetin e angazhimit tonë drejt rritjes së besimtarëve në Krishtin. Ashtu siç e pamë edhe më herët, apostujt, profetët, ungjillorët dhe pastorët-mësuesit ekzistojnë për t’i pajisur besimtarët për punën e shërbesës në ndërtimin e trupit të Krishtit.

Së fundi, qëllimi i këtij shërbimi është që besimtarët të rriten dhe t’i ngjajnë Krishtit në karakterin e Tij. **Ajo që Perëndia mundohet më së shumti është që të nxjerrë burra dhe gra që janë si Biri i Tij, Jezus Krishti.** Teksa Perëndia na inkurajon t’i shtrijmë duart tona drejt të varfërve dhe të jetojmë jetët tona të karakterizuara nga drejtësia, ndershmëria dhe dhembshuria, prioritetet tona në jetë si të krishterë, përfshijnë këto tri fusha:

- Rritja jonë në karakterin e perëndishëm, teksa thellojmë marrëdhënien tonë me Krishtin
- Zgjerimi i mbretërisë së Tij me anë të ungjillëzimit
- Ndërtimi i trupit të Krishtit

Kur marrim në konsideratë shërbesën tonë ndaj besimtarëve të tjerë, të kuptuarit tonë për këtë shërbesë brenda familjes së Perëndisë bazohet mbi pikëpamjen tonë rreth kishës. Brenda kornizës së kishës, besimtarët duhet të rriten në pjekurinë e Krishtit. Mënyrat se si e bëjmë këtë gjë të mundur mund të karakterizohen me anë të titujve: nëpërmjet bashkësisë dhe nëpërmjet dishepullimit. Në mësimin e kaluar ne kemi shikuar rëndësinë dhe kuptimin e bashkësisë, si dhe ndërtimin e trupit duke inkurajuar, qortuar dhe dashur njëri-tjetrin. Në këtë mësim ne do të shohim se si mund të kontribuojmë në ndërtimin e trupit të Krishtit me anë të dishepullimit.

Pali i shkroi dishepullit të tij të ri Timoteut, duke e inkurajuar që t’ua jep gjërat që kishte dëgjuar nga ai (Pali) njerëzve besnikë, të cilët do të jenë të aftë të mësojnë edhe të tjerët (2Tim.2:2). Ashtu sikurse Timoteu edhe ne duhet të kalojmë te të tjerët ato që

kemi mësuar. Një aspekt i rëndësishëm i shërbesës ndaj besimtarëve tjerë është bërja e dishepujve.

Kur ti mendon rreth bërjes së dishepujve, para se gjithash ti mund të mendosh se nuk je i kualifikuar për të dishepulluar të tjerët. Çelësi drejt dishepullimit nuk bie mbi atë se sa mirë jemi të trajnuar, por mbi atë se sa ngushtë ecim me Perëndinë dhe se sa gati jemi të ndajmë jetët tona me ata që janë të rritur më pak se ne në Krishtin. Të dishepullosh të tjerët nuk do të thotë të mësosh, të përdorësh një program të caktuar të materialeve, edhe pse materiale të tilla edhe mund të ofrojnë një ndihmë mjaft të madhe. Do të ishte avantazhi ynë nëse do të kishim mundësi të kryenim çdo trajnim të mundshëm në këtë fushë, mirëpo **i tërë trajnimi që marrim nuk do të zëvendësojë realitetin e ecjes tonë personale me Krishtin.** Në vend të kësaj, dishepullimi është një stil jete që duhet të mësohet, të ndahet me të tjerët dhe të modelohet.

I krishteri i sapolindur duhet të ushqehet nga një i krishterë tjetër, i cili është më i rritur në besimin e tij. Kur të kuptojmë themelet e jetës së krishterë, të vërtetat që paraqiten në një kurs sikurse ky, atëherë Perëndia mund të fillojë të na përdorë për t'u dhënë të tjerëve ato që kemi mësuar, për të ardhur pranë një të krishteri të ri dhe për t'i ndihmuar atij apo asaj në sfidën për të kuptuar këtë besim të ri. Ne mund të lutemi me këtë person, ta inkurajojmë që të flas rreth pyetjeve dhe dyshimeve, dhe të ofrojmë sugjerime të dobishme se ku mund të shikojë në Bibël për të gjetur përgjigjet dhe për t'u rritur.

Shpesh besimtarët e rinj, të cilët në fillim janë të ngazëllyer rreth besimit të tyre, dekurajohen dhe dorëzohen sepse nuk e kanë asnjëri pranë që t'i forcojë në këtë rrugë. Ne nuk duhet t'i kemi përgjigjet e të gjitha pyetjeve; ne thjeshtë kemi nevojë që të jemi pranë për të inkurajuar një besimtar më të ri dhe t'i ndihmojmë atij apo asaj që të mos ik nga rruga.

Është mirë për ne të gjithë që të jemi dishepuj dhe të dishepullojmë të tjerët. Një përparësi e fuqishme e dishepullimit është përgjegjësia. Për shembull, kur ne mund të tundohemi për të bërë një zgjedhje të marrë, e cila do të mund të devijonte nga rruga për t'i shërbyer Perëndisë apo kur jemi duke luftuar me një problem apo ndonjë model mëkatar në jetët tona, atëherë kjo mund të na ndihmojë që të flasim me dikë që mund të na ndihmojë t'i shohim gjërat nga një perspektivë e perëndishme.

Profeti Nathan e luajti këtë rol në jetën e Davidit dhe ishte instrumenti i Perëndisë për të sjellë Davidin në pendim dhe restaurim pasi që kishte kryer tradhti bashkëshortore dhe vrasje. Të jesh dishepull i një më të vjetri, një njeriu më të rritur në besim, mund të sjell shumë bekime, urtësi dhe inkurajim në jetë.



A jeni dishepulluar nga ndonjë njeri? Çfarë ndihme keni marrë nga një marrëdhënie e tillë e dishepullimit? Çfarë të ka shërbyer më së shumti nga kjo marrëdhënie?

Bazuar në atë që sapo ke lexuar, bëjë një përmbledhje rreth dishepullimit.

Çfarë gjëra të ka mësuar Perëndia të cilat mbase mund t'ia kalosh një besimtari më të ri?

Bëjë një listë të të gjithë besimtarëve, që rregullisht preken nga jeta jote dhe të cilët mund të klasifikohen si “më të ri në besim”. Merr një emër nga lista dhe fillo të lutesh për të parë se si mund t'i vish pranë këtij personi dhe t'i ndihmosh që të rritet në ecjen e tij/saj me Zotin.



Bazuar në atë që ke mësuar rreth ungjillëzimit dhe shërbesës, si do ta inkurajoje Hanën (gruan që e prezantuam në fillim të këtij mësimi)?



Detyrat në vijim janë dizajnuar në atë mënyrë për të të dhënë një përvojë në fushat e ungjillëzimit dhe të ndërtimit të trupit të Krishtit. Bëhuni gati që të diskutoni përvojat dhe vlerësimet e juaja.

Pjesa 1: Të arrish të humburit

Lutu për dikë me të cilin do të dëshiroje të ndash ungjillin dhe bëj një plan që të kesh me këtë person një bisedë rreth besimit tënd. Pasi ta kesh bërë këtë, merr kohë dhe shkruaje një vlerësim për këtë përballje, duke përfshirë:

1. Aspektet e bisedës që shkuan mirë
2. Aspektet që mund të përmirësohen.
3. Pyetjet të cilat nuk ke ditur se si t'i trajtosh.
4. Mënyrat ku ti ndjen se ke nevojë të përmirësohesh në këtë fushë të dëshmimit.
5. Çfarë ke mësuar nga kjo situatë e dëshmimit.

Pjesa 2: T'i shërbesh një besimtari tjetër

Merr një fushë të shërbimit tek besimtarët e tjerë. Mbase do të kishe dëshirë të dishepullroje një besimtar më pak të rritur në ecjen e tij apo saj me Krishtin, apo të marrësh pjesë në një shërbesë për t'i treguar dhembshuri dikujt që është në nevojë. Pasi që të kesh përmbushur këtë lloj shërbese, përgjigju pyetjeve në vijim:

1. Përshkruaj aktivitetin e shërbesës
2. A je i kënaqur për mënyrën se si e ke trajtuar situatën e shërbesës? Nëse po, pse, dhe nëse jo, pse?
3. Në cilat fusha mendon se ke nevojë për ndihmë?
4. Bëj një listë të burimeve ku ti mund të gjesh ndihmë për të zhvilluar aftësinë tënde në këtë fushë.
5. Si ke përfituar nga mundësia për t'u përfshirë në shërbesë?

Forca për të shërbyer

Kur ia përkushtojmë jetët tona Perëndisë që t'i përdorë për lavdinë dhe qëllimet e Tij, ne gjithashtu duhet ta kuptojmë se Ai është burimi i forcës sonë për t'i dashur dhe për t'ju shërbyer të tjerëve. Pali, i cili me siguri se ka qenë një njeri shumë energjik dhe ka kryer gjëra të mahnitshme për Perëndinë, e kishte kuptuar se fuqia e tij nuk do të ishte e mjaftueshme për ta çuar atë në një jetë të shërbesës. Ai shkruan, "Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon." (Fil.4:13).

Ne kurrë nuk do të gjenim forcë në vetvete për të vazhduar për t'ju shërbyer të tjerëve pa u përmbysur nga zhgënjimet, dështimet dhe mungesa e rezultateve. Kur jemi të lidhur së bashku me Krishtin, është Ai i cili do të bartë barrën e rëndë që ne bartim, duke lehtësuar ngarkesën tonë dhe duke na dhënë fuqinë që na nevojitet për të përfunduar detyrën për të cilën Ai na ka thirrur (Mat.11:28-30).

Që të rifreskohemi, ne kemi nevojë të kthehemi çdo herë tek burimi i forcës tonë. Mund të ketë kohëra kur do të ndihemi të lodhur në punën e Perëndisë. Ne mund të shohim një shembull të tillë në jetën e Elias tek 1 Mbretërve 18-19. Elija ishte një profet i Perëndisë i cili u ngrit para katërqind e pesëdhjetë priftërinjve të Baalit me të cilët debatoi brenda një dite. Në këtë konfrontim dramatik, me qindra burra thërritën me zë të lartë drejt zotit të tyre, duke u lutur për një përgjigje, por ata nuk morën asnjë përgjigje.

Në fund ishte radha e Elias. Në përgjigje të lutjes së Elias zjarri i Perëndisë ra menjëherë nga qielli dhe konsumoi jo vetëm sakrificën e lagur, por edhe gurët e vetë altarit. Perëndia në sytë e Izraelit e dëshmoi Vetën se ishte një Perëndi i vërtetë. Pas kësaj dite të gjatë dhe dramatike, por edhe të rëndë nga ana emocionale, Elija e përfundoi këtë ditë duke hipur mbi qerre dhe duke shkuar në Jezreel (1Mbret.18:46). A të ngjan kjo si një ditë e plotë pune?

Menjëherë pas këtij konfrontimi, Mbretëresha Jezebel, e cila ishte një adhuruese e pasionuar e Baal-it, i çoi fjalë Elias duke i thënë se deri nesër ai do të ishte i vdekur. Me siguri se kjo nuk ishte pika më e lartë e shërbesës së tij që Elija po priste.



Lexoni 1 Mbretërve 19:3-18. Përshkruani reagimin e Elias në këtë pikë.

1. Çfarë mendime dhe emocione shpreh profeti në këto vargje?
2. Si fitoi forca të reja profeti i lodhur?

Nëse Elija do të kishte vazhduar të shërbente në këtë gjendje, ai do të kishte vepruar jo i plotë dhe do t'i kishte munguar vitaliteti shpirtëror. Ka qenë e domosdoshme për të që të pushojë dhe të ripërtërihet fizikisht, emocionalisht dhe shpirtërisht.

Teksa Jezusi po i trajnonte dishepujt e Tij dhe po i dërgonte për të shërbyer, Ai u dha atyre një shembull që të merrnin kohë për të shkuar në një vend të vetmuar për të

qenë vetëm për vetëm me Atin, për t'u lutur dhe për t'u rifreskuar. Shpesh Ai u tërhoq nga turmat për t'u lutur dhe për të ripërtërirë shpirtin e Tij. Biri i Perëndisë kishte nevojë që të bënte një gjë të tillë. Sa më shumë kemi nevojë ne që pas përpjekjeve dhe shërbesës intensive të tërhiqemi në këtë mënyrë për t'u rifreskuar dhe ushqyer nga Perëndia. Ne kemi nevojë që të ecim në luginat të gjelbërta dhe të ulemi pranë ujit të freskët me Bariun e shpirtit tonë.

Nëse mundohemi përtej kufijve tanë fizik dhe emocional, rezultati shpesh do të jetë një thatësi e shtuar në shpirtin tonë. Marrëdhënia me Perëndinë do të shteroj sepse ne nuk kemi marrë kohë për ta ushqyer dhe për ta mbajtur gjallë atë. Ne do të shohim se kemi shumë pak nga vetja për t'ju ofruar të tjerëve. Ditën tjetër apo në shërbesën tjetër mund të ndjehemi të frikësuar dhe të mërzhitur kur nevojat e të tjerëve drejtohen kah ne. Familja jonë mund të vuaj, si dhe të zemërohet e të mërzhitet, kur ne japim gjithçka nga vetja për të tjerët, mirëpo marrim pak kohë për të ushqyer dhe kënaqur ata që na ka dhënë Perëndia ne.

Sikurse Elija ne duhet të largohemi sa herë që jemi të lodhur, të rifreskohemi nga Zoti dhe t'ia rikujtojmë vetes që detyrat e shërbesës nuk janë vetëm të tonat. Asnjëri nga ne nuk është i domosdoshëm në punën e Zotit. Ai ka shumë shërbëtorë të tjerë të cilët do të ngrejë dhe të cilët do t'i përdorë. Kur i afrohem Atij për të marrë forcë dhe rifreskim, ne do të përjetojmë fuqinë e Tij të veprojë në ne dhe nëpërmjet nesh në mënyrat që asnjëherë nuk i kemi imagjinuar.



A keni përjetuar ndonjëherë një kohë të njëjtë sikurse të Elias, një kohë të lodhjes dhe të dëshpërimit? Si e ke tejkaluar këtë përvojë? Çfarë zakone keni krijuar për të rifreskuar shpirtin tuaj në Zotin?



Merr kohë që të jesh vetëm me Perëndinë, që të mendosh rreth asaj që Ai të ka mësuar në lidhje me shërbesën, dhe kalo kohë në Fjalën e Tij dhe në lutje. Kërko nga Perëndia që të ripërtërijë shpirtin tuaj, të të ndihmojë dhe rifreskojë për shërbesë.

Mendime përmbyllëse

Në këtë mësim ne kemi shqyrtuar privilegjin për t'i shërbyer Perëndisë. Është privilegj i lartë të marrësh pjesë në qëllimet e Perëndisë në botë duke i ftuar të tjerët në mbretërinë e Tij dhe duke i ndërtuar besimtarët drejt pjekurisë. Çdo besimtar është i thirrur që të marrë pjesë në shërbesë. Shërbesa është pjesë normale e jetës së krishterë, dhe jo diçka që është e rezervuar vetëm për kler profesional.

Ne pamë që Perëndia dëshiron që ne t'i shërbejmë Atij me një zemër të përlur, me një shpirt shërbëtori dhe të motivuar nga dashuria për Të. Në një botë që lartëson fuqinë, paranë dhe suksesin, neve na është dhënë thirrja e lartë për të qenë shërbëtorë – shërbëtorë të Perëndisë së Gjallë. Le të lutemi që të bëhemi njerëz të atillë që do të arrijmë të shohim vlerën e të jetuarit për t'i shërbyer Perëndisë dhe të tjerëve, dhe që do të mund të themi ashtu sikurse Pali tha, “E falënderoj Krishtin Zotin tonë, që më bën të fortë, sepse më çmoi të denjë për t'u besuar, duke më vënë në shërbimin e tij” (1Tim.1:12).

FUSNOTAT

¹ Shiko Ray C. Stedman, *Body Life* (Glendale, CA: Regal, 1972), 88-89.

² Bazuar në Richard Halverson, *The Living Body* (Gresham, OR: Vision House, 1994), 116-120.

³ Halverson, 104.

⁴ Halverson, 110.

Përfundimi i garës

Xheri ishte bërë i krishterë në moshën dymbëdhjetë vjeçare pasi kishte ndjekur një program për të rinj. Ai filloi të lexojë Biblën e tij, të shkoj në kishë, dhe ia përkushtoi jetën e tij Perëndisë. Por tani që ndodhet në universitet, ai nuk ka shumë kohë për të studiuar Biblën apo që të përfshihet me të krishterët. Profesorët e tij e përqeshin krishterimin, dhe shokët e tij të klasës e kalojnë kohën e lirë duke u dehur dhe duke shkuar pas vajzave. Duke qenë larg kishës dhe familjes së tij, Xheri duket se po e humb besimin e tij. Herë pas herë ndërgjegjja e tij e pengon atë dhe ai mundohet që të lutet, por Perëndia duket shumë larg.

Çfarë taktika është duke përdorur djalli të josh Xherin për të neglizhuar besimin e tij? Çfarë pasoja mund të ballafaqojë Xheri nëse vazhdon të ecë në këtë rrugë larg Perëndisë? Si do ta sfidojë një të ri që është duke u ballafaquar me një situatë si kjo?



Kur e filluam këtë kurs, ne bëmë përshkrimin e hapit të parë, i cili na vuri në shtegun që është jeta e krishterë. Ne kemi shikuar shumë aspekte të jetës së krishterë që janë themelore në udhëtimin tonë. Teksa i afrohem fundit të këtij udhëtimi, ne dëshirojmë të reflektojmë në atë që kemi mësuar dhe gjithashtu të marrim kohë që të mendojmë rreth së ardhmes sonë. Si do ta përfundojmë shtegun që kemi përpara si ndjekës të Krishtit? Në këtë mësim ne do të shikojmë gjërat që kemi nevojë t'i dimë në mënyrë që të qëndrojmë në besimin tonë teksa shikojmë përpara gjer në fund të jetëve tona, kur shërbesa jonë ndaj Perëndisë të jetë kompletuar.

Përmbledhje e mësimit

Përgatitja për vrapim
Duke i mbajtur sytë tonë drejt qëllimit
Duke lënë anash çdo ngarkesë
Të penguar nga Satani
Të zënë në kurth nga mëkati
Jeta e ushtarit

Shpata e Frymës
Arma e lutjes
Inkurajimi i miqve tanë
Krishti, sunduesi ynë
Përballja me armikun e fundit
Duke vrapuar me qëndrueshmëri
Çmimi i parajsës
Shpërblimi për shërbimin me besnikëri
Duke arritur vijën e fundit të garës (finishin)
Përmbledhje e kursit

Qëllimet e mësimit

Kur ta keni përfunduar këtë mësim, ju do të jeni në gjendje që:

1. T'i japësh besimtarëve arsye për t'i mbajtur sytë e tyre në Jezusin përderisa e jetojnë jetën e tyre të krishterë.
2. Të përshkruani së paku dhjetë taktika që Satani përdor për të mundur ty apo besimtarët që ti i njeh.
3. Të shpjegosh kufizimet që Satani ka në veprimet e tij.
4. Të vlerësosh përdorimin e burimeve që Perëndia të ka dhënë për të rezistuar mëkatin dhe djallin.
5. Të vlerësosh se si motivimet për të jetuar jetën e krishterë ndikojnë në ty që të vazhdosh në besim.

Përgatitja për vrapim

Jeta e krishterë mund të krahasohet me një garë. Pika fillestare e kësaj gare është kur ne fillojmë një marrëdhënie personale me Perëndinë nëpërmjet besimit në Jezus Krishtin. Gara i ngjan një maratone, e cila zgjerohet në distanca të gjëra dhe lloje të ndryshme të terreneve.



Mendo se çfarë përgatitje mund të jenë të nevojshme për një vrapues në distancë të gjatë dhe përgjigju pyetjeve në vijim:

1. Si vishet një vrapues për vrapim? Përse?
2. Ku e fokuson vëmendjen vrapuesi?
3. Çfarë janë disa gjëra që vrapuesi duhet t'i durojë në mënyrë që të përmbyll një garë të gjatë?

Autori i Hebrenjve pikturon pamjen e një atleti i cili është trajnuar të vrapojë dhe i cili është tërësisht i përfshirë në garë.



Lexoni Hebrenjve 12:1-3 dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim në fletoren tuaj:

1. Çfarë duhet të lëmë anash në mënyrë që të vrapohet në një garë vrapimi?
2. Si duhet ta vrapojmë garën e jetës së krishterë?
3. Ku duhet ta fokusojmë vëmendjen teksa vrapojmë në këtë garë?

Duke i mbajtur sytë tonë drejt qëllimit

Teksa vrapojmë në garë, ne duhet të fokusohemi në Jezusin. Ai përshkruhet si Kreu dhe Plotësonjësi i besimit tonë. Me fjalë të tjera, Ai është Personi që e bëri të mundur që ne të vijmë tek Perëndia dhe i cili do të kujdeset që ne të përmbushim procesin e shpëtimit tonë. Pali shkruan tek Filipianëve 1:6 se ai është i bindur “se ai që nisi një punë të mirë në ju, do ta përfundojë deri në ditën e Jezus Krishtit.”

Tek Hebrenjve 12:1-3 ne shohim se Jezusi i cili, për gëzimin që ishte përpara tij, duroi kryqin duke e përçmuar fyerjen dhe u ul në të djathtën e fronit të Perëndisë, duke përmbushur kështu veprën e shpëtimit tonë. Jezusi dha shembullin që ne duhet të ndjekim teksa vrapojmë garën e jetës së krishterë. Ashtu siç Ai shikoi drejt qëllimit më të lartë, po kështu edhe ne jemi nxitur që t’i mbajmë sytë drejt fundit për të parë atë që na pret në fund të garës. Teksa fokusohemi në Të në mesin e garës, zemrat tona do të inkurajohen. Ne mund ta shohim Atë si Trajnerin tonë qiellor, i cili na pret me padurim në fund të garës. Ne mund ta parashikojmë shikimin e kënaqësisë në fytyrën e Tij teksa Ai na shikon ne duke e mbaruar garën me nder.

Të vraposh një garë të gjatë është një detyrë e vështirë. Një burrë apo një grua nuk mundet që thjeshtë të zgjohet në mëngjesin e maratonës dhe të vendos që të marrë pjesë në maratonë. Vrapuesit fillojnë të përgatiten për garën shumë kohë para ditës që do të zhvillohet gara. Ata fillojnë të ushtrojnë; vrapojnë në distanca të shkurtra; dhe gradualisht fillojnë të zhvillojnë qëndrueshmërinë. Ata e studiojnë shtegun dhe marrin në konsideratë fushat me potencial problematik, gjithashtu i studiojnë anët e forta dhe ato të dobëta që ata vetë kanë. Kur përfundimisht dita e garës vije, ata duhet të jenë të vendosur që të qëndrojnë. Ata duhet të vendosin që ta përfundojnë atë, pa marrë parasysh koston.

Ekzistojnë kohë kur vrapuesit e maratonës dëshirojnë të ndalen, dhe atë në momentin kur trupat e tyre duket se janë duke bërë titur, kur mushkëritë e tyre janë duke gulçitur për ajër, dhe kur ata kanë arritur një çast kur duket e pamundur të vrapohet më tutje. Në anën tjetër, shumë vrapues e kanë zbuluar se kur ata ngulmojnë në tejkalimin e kësaj pike të lodhjes së plotë, ata marrin “një erë të dytë,” një energji të re, e cila u lejon atyre të vazhdojnë tutje. Dhimbja e muskujve largohet; frymëmarrja e tyre bëhet më e rregullt, dhe ata gjejnë forcën për të vazhduar në rrugën që i qon përpara.



Kur e transferojmë këtë analogji të garës në jetën e krishterë, çfarë janë disa gjëra që të krishterët do të duhej të duronin? Çfarë janë disa gjëra të cilat mund të ndikojnë që ne të dëshirojmë të heqim dorë nga të jetuarit për Krishtin? A mund ta kujtosh ndonjë njeri që ka hequr dorë? Cila ishte arsyeja?

Si ndikon të fokusuarit në Jezusin për ta ndihmuar një besimtar që të vazhdojë jetën e krishterë? Mendo rreth një shembulli kur ti ke qëndruar duke u fokusuar në Krishtin.

Duke lënë anash çdo ngarkesë

Përderisa një maratonë vrapohet zakonisht në rrugë që janë përzgjedhur me shumë kujdes vetëm për këtë qëllim, jeta e krishterë vrapohet në një terren që është edhe i larmishëm edhe i paparashikueshëm. Ne nuk e kemi përparësinë për ta shikuar shtegun para se të fillojë gara. Ndonjëherë rruga është e sheshtë dhe e këndshme, shpesh është e ashpër, me gurë, dhe e mbushur me gjemba dhe pengesa. Është shumë e lehtë që këmbët tona të koklaviten në shkurre, duke na bërë që të ngecim.

Teksa vrapojmë garën, për ne është thelbësore që të marrim në konsideratë ato gjëra që do na pengojnë për të bërë një vrap të mirë. Vrapuesit vlerësojnë çdo pjesë të rrobave që ata do të veshin në mënyrë që të sigurohen se nuk kanë vënë peshë të tepruar në trupin e tyre apo që të pengohen apo të bëhen pengesë teksa vrapojnë. Ata i kushtojnë vëmendje dhe kujdes për të eliminuar çdo gjë që mund të shkaktojë rezistencë ajrore. Edhe ne si besimtarë po kështu duhet të lëmë anash çdo gjë që mund të na mbajë mbrapa dhe të mos na lejojë që ta vrapojmë garën dhe ta përfundojmë atë mirë.

Kur e fillojmë garën, ne shumë shpejtë e kuptojmë se ekzistojnë modele mëkatore në jetën tonë, të cilat nuk e kënaqin Perëndinë. Ekzistojnë gjëra për të cilat Perëndia shumë qartë na ka urdhëruar që t'i lëmë anash. Teksa ecim tutje në përvojën tonë të krishterë, ne e zbulojmë se është i vazhdueshëm procesi “i të lënit anash të barrës”. Fryma e Shenjtë gradualisht na bind për veprime dhe qëndrime që duhet të lihen anash. Perëndia është në proces të përgatitjes sonë për qiell, duke na rregulluar në atë mënyrë që peshat e mëkatit të mënjanojnë.

Perëndia është në
proces të përgatitjes
sonë për qiell, duke na
rregulluar në atë
mënyrë që peshat e
mëkatit të mënjanojnë.



Kur shikon përvojën tënde të krishterë, çfarë janë disa gjëra që ti ke lënë mënjanë menjëherë pasi je bërë i krishterë? Çfarë janë disa “pesha” apo “ngatërresa” për të cilat je vetëdijesuar dikur vonë në jetën tënde, apo rishtas?



Falënderojë Perëndinë për mënyrën se si ka vepruar në jetën tënde duke të ndihmuar që të lësh anash modelet mëkatore, dhe kërkoi Atij që të të ndihmojë që të lësh anash ato modele për të cilat je në dijeni tani në këtë moment të jetës tënde?

Të penguar nga Satani

Teksa vrapojmë garën tonë mbi një terren të paparashikueshëm, ne përballemi me disa pengesa të vështira, me të cilat një vrapues maratonik sot nuk përballët. Në të vërtetë, ekzistojnë kafshë të egra që fshihen përgjatë rrugës, në pritje për të na sulmuar! Tek 1 Pjetri 5:8-9, Pjetri e përshkruan djallin si një luan vrumbullues, duke ecur me padurim në kërkim të presë së tij me qëllimin që ta gllabërojë atë. Kjo pre jemi ne.

Armiku ynë i frikshëm

Teksa shkojmë poshtë lart jetës sonë të përditshme, ne duhet të jemi në dijeni që ekziston një armik i madh, qëllimi i të cilit është të na shkatërrojë dhe të na parandalojë që të mos përfundojmë garën. Për shumë njerëz është e vështirë të besojnë që djalli është një qenie e vërtetë. Bile edhe të krishterët, të cilët besojnë në ekzistencën e djallit, mund të mos jenë në dijeni për natyrën e taktikave të djallit dhe realitetin e luftës kozmike, në të cilën jemi të përfshirë. Të mos jesh në dijeni për Satanin dhe taktikat e tij është sikur të jesh ushtarë me sy të mbyllur duke shkuar në betejë.

Të mos jesh në dijeni për Satanin dhe taktikat e tij është sikur të jesh ushtarë me sy të mbyllur duke shkuar në betejë.

C. S. Lewis shkroi, “Ekzistojnë dy gabime të barabarta dhe të kundërta, në të cilat raca jonë mund të qesh rreth djallit. Një është të mos besosh në ekzistencën e tij. Tjetra është të besosh, dhe të ndjesh një interes të tepruar dhe jo të shëndetshëm në ta. Ata vetë kënaqen njëjtë për të dyja këto gabime.”¹

Teksa lexojmë Ungjijtë ne bindemi se Jezusi besoi në ekzistencën e djallit. Kur Jezusi filloi shërbesën e Tij, djalli menjëherë e pozicionoi vetën e tij në sulm kundër Krishtit, duke e tunduar Atë në shkretëtirë për të zgjedhur një rrugë të shkurtër, e cila do të eliminonte kryqin. Më vonë, kur Jezusi u tha dishepujve të Tij që vuajtja dhe vdekja e Tij do të ndodhnin së shpejti, Pjetri i rezistoi këtij mësimi, dhe Jezusi e qortoi atë ashpër me fjalët: “Largohu nga unë Satana.” Ai njohu në përpjekjet e Pjetrit taktikat dhe fjalët e Satanait, kryearmikun e Tij.

Shumë mësim të Jezusit dëshmojnë për faktin që Jezusi e konsideroi djallin të jetë real dhe i fuqishëm. Në një shëmbëlltyrë Jezusi duke folur për katër llojet e tokave, Jezusi tha që djalli është i ligu që heq farën e Fjalës së Perëndisë. (Mat.13:19). Në shëmbëlltyrën e Tij rreth grurit dhe egjërës, Jezusi tha që armiku, i cili ka mbjell egjërën në arë është djalli (Mat.13:39). Një pjesë e rëndësishme e shërbesës së Jezusit ishte largimi i frymërave të liga. Para se të përballej me kryqëzimin, Jezusi u lut për dishepujt e Tij të mbroheshin nga i ligu. (Gjoni 17:15). Është e qartë që Jezusi besoi në një qenie të vërtetë dhe djallëzore që kundërshton qëllimet e Perëndisë.

Bibla i portretizon engjëjt e Perëndisë të mbyllur në betejë me forcat e errësirës (Zbu.12:7-9). Djalli është një armik i fuqishëm, i cili posedon fuqi, inteligjencë dhe dinakëri të madhe. **Armiku ynë i frikshëm është tërësisht i përfshirë në luftë kundër Krishtit dhe ndjekësve të Tij.** Ne jemi në një betejë, e cila zhvillohet në nivelet më të larta të universit në mes të armiqve më të mëdhenj: Perëndisë dhe Satanit. Lidhja jonë me Perëndinë në këtë luftë shpirtërore na vë përballë me forcat e Satanit.

Në mënyrë që t'i bëjmë ballë një armiku të tillë, ne duhet të kuptojmë se si vepron ai, në të kundërtën mbrojtjet tona shumë shpejtë do të munden. **Në çdo luftë është absolutisht e nevojshme që të njihet dhe vlerësohet saktë armiku juaj.** Të njohësh armikun tuaj do të thotë të kuptosh karakterin dhe strategjitë e tij, të njohësh mënyrat e veprimit të tij, dhe të kuptosh cilat janë pikat e tua më të ndjeshme ndaj sulmeve të tij. E njëjta gjë vlen edhe në botën shpirtërore.

Taktikat e Satanit. Efesianëve 6:16 flet për “shigjetat e zjarra të të ligut.” Këto janë taktikat e Satanit, qëllimi i të cilit është të të mund dhe të të shkatërrojë ty. Jezusi u mundua që të ngulit në dishepujt e Tij urgjencën e kësaj nevojë për të qenë të përgatitur dhe të zgjuar. Cilat janë disa nga taktikat e Satanit? Lexoni listën si më poshtë dhe vendosni një “+” pranë atyre taktikave për të cilat ju jeni të informuar, dhe një “-” pranë atyre taktikave që ju nuk i keni marrë në konsideratë.

- Ai i verbëron mendjet e njerëzve për të vërtetën e Jezus Krishtit (2Kor.4:4).
- Ai heq farën e Fjalës së Perëndisë, në mënyrë që ajo të mos zë rrënjë (Mar.4:15).
- Ai bënë që ne të devijojmë për shkak të shqetësimeve të kësaj bote.
- Ai na mashtron neve, dhe ai është “ai që mashtron tërë dheun” (Zbu.12:9).
- Ai maskohet si një engjell i dritës (2Kor.11:14).
- Ai e shtrembëron dhe e përdredh të vërtetën, duke përzier të vërtetën me gënjeshtër. Ai i shtyn njerëzit që të besojnë gënjeshtër rreth Perëndisë dhe të refuzojnë Fjalën e Perëndisë. Ai quhet “frymë e gënjeshtres” dhe “at i rrenës” (1Gjoni 4:3-6; Gjoni 8:44).
- Ai depërton në kishë nëpërmjet mësimi të rremë.
- Ai na joshë që të kënaqemi në veprat e mishit, të cilat na çojnë në errësirë shpirtërore dhe mjerim.

- Ai na tundon që të përjetojmë gëzim të rrejshëm me anë të imoralitetit seksual, pornografisë, drogës dhe abuzimit alkoolik.
- Ai kundërshton mbretërimin e Krishtit në botë dhe punon për të ndikuar dhe kontrolluar drejtuesit dhe lëvizjet e liga si dhe sistemet jo të drejta politike. Ai nxit dhe u jep formë forcave të liga të errësirës në këtë botë.
- Ai është shkatërruesi i marrëdhënieve, i cili mbjell farat e zemërimit, pakënaqësisë, inatit dhe abuzimit.
- Ai quhet paditësi i vëllezërve (Zbu.12:10). Ai mundohet të na mund me rrëke gënjeshtresh rreth Perëndisë dhe vetes tonë, dhe na mbush me faj të rremë.
- Ai mundohet të ndajë kishën, të kthejë të krishterët kundër njëri-tjetrit dhe të bëjë që emri i Perëndisë të çnderohet.
- Ai punon drejt zëvendësimit të religjionit të vërtetë me idhujtarinë dhe religjiozitetin.
- Ai mundohet të na mund duke na shkaktuar ankth mental dhe duke na çuar drejt dëshpërimit për mëkatet tona. Përderisa Fryma e Shenjtë na bind për mëkat, që na çon drejt pendesës dhe një marrëdhënieje më të thellë me Perëndinë, djalli na dënon, duke na çuar drejt zhgënjimit, dëshpërimit, dhe humbjes së shpresës, duke na kujtuar shpesh mëkatet dhe dobësitë tona.
- Ai përfshihet në sulme personale në trupat, mendjet dhe shpirtrat e njerëzve të Perëndisë. Ai përdor persekutimin, sëmundjet, depresionin dhe vdekjen.
- Ai përdor krenarinë, vetëbesimin, dhe vetësigurinë, duke na joshur që të mbështetemi në vetvete dhe të shikojmë arritjet tona dhe të mos mbështetemi tek Fryma e Shenjtë.
- Ai na verbëron për dobësitë tona, duke na i vënë në pah dështimet e të tjerëve,
- Ai na tundon që të ndërtojmë mbretërinë tonë, të dëshirojmë famën, fuqinë dhe pasurinë, dhe t'i bëjmë gjërat për qëllimet dhe lavdinë tonë dhe jo për ato të Perëndisë.
- Shpesh herë ai pushton një qenie njerëzore që është krijuar nga Perëndia për lavdinë e Tij. Qëllimi i tij nuk është tjetër pos të vras dhe të shkatërrojë (Mark 5:1-20).
- Në të ardhmen ai do të kërkojë që të personifikojë Trinitetin e Perëndisë me anë të një plani për të mashtruar tërë tokën (Mat.24:24; 2Thes.2:3-10; Zbu.13:2, 4, 11-17).

Satani me të vërtetë është një ngatërrestar, gënjeshtar, dhe vrasës që nga fillimi (Gjoni 8:44). Besimtari duhet të jetë në dijeni për këtë dhe të rrijë zgjuar (1Pjet.5:8), sepse Satani kundërshton çdo gjë që bënë Perëndia. Taktikat e Satanit janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me qëllimet e Perëndisë, ashtu siç janë zbuluar me Jezusin.

Ashtu siç Jezusi zbulon të vërtetën, satani e fsheh atë (Gjon.1:17; 2Kor.4:3-4); ashtu siç Jezusi jep jetë, satani e merr atë (Gjoni 5:24; 8:44; Heb.2:14); ashtu siç Jezusi prodhon fryte hyjnore, satani prodhon frytet e mishit (Gal.5:19-23); ashtu si Jezusi na teston për të na rritur, satani na tundon për të na shkatërruar (Jak.1:2-4; 1Pjet.5:8); ashtu si Jezusi na çliron, satani na bënë skllëvër të mëkatit (Gjoni 8:31-36; 2Tim.2:26); dhe ashtu siç Jezusi na mbron, satani na akuzon (1Gjoni 2:1; Zbu.12:10).



Si do ta përshkruaje njohurinë tënde paraprake të strategjive të satanit? Çfarë pasoja ke përjetuar si rezultat i mungesës së njohurisë rreth karakterit dhe taktikave të tij? Përmendni së paku dhjetë mënyra, të cilat tani mund t'i njihni, që satani i ka përdorur kundër teje?

Kufijtë e armikut. Pas leximit të një liste të tillë, ne mbase mund t'i bëjmë vetes këtë pyetje, “Nëse satani është kaq i fuqishëm, përse nuk del dhe nuk shkatërron çdokënd me gjithë armatën e tij?” Përgjigja është e dyfishtë. E para, **Perëndia i ka vendosur kufizime dhe kufij ne lidhje me atë se çfarë mund të bëjë ai** (2Thes.2:3-6; Job.1:12; 2:6). Satanit nuk i ishte dhënë mbretërim i lirë që të bënte gjithçka që ai dëshironte në jetën e Jobit; atij iu përshkruan kufijtë e tij. Ne si besimtarë jemi vërtetë të pavdekshëm deri sa detyra jonë për Krishtin të kompletohet.²

E dyta, **pasi që satani dëshiron të jetë si Perëndia, ai e dëshiron adhurimin e tërë njerëzimit.** Kur satani e tundoi Jezusin në shkretëtirë, një ndër ato tundime ishte që Krishti të përulej dhe ta adhuronte atë (Mat.4:9-10). Tek Zbulesa 13:3-4 ne shohim se në një kohë në të ardhmen gjatë mundimit të madh, njerëzit do ta adhurojnë bishën dhe dragoin, që është Satani, i cili i jep autoritet bishës. Satani e dëshiron adhurimin tonë, dhe pasi që nuk ia arrin këtij qëllimi, ai mundohet të na shkatërrojë.

Pasi që Satani dhe legjioni i tij janë të kufizuar në përdorimin e fuqisë së tyre, ata nuk janë të kufizuar në përdorimin e inteligjencës dhe dinakërisë së tyre. Ata do të përdorin çdo mjet që kanë në dispozicion. Pali thotë që Satani dhe ndjekësit e tij e maskojnë vetën e tyre si lajmëtarë të dritës.

Satani, duke u munduar të shkatërrojë atë që Perëndia kishte krijuar, e solli botën në gjendjen në të cilën ajo është tani. Si at i gënjeshtrove, Satani parashitroi para Adamit dhe Evës një gënjeshtër të madhe dhe atraktive, gënjeshtër që krijesa për të qenë e lumtur dhe e plotësuar nuk ka nevojë të jetë përgjegjëse ndaj Krijuesit. Adami dhe Eva zgjodhën një rrugë të jetesës të pavarur nga Perëndia, një rrugë që çoi tërë njerëzimin drejt vdekjes si fizike ashtu edhe shpirtërore.

Satani përfitoi një avantazh ndaj nesh dhe planetit të tokës duke shkaktuar ndarjen tonë nga Perëndia. Ai pastaj ishte në gjendje të pohojë sundimin e tij dhe rrjedhimisht është quajtur “perëndia i këtij shekulli” (2Kor.4:4), “prijës i pushtetit të erës” (Ef.2:2). Gjoni thotë se e tërë bota është në duart e të ligut (1Gjoni 5:19). Ai është aktiv në çdo

fushë: në politikë, arsim, ekonomi, argëtim, industri, filozofi dhe në media. Qëllimi i tij është që tërë njerëzimi të përgulen para tij në nënshtrim.



Vini re se si janë të kufizuara veprimet e satanit, dhe përshkruaj efektin që kufizimi i tij ka në ty për të jetuar jetën e krishterë.

Të zënë në kurth nga mëkati

Që të plotësojë qëllimin e tij për të pasur sundim të plotë në botë, satani përdor çdo taktikë të mundshme. Ai ka një përparësi në anën e tij, gjë që e bënë punën e tij më të lehtë. Përparësia është se njerëzit janë të lindur në mëkat. Që prej rënies së Adamit dhe Evës, ne kemi një prirje që të zgjedhim shtegun e pavarësisë nga Perëndia, dhe jo atë të varësisë në Të. Ne lindim të ndarë nga Krijuesi ynë dhe jemi egocentrik, duke zgjedhur që të kënaqim vetëm mishin tonë mëkatar. Mëkati ndikon në çdo aspekt të personalitetit tonë: mendjen, ndjenjat dhe vullnetin tonë. Ne gjithashtu lindim në një botë të rënë dhe të mallkuar, e cila mbështet mishin tonë mëkatar, duke joshur dëshirat tona fizike, pasionin tonë për të poseduar, dhe krenarinë tonë të posedimit dhe ambicies.

Si pasojë, satani vetëm mund të fsheh të vërtetën nga një jobesimtar, duke e mbajtur atë të verbër ndaj faktit se ekziston një rrugë që të çon sërish drejt bekimit të përjetshëm dhe varësisë në Perëndinë, dhe se ekziston një mënyrë për t'ju shmangur zemërimit të Perëndisë si dhe dëshpërimit dhe boshllëkut që ka sjellë pavarësia.

Satani gjithashtu mundohet që të fsheh të vërtetën nga besimtarët – të vërtetën që mëkati nuk ka më zotërim absolut mbi ne. Ne më nuk kemi nevojë që të lejojmë mëkatin të na sundojë; ne kemi mundësinë të zgjedhim që t'i ofrojmë trupat tanë para Perëndisë që të përdoren si instrumentet e Tij të drejtësisë (Rom.6:5-13).

Edhe pse më nuk jemi nën zotërimin e mëkatit, ne vazhdojmë të luftojmë me natyrën mëkatore që është brenda nesh, dhe ne jemi të ndjeshëm që të zihemi në kurth nga mëkati nëpërmjet shumë tundimeve. Jakobi thotë se ne tundohemi të udhëhequr dhe të mashtruar nga vetë lakmia jonë (shiko Jak.1:14).



Lexo Jakobi 4:1-3, 7-10.

1. Si e përshkruan Jakobi tundimin?
2. Si duhet të reagojmë ndaj tundimit?

Kur ne pendohemi dhe kthehemi nga mëkati, qëllimet e satanit shkatërrohen, ndërsa qëllimet e Perëndisë përparojnë. Ne mund ta mposhtim mëkatin në jetën tonë vetëm duke u drejtuar tek Krishti, duke rrëfyer mëkatin tonë, ashtu siç na bind Fryma e Shenjtë

dhe duke zgjedhur që të kthehemi nga mëkati dhe të varemi gjithnjë e më shumë në Perëndinë. Ne duhet ta trajtojmë mëkatin sapo të jemi në dijeni për ekzistimin tij dhe jo ta lëmë që të zë rrënjë në jetët tona dhe të bëhet një kështjellë, një zakon i fuqishëm, të cilin satani e përdor vazhdimisht në mënyrë që të na kthejë drejt qëllimeve të tij.

Satani është gjithnjë në gatishmëri për të gjetur mënyra për të na tunduar neve, duke na joshur mu në pjesët ku jemi të dobët, duke na detyruar që të zgjedhim në mes të të drejtës dhe të gabueshmes, në mes të bindjes dhe mosbindjes, në mes të varësisë në Perëndinë dhe pavarësisë. Ai përfiton nga natyra jonë mëkatore, duke na bërë që ne të fokusohemi tek vetja, gjërat apo të tjerët, dhe jo në Krishtin dhe Fjalën e Tij (Kol.3:1-3). Ai gjithashtu na josh me anë të tërheqjes (joshjes) që bota ofron.



Lexoni 1 Gjoni 2:15-17.

1. Çfarë mendoni se nënkuptoi Gjoni me fjalën “bota”?
2. Si e përshkruan Gjoni botën dhe qëndrimin tonë si besimtarë ndaj saj?

“Lakmia e mishit” i referohet tendencës së përgjithshme të natyrës sonë mëkatore që kundërshton Perëndinë. “Lakmia e syve” flet për një dëshirë që tërheq shqisat fizike, një dëshirë e cila shpesh shprehet me pasionin për të poseduar. “Krenaria e jetës” flet për tendencën e një personi për t’u mburrur në lidhje me atë që ka apo atë që bënë. Gjoni pikturon një kontrast të zymtë në mes të atij që e do këtë botë dhe jeton me anë të vlerave të saj dhe atij që e do Perëndinë dhe jeton për ta kënaqur Atë (shiko 1Gjoni 2:28-3:3).



Në ç’mënyra është munduar satani që të të rrëzojë apo të të zë në kurth? Çfarë sfida ke në fushën e të qenët i dominuar nga apetitet apo dëshirat fizike? Si ndikon në ty dëshira për të poseduar? Çfarë sfida ke me krenarinë për atë që posedon apo për atë që ke arritur?

Jeta e ushtarit

Çdo besimtar është i zhytur në një luftë kozmike. Ne nuk përballemi vetëm kundër luftërave të satanit dhe legjionit djallëzor kundër Perëndisë, por edhe me luftërat e natyrës sonë mëkatore kundër Perëndisë. Lufta është tepër e madhe, dhe qëllimi i djallit është të fitoj epërsi të plotë mbi shpirtin e çdonjërit.

Lista e taktikave të satanit që kemi shkruar më lartë është larg nga të qenët e kompletuar. Mjafton të lexojmë shtypin ditor apo të shikojmë lajmet, dhe të kujtojmë për shtrirjen e madhe të së keqes në botë. Por jemi mirënjohës që kjo nuk është e vetmja pamje që kemi.

Në këtë betejë të dritës kundër errësirës neve na është dhënë siguria e plotë që Drita e Krishtit do të mund errësirën. Ne gjejmë shpresë në këtë, sepse ne nuk luftojmë nga një pozitë e dobësisë por nga fitorja tashmë e fituar dhe siguruar nga vdekja dhe ringjallja e Jezus Krishtit. Për shkak të kësaj, ne nuk duhet të frikësohemi nga armiku ynë, por vetëm të njohim fuqinë dhe dinakërinë e tij, dhe pastaj të planifikojmë për sulmet e tij.

Ne nuk luftojmë nga një pozitë e dobësisë por nga fitorja tashmë e fituar dhe siguruar nga vdekja dhe ringjallja e Jezus Krishtit..

Si ushtarë të Krishtit ne duhet të jemi të gatshëm për betejë çdo ditë dhe gjithashtu të jemi në dispozicion të urdhrat të komandantit tonë. Ne duhet të demonstrojmë ato karakteristika me të cilat çdo ushtar mburret: guximi, vigjilenca, besnikëria, durimi, mprehtësia, forca, shkathhtësia, njohja e armikut, dhe vendi i përjetshëm për të luftuar deri në fund.³

Si ushtarë të Krishtit ne jemi veshur me armë të fuqishme.



Lexoni 2Korintasve 10:3-6. Si i përshkruan Pali armët tona?

Pali në shkrimet e tij e përdor disa herë shëmbëlltyrën e luftës së besimtarit dhe të armëve. Tek Efesianëve 6:10-11 Pali përshkruan armatimin e plotë të trupit që Perëndia ka ofruar për besimtarët, në mënyrë që ne të jemi në gjendje të mbrohemi kundër pritave të djallit. Ai vazhdon të përshkruaj pjesët e këtij armatimi: brezin e së vërtetës, parzmoren e drejtësisë, të mbathurat e gatishmërisë, mburojën e besimit, përkrenaren e shpëtimit, dhe shpatën e Frymës.

Asnjë pjesë e trupit nuk është lënë e pambrojtur, dhe asnjë skaj nuk është pa pajisjen e duhur. Para se ushtarët të përfshihen në betejë me armikun, ekziston një kusht paraprak. Ata duhet ta vënë armatimin (Ef.6:11, 13). Me fjalë të tjera, neve na është siguruar armatimi dhe armët, por ne duhet t'i përdorim ato dhe të mos kapemi pa to.



Rishikoni listën e armatimit që ndodhet tek Efesianëve 6:10-17. Çfarë mendoni se nënkuptohet me atë që thuhet se secili besimtar duhet të vesh secilën pjesë të këtij armatimi?

Shpata e Frymës

Përderisa mbrohemi nga drejtësia e Krishtit dhe armët tona mbrojtëse të besimit, të vërtetës, dhe paqes, arma e vetme mbrojtëse që Pali përshkruan te Efesianëve 6 është shpata e Frymës, që është Fjala e Perëndisë.



Shikoni tek Mateu 4:1-11, kur Krishti u mor në shkretëtirë nga Fryma e Shenjtë që të tundohej nga satani.

1. Në të tre tundimet specifike, çfarë arme përdori Jezusi?
2. Bazuar në shembullin e Jezusit, çfarë parimi mund të aplikosh ti për jetën tënde?

Kur ndodhemi në beteja dhe teste specifike, ne mund të kthehemi tek burimi i Fjalës së Perëndisë që ta aplikojmë për atë situatë. Që të jemi të përgatitur për tundimet, ne kemi nevojë që të ngopim mendjet tona me Fjalën e Perëndisë. Në çastet e tundimit, kur ndihemi të ngatërruar, të frikësuar, apo të dobët, përgjigjja jonë e parë duhet të jetë kthimi tek Zoti tek Fjala e Tij për urtësi, ngushëllim, dhe forcë që të na mbajë. Kur zgjasim duart që të zëmë shpatën e Fjalës së Perëndisë, ne mund të jemi të sigurt që arma të cilën Ai ka vendosur në duart tona, është mjaft e fuqishme që të zmbraps armikun tonë.

Arma e lutjes

Fitorja kundër mëkatit dhe satanit nuk do të arrihet nëse nuk jemi të përkushtuar në lutje.



Shikoni tek Efesianëve 6:18-20. Çfarë toni mund të ndjeni në inkurajimin e Palit për t'u lutur?

Pas përshkrimit të armatimit të krishterë, Pali i thërret besimtarët që të luten. Lutja është dora jonë e djathtë ndaj komandantit tonë në mesin e betejës. Satani me forcat e tij dridhen kur një i krishterë thërret Perëndinë në lutje. Arma e fuqishme e lutjes na lidhe neve me Perëndinë e gjallë, Krijuesin e qiellit dhe tokës, i cili do të kryej fitoren tonë. Kur ne lutemi, ne pranojmë ashtu siç bëri edhe Davidi kur u ballafaqua me Goliatin – se përfundimi i betejës varet nga Zoti – po kështu edhe ne i mbajmë sytë drejt Tij për të mposhtur armikun (1Sam.17:47).

Inkurajimi i miqve tanë

Kur një ushtar shkon në betejë që të luftojë me armikun e tij, ai ushtar qëndron pranë shokëve nën kauzën e njëjtë si pjesë e frontit të bashkuar, duke u ballafaquar me armikun kundërshtar. Kështu besimtarët që janë si ne janë një ndihmë në luftën tonë kundër satanit.

Sa shpesh kemi dëgjuar tregime të guximshme për ushtarë që kanë rrezikuar jetët e tyre për të shpëtuar shokët e tyre në mes të betejës. Po kështu ne duhet t'u ndihmojmë të tjerëve sepse gjatë jetës vazhdimisht ballafaqohemi me shumë beteja shpirtërore. Për gjatë rrugës Pali gjithnjë i ka kërkuar njerëzit të cilët kanë pasur nevojë për ndihmë në jetën e tyre. Ai butësisht i inkurajonte ata që ishin të dobët dhe të tunduar që të hiqnin dorë (1Thes.2:7-14).

Kur jemi të zhgënjyer, do ishte shumë e dobishme sikur të këshilloheshim dhe të kërkonim inkurajimin e ndonjë burri apo gruaje të perëndishme. Ndonjëherë mjafton një fjalë që të të ngrejë në frymë; herë të tjera, neve mund të na nevojitet ndihma dhe mbështetja e vazhdueshme e të tjerëve për një kohë të gjatë. Për sa rritemi në Krishtin, ne mund të fillojmë t'u ofrojmë atë ndihmë dhe mbështetje ushtarëve të tjerë. Tek Isaia 35:3-4 ne gjejmë këto fjalë, *“Forconi duart e dobësuara, bëjini të qëndrueshëm gjunjët e pasigurt! U thoni atyre që e kanë humbur zemrën: “Bëhuni të fortë, mos kini frikë!”*. Ja, Perëndia juaj do të vijë”

Krishti, sunduesi ynë

Bibla është e mbushur me shëmbëlltyra të Krishtit i cili është duke ardhur si Mbreti ynë dhe Shpenguesi ynë. Gjoni pa një vizion të një figure të fuqishme të Krishtit duke kalëruar mbi një kali të bardhë. Ai ishte i veshur me një rrobë të ngjyer në gjak, dhe një shpatë e mprehtë dilte nga goja e Tij. Dhe mbi rrobën e vet dhe mbi kofshën ishte shkruar një emër: Mbreti i Mbretërve dhe Zoti i Zotëve! (shiko Zbu.19:11-16). Ç'pamje madhështore e Krishtit, sundimtarit tonë, dhe një përkujtues për ne që ne asnjëherë nuk mund ta humbasim betejën me një kryekomandant të tillë.



Shikoni vargjet në vijim. Si ju ndihmon secili nga këto vargje teksa mendoni rreth sulmeve të satanit?

- Gjoni 16:33
- Romakëve 8:37
- 1Korintasve 10:13
- 1Gjoni 4:4
- 1Gjoni 5:4-5

Kur jemi të tunduar që të heqim dorë, ne kemi nevojë t'i kujtojmë vetës faktin që ne i takojmë Perëndisë dhe se Ai është shumë më i fortë se sa satani. Pali thotë, “Nëse Perëndia është me ne, kush mund të jetë kundër nesh?” (Rom.8:31). Pali vazhdon duke përmendur një listë të gjërave që ne mund t'i ballafaqojmë në jetë. Tek

Kur jemi të tunduar që të heqim dorë, ne kemi nevojë t'i kujtojmë vetës faktin që ne i takojmë Perëndisë dhe se Ai është shumë më i fortë se sa satani.

Romakëve 8:35 Pali pyet, “Kush do të na ndajë nga dashuria e Krishtit?” Përgjigjja vjen menjëherë: askush, asgjë – as fatkeqësitë natyrore as ato fizike; as vdekja as jeta; as engjëjt as fuqitë e tjera; as gjërat e tashme as gjërat e ardhshme; bile, as edhe ne vetë nuk mund ta ndajmë vetën nga dashuria e Krishtit. Asnjëri dhe askush nuk mund ta ndajmë vetën nga dashuria e Krishtit (Parafrazim i Rom. 8:35-39).

Satani nuk mund të na shkatërrojë kur ne qëndrojmë të fortë në Zotin, të bindur për dashurinë e Tij ndaj nesh dhe duke përdorur armët e luftës që Ai ka siguruar për ne. Satani mund të na tundojë, ai mund të na godas nëpërmjet persekutimit apo sëmundjes, mirëpo Krishti do të na mundësojë që të qëndrojmë. Ne i takojmë skuadrës fitimtare, dhe çfarëdo që Satani mund të bëjë, nuk mund ta ndryshojë këtë fakt.

Teksa po afrohej fundi i Luftës së Dytë Botërore, pasi që gjermanët ishin mundur në Betejën Bulge në janar të vitit 1945, ishte e qartë se Gjermania kishte humbur. Shumë beteja të tjera u bënë pastaj dhe shumë vdiqën para se të ndodhte çlirimi përfundimtar. Por rezultati përfundimtar sigurisht ishte i ditur. Ne jemi në një pozitë të njëjtë. Rezultati i luftës në të cilën ne jemi të përfshirë nuk vihet aspak në dyshim. Ne jemi të sigurt se si do të përfundojë. Një ndër himnet më të fuqishme të Martin Luterit flet për sigurinë e këtij përfundimi në luftë me satanin: “një fjalë e vogël do ta rrëzojë atë.”

Fuqia e armikut mbi tokë dhe banorët e saj një ditë do të përfundojnë përgjithnjë. Përfundimisht, vula e satanit do të mbyllet. Pas luftës së fundit në mes të ndjekësve të Krishtit dhe atyre të satanit, ky i fundit së bashku me ndjekësit e tij do të hidhen në liqenin e zjarrit (Zbu.19:19-20; 20:7-15).



Pushoni për një çast dhe vlerësoni besimin tuaj në Krishtin si sundimtar. Në cilat fusha goditeni më së shpeshti nga satani? Në ç'mënyrë jeni kthyer tek Krishti për ta mundur armikun? Si të kanë ndihmuar shokët tuaj besimtarë? Si mund ta forcosh veten ndaj sulmeve të satanit në të ardhmen?



Tani ndaluni dhe falënderojeni Perëndinë për fuqinë pushtuese të Krishtit si dhe për faktin që fitorja është e sigurt në Të. Kërko nga Krishti që të të forcojë dhe të të ndihmojë në betejën kundër mëkatit dhe Satanit.

Përballja me armikun e fundit

Armiku i madh dhe i fundit, i cili do të shkatërrohet është vdekja (1Kor.15:22-26). Përderisa disa mund të mendojnë që vdekja është pjesë e natyrshme e jetës, Bibla qartë na mëson se vdekja është një armik, që ka ardhur si rezultat i panatyrshëm i mëkatit, si karta më e madhe që satani mban në duart e tij. Kur konfrontohemi me vdekjen, gjithçka brenda neve thërret “Jo!” Hebrejve 2:14-15 thotë se të çlironte të gjithë ata që nga frika e vdekjes i ishin nënshtruar robërisë për tërë jetën, Biri i Perëndisë u bë një krijesë e vdekshme njerëzore. Krishti u bë si njerëzit në mënyrë “që të shkatërronte, me anë të vdekjes, atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin, edhe të çlironte të gjithë ata që nga frika e vdekjes i ishin nënshtruar robërisë për tërë jetën.”

Të gjithë besimtarët do të përballemi me luginën e hijes së vdekjes, mirëpo ne asnjë herë nuk do të ecim vetëm. Vetë Krishti u përball me këtë armik të madh dhe e mundi atë, kështu që ne asnjëherë nuk kemi nevojë të mbahemi robër nga frika e vdekjes. Ne mund ta mundim vdekjen tani duke refuzuar që frika e vdekjes të mbulojë dhe duke u fokusuar në fuqinë e ringjalljes së Krishtit. Pa marrë parasysh se sa kohë na ka dhënë Perëndia, ne mund të përdorim secilën ditë që të jetojmë për mbretërinë e Perëndisë.



Lexoni 1Korintasve 15:51-58 dhe Zbulesa 20:14. Si të ndihmojnë këto vargje për mendimin tënd?

Pali ishte një shembull i mrekullueshëm i njeriut që kishte mundur frikën e tij rreth vdekjes.



Lexoni Filipianëve 1:21-25. Përshkruaj qëndrimin e Palit drejt vdekjes.

Fjalët e Palit kanë inkurajuar miliona besimtarë përgjatë shekujve. Frika e vdekjes nuk duhet të na mbajë më peng, për shkak se ne e dimë që vdekja nuk është asgjë pos pengesa e fundit, të cilën ne duhet ta kalojmë. Psalmisti na ngushëllon me këto fjalë: “Është e çmueshme në sytë e Zotit vdekja e të shenjtëve të tij” (Ps.116:15). Krishti do të jetë me ne teksa ecim në luginën e hijes së vdekjes, dhe kur t’i mbyllim sytë nga kjo jetë, gjëja e parë që do të shohim do të jetë fytyra e Tij. Vdekja nuk është fundi për

besimtarin, mirëpo fillimi i jetës së lavdishme, me anë të së cilës ne kthehemi në bashkësi të përsosur me Perëndinë dhe njëri-tjetrin.

Në muajt para se Mateu të shkonte në shtëpi për të qenë me Zotin, shumë pacientë, infermiere, doktorë, dhe personel të spitalit ishin mahnitur nga shpirti i tij falënderues dhe i hirshëm dhe dëshira e tij ndaj vullnetit të Perëndisë. Gjatë funeralit të tij, një shok tha, “Mateu nuk na mësoi vetëm si të jetojmë, por edhe se si të vdesim.”



Si mund të na mbajë frika ndaj vdekjes në skllavëri? Çfarë mendime të vijnë rreth mundësisë se mund të vdesësh? Si të inkurajon kjo pjesë e mësimit?



1. Si i përdor burimet e Fjalës së Perëndisë, lutjes dhe inkurajimin e besimtarëve të tjerë që t’i ndihmosh vetës për t’i ngjarë më shumë Krishtit?
2. Teksa vazhdon garën, si ndikojnë në ty këto të vërteta rreth të ardhmes sonë të sigurt dhe fitores tashmë të fituar nga Krishti?
3. Çfarë ndryshime duhet të bësh në mënyrë që t’i përdorësh këto burime për të përforcuar jetën tuaj të krishterë?

Duke vrapuar me qëndrueshmëri

Siguria që Krishti do të mund Satanin dhe do të shkatërrojë vdekjen, na jep shpresë dhe guxim për të vazhduar garën e vrapimit. Për kundër kësaj mund të jetë e lehtë që sa herë të fillojnë vështirësitë, të ndihemi të rraskapitur, të na lëshojë zemra dhe të ndihemi të lodhur nga të vrapuarit. Në këtë pjesë të mësimit ne do të shqyrtojmë faktorët që na inkurajojnë të vrapojmë me qëndrueshmëri.

Çmimi i parajsës

Si besimtarë gjatë jetës sonë, Perëndia është duke na përgatitur për parajsën, duke na dhënë formë, ashtu si poçari i jep formë një copë argjile, në mënyrë që ajo të bëhet një enë që mund të përdoret për lavdinë e Tij. Një ditë ky proces do të përfundojë, dhe ne do të futemi në portat e parajsës. Mbajtja e syve të fokusuar drejt qëllimi përfundimtar na ndihmon që të ecim përpara me vendosmëri të ripërtëritë.

Pali e përshkruan mallin e tij për parajsën tek 2 Korintasve 5:1-8 dhe arrin në përfundim se ai më parë do parapëlqente që të lërë trupin e tij në mënyrë që të jetë me Zotin. Mendimi për të qenë në praninë e Krishtit, ishte një faktor i fuqishëm në të menduarit e tij. A të sfidon mendimi rreth idesë për të qenë me Krishtin në parajsë? Kur shikuar jetët e burrave dhe grave të besimit tek Hebrenjve 11 (Mësimi 6), ne pamë

që sytë e tyre ishin të fiksuar në qytetin e përjetshëm. Njerëzit e perëndishëm i kanë sytë e fiksuar drejt parajsës.



Lexo pasazhet në vijim dhe bëjë një përmbledhje rreth porosisë së secilit pasazh rreth parajsës:

- Psalmi 16:11
- Gjoni 14:1-4
- 1Pjetri 1:4
- Zbulesa 7:16-17
- Zbulesa 21:1-5

Nuk ka fjalë të duhura për ta përshkruar parajsën. Teksa është një vend real, parajsa vazhdon të ngelet një vend i huaj ndaj çdo gjëje që kemi përjetuar këtu në tokë. Misteri që rrethon atë, është caktuar që të ngelet një mister. Ata që kanë pasur privilegjin të kenë një vizion të parajsës, nuk kanë pasur fjalë të duhura për ta përshkruar atë.

Apostulli Gjon pati një vizion për qiellin e ri dhe tokën e re (Zbu.21:9-27). Ai pa qytetin e shenjtë, Jerusalemin, duke zbritur nga qielli. Ai e përshkruan atë në formë katërkëndëshe, i cili ishte dymbëdhjetë mijë stade, me mure që ishin prej njëqind e dyzet e katër kubit, rrugët ishin të shtruara me ar të kulluar dhe portat ishin të gdhendura me margaritarë të mëdhenj. **Ky imazh apo këto simbole që Perëndia na jep në Bibël, përfaqësojnë një realitet që i tejkalon përmasat e fjalëve.** Trashësia e mureve flet për sigurinë, ndërkaq përshkrimi i arit dhe gurëve të çmuar flasin për bukurinë e pathënë, të cilat ne do t'i shijojmë përgjithmonë.

Kur mendojmë rreth vendit më të shenjtë, dhoma më e thellë e tabernakullit të Dhiatës së Vjetër dhe tempullit ku Perëndia banoi me popullin e Tij, ka qenë gjithashtu një katërkëndësh i përsosur, mund të jetë që ky vizion i ri i Jerusalemit si katërkëndësh flet rreth realitetit që e tërë parajsa është në fakt tempulli i Tij i shenjtë. Ashtu siç prania e Perëndisë e mbushte vendin më të shenjtë, po kështu ajo do të mbush Qytetin e Tij të Shenjtë. **Ne do të shijojmë praninë e Perëndisë përgjithmonë!**

Në parajsë ne do të përjetojmë përmbushjen e plotë. Nevojat tona më të thella do të plotësohen. Nuk do të ketë më pikëllim, as vaj, as dhimbje, as vetmi, as vdekje. Perëndia do të fshij çdo lot, dhe asnjë nuk do të bie sërish në mëkat. Gjoni e përshkruan parajsën si një vend ku më nuk do të kemi nevojë për diellin apo hënën, sepse Krishti Vetë është drita (Zbu.21:23).

Trupat tanë qiellor do të jenë të pavdekshëm, aq të lavdishëm sa ne as nuk mund t'i imagjinojmë (1Kor.15:42-44). Ne do t'i ngjajmë Jezusit, d.m.th karakteri ynë do jetë i çliruar nga mëkati dhe plotësisht i pastër (1Kor.15:49). Ne do të jemi të lirë nga dëshira për të mëkatuar, për t'i lënduar të tjerët, për të kërkuar hakmarrje apo për të shkaktuar dhimbje.

Joni Eareckson Tada, e cila ka qenë në karrocë invalidësh për më shumë se tridhjetë e pesë vjet pasi kishte pësuar një aksident gjatë notit, përshkruan mallin e saj për parajsën, ku ajo imagjinoi veten duke i përdorur krahët e saj të paralizuar për një kohë të gjatë dhe këmbët e saj duke vrapuar, duke kërcyer dhe duke notuar. Madje ajo shkruan edhe për një mall tjetër akoma më të madh: ajo mezi pret për ditën kur më nuk do t'ia lëndoje zemrën Atit të saj duke mëkatuar. “Pjesa më e mirë e parajsës do të jetë një zemër plotësisht e pastruar.”⁴

“Pjesa më e mirë e parajsës do të jetë një zemër plotësisht e pastruar.”

A besojmë me të vërtetë në realitetin e parajsës? A na motivon mendimi rreth realitetit të parajsës? Dikush ka thënë, nëse me të vërtetë besojmë në parajsë, ne do të kalonim më shumë kohë duke përgatitur vetën për banim të përhershëm atje.



Si të motivon mendimi rreth realitetit të parajsës? Si po e përgatit vetën për një banim të përhershëm atje?



Tani merr kohë dhe falënderoj Perëndinë për të ardhmen e lavdishme që të pret në parajsë dhe kërko nga Ai që të ngjallë në ty dëshirën për t'u bërë gati për të jetuar atje.

Shpërblimi për shërbimin me besnikëri

Bibla e bënë të qartë se shërbimi ynë me besnikëri për Zotin një ditë do të shpërblehet.



Lexoni 2Korintasve 5:6-10. Çfarë na mëson ky pasazh rreth gjykimit të besimtarëve? Vini re kontekstin e këtij pasazhi.

Të gjitha veprat e besimtarëve do të gjykohen. Edhe pse shpëtimi ynë është i sigurt, çdo vepër do të provohet me anë të zjarrit për të parë nëse me të vërtetë ka qenë një vepër e besimit. (1Kor.3:15). Natyra e vërtetë e shpërblimit me besnikëri është debatuar. Dhiata e Re flet për kurorat që të drejtët do të marrin dhe për shërbëtorët, të cilët do të shpërblehen duke u dhënë role të autoritetit në qiellin e ri dhe tokën e re (Lk.19:15-17; Jak.1:12; 2Tim.2:12).

Është më se ngazëlluese të mendosh rreth të vërtetës se një ditë do të qëndrojmë para Vetë Krishtit në vendin e gjykimit. Kur të shohim fytyrën e Tij, fytyrën e Atij që flijoi vetë jetën e Tij dhe i cili u bë mëkat për ne, asgjë nuk do të na sjell më shumë kënaqësi se sa kur do të dëgjojmë Atë duke thënë, “Të lumtë shërbëtor i mirë dhe besnik” (Mat.25:19-21). Mbase do të përjetojmë brejtje të ndërgjegjes të turpit të thellë

për motivet tona vetjake dhe rastet e humbura për t'i shërbyer Atij më shumë. **Çfarëdo shpërblime që të marrim, ato me siguri se do të zbehen në praninë e Vetë Krishtit.** Gëzimi ynë më i madh në parajsë do jetë prania e Krishtit aty dhe fakti që ne do të jetojmë me të përfundimisht.

Zbulesa 4:1-11 përshkruan një skenë të parajsës, përpara fronit të një deti të qelqtë, ku Perëndia rri i ulur në fronin e Tij, i rrethuar nga një ylber smeraldi, dhe përshkruhet nën reflektimin e shkëlqyer të gurëve të çmuar. Ata që i shërbejnë Atij i ulin kurorat e tyre pranë këmbëve të Tij dhe adhurojnë Atë.



Kaloni pak kohë duke e adhuruar Perëndinë, duke e lavdëruar për lavdinë e Tij dhe për fuqinë e Tij. Përkuluni përpara Tij, kërkon nga Ai që t'ju bëjë shërbëtorë të përlurë përgjatë tërë jetës dhe që t'ju ndihmojë që ta nderoni Atë në gjithçka që bëni.




Teksa meditonit rreth qëndrimit në praninë e Birit të Perëndisë në ulësen e gjykimit të Krishtit, çfarë të vije në mendje? Çfarë vendime duhet të marrësh në lidhje me mënyrën e jetesës? Shqyrto motivet e sipërme për të jetuar jetën e krishterë. Pastaj merr në konsideratë ecjen tënde me Krishtin dhe vë re se si secili nga këto motive ndikon në dëshirën tuaj për të qëndruar *besnik*.

Duke arritur vijën e fundit të garës (finishin)

Gara qëndron përpara nesh, rruga shtrihet para këmbëve tona. Kodrat dhe luginat janë të zhytura në hije, akoma të padukshme për sytë tanë. Çdo mëngjes kur zgjohemi, na pret segmenti tjetër i garës.

Tek Filipianëve 3:12-14, Pali përshkruan vetën këmbëngulës drejt synimit. Mbase ai e ka në mendje imazhin e një vrapuesi, i cili është duke u sforcuar fort, duke përdorur çdo muskul, duke u fokusuar me një mendje të vetme drejt synimit të tij. Ai shkruan se dëshira e tij ishte që të rendte për ta zënë atë për çfarë edhe Jezus Krishti e kishte zënë atë. Qëllimi i Krishtit kur na zuri neve ishte të na shpëtojë nga mëkati, të na pastrojë dhe të na bëjë një popull të shenjtë, të cilët i takojnë Atij dhe të cilët i sjellin lavdi Atij (Titi 2:14). Po kështu Pali ngulmonte me shpresën e çlirimit të tij përfundimtar dhe të plotë nga mëkati dhe i ngjasimit me Krishtin.



Pali gjithashtu po rendte për të fituar çmimin për të cilin Perëndia e kishte thirrur drejt qiellit në Jezus Krishtin. Çfarë është çmimi? Është lavdia që do t'i takoj atij kur Krishti do ta transformojë trupin e tij tokësor për t'i ngjarë trupit të Krishtit, i cili është i pavdekshëm dhe i pakorruptueshëm.

Pak para vdekjes së tij, Pali po shkruante nga burgu, teksa po priste ekzekutimin e tij. Ai ishte vetëm me Lukën. Ai shprehi mallin e tij për ta parë Timoteun edhe një herë dhe i dha dishepullit të tij edhe një detyrë të fundit: të durojë vuajtjet për Krishtin dhe të përmbush shërbesën e tij (2Tim.4:5). Në esencë ai po inkurajonte Timoteun që të vraponte garën dhe të përdorte dhuntitë që Perëndia i kishte dhënë atij për t'ju shërbyer të tjerëve. Pali i kujtoi atij se gara mund të përfundohet me ngulmim.

Pastaj Pali shkroi tek 2 Timoteu 4:7-8, “Luftën e mirë e luftova, e përfundova vrapimin, e ruajta besimin. Pas kësaj më pret gati kurora e drejtësisë që Perëndia, gjykatësi i drejtë, do të ma japë atë ditë, dhe jo vetëm mua, por edhe gjithë atyre që presin me dashuri të shfaqurit e tij.”

Pali duket të ketë pasur një ndjesi që fundi i jetës së tij po afrohej. Ai reflekton mbi pikën kulmore të një jete të mbushur me bekimin e njohjes, dashurisë dhe shërbimit ndaj Zotit Jezus me besnikëri. Deklaratat e tij kumbojnë nga kënaqësia sepse ai ishte besnik deri në fund duke i shërbyer Mjeshtrit të tij të dashur. Ai mezi priste me siguri të plotë për çastin kur do të shihte ballë për ballë Shpëtimtarin e Tij.

Pali ishte plot besim dhe në paqe para vdekjes për dy arsye. E para, ai e dinte që vdekja nuk ishte asgjë pos një derë për në praninë e Perëndisë së gjallë. E dyta, ai kishte kaluar jetën e tij duke i shërbyer Perëndisë me besnikëri, gjë që eliminonte çfarëdo ndjesie të keqardhjes për një jetë të çuar kot. Pikëpamja e tij për vdekjen kishte ndikuar jetën e tij, dhe si rrjedhojë mënyra se si kishte jetuar jetën e tij, kishte përforcuar qasjen e tij pozitive ndaj vdekjes.

Kur ne përballemi me vdekjen, a do të jemi të kënaqur me jetët tona ashtu sikurse ishte Pali me jetën e tij? A do të jemi në gjendje që të kthejmë kokën mbrapa edhe të themi, “Luftën e mirë e luftova, e përfundova vrapimin, e ruajta besimin”? A i kemi mbajtur sytë tanë drejt Krishtit? A kemi lënë anash çdo barrë dhe pengesë për të vrapuar garën me dëshirën dhe vendosmërinë për ta përfunduar atë me sukses? A e presim me padurim çmimin e parajsës dhe shikimin në fytyrën e Shpëtimtarit tonë kur Ai të na takojë neve? Çdo ditë e re na ofron një mundësi që të kompletojmë segmentin e radhës së shtegut, i cili është shtruar përpara nesh. U motivofshim nga dëshira për ta njohur Krishtin më thellë dhe për t'i shërbyer Atij më me besnikëri teksa vrapojmë gjatë tërë shtegut e deri te linja e fundit e finishit.

Përmbledhje e kursit

1. Ky kurs është dizajnuar që të na ndihmojë të rritemi drejt pjekurisë në Krishtin. Ne kemi studiuar një numër të larmishëm të aspekteve të jetës së krishterë, si dhe kemi parë karakterin, disiplinën, qëndrimet dhe zakonet që Perëndia dëshiron t'i zhvillojë në ne. Lexoni si më poshtë një përmbledhje të jetës së krishterë:
2. Ne fillojmë jetën e krishterë duke besuar në Jezus Krishtin si Birin e Perëndisë dhe Shpëtimtarin tonë, duke iu përgjigjur hirit të Perëndisë me anë të besimit, dhe ne vazhdojmë të jetojmë jetën e krishterë me anë të besimit, duke i besuar Perëndisë për çdo ditë. Perëndia nuk dëshiron vetëm të na shpëtojë neve, por Ai gjithashtu dëshiron të na bëjë të shenjtë.
3. Qëllimi i jetës së krishterë është që ne t'i përshtatemi imazhit të Krishtit, që t'i ngjasojmë sa më shumë Atij, teksa rritemi drejt pjekurisë në besimin tonë. Perëndia dëshiron që ne t'i ofrojmë Atij tërë jetën tonë, që të përdoremi si instrumente të drejtësisë.
4. Perëndia na ka dhënë Frymën e Shenjtë që të na drejtojë, mësojë dhe bind për mëkat. Ne gjithashtu kemi një zemër të re, e cila kënaqet në gjërat e Perëndisë dhe një identitet të ri si fëmijë të Perëndisë. Neve na janë dhënë burime të nevojshme për të jetuar jetën e krishterë.
5. Rritja jonë shpirtërore varet në marrje të vazhdueshme nga Fjala e Perëndisë dhe zbatim të vazhdueshëm të Fjalës.
6. Është thelbësore një jetë e lutjes që është aktive dhe e gjallë për të pasur një bashkësi me Perëndinë si dhe për rritjen tonë shpirtërore. Me anë të sakrificës së Vetë Jezus Krishtit na është mundësuar qasja tek Perëndia.
6. Jeta e krishterë është një jetë e jetuar me besim, teksa besojmë dhe mbështetemi tek personi i Perëndisë dhe Fjala e Tij për çdo ditë.
7. Perëndia dëshiron që të na drejtojë dhe të na tregojë shtigjet e Tij; ne duhet të përkushtohemi për ta njohur Atë dhe për t'ju bindur vullnetit të Tij ashtu siç është zbuluar në Fjalën e Tij dhe me anë të Frymës së Shenjtë. Ai gjithashtu na drejton në këshillime të urta, rrethana dhe dëshira të zemrës sonë.
8. E tërë jeta e një besimtari është një kujdestari që na është dhënë nga Perëndia. Ne duhet të jemi administratorë të mirë të burimeve që Perëndia na ka dhënë – koha jonë, talentet, burimet materiale, dhuntitë dhe aftësitë, përvojat e jetës, dhe vendin ku Perëndia na ka vendosur. Ai dëshiron që ne të jemi besnik dhe llogaridhënës për mënyrën se si ne i përdorim këto burime.
9. Kur reagojmë ndaj vuajtjes me pranueshmëri dhe i kërkojmë Perëndisë që ta përdorë atë për t'i sjell lavdi Vetës, ne jemi duke u konfirmuar në imazhin e Krishtit, i cili gjithashtu vuajti, dhe kështu ne reflektojmë lavdinë e Tij tek të tjerët.

10. Ne duhet të përkushtohemi ndaj një trupi të besimtarëve vendorë dhe të marrim pjesë në ndërtimin e anëtarëve të tjerë të trupit të Krishtit, ashtu siç edhe ndërrohem prej tyre. Së bashku ne arrijmë një botë që nuk beson dhe u shërbejmë nevojave të komunitetit të krishterë.

11. Jeta e krishterë është një jetë e shërbesës ndaj Perëndisë dhe të tjerëve. Ne jemi të thirrur që të jemi shërbëtorë për të gjithë, dhe motivi i shërbesës sonë është dashuria jonë ndaj Perëndisë. Secili besimtar është i thirrur që të shërbejë në mënyrë që trupi i Krishtit të mund të ndërtohet dhe ungjilli të shpallet.

12. Qëllimi ynë duhet të jetë përfundimi i garës së jetës së krishterë, duke lënë anash çdo mëkat apo qëllime vetjake, të cilat mund të na sprapsin, duke përdorur burimet që Perëndia na ka dhënë për të luftuar kundër satanit dhe mëkatit, teksa vazhdojmë drejt vijës së fundit për në qiell, ku na pret Krishti.

Keni bërë një rrugë të gjatë përgjatë këtij kursi. Keni bërë mjaftë punë, dhe tani duhet të keni një ndjenjë të kënaqësisë për atë që keni arritur. Kompletimi i një kursi na jep një ndjenjë të kënaqësisë, mirëpo testi i vërtetë i mësimit do të shikohet në praktikë. A do të transformohet jeta juaj me anë të së vërtetave që ti ke mësuar? Në kemi mësuar shumë rreth shpëtimit të lavdishëm që na është dhënë me anë të Krishtit, rreth burimeve që Perëndia na ka dhënë që t'i shërbejmë me besnikëri, dhe rreth të ardhmes triumfale që na pret. Rruga shtrihet para nesh. Problemet dhe gëzimet e jetës së përditshme na përkujtojnë që të aplikojmë atë që kemi mësuar dhe me të vërtetë të jetojmë me këtë mësim, duke shikuar Perëndinë dhe duke u mbështetur në Të për fuqi dhe urtësi. Me anë të hirit të Perëndisë jetofshim jetët tona në atë mënyrë që do arrijmë t'i sjellim Atij shumë lavd dhe lavdërim!

ENDNOTES

¹ C. S. Lewis, *The Screwtape Letters*, rev. ed. (New York: Macmillan, 1982), 3.

² Shiko: John White, *The Fight: A Practical Handbook for Christian Living* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1976), 94.

³ Shiko White, 216.

⁴ Joni Eareckson Tada, *Heaven: Your Real Home* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1995), 40

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

27-31

Duke ecur me Krishtin : të vërteta transformuese për
jetën e krishterë / Grup autorësh ; përktheu Blerina Jashari. –
Prishtinë : Tenda, 2016. – 293 f. ; 20 cm. – (Biblioteka Doktrinë
Seria ; 34)

Titulli në origjinalit : Walking with Christ. –Parathënie /
Femi Cakolli : f. 7

1.Jashari, Blerina

ISBN 978-9951-405-62-1